

949.65.

M 98



ISA
BOLETINI

FATMIRA MUSAJ

949.65
M 98

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISE
INSTITUTI I HISTORISE

FATMIRA MUSAJ

ISA BOLETINI

(1864-1916)



TIRANË, 1987

PARATHËNIE

Isa Boletini u formua si figurë e shquar e kombit tonë në periudhën e fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Pra, në një kohë, kur lëvizja e armatosur e masave popullore ishte ngritur në një shkallë cilësisht të re, kur nga kryengritjet e veçuara, spontane e të pa bashkërenduara ishte kaluar në kryengritjet e mëdha, të cilat me forcën dhe gjerësinë e tyre do të trondisnin themelet e sundimit osman në Shqipëri. Në këto rrethana revolucionare u brumos me idealet e larta atdhetare dhe zhvilloi veprimtarinë Isa Boletini. Veprimtaria e Isa Boletinit nuk mund të kuptohet në tërë rëndësinë dhe plotësinë e vet pa pasur parasysh këto rrethana si dhe faktin që ai jetoi e luftoi në Kosovë, që ishte në këtë periudhë një nga vatrat më të nxehta të luftës së popullit tonë për liri e pavarësi. E lidhur pazgjidhmërisht me luftën e popullit të kësaj treve shqiptare, vepra atdhetare e Isa Boletinit është një shembull i shkëlqyer i përpjekjeve dhe i luftës së parreshtur të popullit tonë. Në betejat e shumta që zhvilloi përkrah shokëve të tij, në punën e madhe që bëri për të mirën e atdheut të robëruar, Isa Boletini fitoi dhe cilësitë e vyera si luftëtar i zot, organizator dhe udhëheqës ushtarak popullor.

Si organizator, Isa Boletini u shqua në punën e vë-

shtirë që iu desh të bënte për të bashkuar lëvizjet e armatosura të krahinave të ndryshme në një lëvizje të vetme, për ta nxjerrë atë nga kufijtë e Kosovës e Shqipërisë Veriore e për t'i dhënë asaj karakter mbarëshqiptar. Ai i ra tej e mbanë Kosovës e krahinave të tjera duke mos lënë mbedhje a kuvend pa marrë pjesë e pa dhënë kontributin në përgatitjen e tyre. Ndimesa e tij e çmuar u ndie mjaft edhe në masivizimin e kryengritjeve të mëdha. Autoriteti i tij i madh, fjalla e tij e zjarrtë ngrinte peshë zemrat e djalërisë shqiptare të masave të gjera malësore, të cilët e ndiqnin atë në luftë me besim të madh.

Si udhëheqës ushtarak popullor Isai u dallua në drejtimin e kryengritësve në betejat më të mëdha, si në atë të Grykës së Carralevës etj. Kudo që luftoi vu-ri në zbatim artin e luftës popullore. Ai përdori me mjeshtëri dhe diti të gërshetojë si duhet strategjinë me taktikën luftarake të zhdërvjellët dhe aktive.

Njohja e mirë e terrenit dhe aftësitë ushtarake i dhënë atij mundësinë të sulmonte me efekt. Madje edhe kur mbrohej ai e bënte këtë duke organizuar sulme të befasishme, të shpejta e të fuqishme. Ndjekja me mprehtësi e veprimeve armike si dhe vlerësimi i shpejtë dhe i përpiktë i rrethanave e bënë atë mjeshtër të çarjes së rrethimeve.

Krahas kontributit në organizimin dhe udhëheqjen e luftës së armatosur për të siguruar autonominë dhe pavarësinë e vendit, Isai u përpoq njëherazi edhe për mbrojtjen e sigurimin e tërësisë territoriale të vendit, që përbënte në këtë kohë një detyrë tjetër po aq të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Lufta e armatosur e masave popullore nuk u zhvillua në një vijë të drejtë. Ajo u shoqërua me sulme dhe tërheqje, me fitore dhe disfata. Ashtu siç nuk dehej nga fitoret, Isai asnjëherë nuk u përkul edhe para tërheqjeve dhe disfatave. I mbështetur nga populli i vet, i bindur në drejtësinë e çështjes për të cilën luftonte ai nuk e humbi shpresën dhe besimin në fitore. Përkundrazi

mësimet e nxjerra prej këtyre disfatave ishin një përvojë që sado e hidhur ai e vinte në shërbim të ngritjes së mëtejshme të lëvizjes së armatosur kundërosmane.

Si të gjithë udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare Isai tërhoqi admirimin jo vetëm të bashkëluftëtarëve e të prijësve popullorë, por edhe të ideologëve të shquar të Lëvizjes Kombëtare si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina e të tjerë, të cilët gjetën te Isa Boletini një përkrahës të zjarrtë e të vendosur për realizimin në praktikë të programit politik kombëtar. Ndërsa armiqtë e kombit tonë, ashtu siç mund të pritej, nuk lanë rast pa shprehur urrejtjen e tyre ndaj veprimtarisë së tij atdhetare. Kështu shpjegohen ato tendenca për ta errësuar e shtrembëruar realitetin historik dhe figurën e Isa Boletinit që ndeshen në ndonjë dokument të kohës e sidomos në literaturën historike të vjetër e të sotme, serbe e jugosllave. Disa nga diplomatët e «studuesit», të nisur nga koncepte shoviniste e paraqitnin atë si «rebel», «reaksionar», ndërsa lëvizjen antiosmane të udhëhequr prej tij si «rebele» dhe «reaksionare». Në organet e shtypit serb e rus të kohës cilësohej si «armik» i pakicave serbe që jetonin në trojet shqiptare, si «agjent» i Austro-Hungarisë etj.¹ Të tilla vlerësime nuk i qëndrojnë së vërtetës historike. Ato bëheshin me qëllim që të nxisnin te popullsia serbe ndjenjën e armiqësisë e të urrejtjes ndaj popullsisë shqiptare, për të ulur figurën dhe rolin e madh të Isa Boletinit në zhvillimin, zgjerimin e forcimin e luftës së armatosur për pavarësi si dhe për të denigruar Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.

Për të njëjtat qëllime ato rimerren përsëri nga historiografia e sotme jugosllave. Kështu në artikullin «Udhëheqësi shqiptar Isa Boletini dhe Mali i Zi 1910-1912»² historiani jugosllav Bogumil Hrabak mundohet të mohojë përpjekjet e Isa Boletinit për bashkëpunimin

1) Këto çështje janë trajtuar dhe kanë marrë përgjigje gjatë punimit në pjesët përkatëse.

2) B. Hrabak: Arbanski prvak Isa Boletini i Cerna Gora 1910-1912. Titograd. 1977.

me vendet fqinjë kundër sunduesit osman, gjatë kryengritjes së vitit 1911, madje ai merr hapur në mbrojtje politikën shoviniste të qeverisë malazeze për ta përdorur kryengritjen e 1911-ës si vegël për përmbushjen e planeve të saj antishqiptare. Edhe në punimin tjetër «Kryengritja shqiptare e vitit 1912»¹ ky autor i mbështetur mbi fakte tepër të kufizuara dhe duke i interpretuar ato në mënyrë të njëanshme, bën pohime tendencioze rreth figurës së Isa Boletinit. B. Hrabak shtrembëron me dashje edhe karakterin e bashkëpunimit të Isait me pakicat serbe, duke theksuar se gjoja ai i keqtrajtonte dhe madje i kërcënonte serbët që të ngriheshin në kryengritje bashkë me shqiptarët. Gjithashtu ai minimizon rolin e Isa Boletinit në organizimin e kryengritjes së 1912-ës. Përpos këtyre Hrabaku dhe disa autorë turq si J.H. Bajur dhe S. Külçe, të cilët e cekin shkara-zi veprimtarinë e Isa Boletinit në revolucionin xhonturk, e paraqesin atë si përkrahës të politikës së Sulltan Hamitit II.

••• Duke qenë njëri nga udhëheqësit kryesorë të Kosovës, të asaj treve aq të lakmuar nga borgjezia serbomadhe, Isai u vu në shënjestër të diplomacisë serbe. Ç'mjete e forma nuk u përdorën për ta vënë atë në shërbim të politikës së tyre. Mbasi dështuan në përpjekjet për ta tërhequr në Serbi, ata nën maskën e bashkëpunimit dhe të ndihmës për kryengritjen e 1912-ës u orvatën ta vinin Isanë në shërbim të planeve të tyre antishqiptare.

Dokumentacioni i sjellë në këtë punim dëshmon se këto synime të borgjezisë serbomadhe nuk dhanë rezultate. Isai, nga ana e tij pa e nënvleftësuar për asnjë çast rrezikun serb, diti të shfrytëzojë me mençuri dhe urtësi afrimin e Beogradit për të nxjerrë përfitime për lëvizjen e armatosur kundërosmane. Ndërkaq ai nuk le-

1) B. Hrabak. Arbanashki ustanci 1912 godine, Vranje, 1975.

2) J.H. Bajur. Turk Inkilâbi tarihi CI. Kl. İkinci Baskı. Ankara, 1963. S. Külçe. Ferizovik Toplantısı ve mesrutiyet. Izmir, 1944.

joi asnjë ndërhyrje në punët e brendshme të kryengritjes shqiptare

Figura e Isa Boletinit u vlerësua qysh në shkrimet publicistike të kohës¹, si dhe në ato të disa autorëve të huaj që janë marrë me problemet e historisë së kohës së re².

Në historiografinë shqiptare të paraqirimit për shkak të qëndrimit përcmues të regjimit zogist ndaj traditave patriotike revolucionare të popullit tonë, nuk u botua qoftë edhe një artikull studimor mbi veprimtarinë e Isa Boletinit në shërbim të çështjes kombëtare. U mjaftua vetëm me artikuj përkujtimorë si dhe me botimin e kujtimeve të bashkëkohësve të tij. Në to përmendet kontributi i tij në kryengritjet antiosmane, afrimi me Serbinë në kryengritjen e 1912, por nuk bëhet asnjë argumentim historik i ngjarjeve dhe i veprës së tij³. Një mangësi e tillë vihet re edhe në kujtimet e Hasan Prishtinës për kryengritjen e vitit 1912⁴.

Vetëm në epokën e Partisë u bë e mundur të studiohet në mënyrë të organizuar e mbi baza me të vërtetë shkencore gjithë historia e popullit tonë.

Në kuadrin e studimit gjithnjë e më të thelluar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, të kësaj periudhe kaq vendimtare për fatet e kombit, filloi të ndriçohet edhe vepra e luftëtarit të madh kosovar, Isa Boletinit, duke iu dhënë vendi i merituar në historinë e vendit tonë. Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim u krye gjatë përgatitjes së tekstit të Historisë së Shqipërisë, e më

1) «La Nazione Albanese»: (Pallagoria, Catanzaro, 1902, 1910, 1911, 1912; gazeta «Dielli». Boston Mass, 1910, 1911, 1912, etj.; «L' Albanie». Lozanë, 1916 etj.

2) A. Herbert, *Ben kendim, a record of esaters travel*. London, 1924; J. Swire. *Albanie, The rise, of a kingdom*: London, 1929; F. Çakmak. *Si u humb Rumelia Perëndimore* (sipas përkthimit në Arkivin e Institutit të Historisë më tej: AIH): K. Oestreich, *Reisen Drücke, Aus-Dem Vilajet Kosovo*, Wien, 1899.

3) R. Ll, Siliqi: *Pasqyrë e ditëve të përgjakshme në të pestin shekull të Shqipërisë së robnueme*: Trieste, 1912.

4) H. Prishtina: *Një shkurtim kujtimesh për kryengritjen e vitit 1912*. Shkodër, 1921:

vonë të vëllimit të parë e të dytë të tij¹ ku u theksua roli i Isa Boletinit në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare për liri e pavarësi dhe ruajtjen e tërësisë tokësore të vendit në fund të shek. XIX e fillim të shek. XX.

Për studimin e veprimtarisë atdhetare të Isa Boletinit kanë një rëndësi të dorës së parë vlerësimet e çmueshme që shoku Enver Hoxha ka dhënë për epokën, në të cilën jetoi dhe veproi Isa Boletini, për personalitetet politiko-kulturore në përgjithësi dhe të Isa Boletinit në veçanti. Këto vlerësime kanë shërbyer si një bazë e shëndoshë metodologjike për një trajtim objektiv të rolit të Isa Boletinit në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, duke nxjerrë në pah jo vetëm meritat e tij të mëdha në fitoret e arritura, por edhe ndonjë kufizim i kushtëzuar ky nga niveli i zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit dhe nga koha kur veproi.

Shoku Enver i dha Isait një vend të nderuar, e vendosi atë në radhën e atyre shkëndijave «... që do ta ndiznin më të fuqishëm zjarrin e madh në zemrat e masave për liri, rilindësit tanë, mendimtarët dhe luftëtarët e mëdhenj... ata kanë pasur si objektiv lirinë e atdheut, pavarësinë e tij të plotë dhe të pacunguar nga ana territoriale»².

Duke vlerësuar kontributin që dha Isa Boletini në organizimin dhe masivizimin e kryengritjeve të mëdha kundërosmane shoku Enver e ka cilësuar atë si «shpirtin e këtyre kryengritjeve».³ Gjithashtu shoku Enver ka vënë në dukje edhe meritat e Isait, si udhëheqës ushtarak popullor duke nxjerrë në pah taktikën dhe strategjinë luftarake të përdorur prej tij⁴.

1) Historia e Shqipërisë. Vëll. II (botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës). Tiranë, 1965; vëll. II dhe III, botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH, Tiranë, 1984.

2) Enver Hoxha. Vepra, vëll. 24, f. 6-15.

3) Enver Hoxha. Raporte e fjalime (1972-1973). Tiranë, 1974. f. 195-196:

4) Enver Hoxha. Puna e Partisë në ushtri të përsoset vazhdimisht në librin: «Për Ushtrinë Popullore», vëll. II, Tiranë, 1984, f. 450.

Libri i parë biografik i zgjeruar për figurën e Isa Boletinit u shkrua nga S. Luarasi¹ (Tiranë, 1971). Në hartimin e këtij jetëshkrimi autori, ashtu sikurse thekson edhe vetë në parathënie, është mbështetur në përqijthësi në kujtimet e bashkëkohësve të heroit. Kjo ka bërë që të kalohet në ndonjë mbiverësim të figurës së Isa Boletinit. Megjithatë ky botim pati meritën se për herë të parë popullarizoi veprën atdhetare të Isa Boletinit.

Përvjetorët e lindjes ose të rënies së Isait janë përkujtuar në shtypin e përditshëm me një radhë artikujsh të cilët i kemi pasur parasysht gjatë punimit².

Veprimtaria e Isa Boletinit është trajtuar edhe në historiografinë e Krahinës Autonome të Kosovës të RSFJ, popullsia shqiptare e së cilës krenohet për këtë luftëtar dhe udhëheqës të shquar që iu kushtua luftës për liri e pavarësi. Figura e Isa Boletinit ka zënë vend në trajtesat historike të disa studiuesve kosovarë, si Z. Cana, P. Nushi, Sh. Rahimi, S. Rizaj³, etj. Të dhënat e këtyre trajtesave janë pasur parasysht dhe kanë shërbyer në hartimin e këtij punimi. Në veprën e tij «Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë në vitet 1908 — 1912», Z. Cana, midis të tjerave, ka siellë të dhëna me vlerë edhe për figurën e Isa Boletinit. Me interes për punimin tonë ka qenë analiza që i bëhet qëndrimit të Isa Boletinit në Kuvendin e Ferizajt, në Kuvendin e Verrave të Llukës,

1) S. Luarasi. *Isa Boletini*, Tiranë, 1971.

2) Gaz. «Zëri i popullit», 15 Janar 1968, 23 janar 1981; Gaz. «Zëri i popullit» 23 janar 1976.

3) Z. Cana. *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë në vitet 1908-1912*. Prishtinë, 1979. Kosta Novakoviç për Shqipërinë dhe invadimin nga Serbia: në «Përparimi», nr. 1, Prishtinë, 1977; «Misioni politik i Balluarxhiqit në Shqipëri në vitin 1913, në: «Përparimi», nr. 1: Prishtinë, 1979. Sh. Rahimi: *Vilajeti i Kosovës 1878-1912*. Prishtinë, 1968, Sh. Rahimi. *Kryenqaritet shqiptarë në Kosovë 1909-1912*, në, «Kosovo», nr. 1, Prishtinë 1972. S. Rizaj. *Roli i shqiptarëve në revolucionin xhonturk të vitit 1908 në «Kosovo»*, nr. 3 Prishtinë, 1974. P. Nushi. *Isa Boletini dhe roli i tij në luftën e popullit shqiptar për çlirim nacional*, në: «Përparimi», nr. 3: Prishtinë, 1979:

qëndresës së forcave kryengritëse të udhëhequra nga Isa Boletini në Grykën e Carravelës më 1910, gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake në kryengritjen e vitit 1912 etj. Po kështu të rëndësishme kanë qenë përgjithësimet e bëra nga P. Nushi në artikullin «Isa Boletini dhe roli i tij në luftën për çlirim nacional»; si edhe të dhënat faktike të sjella nga Sh. Rahimi për Isa Boletinin në studimin e tij «Kryengritjet antiosmane në Kosovë në vitet 1909-1912».

Probleme të ndryshme të Rilindjes Kombëtare janë trajtuar në një varg studimesh të tjera të historianëve tanë, të cilat, megjithëse nuk bëjnë objekt të drejtpërdrejtë figurën e Isa Boletinit, me analizat e përgjithësimet e tyre kanë sjellë një ndihmesë të madhe për trajtimin me objektivitet të figurës¹.

Një rëndësi të madhe për ndriçimin e veprimtarisë atdhetare të Isa Boletinit kanë dokumentet vendase të pabotuara që ruhen në Arkivin e Shtetit të RPSSH, si dhe ato të botuara në përmbledhje të posaçme².

Pjesa tjetër kryesore burimore e këtij punimi janë dokumentet e huaja arkivore të pabotuara e të botuara, sidomos fondet e ish-Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, në Vjenë, të ish-Ministrisë së Punëve

1) A. Buda: Rrënjët historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në: «Lidhja Shqiptare e Prizrenit». Tiranë, 1978, St: Pollo, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, në «Mbi lëvizjen Kombëtare Shqiptare». Tiranë, 1962. A. Puto. Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha në vitet 1912-1914. Tiranë, 1972. K. Prifti. Lidhja Shqiptare e Pejës, Tiranë, 1984; M. Çami. Shqipëria në planet e fuqive imperialiste të Antantës në fillim të Luftës së Parë Botërore (gusht 1914 prill 1915), në: «Buletini i shkencave shoqërore të Universitetit të Tiranës». Tiranë, 1961. Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare në vitet 1914-1918 (dorëshkrim) etj.; G. Shpuza. Kryengritja fshatare e Shqipërisë së Mesme në vitet 1914-1915. Tiranë 1986. Z. Prela. Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze 1891-1912, në: Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare» Tiranë, 1962, etj.

2) Ismail Qemali (Përmbledhje dokumentesh), përgatitur nga Teuta Hoxha, Tiranë, 1982; Qeveria e Vlorës dhe veprimtaria e saj, Tiranë, 1963.

të Jashtme të Francës, të Arkivit të Kosovës, të Romës, të Arkivit rus e atij historik bullgar, të grumbulluara në formë fotokopjesh në Institutin e Historisë. Nga botimet e huaja dokumentare janë shfrytëzuar dokumente diplomatike serbe, italiane¹ etj.

Dokumentet e konsullatave të huaja, dërguar minis-trive të jashtme të vendeve përkatëse, na japin të dhëna me interes për veprimtarinë politike, organizative dhe ushtarake të Isa Boletinit. Por si zëdhënese të politikës imperialiste e shoviniste të shteteve që përfaqësonin, në to ndeshim edhe shtrëmbërime e vlerësime të njëanshme e subjektiviste si për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, ashtu edhe për figurën e Isa Boletinit. Ndaj të dhënat e tyre janë marrë me rezervë, ato janë parë e interpretuar nën prizmin klasor, nën dritën e teorisë marksiste-leniniste, duke zbuluar prapa subjektivizmit përmbajtjen e tyre të vërtetë objektive.

Një burim tjetër i rëndësishëm për studimin e figurës së Isa Boletinit ka qenë shtypi shqiptar i kohës, i botuar brenda dhe jashtë vendit. Më me interes kanë qenë intervistat dhe deklaratat e vetë Isa Boletinit dhënë gazetarëve të ndryshëm gjatë qëndrimit të delegacionit shqiptar në Londër dhe në kryeqytetet e tjera të Fuqive të Mëdha evropiane më 1913. Në to shprehet qëndrimi i Isa Boletinit ndaj problemeve të konsolidimit të shtetit të ri shqiptar dhe ruajtjes së tërësisë së tij.

Për studimin e gjendjes ekonomike të familjes Boletini janë përdorur vjetarët statistikorë turq (salname) për vilajetin e Kosovës që ruhen në Bibliotekën Kombëtare të RPSSH.

Dihet se Isa Boletini nuk ka shkruar vetë. Nga dora e tij nuk ka mbetur ndonjë material dokumentar që të shërbente si burim autentik për të analizuar pikëpamjet e tij politiko-shoqërore. Kjo e ka vështirësuar shpje-

1) Dokumenti o spolnoj politici kraljevine Srbije 1903-1914. Beograd, 1980, 1981, 1983, 1984, «I dokumenti diplomatici Italiani. Roma, 1952, seria IV; 1908-1914, vëll. XII.

gimin dhe argumentimin e qëndrimit të tij në disa momente të luftës së popullit shqiptar. Këtë mungesë e plotësojnë burimet dokumentare të lartpërmendura. Të rëndësishme për punimin kanë qenë edhe kujtimet e Tafil Boletinit, bashkëpunëtor i ngushtë i Isait, pavarësisht nga mangësitë e tyre. Duke botuar këtë punim shpresojmë t'u japim lexuesve mundësinë të njihen më gjerë e më thellë me veprimtarinë e Isait dhe rolin e tij në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, në kryengritjet antiosmane dhe në mbrojtjen e tërësisë tokësore të vendit. Njëpërmjet tij ato do të njihen me virtytet më të larta të tij si urtësinë, trimërinë, besnikërinë e dashurinë e tij të pakufishme për atdheun e popullin që e lindi dhe e rriti.

Nuk pretendojmë se me hartimin e këtij punimi janë konsumuar shterueshëm të gjitha materialet që bëjnë fjalë për veprimtarinë atdhetare të Isa Boletinit në shëroim të çështjes kombëtare shqiptare. Dalja në dritë herë pas here e materialeve të reja nga arkivat e vendeve të ndryshme e veçanërisht nga ato të Shtabmbullit, do të krijojë mundësi për hulumtime e studime të reja për këtë figurë të shquar të historisë sonë. Ato do të ndihmojnë sidomos në nariçimin e mëtejshëm të fjalimeve të veprimtarisë atdhetare të Isait, ku materiali dokumentar që kemi është mjaft i kujzuar si dhe të disa problemeve të veçanta të veprimtarisë së tij në vitet e mëvonshme.

Punimi është paraqitur si disertacion për kërkimin e grades shkencore Kanaidat i shkencave historike. Si i tillë ai i është nënshtruar mendimit kolektiv të Sektorit të Historisë së Rilindjes e atij të Pavarësisë të Institutit Historisë të Akademisë së Shkencave të RPSSH. Ndaj e ndiej për detyrë të falenderoj gjithë kolegët për mendimet shumë të vlefshme që kanë dhënë si dhe udhëheqësin shkencor Prof. Kristaq Priftin dhe recensuesit bashkëpunëtorët e vjetër shkencorë Muin Çami e Xhevat Repishti.

KREU I

FILLIMET E VEPRIMTARISË ATDHETARE

1. MJEDISI FAMILJAR DHE RINIA

Isa Boletini lindi më 15 janar të vitit 1864 në fshatin Boletin¹, jo shumë larg qytetit të Mitrovicës, në një familje me tradita të pasura atdhetare. Familja e Boletinëve ishte ndër familjet më në zë për veprimtarinë politike në rrethinën e Mitrovicës. Ajo filloi të shquhej në rrethet atdhetare, sidomos në kohën e Mursel Boletinit, gjyshi i Isait. Kundërshtimi ndaj pushtuesit osman e reformave të tij, e bënë atë të njohur veçanërisht për njerëzit e thjeshtë të Mitrovicës, por edhe për autoritetet pushtuese lokale e të vilajetit të Kosovës.

Ishte koha kur mbarë Shqipërinë e kishin përfshirë kryengritjet e mëdha të masave popullore kundër reformave të Tanzimatit. «Në këto kryengritje merrnin pjesë të gjitha klasat e shtresat e popullit shqiptar, me një

1) Arkivi Qendror Shtetëror i RPSSH (më tej: AQSH). Fondi nr. 74, dosja nr. 4, (Kujtimet e Tafil Boletinit).

shtrirje të gjerë nga Veriu, Lindja e deri në Jug»¹ të Shqipërisë. Në rrugën e luftës kundër despotizmit e absolutizmit të sulltanit ishte futur edhe familja Boletini. Mursel Boletini ishte ngritur disa herë kundër politikës centralizuese të administratës osmane, zgjedhës dhe shfrytëzimit të saj².

Në gjurmët e Murselit ecën edhe shtatë djemtë e tij, midis tyre dhe Adem Boletini (i ati i Isa Boletinit).

Mjedisi familjar, kjo çerdhe luftëtarësh ku me krenari flitej për bëmat e të parëve dhe me mprehtësi gjykohej për ngjarjet e kohës, ndikoi së tepërmi në formimin e Isait si atdhetar i flaktë. Sipas kujtimeve të Tafil Boletinit, nip dhe bashkëluftëtar i ngushtë i I. Boletinit, në edukimin e Isait një rol të madh ka luajtur nëna e tij, Aishja. Ajo ishte një grua malësore, e thjeshtë, trime dhe e mençur³. Si shumë nëna shqiptare, ajo i kishte mëkuar fëmijët e saj me dashurinë për vendin, për popullin dhe urrejtjen për pushtuesit si dhe me shumë veti të tjera të larta të popullit tonë.

Për vitet e fëmijërisë dhe të rinisë së Isait, burimet e shkruara dhe gojore janë shumë të pakta, për të mos thënë që mungojnë krejtësisht. Megjithatë, duke qenë se rridhte nga një familje e njohur dhe me tradita atdhetare, nga burime të tërthorta, mund të gjurmohen disa të dhëna për këtë periudhë të jetës së tij.

Në dy dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XIX, familja Boletini u fuqizua ekonomikisht. Isai tashmë ishte rritur dhe luante rolin e vet në veprimtarinë ekonomike të familjes. Nga gjyshi dhe i ati ai trashëgoi një bazë të mirë ekonomike, toka buke, pyje, kullota dhe mulli në pesë mylqe të ndryshme. Isai kishte çifligje në fshatrat Boletin, Bellajë, Banjë, Maticë e Zharovnicë⁴. Gjithashtu ai zotëronte sipërmarrjen e punimit të

1) A. Buda. *Rrënjët historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, në: «Lidhja Shqiptare e Prizrenit», Tiranë, 1971, f. 63.

2) S. Luarasi. *Isa Boletini* Tiranë, 1971, f. 10.

3) AQSh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

4) *Po aty*.

mokrave të mullirit që ndodhej në afërsi të fshatit Boletin. Siç duket, deri në njëfarë kohe prodhimi i gurëve bëhej nga vetë burrat e shtëpisë. Më vonë, kur Isai e zgjeroi minierën, përdori në këtë punë rreth 200 punëtorë me mëditje¹ nga fshatrat Rudar, Grabovc, Stërbovc, Zhaç, Orahov, Staritërgu, Boletin, Koporiç Soçanie etj.² Përpunimi i gurëve bëhej vetëm me fuqinë e krahut, megjithatë ato ishin të një cilësie të mirë dhe shiteshin jo vetëm brenda vilajetit të Kosovës, por eksportoheshin me shumicë edhe në Serbi, në Bosnjë³ e përmes Selanikut⁴ edhe në vende të tjera. Një tregti e tillë i siguronte familjes Boletini të ardhura të konsiderueshme. Sipas të dhënave që jep salnameja e vitit 1898, ajo siguronte 100-170 lira turke në vit⁵. ndërsa konsulli austro-hungarez në Mitrovicë në vitin 1905 njoftonte se të ardhurat vjetore të famijes Boletini nga gurrorja ishin 200 lira turke, që ishin baras me 4000 pfund, ose 88000 korona⁶. Prodhimi i gurëve të mullirit, tregtimi i tyre me shumicë si dhe përdorimi i punëtorëve me mëditje dëshmojnë për depërtimin e marrëdhënieve kapitaliste, ndonëse në mënyrë të ngadalshme, edhe në fshatin Boletin.

Pozita ekonomike i jepte Isa Boletinit mundësinë materiale të jetonte mirë dhe të priste e të përcillte miq jo vetëm nga Boletini e fshatrat përreth, por edhe të huaj nga vende të ndryshme. Ai mbante, kur e lyp-te nevoja, edhe një numër të kufizuar njerëzish të armatosur. Udhëtarit gjerman Karl Estraj (Karl Oestreich), i ka lënë mbresa vizita në shtëpinë e Isait në Boletin,

1) Sh. Rahimi. *Vilajeti i Kosovës më 1878-1912. Prishtinë*. 1969, f. 37.

2) *Mitrovica dhe rrethina*. Mitrovicë, 1979. f. 131.

3) *Salname-i Vilajeti i Kosova*, Uskub, 1314 (1898), f. 372.

4) *Mitrovica*..., f. 131.

5) *Salname*..., f. 372.

6) *Haus-Hof-Und. Staats Archiv, Wien. Politichs Archiv* (më tej: *HHStA.P.A.*) Ref: I, nr. 62, konsulli austro-hungarez Zambur në Mitrovicë, Vjenës, 3 shtator 1905.

në shtator të vitit 1899. Ja si shkruan ai në shënimet e tij: «Shtëpia ishte dykatëshe,... dhoma shumë e shndritshme, dyshemeja ishte prej guri, mbulesa dru ahu i bardhë si pasqyrë. Dërrasat qenë kufizuar nga pjesë të ngritura, mbuluar me qilim, gjithçka dru i freskët, muret të lyera rishtaz me gëlqere të bardhë, oxhaku, që ndodhej karshi derës që rrethuar me mur, në të dy anët dollape të vegjël muri. Gjithçka e pastër e më e bukur se kudo që kisha parë gjer atëherë»¹. Këtë kullë, të ndërtuar sipas arkitekturës tradicionale shqiptare, Isai e ngriti në fund të shekullit të kaluar, mbi rrënojat e kullës që ia kishin djegur forcat osmane në vitin 1895.

Siç duket edhe nga kjo paraqitje e shkurtër, mund të themi se nga pozita ekonomike e shoqërore, Isa Boletini bënte pjesë në klasën e çifligarëve të borgjezuar. Megjithatë ai u lidh ngushtë me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, me fatet e Atdheut e të kombit shqiptar. Pra Isa Boletini bën pjesë në atë grup patriotësh, të cilët siç ka theksuar shoku Enver Hoxha «...ishin shkëputur nga klasa e tyre dhe nga qëllimet e ideatet skllavëruese të klasës së tyre, ata ishin bashkuar me popullin, i lidhën fatet dhe jetën e tyre me qëllimet dhe me luftën e popullit»².

Lidhja me masat dhe vënia e gjithçkaje në shërbim të çështjes kombëtare, e bënë Isa Boletinin të njohur, të dashur e të respektuar për masat popullore dhe ato e pranuan atë për prijës të tyre.

Rinia e Isa Boletinit (vitet 70-80 të shekullit XIX) përkon me ngjarje të një rëndësie të madhe për Shqipërinë, e në veçanti për Kosovën. Ato lanë gjurmë të thella dhe ndikuan drejtpërsëdrejti në jetën e veprimtarinë e Isa Boletinit, në formimin e karakterit e të personalitetit të tij.

Në gjysmën e dytë të viteve 70 të shekullit të ka-

1) Dr. K. Oestreich. *Reiseen Drücke. Aus-Dem Vilajet Kosovo*, Wien, 1899, f. 366-371.

2) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 16, f. 427-428.

luar, rreziku i copëtimit të trojeve shqiptare nuk ishte më vetëm një rrezik i mundshëm, por edhe real. Tashmë plani i copëtimit kishte hyrë në fazën e zbatimit praktik. Fuqitë e Mëdha evropiane, për interesat e tyre imperialiste, injoruan dhe morën nëpër këmbë të drejtat e ligjshme të popullit shqiptar. Rusia vendosi në Shën Stefan që gati gjysmën e trojeve shqiptare t'ua jepte shteteve sllave. Përveç Bullgarisë dhe Malit të Zi, që iu aneksuan vise shqiptare, Serbisë iu dhanë territoret shqiptare që shtriheshin kryesisht në jugperëndim duke aneksuar viset veriore të Kosovës deri në afërsi të Mitrovicës¹.

Si rrjedhojë e kontradiktave ndër imperialiste, vendimet e Shën Stefanit u pezulluan dhe u vendos që ato të rishikohen në një kongres të posaçëm të Fuqive të Mëdha që do të mbledhëj më 13 qershor 1878². Kongresi u mbajt në Berlin. Por edhe ai nuk i njohu popullit shqiptar asnjë të drejtë kombëtare, e konsideroi Shqipërinë një shprehje gjeografike dhe mori nëpër këmbë tërësinë e saj territoriale. Ai, ashtu si në Shën Stefan, ndau pjesë të Shqipërisë midis shteteve ballkanike, duke i dhënë Malit të Zi krahinat e Plavës, Gucisë dhe Rugovës, Serbisë krahinat e Vranjës, Trenit e Pirotit, ndërsa Greqisë, Çamërinë etj.³

Populli shqiptar nuk mund të pajtohej e nuk u pajtua me këto vendime antishqiptare të fuqive evropiane. Me armë në dorë organizoi vetëmbrojtjen popullore dhe mori një varg masash për të ruajtur territoret e tij nga gjymtimi që po u bëhej.

Në krye të masave popullore u vu Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e cila u krijua më 10 qershor 1878. Krijimi i kësaj organizate politike e ushtarake mbarëshqiptare që ngjarja më e rëndësishme e kohës për gjithë popullin shqiptar. Krijimin dhe veprimtarinë e saj e për-

1) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II, Tiranë, 1984, f. 198.

2) *Po aty*, f. 214.

3) *Po aty*, f. 216:



krahu edhe familja e Boletinëve. Ajo vuri gjithçka në shërbim të Lidhjes dhe në mbrojtje të saj.

Vetë Isa Boletini, megjithëse i ri në moshë, u përfshi në vorbullën e këtyre ngjarjeve dhe përkrah vëllait të tij më të madh, Ahmetit dhe bashkëluftëtarëve të tjerë, mori pjesë aktive për zgjidhjen e problemeve që shtronte koha. Kulla e Boletinëve u kthye në seli kuvendesh, ku luftëtarët nga Boletini dhe fshatrat fqinjë, mbledheshin dhe diskutonin për fatet e atdheut dhe për masat që duheshin marrë¹. Në këtë mënyrë, që herët Isai u njoh me synimet grabitqare të shteteve shoviniste fqinje, me politikën antishqiptare të Fuqive të Mëdha evropiane, të Portës së Lartë dhe me luftën e popullit shqiptar kundër tyre.

Përfshirja e Isait në veprimtarinë ushtarake të Lidhjes, përkon me fazën e fundit të qenies së saj. Për të shtypur Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, siç dihet, Porta e lartë dërgoi forca të shumta ushtarake. Midis ushtrisë osmane dhe forcave të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u zhvilluan një varg betejash të ashpra e të përgjakshme. Një ndër to ishte edhe beteja e Slivovës më 22 prill 1881, ku midis luftëtarëve shqiptarë të ardhur nga Mitrovica, ishte reshtuar edhe Isa Boletini 17 vjeçar².

Si në të gjitha betejat e mëparshme, edhe në Slivovë shkëlqeu me forcë të madhe guximi, trimëria dhe heroizmi i luftëtarëve shqiptarë. Simbol i guximit, trimërisë, heroizmit të treguar në këtë betejë, u bë akti heroik e vetëmohues i Mic Sokolit, i cili për t'u hapur rrugën forcave të Lidhjes, i vuri gjoksin grykës së topit armik. Beteja e Slivovës la gjurmë të thella e të pashlyeshme në ndërgjegjen e Isait. Aty u bë pagëzimi i tij i parë me luftën nga e cila Isai nuk do të shmanget për asnjë çast, deri në fund të jetës së tij.

1) P. Nushi. *Isa Boletini dhe roli i tij në luftën e popullit shqiptar për çlirimin nacional e social*, në: «Përparimi». nr. 3. Prishtinë, 1979, f. 135.

2) S. Luarasi, *Vep. e për.*, f. 16.

Mbas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Porta e Lartë vendosi në Shqipëri një regjim të egër politik për t'u mbyllur shqiptarëve rrugën e bashkimit dhe të luftës për autonomi. Autoritetet pushtuese osmane ushtruan mbi popullsinë shqiptare dhunë e terror të paparë. Xhandarmëria ndiqte dhe internonte me qindra atdhetarë shqiptarë.

Në përpjekjet për të zhdukur çdo vatër të atdhetarisë shqiptare, autoritetet lokale osmane të Mitrovicës e përqëndruan vëmendjen edhe ndaj familjes së Boletinëve. Në vitin 1886 komandanti i forcave osmane në Mitrovicë, Rexhep Pasha, i ofroi Ahmet Boletinit ofiqe e grada, për ta vënë atë e Boletinët e tjerë në shërbim të politikës osmane, por nuk mundi t'ia arrinte qëllimit¹. Pasi nuk arriti ta korruptonte, ai ndoqi rrugën tjetër të zakonshme, vendosi ta asgjësonte. Për këtë, Rexhep Pasha e thirri disa herë Ahmet Boletinin gjoja për të biseduar. Ky i fundit, që i njihte mirë manovrimet e autoriteteve osmane, nuk pranoi dhe i hodhi poshtë kërkesat e tij². Pashai i dërgoi Ahmetit edhe dy tregtarë nga Mitrovica për t'i mbushur mendjen për një takim³. Këtë herë Ahmeti pranoi të takohej me komandantin e forcave osmane në Mitrovicë, por para se të shkante në takim, që të mos ndodhej para ndonjë të papriture, mori masat e nevojshme. Sipas kujtimeve të Tafil Boletinit, ai e vendosi Isanë me një grup luftëtarësh të armatosur në kodrën e Lisicës⁴, të gatshëm për t'i ardhur në ndihmë në rast rreziku.

Isai, tashmë i rritur, ishte lidhur edhe më ngushtë me të vëllanë, si dhe me bashkëluftëtarët e tij në Boletinin. Ahmeti ishte për Isanë jo vetëm i parë i familjes, por edhe një shembull, prej të cilit ai mësoi shumë për jetën e për luftën.

Sipas kujtimeve të Tafilit, ashtu siç ishte parashi-

1) AQSh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Po aty.

kuar, pas të ashtuquajturit takim fshihej një kurth i përgatitur nga pashai dhe veglat e tij. Mbas bisedës së «përzemërt» me pashën, ai u gjend i rrethuar nga xhandarët¹. Megjithëse i vetëm, ai nuk u dorëzua, por veproi me shkathësi e gjakftohtësi dhe arriti të çante rrethimin. Ndërkohë, Isai i shqetësuar për vonesën e të vëllait, u nis bashkë me shokët në drejtim të shtëpisë së pashës nga ku po dëgjoheshin të shtëna armësh. Rrugës takohen me Anmetin dhe kthehen në Boletin².

Kjo ngjarje ia forcoi edhe më tej bindjen Isait për egërsinë e dredhitë e sunduesve osmanë dhe e mësoi atë të ishte syçelët ndaj lajkave e premtimeve të autoriteteve të administratës osmane e të mos u zinte besë atyre.

Mbas çdo përpjekjeje me armikun, Boletinët bëheshin më të fortë e më të dëgjuar. Emri i tyre i kaloi kufijtë e Mitrovicës. Autoriteti i Boletinëve rritej e krahas me të, rritej edhe numri i atyre që i pasonin e i mbronin.

Në vitin 1894 Ahmet Boletini vritet¹. I pari i familjes mbeti Isai, i cili iu kushtua thujtë tërësisht çështjes kombëtare. Ai e ndiente për detyrë që të vijonte punën e të parëve të tij. Ashtu si dhe ata ai nuk mundi të pajtohej me absolutizmin e Perandorisë Osmane. Lufta për çlirim kombëtar do të ishte tashmë edhe çështja themelore e jetës së tij. Në këtë mënyrë ai do të ecte në gjurmët e të parëve.

Rritja e vazhdueshme e taksave, e arbitraritetit dhe e abuzimeve të nëpunësve osmanë, çuan në vitin 1894-1895 në një ngritje të re të lëvizjeve e protestave të masave popullore në krahinat e ndryshme shqiptare. Kundër këtij arbitrariteti u ngrit me armë në dorë edhe Isa Boletini. Kështu, në fund të vitit 1894, ai me bashkëluftëtarët e tij vranë një oficer turk dhe pesë

1) Po aty.

2) Po aty.

3) AQSh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4. (Në kujtimet e tij Tafili tregon se Ahmetin e vrau gjakësi).

xhandarë¹, të cilët me sa duket, kishin kryer në Boletin veprime arbitrare ndaj fshatarëve për nxjerrjen e taksave të reja. Kjo vrasje i shqetësoi autoritetet osmane të vilajetit të Kosovës, të cilat shihnin tek Isai e mbarë Boletini një pengesë për forcimin e administratës osmane në Mitrovicë. Prandaj Hafëz Pasha (vali i Kosovës) nisi në vitin 1895 në drejtim të Boletinit forca të shumta ushtarake të komanduara nga bimbashi Mehmet Pashë Qyrdi.

Ky i fundit u përpoq të shfrytëzonte njohjen dhe miqësinë e tij me familjen Boletini, me qëllim që ta kapte Isanë në befasi. Ai u nis për tek Isai si «mysafir» duke i porositur forcat osmane që, gjatë kohës që Isai do ta priste si mik, ato të afroheshin në fshehtësi, të rrethonin kullën, pastaj të sulmonin për të asgjësuar atë².

Isai, i lajmëruar nga luftëtarët e tij për ardhjen e forcave osmane, i përkrahur nga masa e gjerë e fshatarëve në Boletin dhe nga luftëtarë të krahinave përreth përgatiti dhe organizoi një mbrojtje mjaft të përshtatshme për ta pritur «mysafirin» ashtu siç e donte zakoni i shqiptarit: kush vinte për pushkë pritej me pushkë. Pasi pritën derisa u afruan, ai dhe forcat e tij i goditën osmanët ku ata nuk e prisnin, duke lënë mjaft të vrarë, midis të cilëve edhe vetë Mehmet Pashën³. Plani për të kapur Isanë në befasi, dështoi, ashtu siç kishte dështuar kapja në befasi e Ahmetit. Sipas kujtimeve, në luftimin kundër forcave osmane të komanduara nga Mehmet Qyrdi, përkrah Isait mori pjesë edhe nëna e tij Aishja.. Ajo shkante sa te njeri luftëtar te tjetri, u mjekonte plagët dhe u jepte zemër. «Garjet djalë, — i thoshte ajo Isait, — se të ka ba nana me luftue me pashallarë»⁴

1) K. Oestreich. *Vep. e për.*, f: 366-371:

2) *Po aty*

3) *AQSh*. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

4) *Po aty*.

Pas luftimesh të ashpra e të vazhdueshme ku lanë shumë të vrarë, forcat osmane u detyruan të hiqnin dorë nga sulmi dhe u tërhoqën në pritje të ardhjes së përforcimeve të tjera nga Mitrovica, në krye të të cilave u vu vetë Hafëz Pasha.

Duke parë se vazhdimi i luftimeve që i pamundur, sepse municioni nuk mjaftonte dhe raporti i forcave ishte në anën e armikut, Isa Boletini vendosi të tërhiqej¹. Ai shfrytëzoi errësirën e natës dhe bashkë me forcat, e familjen e tij la kullën në Boletin dhe u nis për në fshatin Banjë. Në të gdhirë Hafëz Pasha, duke menduar se do ta shtinte në dorë Isa Boletinin, iu afrua me kujdes kullës dhe me gjithë forcat e tij e rrethoi për ta sulmuar, por aty nuk gjeti njeri. Forcat osmane u futën brenda, grabitën e plaçkitën çfarë gjetën dhe pastaj i vunë zjarrin.

Djegia dhe shkatërrimi i kullës nga forcat osmane nuk e ligështoi Isa Boletinin. Përkundrazi, rritja e qëndresës së përgjithshme kundërosmane si dhe vendosmëria e bashkëluftëtarëve në luftën kundër forcave osmane në Boletin, ia shtuan Isait forcat dhe vrullin, ia kalitën guximin për të vepruar dhe i përforcuan më tepër bindjen për papajtueshmërinë e tij me pushtuesit dhe për domosdoshmërinë e qëndresës ndaj tyre. Kjo shprehet në fjalët që Isai i dërgoi Hafëz Pashës: «Unë shëndosh e mirë shkova në kullën time në Banjë, ju pres edhe aty për «muhabet»»². Kjo që paraqitja e parë e Isait 31-vjeçar në krye të bashkëluftëtarëve, përballë forcave osmane.

Në vitin 1898 Isai e ndërtoi përsëri kullën. Këtë radhë në shpatin Sokolaj dhe, siç shprehet në përshkrimet e veta Karl Eštraj edhe më të fortë e më të bukur se e para. Shpati Sokolaj ishte një pikë strategjike nga ku mund të vëzhgohej shumë mirë kushdo që mund t'i afrohej. Ajo mund të mbrohej mjaft mirë edhe me forca të pakta. Për pozicionin e saj, Karl Eštraj në shënimet e tij

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

shkruante: «Kulla ishte ndërtuar në pjesën veriperëndimore të Sokolicës. Nga maja e saj, që arrinte lartësinë 914 metra, mund të shquhej mirë lugina e Ibrit që hapet gjer në Mitrovicë, në qytet shihej çdo shtëpi e dukshme, në juglindje fusha e Prishtinës, nga e majta shquhej mirë lugina e Boletinit. Në kohë shiu, kur re të ngjiteshin lart, mund të shquhej Zhljebi në Pejë pothuajse deri në majë»¹.

Ndrësa gazetari i huaj shijonte romantikën e pamjeve të mahnitshme që i shpaloseshin para syve, Isai e kishte zgjedhur këtë vend për të shfrytëzuar në radhë të parë pozicionin e saj të favorshëm.

Kulla në shpatin e Sokolicës ishte jo e zakonshme. Ajo nuk ishte thjesht një banesë. E ndërtuar e tëra prej guri masiv, me një kullë të vogël në qendër, me një çati që ngrihej thikë përpjetë, ajo kryente dhe një funksion tjetër shumë të rëndësishëm, atë të mbrojtjes nga sulmet e kundërshtarëve të Isait. E gjithë arkitektura e saj i shërbente këtij qëllimi. Në murin e përparmë, përveç disa frëngjive, ndodhej dera e ulët me një hark. Kulla ishte dykatëshe; kati i parë ku gjendeshin katojtë për kuajt dhe kati i sipërm që kishte një paradhomë e dhomë. Nga paradhoma një shkallë e ulët të çonte përsëri në tokë ku kishte depo rezervash ushqimore e depo të tjera, kuptohet për armë e municion. Oda e miqve kishte tri dritare që mbylleshin me pllaka prej guri nga sipër. Ato shikonin nga lugina dhe ishin të paarrtshme nga plumbat. Kudo, në të gjitha drejtimet kishte frëngji për mortaja të vogla. Blloqet, prej të cilave ishte ndërtuar shtëpia nga muratorët dibranë, ishin dy metra të gjata dhe 1 — 1,2 m të trasha². Nga të gjitha këto që përmendëm gazetari gjerman në kujtimet e tij për vizitën që i bëri Isa Boletinit, arrin në përfundimin shumë kuptimplotë: «Ne ishim në një kala të vërtetë, në kështjellën e një të nderuari»³.

1) K. Oestreich *Vep. e për.*, f. 366-371.

2) *Po aty*.

3) *Po aty*.

Në kujtimet e tij Karl Estraj na jep dhe disa nga karakteristikat e personalitetit të Isa Boletinit. «Ai, — shkruante gazetari i huaj, — ishte një burrë i madh, i bukur, ende i ri, me fytyrë të mprehtë, sytë e tij kishin një shprehje që nuk kishin asgjë të egërsisë por më tepër diçka të përmallshme... Me njerëzit e thjeshtë, Isai kishte marrëdhënie shumë të mira. Te ky burrë sheh shumë dashuri si në sjelljet e tij me adjutantit e vet, ashtu dhe me njerëzit e gjakut të vet.»¹ Nisur nga këto tipare të Isa Boletinit, Karl Estraj e tipizon atë zotni fisnik dhe aspak «kre grabitësish»² duke polimizuar kështu edhe me ata që e kishin nxirë portretin e Isait me tendencë. Përkundrazi, «cilindo që nuk e ka armik, — shkruan gazetari, — ai e ka mik dhe e mbron, madje edhe në qoftë se shfaqet ndonjë grabitës, i cili nuk arrin të dënohet, atëherë Isai ja zëvendëson të grabiturit humbjen nga pasuria e vet»³.

Deri në vitin 1897 Isai qëndroi në kullën e tij në Bannjë. Në pranverën e këtij viti gjendja politike në Shqipëri u acarua edhe më tepër. Shpërthimi i Luftës Greko-Turke për Kretën, u bë shkak për ndërhyrje të reja të Fuqive të Mëdha dhe të monarkive shoviniste ballkanike në punët e brendshme të Perandorisë Osmane e të popujve të tjerë që gjendeshin ende nën sundimin e saj dhe veçanërisht në territoret shqiptare. Qarqet sunduese ballkanike menduan se erdhi çasti që të realizohen synimet e tyre shoviniste. Prandaj shpejtuan kush të pushtonte e të rrëmbente sa më shumë territore nga Perandoria Osmane. Kështu, p.sh., qeveria greke, sikurse del edhe nga dokumentet e kohës, nxitoi «Së pari të shtjerë në dorë Kretën, dhe së dyti, Epirin»⁴. Krahas rrezikut që i kërcënohej pjesës jugore të Shqipërisë, përvijonte dhe rreziku i ndërhyrjes së shteteve të tjera të Ballkanit (të Serbisë e Bullgarisë) për të

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) K. Prifti. *Lidhja Shqiptare e Pejës*, Tiranë, 1984, f. 143-144.

cenuar tërësinë territoriale të trevave veriore dhe verilindore të Shqipërisë¹.

Gjendja e krijuar, ashtu si te të gjithë atdhetarët shqiptarë edhe tek Isa Boletini, shkaktoi shqetësim të madh. Me sa duket rreziku i copëtimit të trojeve shqiptare që tashmë ishte i ditës si dhe propaganda demagogjike e Portës së Lartë për ta paraqitur luftën kundër Greqisë si luftë për mbrojtjen e trojeve shqiptare, ishin arsyet kryesore që e shtynë Isain të rreshtohej me forcat vullnetare të Kosovës dhe të marrë pjesë në frontin e Thesalisë², kundër forcave greke. Pas përfundimit të Luftës Greko-Turke asnjë e dhënë dokumentare ose kujtim i bashkëkohësve nuk dëshmon për ndonjë shpërblim të dhënë Isait nga porta e Lartë, sikurse u veprua me disa krerë feudalë të cilët pjesëmarrjen e tyre në luftën kundër Greqisë e panë lidhur ngushtë me interesat e tyre ekonomike me Stambollin. Kjo është një dëshmi tjetër që vërteton se Isai mori pjesë në këtë luftë i frymëzuar nga idealet e larta atdhetare, nga idealet kombëtare për mbrojtjen e tërësisë territoriale të trojeve shqiptare. Marrëdhëniet e tij me Stambollin mbas Luftës Greko-Turke, mbetën ashtu si dhe më parë.

Me t'u kthyer nga Lufta Greko-Turke, Isa Boletini njihet me përpjekjet e atdhetarëve shqiptarë si Haxhi Zeka e Bajram Curri, të cilët ishin nismëtarët e krijimit të një organizate që u quajt «Beslidhja Shqiptare». Në kushtet e reja krijimi i një organizate të tillë që synonte të organizonte masat në luftën kundër përpjekjeve të monarkive fqinje, për copëtimin e tokave shqiptare të vilajetit të Kosovës dhe të Manastirit, ashtu dhe për fitoren e autonomisë ishte i domosdoshëm. Në janarin e vitit 1899 Isai u zgjodh delegat i rrethit të Mitrovicës³ për të marrë pjesë në Kuvendin e Pejës që u

-
- 1) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 311.
 - 2) «L'Albanie», Lozanë, 16 shkurt 1916, nr. 9.
 - 3) *Mitrovica ...*, f: 89

mbloodh nga 23 deri 29 janar 1899, ku, përveç delegatëve nga krahinat e ndryshme të vilajetit të Kosovës, morën pjesë dhe nga vilajeti i Manastirit dhe i Janinës. Në vendimin prej 11 pikash, të miratuar në Kuvend më 28 janar 1899, vihej theksi në luftën për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë kundër çdo orvajtjeje që Serbia, Bullgaria, Mali i Zi dhe Greqia do të ndërmerrnin për copëtimin e trojeve shqiptare. Në të njëjtën kohë u diskutua edhe çështja e autonomisë së Shqipërisë. Ndonëse Lidhja e Pejës nuk pati jetë të gjatë, vendimet e saj Isai i pati parasysh gjatë gjithë veprimtarisë së tij në dobi të çështjes kombëtare. Krahas luftës kundër sunduesit osman, ai nuk harroi për asnjë çast rrezikun që u kërcënohej trojeve shqiptare nga llakmitë shoviniste të shteteve fqinje dhe luftoi deri në fund për ruajtjen e tërësisë së tyre.

2. LUFTA KUNDËR PLANEVE ANTISHQIPTARE TË SERBISË NË VITET 1900-1902

Në fillim të shek. XX popullit shqiptar iu desh të ndeshesh jo vetëm me sunduesin osman e shovinizmin e shteteve fqinjë, por edhe me ndërhyrjen e shteteve të mëdha imperialiste në Shqipëri dhe në veçanti me imperializmin rus.

Perandoria Osmane ishte me një këmbë në varr. Fundi i saj ishte i pashmangshëm. Dobësimi i vazhdueshëm i saj u shoqërua me intensifikimin e ndërhyrjeve të fuqive imperialiste. Këto fuqi për interesat vetjake për të vënë nën ndikimin e tyre shtetet ballkanike, i përdorën territoret e pushtuara nga Perandoria Osmane, veçanërisht tokat shqiptare, si plaçkë tregu. Shumë vise shqiptare, e sidomos Kosova u bë një vend i preferuar ku takoheshin interesat e Fuqive të Mëdha imperialiste dhe shteteve fqinje. Këto të fundit me ras-

tin e të ashtuquajturave reforma për Maqedoninë, i shtuan pënpjekjet për rritjen e ndikimit të tyre në territoret shqiptare, për t'i copëtuar e aneksuar ato sapo të prishej status quo-ja në Ballkan.

Në rrethanat e krijuara populli shqiptar zgjeroi në një shkallë më të gjerë luftën e armatosur për të ruajtur tërësinë territoriale nga rreziku i copëtimit dhe për të fituar autonominë. Në krye të kësaj lufte, krahas atdhetarëve dhe udhëheqësve të tjerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, ishte edhe Isa Boletini.

Në këtë kuadër qarqet shoviniste serbe ishin përpjekur dhe përpigëshin vazhdimisht të rrëmbenin «copën e tyre.» Për to kishte qenë gjithmonë një ëndërr ideja e «Serbisë së Madhe», në të cilën përfshinin mjaft toka të Shqipërisë Veriore e në radhë të parë Kosovën. Isa Boletini i demaskoi dhe iu kundërvu me vendosmëri të gjitha formave dhe metodave që përdorte qeveria serbe për të realizuar ëndrrën e saj.

Me shpalljen e Naçertanies* në vitin 1844, borgjezia serbe shpалosi hapur e qartë programin e politikës së saj të jashtme shoviniste. Sipas saj, principata serbe, si pasardhëse e perandorisë mesjetare të Stefan Dushanit, do të luftonte për përtëritjen e saj me qëllim që të shndërrohej në një shtet të madh hegjemon në Ballkan. Kjo do të thoshte që në përbërjen e saj, të përfshiheshin, përveç të tjerash, edhe shumë troje shqiptare. Për zbatimin e këtij plani borgjezia serbe kishte luftuar dhe luftonte vijimisht.

Në fillim të shek. XX qarqet shoviniste serbe i shtuan pënpjekjet për të vënë në jetë këtë program. Ato pretendonin dhe propagandonin tezën se Kosova ishte

*) Naçertanie Platforma e politikës së jashtme të borgjezisë shoviniste serbe që u përpunua pas konsolidimit të pozitave të saj politike në shtetin serb nga I Garashaninin. Aty propagandohej ideja e shtetit të madh serb, ku krahas synimeve për të bashkuar rreth shtetit serb territoret e banuara nga sllavët e Jugut, parashikohej gjithashtu aneksimi i trojeve shqiptare të Kosovës e të gjithë Shqipërisë së Veriut e të Mesme.

tokë serbe dhe se shqiptarët aty ishin të ardhur¹. Shovinistët serbë bënë gjithçka për të falsifikuar të vërtetën historike, me qëllim që të bindnin opinionin e brendshëm publik dhe atë ndërkombëtar, se gjoja ishte një «e drejtë historike» e Serbisë që ajo t'i shkëpuste Shqipërisë Kosovën, e gjithë Shqipërinë e Veriut e t'i përfshinte ato brenda kufijve të shtetit serb.

Për të vënë në jetë këto synime, qeveria serbe kaloi edhe në veprime konkrete në fushën politike e ideologjike, kulturore, arsimore e ushtarake. Ajo dërgoi në Kosovë dhe në krahinat e tjera shqiptare priftërinj, mësues e agjentë serbë, nxiste grindje, përçarje e konflikte midis popullsisë shqiptare e asaj serbe, hidhte vazhdimisht banda të armatosura që ushtronin terror mbi popullsinë shqiptare, që vrisnin e zhduknin udhëheqës popullorë shqiptarë të cilët ishin bërë pengesë në realizimin e synimeve të saj. Njëpërmjet tyre qeveria serbe kishte si qëllim të shkombëtarizonte popullsinë shqiptare, të forconte në Shqipëri pozitën politike të Serbisë dhe të krijonte në këtë mënyrë rrethana të favorshme për ndërhyrje të hapur.

Isa Boletini iu kundërvu veprimtarisë antishqiptare të qeverisë serbe dhe në çdo rast e demaskoi atë. Jo vetëm kaq, por ai si shumë atdhetarë të tjerë kosovarë, u përpoq parreshtur që, midis shqiptarëve të vilajetit të Kosovës që përbënin 79,1 për qind të të gjithë popullsisë së vilajetit (pa sanxhakun e Shkupit) dhe pakicave serbe, malazeze etj. që banonin aty, të vendoseshin marrëdhënie të mira. Këto marrëdhënie ai i vlerësonte si një faktor pozitiv jo vetëm në luftën kundër Perandorisë Osmane, por edhe kundër sulmeve shoviniste serbe. Isa Boletini mbante, ashtu si i ati Adem Boletini, qëndrim të drejtë ndaj popullsisë serbe. Sipas të dhënave ai e ndihmonte atë në

1) J. Cvijić. *La guerra Balcanica e la Serbia*. Romë, 1912, (sipas përkthimit në AIH, f. 5).

luftë kundër sunduesve osmanë¹, e mbronte nga grabitësit e ndryshëm që shfaqeshin në fshatrat serbe² etj. Sipas pohimeve të Isait, edhe babai i tij e kishte ndihmuar popullsinë serbe në Boletin për të ngritur manifestimin e tyre³. Isai edhe në këtë periudhë vazhdoi të kërkonte vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë, të hapur e të sigurtë midis shqiptarëve dhe popullsisë serbe për luftë kundër armikut të përbashkët. Ai u kish-te bërë thirrje gjithnjë pakicave serbe që të ngriheshin në luftë përkrah popullsisë shqiptare kundër pushtuesit osmanë, sepse dhe ato, njëloj si popullsia shqiptare shtypeshin e shfrytëzoheshin prej tyre. Por këto përpjekje nuk gjetën përkrahjen e pakicave serbe, për shkak të politikës shoviniste e antishqiptare të Beogradit. Beogradi sikurse u theksua edhe më sipër punoi jo për bashkimin, por për përçarjen e shqiptarëve me serbët. Asnjëherë qarqet drejtuese serbe nuk iu përgjigjën kërkesës së shqiptarëve për bashkëpunim në luftën kundër sunduesit osman, as në këto vite as më vonë, gjatë kryengritjeve të mëdha antiosmane 1909-1912.

Armatosja e pakicave serbe në mënyrë të njëanshme dhe fshehtas popullsisë shqiptare, (veprim të cilit qeveria serbe e kishte filluar në dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XIX, por që kishte hasur në kundërshtimin e fortë të popullsisë shqiptare me në krye atdhetarët Haxhi Zeka, Bajram Curri etj.), përbënte një rrezik, një thikë pas shpine jo vetëm për tërësinë e trojeve shqiptare, por edhe për vetëqënien e popullsisë shqiptare. Në qoftë se qeveria e Beogradit do të kryente armatosjen e pakicave kombëtare për ta ngritur në luftë kundër sunduesit osman, një veprim i tillë nuk kishte për-

1) «Mitrovica...», f. 90.

2) AIH, dosja nr. 31, f. 114-116.

3) Po aty:

4) F. Bahtiri. *Rezistenca e shqiptarëve të Selacit ndaj turqve në fillim të shek. XX*, në: «Përparimi», nr. 4, Prishtinë, 1969, f. 349:

se të kundërshtoj nga Isa Boletini e atdhetarët e tjerë kosovarë, mbasi për luftë kundër Perandorisë Osmane ishte i interesuar drejtpërsëdrejti edhe populli shqiptar, madje ai vijimisht kishte qenë e ishte në luftë me të. Por me këtë veprim qeveria serbe synonte të krijonte një forcë të armatosur për ta pasur të gatshme, që në çastet më të përshtatshme ta përdorte si pararojë e si rezervë siç u veprua gjatë Luftës Ballkanike kundër popullsisë shqiptare e të përmbushte me ndihmën e tyre ëndrrën e vjetër për aneksimin e trojeve shqiptare.

Në këto rrethana janë plotësisht të kuptueshme qëndrimi dhe veprimtaria e Isa Boletinit ndaj armatosjes së popullsisë serbe që jetonte në krahinat e saj kufitare me Kosovën si dhe të pakicave serbe në trojet shqiptare brenda kufijve të Perandorisë Osmane nga qeveria serbe. Prandaj i mbështetur nga masat popullore të Mitrovicës, Vuçiternit e krahinave të tjera, ai e kundërshtoi me forcë një hap të tillë tepër të rrezikshëm të qeverisë serbe.

Për këtë Isai njoftoi edhe autoritetet osmane të Mitrovicës që të merrnin masat e nevojshme. Për autoritetet osmane nuk ishin të panjohura këto veprime të qeverisë serbe. Patrullat turke të kufirit kishin rënë në përplasje me banda të armatosura serbe¹ dhe kishin kapur armë të tipit «martini»² me vulën e ushtrisë serbe, të futura kontrabandë nga Serbia.

Një veprim i tillë, i ndërmarrë nga qeveria serbe, nuk i interesonte Perandorisë Osmane, sepse vetëkuptohet që ato armë do të përdoreshin edhe kundër saj. Por Porta e Lartë nuk mori asnjë masë serioze për të ndaluar këtë aksion. E detyruar nga Fuqitë e Mëdha

1) HHStA, PA. Relacion nr. 145 i konsullit Para në Shkup, drejtuar MPJ, Vjenë, 13 korrik 1901.

2) Politiches Archiv des Aus Waringen Amtes (më tej: PAAA). Tel. nr. 115 i legatës perandorake gjermane në Beograd, Kon- tit von Bulov, kancelar i Rajhut, 26.7.1901.

imperialiste ajo edhe më parë kishte lëshuar pjesë të trojeve shqiptare për të plotësuar lakmitë e shovinistëve fqinjë. Prandaj edhe në këtë rast stepja e saj, shpjegohet me pafuqinë e Portës për t'i bërë ballë një konflikti të armatosur me Serbinë, prapa së cilës qëndronte Rusia cariste.

Ndërkaq, Porta e Lartë mendohej të mbante marrëdhënie të mira edhe me shqiptarët. Për të mos u komprometuar hapur në sytë e tyre, autoritetet osmane në Mitrovicë iu përgjegjën Isa Boletinit se nga «kontrolli» i organizuar nga patrullat e kryesura nga Qemal Begu (komandant i xhandarmësisë në Prishtinë), nuk ishte gjetur asnjë armë në krahinën e Kolashinit dhe Rogoznës¹.

Në këto rrethana para popullit shqiptar, qëndronte detyra e lartë e mbrojtjes së tërësisë së trojeve shqiptare. Për realizimin e kësaj detyre një rol të rëndësishëm përkrah atdhetarëve të tjerë, luajti Isa Boletini.

I bindur se e vërteta qëndronte krejt ndryshe nga ç'pohonin autoritetet turke, i mbështetur nga krerë të tjerë popullorë, Isai organizoi patrullimin në kufi dhe arriti që të kapte serbë të armatosur si dhe kafshë të ngarkuara me armë, të cilat i çoi në komandën turke në Mitrovicë. Këtë Isai e bëri së pari, për ti vënë autoritetet turke para një prove të gjallë në mënyrë që ato të mos kishin mundësi ta mohonin ende futjen në mënyrë të fshëhtë të armëve nga ana e Serbisë dhe së dyti, për të demaskuar propagandën serbe se gjoja armët nuk silleshin nga Serbia, por u shiteshin fshatarëve serbë nga kontrabandistë shqiptarë². Kundër një qëndrimi të tillë indiferent të autoriteteve lokale osmane, Isa Boletini dhe shumë shqiptarë të tjerë i dërguan një telegram proteste Portës së Lartë, ku kërkohej që të merreshin masa të menjëhershme, ndryshe do ta merr-

1) AQSh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

2) HHStA, PA. Raport nr. 155 i konsullit, Para në Shkup, drejtuar Vjenës, 7 gusht 1901.

nin vetë në dorë mbrojtjen e vendit¹. Porta e Lartë jo vetëm që s'mori asnjë masë, por në përgjigjen e saj urdhëronte që shqiptarët të qëndronin të qetë².

Pas kësaj Isa Boletini u kujdes vetë për çarmatimin e popullsisë serbe. Ai filloi menjëherë çarmatimin e serbëve në krahinën e Mitrovicës³. Veprimtaria e shqiptarëve dhe e Isa Boletinit e detyroi Portën e Lartë që më 15 korrik të miratonte kryerjen e çarmatosjes së pakicave serbe nga shqiptarët⁴. Brenda një kohe të shkurtër lëvizja përfshiu Vuçiternin, Pazarin e Ri, Kolashinin etj.

Gjatë këtij aksioni, për të mos i ashpërsuar marrëdhëniet me popullsinë serbe, Isai përpiquej t'i bindte fshatarët serbë t'i dorëzonin vetë armët. Kjo bëri që brenda pak ditësh, siç kujton Tafil Boletini, të mblidheshin rreth 1500 armë të reja me nga 200 fishekë.⁵

Lëvizja shqiptare, e udhëhequr drejtpërsëdrejti nga Isa Boletini, i shqetësoi së tepërmi qarqet qeveritare serbe. Edhe në këtë rast atyre u erdhi në ndihmë qeveria ruse, e cila për të shtënë nën kthetrat e saj Evropën Juglindore, për të pushtuar Stambollin dhe ngushticat e të dilte në brigjet lindore të detit Mesdhe, u bë mbështetja kryesore e realizimit të planeve të borgjezisë serbe në dëm të trojeve shqiptare.

Në korrik 1901 qeveria ruse e ajo serbe, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Stamboll ushtruan presion mbi Portën e Lartë që të ndërhynte qoftë edhe me forcë për të ndaluar menjëherë çarmatimin, të cilin e quajtën si «masakrim të popullsisë serbe». Gjithashtu Rusia e Serbia, duke parë se Isa Boletini ishte jo vetëm udhëheqësi kryesor i lëvizjes shqiptare, por edhe një luftëtar

1) PAAA, Tel; nr. 115. Legata perandorake gjermane në Beograd, — kontit von Bulov, kancelar i Rajhut, Berlin, 26 korrik 1901

2) Po aty.

3) Po aty.

4) HHStA. PA. Tel. nr. 16 i administratorit Dobrozanski në Shkup, Vjenës, 19 korrik 1901.

5) AqSh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

e udhëheqës i vendosur i luftës për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga rreziku i copëtimit prej shovinistëve fqinjë, i kërkuan qeverisë turke ta largonte atë nga Mitrovica e nga Kosova¹. Me këtë ata synonin të zhduknin një pengesë serioze në rrugën e tyre për aneksimin e trojeve shqiptare. Rusia e Serbia për të mashtruar opinionin publik të brendshëm e të jashtëm propagandonin në faqet e shtypit të tyre sikur lëvizja për çarmatimin, ishte lëvizje që nxitej nga Austro-Hungaria dhe krerët e saj s'ishin gjë tjetër, veçse «agjentë» të Austro-Hungarisë.² Kjo propagandë përpiquej të maskonte veprimtarinë dhe synimet antishqiptare të Serbisë e të Rusisë. Është e vërtetë se Austro-Hungaria, si fuqi imperialiste kishte edhe ajo synimet e veta në Shqipëri. Njëpënjmjet territoreve shqiptare, ajo mendonte të dilte në Selanik. Këto plane të Austro-Hungarisë binin ndesh me interesat imperialiste ruso-serbe. Por lëvizja shqiptare nuk kishte të bënte aspak me interesat e Austro-Hungarisë. Edhe vetë konsulli austro-hungarez në Shkup, pohonte në atë kohë se shkaku kryesor i kësaj lëvizjeje ishte ndërhyrja e Serbisë njëpënjmjet përhapjes së shkrimeve irrituese, nxitja e shovinizmit në popullsinë serbe si dhe futja kontrabandë e një numri të madh pushkësh për armatosjen e të krishterëve serbë³.

Qeveria serbe e mbështetur nga Rusia e shtriu veprimtarinë kundër lëvizjes shqiptare edhe në Mitrovicë. Më 17 korrik 1901, me pretekstin e verifikimit të gjendjes në vend, por në të vërtetë për të ushtruar presion ndaj shqiptarëve dhe krerëve të tyre, ato dërguan përfaqësuesit e tyre nga Shkupi në Mitrovicë. Po në atë kohë të dërguarit e Rusisë dhe Serbisë i kërkuan kaimkamit të Prishtinës që ta detyronte Isa Boletinin të ndër-

1) HHStA, PA. Tel. nr. 16 i administratorit Dobrozanski, — Vjenës, 18.7.1901.

2) Po aty. Relacion nr. 155 i konsullit Para në Shkup, Vjenës, 7 gusht 1901.

3) Po aty.

priste çarmatimin¹. Nën presionin e tyre, autoritetet osmane të Mitrovicës i dërguan Isait dhe bashkëpunëtorëve të tij dy korrierë dhe u parashtruan atyre kërkesën e lartpërmendur.

Ardhja e konsullit rus u dha zemër të armatosurve serbë, të cilët e ndërprejnë dorëzimin e armëve. Por Isai nuk iu nënshtrua presionit ruso-serb. Ai e vazhdoi më me këmbëngulje punën për çarmatimin e elementit serb, duke kundërshtuar në këtë mënyrë edhe urdhrin e autoriteteve osmane. Këto veprime të Isa Boletinit bënë që në Mitrovicë të flitej se «mbreti i vogël (është fjala për Isa Boletinin — F.M.) nuk po pyet për mbretin e madh (sulltanin — F.M.), por bën si do vetë»².

Qeveria serbe dhe ajo ruse, duke parë se përpjekjet e tyre nuk po jepnin fryt dhe se shqiptarët nën udhëheqjen e Isa Boletinit ishin të vendosur për ta çuar lëvizjen deri në fund, e shtuan presionin ndaj Portës së Lartë që kjo të ndërhynte me forca të armatosura për të shtypur lëvizjen shqiptare.

Porta e Lartë, e trembur nga rreziku i shpërthimit të një konflikti me Rusinë dhe Serbinë, u mundua të pengonte veprimtarinë e shqiptarëve për çarmatim. Kështu, më 23 korrik 1901 ajo nxori iradenë perandorake, ku urdhëronte ndalimin e çarmatimit të serbëve³, ndërsa në fund të muajit korrik, qeveria turke i dërgoi Isa Boletinit, Nuri Pashën që t'i mbushte mendjen ta ndërpriste veprimtarinë ndaj serbëve, sepse ndryshe do t'i hapte telashe të mëdha Perandorisë⁴.

Isa Boletini e njihte mirë politikën me dy faqe të Portës së Lartë dhe e kuptonte drejt rrezikun që paraqiste kjo për tërësinë e trojeve shqiptare. Ai e kishte më se të qartë se në luftën kundër rre-

1) PAAA. Aneks i relacionit nr. 117 i ambasadës gjermane në Therapia, kontit von Bulov, 18 shtator 1901.

2) AQSH, Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

3) HHSStA, PA, Rap. nr. 155 konsulli Para në Shkup, Vjenës, 7 gusht 1901.

4) AQSH, Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

zikut serb nuk mund të mbështetësh te Porta e Lartë, e cila për ta shtyrë sa më shumë fundin e saj, ishte gati të sakrifikonte pjesë të tëra të trojeve shqiptare. Prandaj ai, nuk iu bind as iradesë dhe as kërkesës së të dërguarit të Portës së Lartë. «Unë — ju përgjegj Isa Boletini Nuri pashës — nuk mundem me msheleë sytë kur punohet në dëm të vendit tim. Në qoftë se ju keni frikë prej Serbisë, ikni se shqiptarët do t'i dalin zot vendit të tyre»¹.

Vendosmëria e shqiptarëve nuk shihej me sy të mirë nga Porta e Lartë edhe për një arsye tjetër. Ajo kishte frikë se mos rritja e lëvizjes për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga synimet e shovinistëve fqinjë, mund të shndërrohej në një luftë të armatosur kundër sundimit osman. Për të shmangur këtë rrezik, Porta e Lartë mori masa për të goditur e dobësuar lëvizjen shqiptare dhe për të zhdukur sa të ishte e mundur më shumë udhëheqësit e saj. Nga njëra anë ajo dërgoi në Kosovë forca të shumta ushtarake dhe nga ana tjetër, ftoi në Stamboll Isa Boletinin dhe shumë atdhetarë, të tjerë nga Peja, Prishtina e Mitrovica, Pazari i Ri.²

Isai dhe atdhetarët e tjerë që i njihnin dredhitë e Portës së Lartë, dyshuan në «ftesën» e Stambollit, prandaj siç shkruan konsulli austro-hungarez në Shkup, asnjëri prej tyre nuk iu përgjigj ftesës së qeverisë turke³.

Atëherë qeveria turke filloi të ushtronte terror të maskuar për t'i asgjësuar në mënyrë të veçuar krerët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Kështu, më 21 shkurt, 1902, me nxitjen e autoriteteve osmane dhe të agjentëve serbë, u vra në Pejë njeri nga udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe shok i Isa Boletinit, Haxhi Zeka.

Haxhi Zeka ishte organizatori dhe frymëzuesi i Lidhjes

1) *Po aty*.

2) *HHSStA, PA*. Ref. nr. 226 i konsullit austro-hungarez në Shkup, Vjenës, 27 shtator 1901.

3) *Po aty*.

së Pejës (1899-1900), luftëtar i vendosur për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe për autonominë e saj. Humbja e Haxhi Zekës e preku thellë mbarë popullin shqiptar, dhe në veçanti Kosovën, ku ai lindi, u rrit dhe luftoi.

Vrasja e Haxhi Zekës, që kishte karakter të theksuar politik, e rriti edhe më tej urrejtjen popullore ndaj pushtuesit. Populli i Pejës e i qyteteve të tjera, i zemëruar nga ky akt kriminal, u çua në kryengritje. Në Mitrovicë populli i thjeshtë i qytetit dhe i rrethinave të tij, nën udhëheqjen e Isa Boletinit protestoi fuqishëm tek autoritetet osmane dhe në emër të të gjithë krahinës i dërgoi Portës së Lartë një telegram, ku kërkohej dënimi i vrasësve të Haxhi Zekës e dëbimi i tyre jashtë kufijve¹. Por autoritetet osmane e bënë veshin të shurdhër ndaj kërkesave e protestave të shqiptarëve. Ato i vazhduan më tej përpjekjet për asgjësimin e atdhetarëve shqiptarë.

Në fund të muajit mars 1902 autoritetet osmane mundën të kapnin pabesisht Aqif Pazarin, njërin nga krerët popullorë të Pazarit të Ri, dhe e dërguan ishëhurazi në Stamboll. Sapo kjo gjë u zbulua, u njoftua menjëherë Isa Boletini².

Forcat kryengritëse zunë bashkinë e qytetit. Prej aty Isai i dërgoi një telegram Portës së Lartë, në të cilën tregoi se dëshira dhe vullneti i kryengritësve ishte liri i menjëhershëm i Aqif Pazarit si dhe shkarkimi nga detyra i Kajmekamit të Pazarit të Ri, si pjesëmarrës në arrestimin e Aqifit³. Porta e Lartë u gjend në udhëkryq. Një përgjigje pozitive ndaj telegramit të kryengritësve, do ta ulte mjaft autoritetin e saj si brenda ashtu edhe jashtë Perandorisë. Nga ana tjetër, grumbullimi i një

1) «La Nazione Albanese». Catanzaro, 15 prill 1902, viti VI, nr. 17, f. 10.

2) AQSh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

3) Archives du Ministère des Affaires Etrangères, Correspondance politique consulaire. Më tej: AMAE.CPC. Letër e konsullit të Francës në Shkup Kublie ministrit të Punëve të Jashtme të Francës Delkase, 10.4.1902.

numri të madh shqiptarësh të armatosur në një vend krejt të çorganizuar nga ana ushtarake¹, e detyronte Portën e Lartë të mos e nënvleftësonte kërkesën e shqiptarëve. E ndodhur në këtë pozitë ajo preferoi rrugën e mesit «të artë», duke i kthyer Isait dhe kryengritësve shqiptarë një përgjigje të papërcaktuar, ku thuhej se për këtë çështje të merreshin vesh me Shemsi pashën (komandant i Korparmatës XVIII osmane në Mitrovicë), sepse gjoja ishin gjëra të vogla që mund të zgjidheshin fare lehtë midis tyre dhe s'kish përse të ndërhynte Porta e Lartë². Në të njëjtën kohë Porta porositi Shemsi pashën që të përdorte të gjitha format për të përçarë kryengritësit.³

Kjo përgjigje nuk i qetësoi kryengritësit. Me propozimin e Isa Boletinit, iu dërgua Portës së Lartë një telegram tjetër si ultimatium, ku kërkohej lirimi i Aqif pashë Pazarit brenda 24 orëve.⁴ Në këtë kohë, në gjirin e kryengritësve, — shkruante në letrën e tij konsulli francez në Shkup, — flitej se nuk e donin sulltanin⁵. Nga frika se mos lëvizja e Pazarit të ri shndërrohej në kryengritje të gjerë me kërkesa politike më të qarta e më të përcaktuara, qeveria turke u detyrua më 7 prill të lironte Aqif Pazarin dhe të shkarkonte nga detyra Kajmekamin e Pazarit të Ri⁶.

Kjo fitore u tregonte edhe një herë shqiptarëve se vetëm duke qenë të bashkuar dhe të vendosur në luftë mund të mbronin të drejtat e tyre. Lëvizja e Pazarit të Ri e afirmoi Isa Boletinin si një udhëheqës të zot të një lëvizjeje të gjerë, ku merrnin pjesë jo vetëm luftëtarë të Mitrovicës, por edhe të disa krahinave të tjera si Podgori, Vuçiterni, Peja, etj. Kjo dëshmonte për rritjen e autoritetit dhe zgjerimin e ndikimit të tij në masat popu-

1) *Po aty.*

2) *AQSh.* Fondi nr. 74, dosja nr. 4, B. Viktor. *La révolution turque*, Paris, 1909, f. 163.

3) *Po aty.*

4) *Po aty.*

5) *AMAE.* Letër nr. 2 konsulli Kublie, Shkup, — ministrit të Punëve të Jashtme, Delkase, 10 prill 1902.

6) *Po aty.*

llore. Në të njëjtën kohë, kjo kryengritje i tregoi Portës së Lartë se Isa Boletini ishte një njeri i rrezikshëm për politikën e saj sunduese në viset shqiptare, një njeri që do t'i kundërvihej kësaj politike në të gjitha drejtimet.

Krahas reaksionit politik që ndërmori ndaj udhëheqësve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, qeveria osmane në fund të vitit 1901 dhe gjatë vitit 1902 e rriti më tej shtypjen ekonomike ndaj popullsisë shqiptare. Për të mbajtur në këmbë aparatit e saj burokratik, ushtrinë etj. ajo rriti rreth 6 për qind taksat ekzistuese, vendosi të tetën¹ dhe kërkoi të bënte një rekrutim të ri në popullsinë shqiptare për të mbushur radhët e ushtrisë osmane. Kjo pati si rrjedhim ngritjen e qëndresës së masave popullore, në organizimin e së cilës një rol të rëndësishëm luajti Isa Boletini. Ai u lidh me besë me krerët e Pazarit të Ri, Prishtinës, Vuçiternës, Rozhajës, Mitrovicës, Senicës etj. për të kundërshtuar me forcë rritjen e shtypjes e të shfrytëzimit ekonomik ndaj masave popullore. Duke bërë fjalë për këtë lëvizje antiosmane, revista «La Nazione Albanese» theksonte: «Në krye të të pakënaqurve ishte Isa Boletini»².

3. QËNDRESA KUNDËR NDËRHËRJES SË IMPERIALIZMIT NË SHQIPËRI

Rritja e luftës së popullit shqiptar kundër shtypjes dhe shfrytëzimit osman, për ruajtjen e tërësisë territoriale të vendit në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX si dhe dalja e Isait gjithnjë e më dukshëm në krye të lëvizjes së masave popullore në Kosovë ngjalli shqetësime jo vetëm te Porta e Lartë. Edhe Fuqitë e Mëdha imperialiste, të cilat me politikën e ruajtjes së status quo-së në Perandorinë Osmane qenë në kundërshtim të hapur me lëvizjen revolucionare të po-

1) E. Pllana: *Kosova e reformat në Turqi*: Prishtinë, 1973, f. 151.

2) «La Nazione Albanese», viti IV, nr. 15, 19 gusht 1902.

pujve të shtypur, ishin po aq të shqetësuar. Njëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Stamboll i tërhoqën vëmendjen Portës së Lartë për qëndrimin e zbutur që ajo mbante ndaj lëvizjes shqiptare dhe udhëheqësve të saj si Isa Boletinit. Ata e nxitën atë dhe i bënë presion të merrte masa energjike për të shtypur me dhunë këto lëvizje¹ e për të mos u plotësuar asnjë kërkesë shqiptarëve, ndryshe, — shkruante konsulli francez në Shkup, — do të nxiteshin lëvizje që do të paraqitnin rrezik për ngjarje të rënda² (për shkatërrimin e Perandorisë Osmane — F.M.).

Nga ana tjetër për të përmbushur synimet e saj, qeveria ruse i zgjeroi ndërhyrjet në Shqipëri në gjysmën e dytë të vitit 1902. Por planet e saj hasën në kundërshtimin e fortë të popullsisë së Mitrovicës me në krye Isa Boletinin e atdhetarët e tjerë kosovarë.

Nën pretekstin e ruajtjes së elementit të krishterë, qeveria ruse, nxori lejën nga Porta e Lartë për të hapur një konsullatë në Mitrovicë. Njëpërmjet saj ajo do të forconte ndikimin e vet në këtë krahinë, do të nxiste politikën antishqiptare të shovinistëve serbë, do të dobësonte Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.

Isa Boletini dhe udhëheqësit popullorë të Vuçiternit, Pazarit të Ri etj. nuk u pajtuan dhe nuk qëndruan indiferent ndaj kësaj përçapjeje të Rosisë. Hapjen e konsullatës ruse në Mitrovicë, me të drejtë ata e panë si një qendër spiunazhi e diversioni, si përçuese të politikës së imperializmit rus në tokat shqiptare.

Isai deklaroi se «do të vriste me dorën e vet konsullin rus në qoftë se ky do të përpiquej të hynte në Mitrovicë»³. Për të ndaluar qoftë edhe me forcë hapjen e konsullatës ruse, Isai në bashkëpunim me atdhetarët e tjerë, të mbështetur nga populli i Mitrovicës e i krahinave

1) AMAE. Letër nr. 63 e ministrit të Francës në Beograd, 20 shtator 1902.

2) *Po aty*, Letër nr. 2 e konsullit Kublie në Shkup, ministrit të Punëve të Jashtme të Francës Delkase, 10 prill 1902.

3) «Albania e vogël»: Bruksel, viti IV: nr. 3, 9 shtator 1902. f. 2.

përreth, hyri në marrëveshje me shqiptarët e rretheve të Gjilanit, Pejës. Pazarit të Ri¹, me të cilët lidhi besën shqiptare. Kundërshtimin e vendosur të popullit shqiptar krerët popullorë të këtyre krahinave ua bënë të njohur edhe autoriteteve osmane. Kështu, në ditët e para të gushtit, u dërgua te Qamil pasha (komandant i divizionit XVIII në Mitrovicë — F.M.) një delegacion i përbërë prej disa njerëzve të shquar shqiptarë për të njoftuar se shqiptarët ishin të vendosur të kundërshtonin, po të ishte nevoja edhe me qëndresë, hyrjen e konsullit rus².

Isai e kishte të qartë se autoritetet osmane nuk do ta vlerësonin kundërshtimin e popullit të Mitrovicës, madje mund të përdornin edhe forcën për t'iu diktuar atyre hapjen e konsullatës ruse. Për këtë arsye ai filloi të marrë masat e nevojshme për të kundërshtuar me armë ndërhyrjen ruse dhe për të përballuar rrethanat që mund të krijoneshin në këtë rast. Ai grumbulloi ushqimë, drithë (miell) etj., në Boletin³. Autoritetet osmane, me t'u njoftuar për planin dhe përgatitjet e Isait e atdhetarëve të tjerë i shtuan forcat e armatosura për t'i siguruar jetën konsullit rus kur ky të vendosej në Mitrovicë. Por as kjo nuk e lëkundi Isa Boletinin dhe popullin e Mitrovicës e të krahinave të tjera nga vendimi që kishin marrë.

Në fillim të shtatorit 1902 u dukën në Mitrovicë kafazi i konsullit rus dhe një shërbëtor. Isa Boletini thirri menjëherë në kuvend parinë, ku, siç bën të ditur revista «La Nazione Albanese», u vendos: Të ndiqeshin shërbyesit e konsullit rus, të ndalohej ngritja e konsullatës

1) *HHStA, PA*. Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup, kontit von Goluhovski, Vjenë, 12 shtator 1902.

2) *AMAE*. Raport i konsullit francez në Shkup Kublie, ambasadorit të Francës në Stamboll, Konstan, 3 shtator 1902.

3) *HHStA, PA*. Informacion i konsullit austro-hungarez kontit von Goluhovski, Vjenë, 12 shtator 1902; *AMAE*, Zv. Konsulli i Francës në Shkup Kublie, ambasadorit të Francës në Stamboll, Konstan, 3 shtator 1902.

dhe të mos lejohej konsulli të futej në qytet, ndryshe do ta vrisnin¹. Këto vendime të kuvendit, iu njoftuan, me anën e tellallit edhe popullsisë. Në të njëjtën kohë dihëj botërisht se kushdo që do të shkelte besën, do të vritej dhe do t'i digjej shtëpia.²

Autoritetet osmane të Mitrovicës, të shqetësuara shumë nga këto vendime të kuvendit dhe nga veprimtaria e Isa Boletinit, dërguan forca të konsiderueshme ushtarake për të siguruar hotelin.

Marrja hapur në mbrojtje e të dëguarve rusë e zemëroi së tepërmi Isa Boletinin dhe popullin e Mitrovicës dhe e rriti vendosmërinë e shqiptarëve për të mos lejuar kurrsesi strehimin e tyre në Mitrovicë. Edhe pronari i hotelit, me gjithë sigurimet që iu dhanë nga autoritetet ushtarake osmane, zbatoi menjëherë urdhrin e Isa Boletinit dhe, siç kujton Tafil Boletini, i nxori nga hoteli «mysafirët».

Shemsi Pasha, i pafuqishëm të zbuste zemërimin e popullit që rritej nga çasti në çast, i çoi përfaqësuesit e konsullatës në gazerinë për të kaluar natën. Kur kafazi rus pyeti se pse u nxorën jashtë hotelit në mënyrë aq të ashpër, Shemsi pasha iu përgjigj: «Është besa shqiptare që kishin lidhur për mospranimin e konsullit rus»³.

Në mëngjesin e ditës tjetër punonjësit e konsullatës ruse u nisën me tren nga kishin ardhur. Mbas kësaj, titullari i konsullatës ruse, me gjithë miratimin që kishte marrë nga Porta e Lartë, u detyrua të qëndronte dhe 6 javë të tjera në Stamboll në pritje që t'i hapej rruga nga shqiptarët për t'u vendosur në selinë e tij⁴.

Qëndresa e shqiptarëve të udhëhequr nga Isa Boletini, shkaktoi reaksion të fortë në qeverinë ruse. Edhe

1) «La Nazione Albanese», Kundër një konsullate ruse, artikulli i nxjerrë nga gazeta «Neue Freie Presse», viti VI, nr. 18, 30.9.1902, f. 9.

2) Po aty. Kafazi (Portieri i konsullatës)

3) AQSh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

4) AMAE, Letër nr. 1981 ambasada e Francës në Stamboll, ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Delkase, 13 nëntor 1902.

qarqet qeveritare serbe u shqetësuan së tepërmi nga kundërshtimet e shqiptarëve aq më tepër që ky ishte një kundërshtim i ndërgegjshëm, i vendosur e i organizuar, i cili u hiqte atyre një bazë mbështetëse për të plotësuar lakmitë e tyre ndaj trojeve shqiptare.

Për qarqet qeveritare ruse tashmë u bë plotësisht e qartë se qëndresa e popullit të Mitrovicës dhe e krahinave të tjera e udhëhequr nga Isa Boletini, ishte një pengesë serioze për planet e Rusisë në trojet shqiptare. Gazeta «Moskovski Vjedomosti» shkruante më 1902 se Isa Boletini është një kundërshtar i madh i hapjes së konsullatës ruse në Mitrovicë¹. Kjo është arsyeja që qeveria ruse bashkë me atë serbe, i kërkuan Portës së Lartë jo më largimin e Isa Boletinit nga Mitrovica e nga Shqipëria, siç kishin bërë gjatë kohës së lëvizjes për çarmatim, por asgjësimin e tij fizik².

Por Porta e Lartë nuk ishte në gjendje ta plotësonte kërkesën e Rusisë. Stambolli ishte bindur tashmë që, në qoftë se arrestimi i Aqif Pazarit shkaktoi lëvizjen e Pazarit të Ri, vrasja e Isa Boletinit do të kishte pasoja të mëdha dhe do t'i nxirrte shumë telashe Perandorisë. Nga ana tjetër, Porta e Lartë mendoi ta shfrytëzojë autoritetin e madh të Isait, dhe ta vinte atë në shërbim të politikës së vet, mbasi, sikurse theksonte revista «Kalendari Kombiar», «deri sa të kishte për vedi Isën, kishin për vedi gjithë ato anë të Kosovës të cilat me një fjalë të të parit të vetë, ishin gati me i qit djemtë dhe burrat e vet në mal t'uj bjerë gjithçka kishin shpi e tokë, gra e fëmijë, mjaft që ta lyppte nevoja me dalë e me dekë në luftë kundër armiqve të kombit»³. Për këto arsye, dhe e ndodhur nën presionin e Rusisë që kërkonte me këmbëngulje hapjen e konsullatës në Mitrovi-

1) PAA. Tel. nr. 163. Konsulli gjerman në Beograd, kancelarit të Rajhut von Bulov në Berlin, 1 shtator 1902. *Mitrovica* ... f. 90.

2) PAAA. Letër nr. 189 e konsullatës gjermane në Beograd, — kancelarit von Bulov në Berlin, 11 shtator 1902.

3) *Kalendari Kombiar i vjetër 1919*. Vepra Pijore: Shkodër. 1918, f. 22.

cë, sulltan Abdyl Hamiti u detyrua të dërgonte tek Isa Boletini, Shemsi pashën, si dhe miq të tij si Sulejman agë Begçeqiqin e Haxhi Adem agë Nikshiqin që t'i mbushnin mendjen të shkonte në Stamboll për të biseduar me vetë sulltanin. Ata, në emër të sulltanit i ofruan Isait mjaft pasuri e ofiqe, por edhe kjo përpjekje e tyre nuk pati sukses. «Të tjerë janë ata që shkojnë pas kockave, — i përgjigj Isai të dërguarve të Stambollit. Unë nuk jam nëpunës që të kënaqem me tituj e as tregtar për fitime»¹.

Përpjekjet e të dërguarve të Portës së Lartë për të bindur Isanë të nisej për Stamboll për të biseduar me sulltanin nuk reshtën më se dy muaj. Në fillim të nëntorit 1902, Isai duke menduar se do të mund të bindte sulltanin që të mos lejonte hapjen e konsullatës ruse në Mitrovicë, vendosi të nisej. Për siguri ai i kërkoi sulltanit që të merrte me vete tre djem të armatosur si dhe të mos lejohej vendosja e konsullit rus në Mitrovicë. Porta i pranoi këto kushte të Isait.

Ditën që Isai do të nisej për në Stamboll, u njoftua nga Sulejman aga se do të mbahej për një kohë të gjatë në Selanik. Kjo do të thoshte se Porta mund të kishte përgatitur internimin e tij, prandaj Isai e anuloi nisjen². Kështu që sulltanit iu desh përsëri të ndërmerrete bisedime të tjera me Isa Boletinin dhe ta siguronte se ndaj tij nuk do të merrej asnjë masë. Për këtë Isait iu premtua se do të dërgohej në Boletin si peng cilido që do të dëshironte Isai derisa ai të vinte në Stamboll³.

Vetëm mbas gjithë këtyre përpjekjeve dhe premtimeve, — siç shkruante dhe gazeta «Neue Freie Presse», — u bë e mundur të shtyhej Isa Boletini drejt Konstandinopolit⁴. Në fund të nëntorit Isai u nis për në

1) AQSh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) PAAA, Relacion i përfaqësisë gjermane në Beograd, kancelarit von Bulov. Berlin, 30 dhjetor 1902.

Shkup e më 4 dhjetor u nis për në Stamboll¹, i shoqëruar nga kunati i tij, Bislim Radisheva, e dy shokë të tjerë Ahmet Leskovski e Halit Ahmeti².

Premtimeve të sulltanit Isai nuk u zinte shumë besë, prandaj para se të largohej nga Boletini për në Stamboll, ai u la porosi bashkëluftëtarëve të vet që të mos pranonin në asnjë mënyrë internimin e tij dhe në rast se sulltani merrte një vendim të tillë, ata t'i përgjigjeshin me një kryengritje të hapët³.

Në takimin me sulltanin, Isai i shprehu atij kundërshtimin e vet të vendosur për hapjen e konsullatës ruse në Mitrovicë. Misionin e kësaj konsullate Isai e konsideronte një çështje politike me rëndësi, një përpjekje konkrete për të përhapur ndikimin rus në këto zona. Shqiptarët, — i tha Isai sulltanit, — nuk pajtohen kurrë që në zemër të vendit të tyre, ku nuk ka asnjë rus, të bëhet qendra e sllavizmit⁴.

Pabesia e Portës së Lartë po i nxirrte këmbët e saj. Kishin kaluar gati dy muaj dhe Isa Boletini nuk po kthehej. Vonesa e Isait i shqetësoi shokët e tij në Mitrovicë, prandaj të besëlidhurit e tij Zenel Mahmut Begoviqi, Zejnullah agë Shishekoviqi nga Vuçiterni dhe Aqif Pazari nga Pazari i Ri, sipas porosisë që u kishte dhënë Isai, organizuan një lëvizje që, filloi të marrë një zhvillim të rrezikshëm për autoritetet osmane. Në telegramin e tyre ata kërkonin kthimin e menjëhershëm të Isa Boletinit⁵.

Nën presionin e shqiptarëve sulltani mendoi ta liron-

1) HHStA, PA. Tel. nr. 50 i konsullit Para në Shkup, Vjenës, 4 dhjetor 1902.

2) PAAA. Relacion i përfaqësisë gjermane në Beograd, kancelarit von Bulov, Berlin, 30 dhjetor 1902.

3) Po aty:

4) «Zastava», organ i Partisë Radikale serbe, nr. 22, Novi Sad, 20 mars 1903. Cituar sipas E. Pllanës, në artikullin «Popujt e Kosovës ndaj reformave në Turqi», në: «Kosovo», nr. 3. Prishtinë, 1974, f. 110.

5) PAAA. Relacion i përfaqësisë gjermane në Beograd, kancelarit të Rajhut, von Bulov, Berlin, 30 dhjetor 1902.

te Isa Boletinin, por hasi në kundërshtimin e rreptë të ambasadorit rus në Stamboll, Zinovievit¹. Kështu që Porta e Lartë e mbajti të veçuar Isa Boletinin në Stamboll deri në vitin 1906.

Gjatë viteve që qëndroi në Stamboll, Isai mbajti lidhje të rregullta me popullin e atdheun. Shtëpia ku ai qëndronte priste e përcillte çdo ditë miq e shokë që vinin nga Kosova dhe e njoftonin atë për gjithçka që ndodhte atje. Për veprimtarinë atdhetare të Isait në Stamboll ne sot për sot nuk kemi të dhëna dokumentare. Në kujtimet e Tafilit përmendet propozimi që autoritetet osmane i bënë Isa Boletinit për të qëndruar përgjithmonë në Stamboll. Ato i prematuan atij grada dhe ofiqe, por Isai i hodhi poshtë me përgjigjen «Boletini është më i mirë se Stambolli»².

Pak kohë pas largimit të Isa Boletinit në Stamboll, filloi punë në Mitrovicë konsulli rus, Grigor Shçerbin. Në këtë mënyrë, qeveria turke iu bind vullnetit të më të fortit, duke shkelur premtimin që i kishte dhënë Isa Boletinit. Kjo e rriti pakënaqësinë e masave popullore shqiptare, të cilat, nga fundi i shkurtit 1903, filluan përpjekjet për organizimin e një lëvizjeje kundër reformave që Porta e Lartë po zbatonte në vilajetin e Kosovës, të Selanikut e të Manastirit, si dhe kundër hapjes së konsullatës ruse në Mitrovicë³. Për të zgjeruar më shumë lëvizjen, krerët popullorë, hynë në lidhje me krahinën e Pejës e me disa krahina të tjera që i kishin dhënë besën Isa Boletinit dhe bënë plane për të hyrë në Mitrovicë⁴.

Më 29 mars 1903 shqiptarët të mbledhur në Vuçitern, u nisën drejt Mitrovicës. Kjo ngjalli alarm të madh në forcat osmane dhe në konsullatën ruse të sapohapur. Forcat osmane u vendosën përreth qytetit. Për të ndje-

1) *Po aty*.

2) *AQSh*. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

3) *AMAE*. Raport i nënkonsullit të Francës në Shkup, ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Delkase, 1 prill 1903.

4) *Po aty*.

kur nga afër zhvillimin e ngjarjeve erdhi edhe konsulli rus, Shçerbin. Me urdhër të tij, forcat osmane hapën zjarr mbi kryengritësit shqiptarë, që tashmë kishin arritur tek ura në hyrje të qytetit. Nga luftimet e ashpra që u zhvilluan mbetën të vrarë afro 300 shqiptarë. Kryengritësit u detyruan të tërhiqeshin për të zënë pozicione më të përshtatshme. Të nesërmen në mëngjes konsulli rus shkoi për të kontrolluar pozicionet e forcave osmane dhe i kërkoi komandantit turk, Sait Beut, të rifillonte luftimet kundër shqiptarëve.¹ Në këtë kohë ushtari Ibrahim Halit Popovci nga Gjilani, kur mori vesh se cili ishte konsulli rus, për shkak të të cilit një ditë më parë qenë vrarë 300 shqiptarë, e qëllloi atë me pushkë dhe e plagosi rëndë. Mbas disa ditësh konsulli rus Grigor Shçerbin vdiq.

Vrasja e konsullit rus shkaktoi zemërimin e qeverisë ruse. Megjithëse në këtë kohë Isai nuk ishte në Shqipëri, Rusia bënte atë përgjegjës për vrasjen e konsullit rus. Cari i Ruisë i kërkoi sulltanit kokën e Isa Boletinit². Për këtë qëllim Cari, sikurse del nga kujtimet e Tafil Boletinit, dërgoi në Stamboll dy herë ambasadorin turk në Petrograd, Turhan pashën. Në një takim të rastit Turhan pasha i thotë Isa Boletinit se «Cari i Ruisë kërkon largimin e dëngimin tuaj në gjyq, kërkon kokën tuaj. Nuk mjaftoi përzënia e kasnecëve, por edhe konsullin ta vrisnit? Unë — iu përgjigj Isa — bana punën time, më vjen keq që nuk munda me ba gja më tepër»³.

1) *Po aty*

2) *AQSh*. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

3) *Po aty*.

KREU II

LUFTA KUNDËR POLITIKËS CENTRALIZUESE TË TURQVE TË RINJ

1. KTHIMI NË SHQIPËRI DHE VEPRIMTARIA E TIJ.

Gjatë kohës së internimit të Isa Boletinit në Stamboll, populli i Kosovës nuk reshti së kërkuari lirim të Isait dhe kthimin e tij në Mitrovicë.

Edhe Isai, gjatë këtyre tre vjetëve, siç përmend Tafil Boletini në kujtimet e tij, i kishte kërkuar disa herë Portës së Lartë ta lejonte të kthehej në atdhe. Por të gjitha këto përpjekje nuk dhanë përfundime.

Në mars të vitit 1905 në Mitrovicë, Vuçitern, Pazarin e Ri etj., shpërtheu një valë e re lëvizjesh popullore, kërkesa e të cilave ishte kthimi i Isa Boletinit në atdhe. Krerët e lëvizjes hartuan një lutje, të cilën ia dërguan telegrafisht Portës së Lartë, ku kërkohet liri i Isa Boletinit¹.

Porta e Lartë e ndodhur përpara kërkesave të va-

1) HHSIA. PA. Tel. nr. 21, konsulli Zambaur në Mitrovicë, Vjenës, 22 mars 1905.

zhdueshme e gjithnjë në rritje të bashkëluftëtarëve të Isait dhe këmbënguljes së tij për t'u kthyer në vendlindje, si dhe duke u nisur nga fakti që tashmë konsullata ruse në Mitrovicë, për të cilën Isa Boletini ishte in-ternuar në Stamboll, qe hapur e forcuar, vendosi që ta lejonte atë të kthehej në atdhe. Kështu më 26 shkurt 1906¹, Isai arriti në stacionin hekurudhor të Mitrovicës ku u prit me gëzim të madh nga familja e të afërmit, nga shokët e miqtë e tij të shumtë nga krahina të ndryshme të Kosovës.

Kthimi i Isait në atdhe u bë në një kohë kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare po merrte përpjesëtime të reja. Atdhetarët revolucionarë e demokratë i shtuan përpjekjet e tyre për organizimin e saj mbi baza të reja. Në nëntor 1905 u krijua në Manastir Komiteti i Fshehtë Shqiptar «Për lirinë e Shqipërisë»². Komitete të tilla u krijuan edhe në shumë qytete të Shqipërisë së Jugut si në Korçë, në Kolonjë, në Berat, në Përmet etj. U ngritën çetat e armatosura. Kosova ishte përfshirë nga një varg lëvizjesh kundërosmane për shkak të rritjes së taksave ekzistuese e vendosjes së taksave të reja nga Porta e Lartë. Në një varg krahinash shpërthyen lëvizje, që i parashtruan Portës së Lartë jo vetëm kërkesa me karakter ekonomik, por edhe me karakter politik. Kështu, në muajin mars 1906, një numër i madh fshatrash të Vuçiternit u ngritën kundër zbatimit të lippullit u ngrit kundër arbitraritetit të Xhavit pashës, komandant i trupave ushtarake osmane në Mitrovicë dhe kërkuan largimin e tij nga Peja⁴.

Autoritetet osmane, për të shuar këto lëvizje kërkuan përkrahjen e Isa Boletinit. Isai «pranoi» kërkesën e

1) *Po aty*. Tel. i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Vjenës, 26 shkurt 1906.

2) *Historia e Shqipërisë*, Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 361.

3) *AMAE*. Letër nr. 10 e zëvendëskonsullit. Krajevski në Shkup. ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Burzhua, 18 prill 1906.

4) *AQSH*. Fondi nr. 74. dosja nr. 4.

tyre dhe së bashku me ta, u nis për në Pejë e në Vuçitern, por qëndrimi i tij ndaj kryengritësve që i kundërt me atë që shpresonin autoritetet osmane. Ai i përkrahu kërkesat e kryengritësve, e mbështeti luftën e tyre dhe i kërkoi Portës së Lartë largimin e Xhavit Pashës nga Peja si dhe tërheqjen e ligjit mbi taksën e re. Këmbëngulja e kryengritësve dhe aq më tepër mbështetja e tyre nga Isa Boletini, e detyruan Portën e Lartë të largonte Xhavit Pashën nga Peja¹, të mos mblidhte taksën e të pezullonte zbatimin e saj në krahinën e Vuçiternit². Kjo që një fitore për masat popullore dhe e rriti më tepër popullaritetin e Isa Boletinit.

Qëndrimi i Isait në dobi të luftës së masave popullore, binte në kundërshtim me interesat e imperializmit në Shqipëri e në Ballkan. Fuqitë e Mëdha, e shihnin me shqetësim rritjen e lëvizjes së armatosur në Shqipëri. Kthimin e Isait në Mitrovicë e propagandonin si të rrezikshëm se gjoja, me ardhjen e tij ishte prishur qetësia në krahinë, nuk zbatohesh më ligji i mosmbajtjes së armëve nga shqiptarët, «cubat» dhe elementët «brutalë» hynin e dilnin lirisht në shtëpinë e tij dhe ishin marrë nën mbrojtjen e tij. Në relacionin që Vjena i dërgonte ambasadorit austro-hungarez Kalise në Stamboll e porosiste atë «t'ia bënin të qartë përgjegjësinë e vet Portës së Lartë, në qoftë se si pasojë e një tolerimi të mëtejshëm të këtyre veprimeve (të Isa Boletinit) gjendja në Mitrovicë e në viset e saj do të keqësohej përsëri³ dhe t'i kërkonin rilargimin e Isait nga krahina⁴. Ndërkaq qeveria franceze, nëpërmjet konsullit të saj, më 18 prill 1906 u kërkoi me këmbëngulje

1) *Po aty.*

2) *AMAE.* Letër nr. 10 e zëvendëskonsullit francez Krajevski në Shkup, ministrit të Punëve të Jashtme, të Francës. Burzua, 18 prill 1906.

3) *HHStA, PA.* Relacion nr. 398 drejtuar baronit Kalise, Kos-tandinopojë, Vjenës, 19 prill 1906.

4) *Po aty.*

autoriteteve osmane, që ta mbanin Isain të veçuar, në mënyrë që të pakësohej sa më shumë ndikimi i tij në sytë e bashkatdhetarëve. Por përpjekjet e Fuqive të Mëdha për sabotimin e luftës antiosmane të masave popullore si dhe për rilargimin e Isa Boletinit nga Mitrovica, nuk mundën të ndalnin hovin gjithnjë në rritje të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare e brumosjen e Isa Boletinit si udhëheqës e organizator i lëvizjes së armatosur të masave popullore.

2. REVOLUCIONI XHONTURK DHE ISA BOLETINI

Për të përvijuar më drejt qëndrimin e Isait në Revolucionin Xhonturk, e shohim të nevojshme të sqarojmë shkurt përmbajtjen dhe synimet e lëvizjes së turqve të rinj. Lëvizja kombëtare borgjeze xhonturke kishite filluar qysh në vitet 60-të të shek. XIX. Ajo drejtohej kundër tiranisë së sulltan Abdyl Hamitit II¹. Programi i kësaj lëvizjeje kufizohej vetëm me kërkesën për rivendosjen e Kushtetutës së vitit 1876 dhe kryerjen e disa reformave që do të forconin Perandorinë për të përballuar më lehtë ndërhyrjen e huaj². Në të njëjtën kohë ajo ishte kundër autonomisë së popujve të shtypur. Lufta kundër absolutizmit të sulltan Abdyl Hamidit ishte pika që bashkonte shqiptarët dhe popujt e tjerë të shtypur me xhonturqit. Në lëvizjen xhonturke morën pjesë, qysh në fillimin e saj, atdhetarë shqiptarë si Ibrahim Temo, Dervish Hima, Ismail Qemali, Hamdi Ohri etj.

Në Kongresin e vitit 1907, turqit e rinj u detyruan të ndryshonin drejtimin e lëvizjes dhe vendosën të përdornin kryengritjen e armatosur si mjet për përmbysjen e autokracisë së sulltanit³. Në shpejtimin e fillimit

1) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 409.

2) *Po aty*, f. 410.

3) *Po aty*, f. 411.

të kryengritjes xhontunke, ndikuan deklarata e janarit e vitit 1908 e ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Erental, sipas së cilës, me pëlqimin e sulltanit, Vjena do të fillonte ndërtimin e hekurudhës në zonën e Mitrovicës si dhe marrëveshja anglo-ruse e qershorit të atij viti mbi reformat e reja për Maqedoninë. Këta xhonturqit i konsideronin si hapa të mëtejshëm të politikës kapitulluese të sulltanit përpara Fuqive të mëdha¹.

Këto dy ngjarje çuan në acarimin e mëtejshëm të gjendjes politike në Shqipëri. Fillimi i ndërtimit të hekurudhës në zonën e Mitrovicës, që do të lehtësonte depërtimin austriak në vilajetin e Kosovës e Manastirit, u prit nga Isa Boletini, Bajram Curri e populli i Kosovës me shqetesim të madh.

Sinjali i parë i lëvizjes së masave popullore ishte sabotimi nga shqiptarët i ekskursionit, që ishte parashikuar të organizohej më 5 korrik 1908 nga shkolla austro-gjermane e hekurudhave në fshatin Saratishtë në afërsi të Ferizajt². Shqiptarët e krahinës së Mitrovicës e të krahinave të tjera, sikurse pohon konsulli francez Krajevski në Shkup, të ndarë në dy grupe të armatosura që arrinin në 15 000 veta, bllokuan hekurudhën nga Kaçaniku në Lipjan³. Ata mbasi shkatërruan vendin e caktuar për ekskursion, u drejtuan për në Ferizaj.

Në këtë situatë, për të mbrojtur vendin nga rreziku i jashtëm, në qytetin e Prizrenit u mblodhën në kuvend krerët e Prishtinës, të Mitrovicës, të Gjakovës, të Vuçiternit e të Pejës, të cilët miratuan dhe i dërguan sulltanit një irade, ku kërkohej të merreshin masa dhe t'i pritej rruga ndërhyrjes së imperializmit austro-hungarez në Shqipëri⁴.

Duke u mbështetur në zhvillimin e mëvonshëm të

1) *Po aty*.

2) AMAE. Raport i zëvendëskonsullit francez në Shkup, Krajevski, të ngarkuarit me punë të Francës në Stamboll, Bop, 9 korrik 1908.

3) *Po aty*.

4) Z. Cana. *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*. Prishtinë, 1979, f. 33.

ngjarjeve mendojmë se Isai duhet të ketë marrë pjesë në kuvendin e Prizrenit. Përveç iradesë atje duhet të jetë diskutuar edhe nevoja e organizimit të një kuvendi më të gjerë, ku të merrnin pjesë luftëtarë nga shumë krahina të Kosovës. Këtë e mbështetnin në faktin, se menjëherë pas Kuvendit të Prizrenit krerët më të shquar të vilajetit të Kosovës, të Pazarit të ri, Prishtinës, Gjilanit, Vuçiternit, Lumës, Tetovës filluan të zbrisnin në Ferizaj. Në këtë kuvend, në krye të forcave të armatosura të Mitrovicës ishte edhe Isa Boletini, të cilin konsulli italian në Shkup e cilësonte në atë kohë si një nga udhëheqësit më të shquar të vilajetit të Kosovës¹.

Në kuvendin e Ferizajt, që filloi më 5 korrik 1908², Isai bashkë me pjesëmarrësit e tjerë, shprehu zemërimin kundër politikës ekspansioniste të Austro-Hungarisë ndaj Shqipërisë dhe dënoi politikën e lëshimeve që ndiqte Porta e Lartë ndaj trojeve shqiptare.

Lëvizja e Ferizajt nuk qe vetëm një manifestim antiimperialist e antiosman, por pati edhe kërkesa të karakterit politik. Sipas pohimeve të konsullit italian në Shkup, pjesëmarrësit e kuvendit të Ferizajt kërkuan të vetëqeveriseshin.³ Në thelb kjo kërkesë shprehte qartë aspiratën e shqiptarëve për të flakur tej zgjedhën osmane dhe për të siguruar autonominë e Shqipërisë.

Kuvendi i Ferizajt përkoi me fillimin e revolucionit të turqve të rinj, që shpërtheu më 3 korrik 1908. Turqit e rinj, menduan ta shfrytëzonin gjendjen e acaruar politike në Shqipëri, e sidomos numrin e madh të forcave të armatosura të grumbulluara në Ferizaj, që sipas të dhënave të ndryshme arrinte në afro 20 mijë veta⁴. Ata dërguan aty përfaqësuesit e tyre që të siguronin

1) *Archivio Centrale Dello Stato Roma (ACSR)*. Letër nr. 316/ 116 konsulli italian Strainer në Shkup, ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë, 15 korrik 1908.

2) *Po aty*:

3) *Po aty*.

4) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II: Tiranë, 1984, f. 412:

përkrahjen e këtyre forcave për të realizuar programin e lëvizjes xhonturke. Të dërguarit e turqve të rinj zhvilluan një agjitacion të gjerë kundër sulltanit e Fuqive të Mëdha dhe u premtuan pjesëmarrësve në kuvend, se me shpalljen e kushtetutës do t'i sigurohej kombit shqiptar liria, barazia, vëllazëria dhe drejtësia¹.

Me interes është të ndalemi në qëndrimin që mbajti Isa Boletini në kuvendin e Ferizajt ndaj revolucionit të turqve të rinj, mbasi në historiografinë e huaj, janë dhënë mendime të ndryshme për këtë problem. Ashtu si shumë udhëheqës të tjerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Isa Boletini vendosi të përkrahte revolucionin e turqve të rinj, duke shpresuar se me shpalljen e kushtetutës së vitit 1876 do të krijoheshin mundësitë për fitoren e autonomisë së Shqipërisë.

Qëndrimi ndaj revolucionit të turqve të rinj krijoi në kuvend dy rryma. Rryma e parë, me përfaqësues Isa Boletinin, Bajram Currin dhe shumë atdhetarë të tjerë, u shpreh për bashkëpunimin me turqit e rinj². Rryma e dytë, e përbërë nga përfaqësues të shtresës çifligare e që kryesohej nga Mehmet pashë Deralla u shpreh për besnikëri ndaj regjimit të vjetër të sulltan Abdyl Hamitit³.

Qëndrimi i vendosur i Isa Boletinit në krye të forcave shqiptare për t'iu kundërvënë regjimit absolutist osman, siç shkruan autori turk Mehmet Ali Ayni⁴, si dhe mbërritja aty e krerëve të Prishtinës e të Shkupit, që përkrahën mendimin e tij, bënë që kuvendi të vendoste të bashkëpunonte me revolucionin e turqve të rinj⁵.

Më 20 korrik iu dërgua sulltanit një telegram ku

1) *Po aty*.

2) Z. Cana, *vep. për.*, f. 37.

3) *Po aty*.

4) S. Rizaj, *Roli i shqiptarëve në revolucionin xhonturk*, në: «Kosovo», nr. 3, Prishtinë, 1974, f. 173.

5) Z. Cana. *vep. për.*, f. 37.

kërkohej rivendosja e kushtetutës së vitit 1876 dhe thirrja e parlamentit me përfaqësues të popullit.¹ Telegrami u nënshkrua nga 170 veta, midis të cilëve edhe nga Isa Boletini². Sulltani, meqenëse i kishte dhënë Isait titullin bej e i kishte lidhur një pension, kishte besim se ai do ta mbështeste, por siç del edhe nga kujtimet e kryesekretarit të zyrës së pallatit, Tahsim Pasha, edhe Isa Boletini kishte hyrë në rrugën e «gabueshme»³. d.m.th. po përkrahte revolucionin. Edhe ky fakt hedh poshtë mendimin e historianit jugosllav Bogumil Hrabak⁴ dhe të historianëve turq S. Kylçe⁵ e J. H. Bajur⁶ se gjoja, në kuvendin e Ferizajt, Isa Boletini i shtynte shqiptarët t'i shërbenin padishahut.

Përvoja e luftës kundër absolutizmit të sulltan Abdyl Hamitit e kishte mësuar Isanë të mos u zinte besë as premtimeve e parullave të turqve të rinj. Edhe në të kaluarën shumë herë Porta e Lartë u kishte premtuar shqiptarëve të drejta kombëtare, por në praktikë ajo u kishte mohuar atyre edhe ato më elementaret. Prandaj, Isai në kuvendin e Ferizajt, megjithëse doli në përkrahje të turqve të rinj, u bëri thirrje dhe i paralajmëroi shqiptarët që të mos u zinin besë atyre, sepse «këta halldupë, — theksonte ai — me një fytyrë të rreme propagandojnë vëllazërim e bashkim e si të mbarojnë punërat e veta, t'ia shpërblejnë mirësinat e nderet tuj i trashue prangat e robnisë mbarë kombit shqiptar»⁷.

Isai, bashkëpunimin me turqit e rinj për përmbly-

1) S. Rizaj, *art. perm.*, f. 17.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) S. Rizaj, *art. perm.* f. 119.

5) S. Külçe *Ferizovik Toplantisi ve meshrutiyet*, Izmir; 1944 (sipas përkthimit në AİH, f. 23).

6) J. H. Bayur *Turk Inkilabi tarihi Cl. kl. Inkinci Baski*. Ankara, 1963, f. 469.

7) R. Ll. Siliqi, *Pasqyrë e ditëve të përgjakshme në të pestin shekull të Shqipërisë së robëruese*. «Libri I», Trieste, 1912, f. 15.

sjen e absolutizmit, e shihte jo thjeshtë si një ndihmë që iu jepet atyre, por në radhë të parë, si një rrugë të mundshme për ta shfrytëzuar për interesat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Prandaj, Isai kërkoi në kuvend, siç shkruante revista «La nazione albanese», që bashkëpunimi me turqit e rinj të mos bazohej vetëm në premtimet e përgjithshme e të papërcaktuara si liri, barazi, vëllazëri e drejtësi, por t'u vihej atyre si kusht autonomia e Shqipërisë, mbasi «... pa këtë, — theksonte Isai, — vendi ynë do të vazhdojë të persekutohet nga turqit e rinj»¹. Të njëjtin kusht ua parashtroi turqve të rinj edhe Çerçiz Topulli në takimin që pati me ta në korrik të vitit 1908 në Pogradec².

Ndërsa përgjigja e telegramit vonohej, shqiptarët mbushnin radhë të armatosurve e përgatiteshin për të përmbushur kërkesat e tyre me forcë. Të trembur nga përmasat e lëvizjes shqiptare, përfaqësuesit e turqve të rinj, të kryesuar nga Galip beu, bashkë me kryetarin e bashkisë së Prishtinës, i dërguan sulltanit më 22 korrik 1908 telegramin e dytë ku thuhej: «Qetësimi i hovit entuziast s'është i mundur, populli me armë në dorë po zbret poshtë. Ju lutemi nxirrni një përgjigje të favorshme, se në u refuzoftë, rreziku është i paevitueshëm»³. Me një veprim të tillë, turqit e rinj synonin, nga njëra anë, të bënin presion mbi sulltanin për të pranuar shpalljen e kushtetutës dhe, nga ana tjetër, të kufizonin e të pengonin rritjen e mëtejshme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Qëndrimi i vendosur i Isa Boletinit, Bajram Currit dhe i atdhetarëve të tjerë në kuvendin e Ferizajt i mbështetur gjerësisht nga masat popullore, qe një ndër faktorët e rëndësishëm për fitoren e revolucionit. Meqenëse pjesa dërrmuese e kuvendit përkrahu këta atdhetarë, rryma e dytë, e cila kërkonte të mbrohej regjimi absolutist i sulltan Abdyl Hamitit, pësoi disfatë.

1) «La Nazione Albanese», 31 mars 1908, viti 15. nr. 10.

2) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II, Tiranë, 1984, f. 412.

3) S. Külçe, *vep, për.*, (përkth. f. 21).

Austro-Hungaria, nga ana e saj, u përpoq ta drejton-te kuvendin e Ferizajt sipas interesave të saj. Ajo u orvat të shkaktonte grindje midis popullsisë shqiptare e asaj serbe, me qëllim që të largonte vëmendjen e tyre nga synimet e veta imperialiste. Isai dhe krerët e tjerë atdhetarë i ndiqnin syçelët veprimet e austro-hungarezëve dhe e kishin pikasur me kohë rrezikshmërinë që ato paraqisnin për çështjen kombëtare shqiptare. Prandaj, në kuvend, përveç të tjerave u mor vendim që shqiptarët t'u shmangeshin konflikteve me popullsinë serbe duke mos rënë kështu në grackën e përçarësve. Për zbatimin e këtij vendimi Isai bëri përpjekje të vazhdueshme¹.

Shpallja e Hyrjetit (kushtetutës) u prit me gëzim nga i gjithë populli shqiptar. Mbas kuvendit të Ferizajt, Isa Boletini u kthye në Mitrovicë. Ashtu si mjaft veprimtarë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare edhe ai shpreonte se tani, shqiptarëve dhe kombësive të tjera të shtypura do t'u siguroheshin liritë politike dhe barazia, të premtuara nga turqit e rinj.

3. QENDRESA NDAJ REAKSIONIT KHONTURK DHE KRYENGRITJA E VITIT 1909

Me shpalljen e kushtetutës, masat popullore filluan të vepronin për të realizuar kërkesat e tyre. Ato nisën të dëbonin nëpunësit osmanë dhe t'i zëvendësonin me shqiptarë. Administrata osmane u shtur. Atdhetarët shqiptarë filluan të hapnin shkolla shqipe për mësimin e gjuhës amtare. Në mjaft qytete u krijuan klube, të cilat morën në dorë zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Turqit e rinj, përderisa nuk e kishin forcuar ende pushtetin e tyre, nuk mund të dilnin hapur kundër shqiptarëve të cilët luajtën një rol vendimtar për shpalljen e ku-

1) P. Nushi. *Isa Boletini dhe roli i tij në luftën e popullit shqiptar për çlirimin nacional e shoqëror*, në: «Përparimi» nr. 3 Prishtinë, 1979, f. 343.

shtetutës. Megjithatë në forma të ndryshme, ata iu kundërvunë rritjes së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe kërkesës së saj për autonomi, madje u munduan që ta vinin këtë Lëvizje edhe nën kontrollin e tyre. Turqit e rinj zgjeruan rrjetin e komiteteve osmane «Bashkim e përparim» në të gjitha qytetet dhe e përqendruan tërë pushtetin në duart e tyre, duke pasur si mbështetje forcat ushtarake turke¹.

Krahas këtyre përpjekjeve turqit e rinj morën një sërë masash edhe për të forcuar pushtetin e tyre. Kështu, në gusht të vitit 1908 shpallën ligjin e ri mbi shërbimin ushtarak sipas të cilit merreshin ushtarë të gjithë shqiptarët, duke përfshirë edhe ata të krahinave më malore, që deri atëherë kishin qenë të përjashtuar nga shërbimi ushtarak. Në shtator shpallën programin e tyre reaksionar të «osmanizimit» që ishte vijim i mëtejshëm i politikës së vjetër për asimilimin e kombësive joturke.² Më vonë turqit e rinj nxorën edhe mjaft ligje të tjera antipopullore, rritën taksat e vjetra dhe vunë të reja. Në këtë mënyrë, regjimi i ri kushtetues jo vetëm nuk i përlligji shpresat e masave popullore për liri, barazi e vëllazëri, por përkundrazi ashtu siç ishte shprehur Isai në kuvendin e Ferizajt në korrik 1908, po ia trashnin prangat e robërisë popullit shqiptar. Kjo i dha shkas rritjes së pakënaqësisë së masave popullore, e cila u shtri tashmë jo vetëm në zonat fushore, por edhe në ato malore. Shprehje e kësaj pakënaqësie ishte kundërshtimi gjithnjë e më i hapur i masave dhe ligjeve të reja që qeveria osmane nxirrte vazhdimisht. Kështu, në shumë krahina si në Prizren, Pejë, Mitrovicë etj., populli u vu në lëvizje. Po forcohej tek ato gjithnjë e më shumë ideja e organizimit rishtas të rezistencës antiosmane³. Në këto krahina u krijua një komision për t'i

1. *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 415.

2) *Po aty*.

3) *ACSR*. Relacion i konsullit italian Galanti në Shkup «Mbi gjendjen në Shqipëri 1968-1910». (AIH, dosja nr. L — 511).

paraqitur Komitetit të turqve të rinj në Selanik kërkesat e shqiptarëve, që ishin: shfuqizimi i ligjeve gjyqësore të urryera nga populli, përjashtimi nga taksat e shërbimi ushtarak, çelja e shkollave shqipe me shpenzimet e qeverisë, heqja e kontrollit evropian¹. Nga kërkesat e paraqitura më sipër, del se lëvizjet antiosmane të vitit 1909 ishin të karakterit ekonomik, shoqëror dhe politik.

Për të minuar lëvizjen popullore që shpërtheu në krahinat e mësipërme, turqit e rinj synuan të bënin për vete udhëheqësit e lëvizjes popullore shqiptare, ose të paktën të asnjësonin veprimtarinë e tyre.

Në këtë drejtim, një vëmendje të veçantë turqit e rinj i kushtuan Isa Boletinit. Kjo nuk ishte e rastit. Isa Boletini tashmë ishte jo vetëm një ndër udhëheqësit e mirënjohur të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por edhe një personalitet me ndikim të madh në masat popullore të Kosovës. Prandaj, turqit e rinj u përpoqën të vinin Isa Boletinin në shërbim të politikës së tyre (osmanizuese). Për këtë, ata përdorën të gjitha format e njohura, që nga premtimet për grada e ofiçe e deri te presionet e dhuna e armatosur. Në fillim turqit e rinj i kërkuan Isait të shkonte në Mitrovicë që të shprehte besnikërinë e tij ndaj regjimit të ri² dhe si shpërblim i premtuan privilegje të shumta. Por Isai nuk e pranoi kërkesën e autoriteteve osmane. Meqenëse nuk mundën ta komprometonin me «të mirë», ata iu kthyen mjeteve të presionit. Kështu, në fillim të gushtit 1908, ndërsa po ktheheshin nga Stambolli në Mitrovicë djali i Isait, Halili dhe nipi i tij Tafili, u kapën e u mbajtën peng në Selanik. Të detyruar nga autoritetet e vendit, dy të rinjtë i shkruan Isait të shkonte në Mitrovicë e t'u jepte besën turqve të rinj, përndryshe, ata nuk do të liroheshin³.

Në përgjigjen që Isai u dërgoi Halilit e Tafilit ua

1) *Po aty.*

2) *AQSH.* Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

3) *Po aty.*

bënte të qartë autoriteteve xhonturke se ishte gati t'i sakrifikonte të dy djemtë, veçse në rrugën e tradhtisë nuk do të futej kurrë. «Duhet të mos dëshpëroheni për çdo eventualitet të fatit tuaj, — u përgjigjej Isai djalit dhe nipit, — duhet të dini se unë kam edhe 8 djem të tjerë... deri tash nuk i kam puthë dorën kurkujt dhe tani nuk mund të mësohem në pleqëri»¹.

Turqit e rinj, mbasi edhe me presione të tilla nuk arritën ta bënin për vete Isanë, u orvatën ta mënjanonin atë nga ndonjë veprim i armatosur që mund të organizonte kundër tyre. Për këtë qëllim, autoritetet lokale osmane i kërkuan atij të mos lëvizte i armatosur nëpër krahina me bashkëluftëtarët e tij².

Politika antishqiptare e turqve të rinj, si dhe rritja e kundërshtimit të saj nga masat popullore, e forcuan edhe më shumë bindjen e Isa Boletinit se regjimi i ri në thelb nuk ndryshonte aspak nga ai i vjetri, se ai nuk do të bënte asgjë për Shqipërinë, por përkundrazi po përpiqej të forconte pozitat e sunduesit. Prandaj dhe lufta ndaj tij duhej thelluar e zgjeruar më tej. I lidhur ngushtë me masat fshatare e sidomos me ato malësore, Isai që ndër të parët udhëheqës të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që doli hapur kundër politikës shoviniste të turqve të rinj, mbështeti lëvizjen e gjerë antiosmane të krahinave të ndryshme dhe që iu vu punës për organizimin e qëndresës popullore.

Në fund të tetorit e në fillim të nëntorit 1908, Isai, në bashkëpunim me udhëheqësit e tjerë popullorë, kaloi nga një krahinë në tjetrën dhe u lidh me krerët e krahinave të ndryshme, si të Pesnterit, të Pejës, të Rozhajës, të Prizrenit, për t'i organizuar e për t'i bashkuar ato në luftë kundër pushtuesit osman. Kudo që kaloi, Isai zhvilloi një propagandë të gjerë dhe i bëri thirrje popullit për luftë³. Rritjen dhe zgjerimin e lëvizjes

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) Sh. Rahimi. *Kryengritjet shqiptare në Kosovë 1909-1912*, në: «Kosovo». nr. 1. Prishtinë, 1972, f. 25.

antiosmane në krahina të ndryshme të Kosovës dhe në vilajetet e tjera shqiptare, Isai dhe krerë të tjerë popullorë, si Rustem Shabani nga paria e Prizrenit, Ram Pazharani nga Gjilani etj., i shfrytëzuan për t'i dhënë lëvizjes karakter mbarëshqiptar. Me nismën e Isa Boletinit, ata u mbledhën në Ferizaj dhe vendosën të organizonin një kuvend të gjerë, në të cilin të merrnin pjesë përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, ku do të bisedohej për çështje shumë të rëndësishme¹. Të dhënat dokumentare të deritanishme nuk na dëshmojnë se çfarë do të shtrohej konkretisht në atë kuvend me karakter kombëtar, por duket se aty do të diskutoheshin probleme të rëndësishme që shtroheshin përpara Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, përballë reaksionit xhonturk gjithnjë në rritje, si organizimi i luftës së armatosur, kërkesa për autonominë e Shqipërisë etj. Me gjithë masat që morën Isa Boletini dhe krerët e tjerë popullorë, kuvendi nuk arriti të mbledhej. Turqit e rinj që kishin rënë në gjurmë kapën dhe zhdukën telegramet, duke penguar në këtë mënyrë lajmërimin e krahinave të tjera. Gjithashtu turqit e rinj nisën nga Manastiri në drejtim të Ferizajt batalionin e 5-të të ndjekësve dhe një bateri të garnizonit të Prishtinës².

Rritja e veprimtarisë antiosmane e Isa Boletinit, po i shqetësonte gjithnjë e më shumë autoritetet e vendit. Nënprefektura e Mitrovicës, në nëntor 1908, i dërgoi atij një letër, ku e këshillonte që të largohej nga populli dhe të mos bëhej pengesë në këtë periudhë kur mbretëronte hyrjeti³. Gjithashtu autoritetet turke ishin gati të hynin në marrëveshje me Isa Boletinin dhe për këtë i premtuan atij çdo gjë, vetëm të braktiste rrugën e luf-

1) AMAE. Raport i nënkonsullit francez Krajevski në Shkup, ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Pishon, 29 nëntor 1908; ACSR. Raport i konsullit italian Strainer në Shkup, Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, më 19.11.1908; 21.11.1908.

2) *Po aty*.

3) AQSh. Fondi nr. 74, dosja nr: 4.

tës. Isa Boletini i hodhi poshtë edhe kësaj here kërkesat e autoriteteve osmane. Në përgjigjen e tij ai theksonte se do të luftonte jo për të fituar privilegje, por kundër padrejtësive që i bëheshin popullit të vet, të cilat nuk i kishte duruar asnjëherë¹.

Më në fund turqit e rinj, kur panë se dredhitë, premtimet e presionet nuk dhanë përfundim dhe se Isai gjithnjë e më shumë po bëhej një rrezik i madh për politikën dhe administratën e tyre, vendosën të përdornin forcën kundër tij. Më 20 nëntor 1908 Xhavit Pasha në krye të forcave të shumta ushtarake, iu drejtua Boletinit. Objekti kryesor i goditjes së forcave osmane ishte Isa Boletini, të cilin donin ta kapnin ose ta vrisnin, sepse po bëhej një ndër organizatorët e qendrës shqiptare, rritja e së cilës, — siç shkruante konsulli francez në Shkup, — i tmerronte xhonturqit². Në këtë kohë Isai ndodhej në Podgor të Pejës. Me të marrë vesh qëllimin e ardhjes së forcave osmane, Isai u nis me shpejtësi bashkë me luftëtarët e tij për në Boletin. Në të njëjtën kohë ai u dërgoi lajm luftëtarëve të Selacit e të gjithë krahinës së Shalës për t'i ardhur në ndihmë. Ndërkohë, i biri i Isait, Halili³, dhe nipi i tij Tafili, kishin filluar përgatitjen në kullë për të përballuar sulmin e Xhavit Pashës.

Më 22 nëntor 1908, forcat ushtarake osmane hynë në Boletin⁴ dhe, duke iu afruar kullës në dy drejtime me dy kolona, e rrethuan atë. Në afërsi të kullës Xhavit Pasha vendosi 4 topa, ndërsa 6 të tjerë, i vuri në kordinën e Rahovës përballë saj, me qëllim që të përqen-

1) *Po aty*.

2) *AMAE*. Letër nr. 85 e zëvendëskonsullit të Francës Krajevski në Shkup, MPJ të Francës, 20 nëntor 1908.

3) Pas dështimit të përpjekjes për ta detyruar Isanë të jep-te besën ndaj tyre duke i mbajtur peng djalin dhe nipin, turqit e rinj i liruan ata dhe i kthyen së Boletin.

4) *ACSR*. Letër nr. 623 e konsullit italian në Shkup Strai-ner, MPJ të Italisë, 24 nëntor 1908.

dronte zjarr të fuqishëm mbi muret e kullës së Boletinëve¹.

Nga maja e Koritës së Gurit, Isai ndiqte me kujdes lëvizjet e forcave osmane. Mbasi zbuloi planin e sulmit të tyre, organizoi mbrojtjen me forcat e tij, megjithëse këto ishin shumë më të pakta se të armikut².

Luftimet u zhvilluan të ashpra gjatë gjithë ditës. Të rrethuarit, nën komandën e Isait, mundën t'i bënin ballë me sukses si zjarrit të artilerisë, ashtu edhe sulmeve të këmbësorisë armike, duke i thyer ato disa herë. Humbjet e shumta që po pësonin forcat e Xhavit Pashës, zëvendësoheshin me forca të freskëta të ardhura nga Mitrovica. Isait i erdhën në ndihmë luftëtarë nga Selaci e fshatra të tjerë të Shalës, megjithatë raporti i forcave nuk ndryshoi. Xhavit Pasha mundi të ngushtonte rrethimin dhe zuri të gjitha shtigjet e rëndësishme nga mund të bëhej tërheqja e forcave të rrethuara në kullë³. Por edhe qëndresa e vendosmëria

1) *Po aty*. Relacion i konsullit Galanti në Shkup mbi gjendjen në Shqipëri në vitet 1908-1910, MPJ të Italisë. (AIH, dosja L — 511)

2) *AQSh*. Fondi nr. 74, dosja nr. 4. Ja si përshkruhet vendosmëria e Isait për luftë kundër forcave osmane në këngën popullore kushtuar luftës së zhvilluar pranë mureve të kullës së Boletinit në këtë kohë.

Isa Begu rrin n'krevat
mirë po i flet nana e vet
po vijnë topat me katana
tre sahat po i ndihet gjama,
rri moj nënë mos kije dent
do t'a baj një luftë me mbret
kam ba kullë për devlet,
topi murit nuk po ja qet
hapi arkat me fishek/ merrni djem sa të doni vet.

3) *AQSH*: Fondi nr. 74, dosja nr. 5. Për zhvillimin e luftimeve kënga vazhdon:

N'korit të gurit lufta ka fillue
Shumë ushtarë i ka damtue.
Të shtat krajlat po bajnë seri
pesë tabore si i ndjek një njeri?

e Isait dhe e luftëtarëve të tij ishte e madhe. «Derisa të kemi fishekë, — u thoshte Isai luftëtarëve, — nuk duhet lëshuar vendi»¹.

Rrethimi po bëhej gjithnjë e më i ngushtë, municioni po mbarohej dhe vazhdimi i mëtejshëm i luftimit ishte i pamundshëm. Në këto kushte, Isa Boletini vendosi të linte kullën e të çante rrethimin. Ai, me mjaft mençuri, organizoi zjarrin e të gjitha armëve të luftëtarëve të tij që shkaktoi panik në radhët e armikut dhe në shpejtësi e befasi, mundi të largohej bashkë me luftëtarët dhe familjen e tij në drejtim të Isniqit të Pejës². Në këtë betejë Xhavit Pasha la disa të vrarë e të plagosur, ndërsa nga forcat e Isait pati tre të vrarë e dy të plagosur. Midis të vrarëve ishte edhe xhaxhai i tij, kurse të plagosur ishin vetë Isai dhe Bislum Radisheva.³

Lufta mbrojtëse në kullën e Boletinit midis luftëtarëve shqiptarë me në krye Isa Boletinin dhe forcat osmane, pati rëndësi të madhe politike. Ajo bëri që në masat popullore të zhdukej çdo iluzion për turqit e rinj dhe për parullat e tyre për liri, barazi, vëllazëri e për kushtetutë.

Kështu në kullën boletinase u shpalos së pari flamuri i qëndresës me armë ndaj regjimit xhonturk. Jehona e betejës u përhap anë e mbanë Kosovës. Kjo e rriti edhe më tepër figurën e Isa Boletinit në sytë e masave popullore. Trimërinë që ai tregoi në këtë betejë dhe vendosmërinë për të mos rënë gjallë në duart e armikut populli e përjetësoi në këngët e tij³.

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) ACSR. Letër nr. 623 e konsullit Srainer në Shkup, ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë, 24 nëntor 1908; AQSh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

4) Gaz. «Drita», 25 janar 1981.

«Isa begu koka varrue
a ra n'kullë me u mjekue

Të nesërmen, forcat e Xhavit pashës, mbasi nuk arritën ta kapnin Isa Boletinin, grabitën gjithçka që gjetën në kullë dhe dogjën atë e kullat e tjera të Isait në Banjë, Maticë e Zharovnicë¹.

Edhe pas dështimit që pësuan në Boletin, xhonturqit nuk hoqën dorë nga orvatjet për ta zhdukur fizikisht Isa Boletinin. Ata e ndoqën atë vazhdimisht, madje paguan dhe agjentë për ta vrarë². Por nuk ia arritën qëllimit, sepse Isanë e strehonte dhe e mbronte populli i thjeshtë.

Pranvera e vitit 1909 i gjeti masat popullore dhe Isa Boletinin në kontradiktë të acaruar me turqit e rinj. Të korrat e këqija të dy viteve të mëparshme, pengimi i mallrave austriake për shkak të aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës nga Austria nga njëra anë, dhe mbledhja e taksave të prapambetura të vitit 1908, nga ana tjetër, bënë të keqësohej më tej gjendja ekonomike e Shqipërisë e për rrjedhojë, të përnapej e të forcohej lëvizja antiosmane në vilajetet e Shkodrës, Janinës dhe në një sërë krahinash të vilajetit të Kosovës si në Mitrovicë, në Pejë, në Gjakovë, në Lumë, në Dibër, në Pazar të Ri³. Popullsia e këtyre krahinave nuk pranoi të paguante taksat e të jepte ushtarë për perandorinë. Nëpunësit e administratës osmane nuk mundnin të zbatonin urdhërat e qeverisë, sepse priteshin me armë nga masat popullore.

Isa Boletini, megjithëse i plagosur nuk e ndërpreu veprimtarinë e tij. Ai e ndiqte nga afër zgjerimin dhe fuqizimin e lëvizjes antiosmane të masave popullore. Situatën e brendshme dhe të jashtme ndërkombëtare

po i lidh varrat me një marhamë
bini shok ta bëjmë piskamë
se jam shqiptar nuk dal i gjallë
për pa më ra zjarmi në qafë.

1) AQSH. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

2) AMAE. Letër e nënkonsullit francez Krajevski në Shkup. ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Pishon, 29 nëntor 1908.

3) Sh. Rahimi, *art. për.*, f. 28.

(kriza e madhe politike që u shkaktua nga aneksimi i Bosnjës, i Hercegovinës nga Austro-Hungaria, shpallja e Pavarësisë së Bullgarisë etj.), Isai e atdhetarë të tjerë, e panë të favorshme dhe e shfrytëzuan për përgatitjen e një kryengritjeje popullore kundër regjimit xhonturk. Në ato momente veprimtaria organizuese e Isa Boletinit ngrihet në një shkallë më të lartë. Ai, ashtu siç kishte vepruar edhe herë tjetër, bëri përpjekje për ta nxjerrë lëvizjen nga kuadri krahinor dhe për ta shndërruar atë në një lëvizje të gjerë e të vetme anti-osmane që të përfshinte të gjitha krahinat e Kosovës, madje edhe krahina të tjera të Shqipërisë Veriore. Për këtë qëllim, aty nga fillimi i vitit 1909 Isa Boletini hyri në lidhje bashkëpunimi me Mahmut Zajmin dhe Rustem Kabashin dhe së bashku filluan të organizonin një kryengritje kundër sundimit osman¹.

Në vijim të këtyre përpjekjeve në fund të janarit 1909, Isai shkoi nga Peja në Lumë², ku u takua me Hysen Dacin, një nga krerët e asaj krahine, me të cilin bisedoi për kryengritjen e armatosur. Propaganda e Isait edhe në Lumë dha frytet e saj. Midis tij dhe lumjanëve u arrit një marrëveshje për t'u bashkuar në luftë kundër xhonturqve³.

Nga Luma, Isai u kthye përsëri në Pejë, ku u përpoq të tërhiqte në kryengritje dhe parinë e Pejës. Qëllimi i tij ishte që në luftë kundër sunduesit osman, shqiptarët të ngriheshin të bashkuar dhe turqit e rinj të mos kishin në Shqipëri një mbështetje shoqërore. Por, me gjithë përpjekjet e Isait, Zenel Mahmut Begolli, përfaqësues i bejlerëve e çifligarëve të mëdhenj të Pejës, nuk pranoi të merrte pjesë në kryengritje. Atë si dhe shumë bejlerë të tjerë të Pejës, i lidhnin interese të shumta ekonomike me xhonturqit. Këtë ata e për-

1) *Centralni Drzhavni Istoričeski Arhiv, Sofie (më tej: CDIA). Letër e Agjencisë bullgare në Shkup, MPJ/ të Bullgarisë, 12 mars 1909.*

2) *Po aty; ACSR. Letër 114/37 e konsullit italian në Shkup, Galanti, MPJ të Italisë, 18 mars, 1909.*

3) *Po aty:*

ligjin me pretekstin se nuk mund të luftonin kundër kushtetutës¹.

Ndërkaq Mahmut Zajmi i premtoi Isait se do të ngrihej në kryengritje sapo të hidhej krahina e Lumës².

Marrëveshje të tilla u arritën edhe midis krerëve të Prizrenit, Gjilanit, Pozharanit etj., të cilët shprehën gatishmërinë se do të ngriheshin në luftë me t'u dhënë sinjali³.

Isai synoi që në kryengritje të përfshihej edhe popullsia katolike e Malësisë së Mbishkodrës dhe e Mirditës. Për këtë ai dërgoi në ato krahina përfaqësuesit e vet për të mbajtur lidhje dhe për të përhapur në popull idenë e kryengritjes. Një gjë të tillë Isai e bëri edhe në Dibrën e Poshtme, ku gjendja ishte në favor të kryengritjes⁴.

Ndërsa Isa Boletini dhe krerët e tjerë popullorë po përgatitnin kryengritjen antiosmane, qeveria xhonturke, që e kishte pikasur valën e re që po afrohej u bë gati të kundërvepronte. Ajo përqendroi forca e mjete të shumta ushtarake në Mitrovicë, Pejë e Lumë⁵.

Përqendrimin e forcave, autoritetet osmane e trumbetonin si një masë për të ndjekur e asgjësuar dy komitetë shqiptarë, Isa Boletinin dhe Hysen Dacin⁶ të cilët ishin ngritur kundër kushtetutës. Por qëllimi i tyre i vërtetë ishte, të parandalonin kryengritjen që po

1) CDIA. Letër e agjencisë tregtare bullgare në Shkup. MPJ të Bullgarisë, 12 mars 1909.

2) *Po aty*.

3) *Po aty*.

4) *Po aty*. Relacion i konsullit bullgar në Shkup, MPJ të Bullgarisë, 21 mars 1909.

5) *HHStA, PA*. Tel nr. 7 i Fon Rudnay në Prizren, ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, 24 mars 1909; *AMAE*. Letër e zëvendëskonsullit Krajevski në Shkup, ambasadorit të Francës Konstan në Stamboll, 19 mars 1909.

6) *AMAE*. Letër e zv/kons. Krajevski në Shkup, amb francez në Stamboll, Konstan, 19 mars 1909; *HHStA, PA*. Tel. nr. 7 i kons. Zambaur në Mitrovicë Baronit Alois Von Ehrenthal — Vjenë, 24 janar 1909.

përgatitej nga Isa Boletini¹, dhe se në rast se ajo do të shpërthente, ta shtypnin me shpejtësi.

Për shtypjen e saj më 20 mars 1909 u nisën nga Mitrovica për në Pejë 3000 forca, të organizuara në 4 batalione, e të pajisura me 16 topa. Në krye të tyre ishte Xhavit Pasha, i cili mendoi se erdhi rasti për t'u hakmarrë për dështimin që kishte pësuar në nëntorin e vitit 1908. Më 24 mars, Xhavit Pasha urdhëroi nisjen drejt Isniqit ku ndodhej Isa Boletini² dhe premtoi shuma të mëdha për atë që do të vriste Isa Boletinin.

I lajmëruar për veprimet e forcave ushtarake osmane, Isai mbledhi në kuvend parinë dhe luftëtarët për të biseduar rreth situatës së krijuar³. Në kuvend, megjithëse pjesëmarrësit shprehën gatishmërinë për të luftuar⁴, u vendos që Isa Boletini të largohej nga Isniqi në Bellajë për të mos i dhënë shkas Xhavit Pashës për vrasje e shkatërrime⁵. Në kushtet kur ushtria xhonturke ishte shumë herë më e madhe në numër dhe e armatosur me artileri, vendimi i kuvendit për t'iu shmangur veprimeve luftarake me Xhavit Pashën ishte i drejtë, sepse krijonte mundësi për përgatitjen më të mirë të kryengritjes dhe shpërthimin e saj në një kohë më të përshtatshme. Më 25 mars 1909 forcat osmane rrethuan Isniqin duke shpresuar se do ta kapnin Isa Boletinin në befasi.

I zhgënjyer edhe një herë në shpresat e tij për asgjësimin e Isa Boletinit, Xhavit Pasha bëri raprezalje në popullsinë e krahinës dhe urdhëroi të gjendej me çdo kusht ai që e kishte njoftuar Isanë për ardhjen e ushtrisë osmane. Njëkohësisht, ai lajmëroi se kujt do që do të strehonte Isanë dhe njerëzit e tij, do t'i digjej

1) ACSR. Letër nr: 114/37 kons. italian. në Shkup — MPJ të Italisë, 18 mars 1909.

2) AMAE: Letër nr, 27 e zv/kons francez në Shkup-MPJ të Francës, Pishon. 2 prill 1909: Letër e zv/kons. francez në Shkup-amb të Francës në Stamboll, 22 mars 1909.

3) AQSh, Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

4) *Po aty.*

5) *Po aty.*

kulla. Për të detyruar masat popullore të largoheshin nga rruga e kryengrities së armatosur e të mos mbështetnin Isa Boletinin, Xhavit Pasha ushtroi terror e shkatërroi kulla jo vetëm në Isniq, por edhe në Pejë. Banië etj. Sipas një informacioni të dhënë nga konsulli austro-hungarez, në Mitrovicë, dyzet vendbanime të pasesve të Isa Boletinit u bënë rrafsh me tokën¹. Me gjithë terrorin e raprezaljet, Xhavit Pasha, jo vetëm nuk e lëkundi besimin dhe dashurinë e masave popullore për Isa Boletinin, por e shtoi edhe më shumë vendosmërinë e tyre për ta mbrojtur atë më me besnikëri. Kështu, kur Xhavit Pasha iu kërcënua Bek Tafilit (malësor nga Isniqi) se do t'ia digjnin kullën, mbasi kishte strehuar Isa Boletinin, ky iu përgjigj: «Pse a paskeni kaq shumë nge me ardhë e me ma djeg kullën sa herë të pres Isanë?»². Ndërsa kur pashai turk e pyeti nëse do ta mbante përsëri Isanë, malësori pa asnjë mëdyshje iu përgjigj: «Po besa»³.

Për mbështetjen që Isa Boletinit i jepej nga malësorët e thieshtë, bën fjalë edhe konsulli austro-hungarez në Mitrovicë në telegramin që i dërronte Vjenës, ku thotë «Ndihmë të madhe i iepnin Isa Boletinit, mbas sekuesttrimit të pasurisë së tij në rrethin e Mitrovicës në nëntorin e vitit 1908. shokët dhe miqtë e tij të shumtë»⁴.

Në raportin që nënkonsulli francez në Shkup i drejton MPJ të Francës më 13 prill 1909, midis të tjerash, përmend se në pjesë e popullsisë së Giakovës kishte dërguar pranë Xhavit Pashës një delegacion me anën e të cilit i premtuan atij se Isa Boletini nuk do të gjente strehë tek ata⁵. Një gjë e tillë ishte rrjedhojë e propa-

1) HHS_t, PA. Informacion nr. 28. Konsulli Zambaur në Mitrovicë — Baronit Alois von Ehrenthal, Vjenë, 10.4.1909.

2) AQSh. Fondi nr. 74, dosja 4.

3) Po aty.

4) HHS_t PA. Teleg. nr. 1 e kons Zambaur në Mitrovicë, Vjenës, 8 janar 1909.

5) AMAE. Raport i nënkonsullit francez Krajevski në Shkup, MPJ të Francës, Pishon, 13 prill 1909.

gandës që xhonturqit bënë kundër Isa Boletinit, i cili sipas tyre ishte ngritur dhe luftonte kundër regjimit të ri kushtetues. Por kjo vetëm për pak kohë. Vetë jeta, ngjarjet e mëvonshme do t'ua çirnin maskën parrullave të xhonturqve.

Kështu, kur u pa qartë që ekspedita ndëshkimore e Xhavit Pashës në rrethin e Pejës, nuk kishte për qëllim vetëm asgjësimin e Isa Boletinit, por kryesisht shtypjen e lëvizies antiosmane, regjistrimin e popullsisë dhe vendosien e taksave të reja, popullsia e Giakovës e paralajmëroi Xhavit Pashën që të mos e kapërcente Drinin e të mos hidhej në krahinën e tyre se ndryshe do të ndeshej me forcat e Giakovës e të malësisë së saj¹. Mbas kësaj, propaganda xhonturke kundër Isa Boletinit, nuk gjeti përkrabës në popullsinë e krahinës së Giakovës. Nierëzit e thieshtë e atdhetarë të kësaj krahine i qëndruan besnikë Isa Boletinit, e ndihmuan dhe e strehuan atë në caste të vështira. Kështu, kur Isa Boletini, i ndiekur nga forcat osmane kaloi nga Bellaja në Krasniqë të Giakovës², ai u mbait dhe u mbroit në shtënitë e fshatarëve të varfër, por të ndershëm malësorë «Jam i vobegët — i ftohtë një malësorë (Ibrahim Dollapi, Isait) — së bashku do të qëndrojmë me bukë e kripë, vetëm mos u mërzit»³.

Në maj — qershor 1909 forca të shumta osmane hyjnë në krahinën e Giakovës e të Lumës me qëllim që të çarmatosnin popullsinë, të vilnin taksat e prapambeturat e madje që t'i detvronin giakovarët e lumianët të bënë ndryshime në arkitekturën e kullave të tyre.

Terrori dhe masakrat e Xhavit Pashës në Pejë, Giakovë etj., nuk e lëkundën Isa Boletinin nga rruga e nisur. Kontradiktat midis shqiptarëve dhe turqve të rinj po acaroheshin edhe më tepër. Goditjet që morën tru-

1) *Po aty*.

2) HHS t.A.P.A. Raport nr. 14 i nënkonsullit Prohaska / në Prizren, ambasadorit austro-hungarez Pallaviçinit në Stamboll, 16 prill 1909.

3) A.Q.Sh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4:

pat osmane në Malësinë e Gjakovës e të Lumës e detyruan Xhavit Pashën të tërhiqej në qytetin e Gjakovës.

Në shtator 1909 lëvizje të reja të fshatarësisë filluan përsëri në rrethet e Ferizajt, Pejës, Prizrenit e Lumës kundër politikës antishqiptare të xhonturqve. Në emër të tyre iu paraqit më vonë qeverisë osmane një memorandum ku parashtroheshin kërkesat për emërimin e nëpunësve shqiptarë, mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha shkollat, kryerjen e shërbimit ushtarak vetëm në Shqipëri, ndryshimin e sistemit të taksave sipas nevojave të vendit etj.¹ Siç shihet kërkesat e paraqitura në dhjetor janë pak a shumë të njëjta me kërkesat e kryengritësve të udhëhequr nga Isa Boletini të paraqitura në fund të gushtit 1908.

Lëvizja e vitit 1909 e krahinave të ndryshme të Kosovës, u shtyp nga forcat osmane. Megjithëse nuk arriti të kthehej në një lëvizje të përgjithshme, zhvillimi i saj pati rëndësi, sepse shprehu papajtueshmërinë e shqiptarëve me shtypjen ekonomike, shoqërore e politike të ushtruar nga xhonturqit. Ajo që një lëvizje që drejtohej kundër centralizmit të pushtetit të xhonturqve².

Disa përfaqësi konsullore në Kosovë, të nisura thjesht nga pozita antishqiptare, në informacionin e kohës, e kanë cilësuar lëvizjen antiosmane të udhëhequr nga Isa Boletini në fund të vitit 1908 e në vitin 1909 si lëvizje reaksionare³, që gjoja ishte ngritur kundër kushtetutës, ndërsa Isa Boletini, sipas tyre, luftonte për të rivendosur regjimin e vjetër⁴. Edhe në gazetën «Liria» të Selanikut, Abdyl Ypi, po nga këto pozita në artikullin e tij «Forca e madhe e mbretërisë dhe shqiptarët»

1) Gaz: «Shqypeja e Shqypenis», Sofje, 5 dhjetor 1909, nr. 13.

2) CDIA, Konsullata diplomatike bullgare, MPJ të Bullgarisë, Cetinë, 14 prill 1909.

3) AMAE. Raport i zv/kons, francez në Shkup Krajevski, MPJ të Francës, Piston, 28 janar 1909.

4) CDIA. Informacion, legata bullgare në Cetinë, MPJ të Bullgarisë 22 janar 1909.

del kundër Isa Boletinit dhe në mënyrë provokuese pyet: «vallë nuk është aq e fortë qeveria sa të shtrojë Isa Boletinin»¹.

Këto pohime për «besnikërinë» e Isa Boletinit ndaj regjimit të vjetër të sulltan Abdyl Hamitit i përgënjeshtrojnë më së miri vetë qëndrimi që mbajti Isai ndaj kundërrevolucionit që shpërtheu në Turqi më 13 prill 1909 nga forcat feudo-klerikale dhe kompradore të lidhura me regjimin e vjetër absolutist. Siç dihet, kjo lëvizje drejtohej kundër turqve të rinj. Po të ishin të vërteta pohimet e mësipërme, vetëm kjo duhej të mjaftonte që Isa Boletini të rreshtohet në anën e kundërrevolucionit aq më tepër që turqit e rinj kishin përdorur edhe armët kundër tij.

Isa Boletini nuk u dha asnjë përkrahje forcave kundërrevolucionare të sulltanit. Qëndrimi i drejtë i Isa Boletinit në ngjarjet e 13 prillit 1909, është një dëshmi e pakundërshtueshme edhe për karakterin e lëvizjes popullore që ai udhëhoqi. Dashur pa dashur në relacionet e tyre konsullatat e huaja janë detyruar të pranojnë të vërtetën mbi karakterin e lëvizjes shqiptare të vitit 1909. Rrëzimi i Abdyl Hamitit nga fronin, shkruan zv/konsulli francez në Shkup — në qendrat shqiptare si Prizreni, Gjakova, Peja, Mitrovica e Prishtina etj., është pritur me kënaqësi².

Turqit e rinj meqenëse edhe këtë radhë nuk mundën të nënshtronin Isa Boletinin me forcën e armëve, iu kthyen rishtazi formave paqësore. Në fund të qershorit 1909, vetë kryeministri turk Hysen Hilmi pasha, i propozoi Isa Boletinit të largohej nga Kosova për në Anadoll, ku do t'i jepeshin pasuri të mëdha. Po ashtu si dhe më parë, Isai e hodhi poshtë këtë propozim të kryeministrit turk. «Të kisha pranue me iu përulë Stambollit

1) Gaz. «Liria», Selanik, mot. i parë, 21 mars 1909; nr. 34. f. 2.

2) AMAE. Letër e zv/Konsullit francez Krajevski në Shkup, ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Pishon 3 maj 1909.

e me ma vue zgjedhën në qafë, të kisha mendue për kokë e pasuri, — i daklaroi Isai të dërguarit të Hysen Hilmi pashës, — isha marrë vesh me kohë e nuk i kisha shti në grykë të topit e humbë kaq meshkuj e pasuni e djegë me qindra shtëpi të farë e fisit e të miqve. I falëm nderës Hilmi Pashës që është kujdes për të mirën teme. Tash nuk kërkoj të mirën teme, por të mirën e vendit tem»¹.

1) S. Luarasi. vep. për. f. 94.

KREU III

ISA BOLETINI GJATË KRYENGRITJEVE TË VITEVE 1910-1911

1. NË KRYENGRITJEN E VITIT 1910

Me shtypjen e kundërrevolucionit të 13 prillit 1909, xhonturqit i forcuan më tej pozitën e tyre dhe e drejtuan vëmendjen në forcimin e pushtetit administrativ lokal. Ata morën një sërë masash që çonin në rritjen e shfrytëzimit të masave popullore dhe në shtypjen e lëvizjeve nacionalçlirimtare të popujve që ishin nën zgjedhën osmane.

Në fund të vitit 1909 dhe në fillim të vitit 1910 turqit e rinj përdorën dhunën për t'i diktuar popullit shqiptar taksa të reja dhe ligjin mbi shërbimin ushtarak. Pa kaluar shumë kohë nga ardhja e tyre në pushtet, ata e hoqën maskën e «barazisë, vëllazërisë e lirisë», nxorën në shesh fytyrën e tyre të vërtetë e u hodhën në sulm të hapur kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Në këto kushte kontradiktat e popullit shqiptar me sunduesit e rinj osmanë, u acaruan së tepërmi, pakënaqësia dhe qëndresa e masave popullore në krahina të ndryshme të vendit e sidomos në Kosovë, u rrit dhe mori forma të ashpra. Sipas një vëzhguesi të huaj në Shkup, gjendja e përgjithshme në Shqipëri në fund të vitit 1909 dhe në fillim të vitit 1910, paraqitej e pasigurt, e turbullt, kudo gjakrat ishin nderur, kudo ndihej pakënaqësia. Konflikti midis komitetit xhonturk dhe shqiptarëve ishte bërë më i mprehtë¹.

Gjendjen e krijuar Isa Boletini dhe atdhetarë të tjerë kosovarë e vlerësuan të përshtatshme për organizimin e një kryengritjeje të re. Përpjekjet e Isait gjatë viteve 1908 e 1909 për t'i bashkuar lëvizjet e krahinave të ndryshme në një kryengritje të vetme patën shumë rëndësi. Ato përbënin hapat e parë të një lëvizjeje të madhe dhe në të njëjtën kohë për Isa Boletinin një përvojë të mirë për organizimin e lëvizjes së armatosur, për ta nxjerrë atë nga kuadri lokal e për ta ngritur në një lëvizje të përgjithshme e të organizuar. Përvojën e fituar gjatë viteve 1908-1909 ata u munduan ta shfrytëzonin në kryengritjet antiosmane në vitet 1910-1912.

Për shpejtimin e organizimit dhe zhvillimin e kryengritjes Isa Boletini dhe Idriz Seferi kishin marrë edhe mjaft letra nga deputetët shqiptarë të Stambollit. Siç shkruan gazeta «Le progres de Selanique» në këto letra ata bënin thirrje se kishte ardhur koha për t'u ngritur në kryengritje². Por deputetët shqiptarë në Stamboll mbetën vetëm në kuadrin e letërkëmbimit me kryengritësit. Asnjëri prej tyre nuk mundi të vinte në Kosovë, si gjatë përgatitjes së kryengritjes, ashtu edhe gjatë zhvillimit të saj për të ndihmuar në përpunimin

1) ACSR. Relacion i konsullit italian Galanti në Shkup «Mbi gjendjen në Shqipëri në vitet 1908-1910» — MPJ të Italisë. (AIH dosja L 511).

2) AMAE; Nxjerrë nga gaz. «Le progrès de Selaniques», nr. 144. 16 maj 1910.

e një programi politik që kërkonte koha. Ata e kufizuan luftën antiosmane me veprimtarinë në parlament, duke demaskuar nga tribuna e tij mizoritë e kryera në Kosovë nga qeveria dhe në kërkesën që kjo e fundit të ndryshonte qëndrimin e saj ndaj kombësisë shqiptare¹.

Në fund të vitit 1909 Isa Boletini ripërtëriu lidhjet e krijuara në pranverën e atij viti e krijoi lidhje të reja me disa nga krerët e krahinave të ndryshme. Gjatë qëndrimit në krahinën e Pejës ai u takua me parinë e Isniqit, të Malësisë së Gjakovës, të Deçanit etj., si me Sulejman Batushën, Llush Demën, Bajram Hasanin, Dem Jusufin, Elez Hoxhën etj., me të cilët u mor vesh për të organizuar një kuvend në Verrat e Llukës. Aty do të merrnin pjesë atdhetarë dhe udhëheqës popullorë e luftëtarë nga të gjitha krahinat e tjera shqiptare që do të lidhnin besën për luftë kundër qeverisë së turqve të rinj².

Ndërsa ndërmerreshin këto përpjekje gjendja në Kosovë po bëhej dita-ditës më e nderë. Në mars të vitit 1910, valiu i Kosovës, Manxhar Pasha, vendosi në mënyrë arbitrare taksën e oktrovit³, e cila nuk taktohej në asnjë vend të Perandorisë Osmane. Të parët që u ngritën kundër arbitraritetit të valiut të Kosovës, ishin fshatarët e Mitrovicës, Vuçiternit, Llapit, Prishtinës etj.⁴. Revolta e tyre shërbeu si sinjal për fillimin e kryengritjes. Masat fshatare shprehën kërkesat për shkollë shqipe, për ndërtimin e rrugëve, për të mos pa-

1) *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë, 1984, f. 438.

2) *AQSh*: Fondi nr: 74, dosja nr. 4:

3) *HHSIA,PA*. Tel. nr: 14, nënkonsulli. Prohaska në Prizren-Pallavicinit në Stamboll, 23 mars 1910 L: Simavi: Gjerduklirim. Çfarë pashë në sarajet e Sulltan Mehmet Reshadit. (Si pas përkthimit në AIH, f. 10): Taksa e oktrovit ishte një lloj takse e vjetër që u vihej fshatarëve për çdo produkt bujqësor që sillnin në treg.

4) *ACSR*: Relacion i konsullit italian në Shkup Galanti «Mbi gjendjen në Shqipëri në vitet 1908-1910 — MPJ të Italisë. (AIH, dosja L-511)

guar taksat e rënda që ishin vënë nga autoritetet e vëndit etj. Në të njëjtën kohë masat popullore të Pejës, duke mos e duruar më sjelljen e autoriteteve osmane u ngritën dhe vranë komandantin e forcave osmane, Rushit beun dhe plagosën mytesarifin e Pejës¹.

Në këto rrethana para Isa Boletinit dhe udhëheqësve të tjerë popullorë, dihte si detyrë e ngutshme të vepronin energjikisht për organizimin dhe drejtimin konkret të masave kryengritëse. Për këtë qëllim, Isa Boletini zhvilloi një veprimtari të vullshme. Ai shkoi sa në një krahinë në tjetrën, nga një qytet në tjetrin², duke zhvilluar në masat popullore propagandë për luftë kundër regjimit xhonturk, në mënyrë që kryengritja të merrte karakter sa më të gjerë popullor. Gjatë kohës që Isa Boletini vepronte në Pejë dhe në krahinë të tjera, Idriz Seferi bashkëpunonte me krerët e Gjilanit dhe të krahinës së Karadakut për të njëjtin qëllim. Në mars 1910 ata mundën të organizonin një mbledhje ku u trajtuan probleme të kryengritjes³...

Në ditët e para të prillit Isa Boletini dhe krerë të tjerë, si Hasan Hysen Budakova, Sulejman Batusha etj, vendosën të thirrej kuvendi, i cili u mbledh në fund të prillit në logun tradicional në Verrat e Llukës⁴. Aty morën pjesë përfaqësues nga Malësia e Gjakovës, nga Vokshi, nga krahina e Podgorit dhe Prekorupës, përfaqësues të shtresave të ndryshme qytetare si të esnafëve, çarshive etj.

Isai i kushtoi një vëmendje të madhe pjesëmarrjes në kuvend të përfaqësuesve nga të gjitha krahinat dhe shtresat e shoqërisë shqiptare të asaj kohe, sepse kjo kishte rëndësi të madhe si nga ana ushtarake, për forcën dhe përmasat e kryengritjes, ashtu dhe politike, se i tregohej opinionit të jashtëm se shqiptarët kishin një unitet mendimi e veprimi përballë qeverisë xhonturke.

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) Z. Cana. *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë në vitet 1908-1912*. Prishtinë, 1979, f. 100.

4) *AQSh*. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

Për këto arsye, Isai këmbënguli që në kuvend të merrte pjesë edhe Zenel Mahmud Begollaj, si përfaqësues i parisë së Pejës.

Zenel Begollaj e Jashar Pasha nuk ishin për një kuvend të tillë dhe fillimisht nuk iu përgjigjën thirrjes së Isa Boletinit por më vonë, kur panë se kuvendi u mblodh dhe nisi punimet, për të mos u komprometuar në sytë e masave dhe sidomos pasi morën edhe udhëzime nga mytesarif i Pejës¹, siç shkruante konsulli serb në Shkup, shkuan në kuvend me qëllimin e vetëm që ta sabotonin atë.

Përfaqësuesit e parisë së Pejës që në fillim u munduan ta përçanin kuvendin e t'i bindnin kryengritësit të ktheheshin në shtëpitë e tyre, por këto përpjekje dështuan. Propaganda e tyre në radhët e pjesëmarrësve në kuvend për t'i bindur ata që t'u nënshtroheshin turqve të rinj, nuk pati efektin e dëshiruar.

Qëndrimi i Zenel Begollajt e Jashar Pashës u kundërshtua me forcë nga Isa Boletini, Shaban Binaku dhe shumë krerë të tjerë të njohur të cilët, mbrojtën e propaganduan rrugën e luftës së armatosur.

Si rezultat në kuvend u krijuan dy palë të kundërta. Njëra palë përfaqësuese e bejlerëve e çifligarëve e përfaqësuar nga Zenel Begollaj e Jashar Pasha dhe pala tjetër, shprehëse e interesave të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e kryesuar nga Isa Boletini, Shaban Binaku, Sulejman Batusha².

Isa Boletini u mundua të përcaktonte për kryengritjen që po përgatitej, perspektiva më të gjera e objektiva të guximshëm. Sipas Risto Ll. Siliqit, Isai në fjalën e tij tregoi se lufta e shqiptarëve kundër turqve të rinj nuk drejtohej vetëm kundër taksave dhe arbitraritetit të autoriteteve osmane, por kishte pikësynime më të larta për çlirim kombëtar dhe për përparim shoqëror. Isa Boletini kërkonte ngritjen në luftë kundër

1) Arkivi i Kosovës (më tej; AK: Raport i kons. serb në Shkup, MPJ të Serbisë, 22 prill 1910; 5 maj 1910.

2) Z. Cana: vep. përm., f. 105.

sunduesit osman, hapjen e shkollave shqipe për fëmijët shqiptarë, emërimin e gjyqtarëve shqiptarë, hapjen e rrugëve dhe ngritjen e fabrikave për të mos i lënë djemtë të mërgonin¹.

Përmbushja e këtyre kërkesave do të çonte në realizimin shkallë-shkallë të autonomisë së Shqipërisë. Lufta e armatosur e sidomos bashkimi i të gjithë popullit shqiptar në këtë luftë, shiheshin nga Isa Boletini dhe atdhetarë të tjerë si dy faktorë të domosdoshëm për arritjen e fitores. Ai u bëri thirrje pjesëmarrësve në kuvend që të bashkoheshin me armë në dorë, se vetëm kjo rrugë do të sillte në vend të drejtat e shqiptarëve, do të mbronte nderin e Shqipërisë². «Tokën tonë që e thau osmanllia, lotët tanë nuk mujtën me e njomë e tash na kena me e vaditë me gjak të shqiptarit»³.

Jehona e Kuvendit u përhap anembanë Kosovës. Punimet e tij i ndiqte me vëmendje edhe grupi i kryengritësve i udhëhequr nga Idriz Seferi, i cili vijonte organizimin e kryengritjes në Gjilan e Vuçitern.

Për të shtypur që në embrion kryengritjen, autoritetet osmane filluan të grumbullonin e të përqendronin në Kosovë forca të shumta ushtarake. Përpara kësaj situatë qendra e kryengritësve e udhëhequr nga Idriz Seferi i dërgoi një letër Isa Boletinit ku i kërkonte që të shpejtonin lidhjen e Bësës se koha nuk priste.⁴ Por me gjithë përpjekjet që u bënë bashkëpunimi midis Idriz Seferit dhe Isa Boletinit, si dhe udhëheqësve të tjerë të forcave kryengritëse, që i kufizuar. Nuk u arrit të bashkoheshin organizativisht të gjitha forcat kryengritëse në një udhëheqje të vetme. Ato mbetën të ndara, si para, ashtu edhe gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake.

Kuvendi në Verrat e Llukës pati një rëndësi të ma-

1) R. Ll. Siliqi: *Pasqyrë e ditëve të përgjakshme në të pestin*.... Libri I, Trieste, 1912, f. 19.

2) *Po aty*, f. 19-20.

3) *Po aty*.

4) AQSh. Fondi nr, 74, dosja nr. 4.

dhe për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Ai ishte një manifestim i vendosmërisë dhe i gatishmërisë së masave popullore për të luftuar kundër sunduesit osman.

Kryengritja e vitit 1910 që në fazën e përgatitjes së saj kishte për objektiv lirinë dhe autonominë e Shqipërisë¹. Këtë gjë e vërtetojnë më së miri kërkesat e Isa Boletinit në kuvend për të luftuar për çlirimin kombëtar, për lirinë dhe bashkimin e vendit, për çeljen e shkollave shqipe si dhe kërkesa për autonominë e Shqipërisë që kryengritësit ia paraqitën kryeministrit turk në fazën e fundit të zhvillimit të lëvizjes².

Isa Boletini e udhëheqësit e tjerë popullorë bënë përpjekje ta shtrinin kryengritjen edhe në krahina të tjera shqiptare. Ai dërgoi njerëz në Malësinë e Mbi-shkodrës, në Dibër e Mat për të propaganduar kryengritien³. Si rrjedhojë, fryma e saj u përhap edhe në krahina të tjera si në Gostivar, Lumë etj. Në fillim të majit, një grup luftëtarësh nga Luma me Hysen Dacin në krye, u nis drejt Prizrenit për t'u bashkuar me kryengritësit⁴.

Nuk u la jashtë vëmendjes edhe sigurimi i ndonjë mbështetjeje nga jashtë. Në prill 1910 krerët e Llapit e të Shalës iu drejtuan konsullit serb në Prishtinë dhe i kërkuan t'i ndihmonte me armë e municion, ose t'u jepte strehim në rast se dështonte kryengritja⁵. Ndërsa në

1) *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë, 1984, f. 155.

2) ACSR. Relacion i konsullit italian Galanti në Shkup. «Mbi gjendjen në Shqipëri në vitet 1908-1910». drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë: (AIH dosja, nr. L-511)

a) Të bëhet menjëherë amnistia e përgjithshme.

b) Të lejohej mbajtja e armëve.

c) Të krijohesh një njësi e vetme administrative që të përfshinte të gjitha tokat shqiptare.

d) Të hapeshin me shpenzimet e qeverisë shkolla shqipe dhe turke etj.

3) Gaz «Dielli». Boston Mass. nr. 201, maj 1910, f. 2.

4) AK. Konsullata mbretërore serbe në Prishtinë. MPJ, Beograd. 29 prill (12 maj) 1910.

5) Sh. Rahimi: *Kryengritjet shqiptare në Kosovë 1909-1910*, në: «Kosovo». Prishtinë, 1972. nr. 1, f. 22.

maj 1910, Isai dhe Hasan Ferri dërguan njerëz në Rashkë për t'i kërkuar qeverisë serbe pushkë e fishekë¹. Duhet theksuar këtu se Isa Boletini dhe krerët e tjerë të kryengritjes i njihnin mirë pretendimet e Serbisë ndaj trojeve shqiptare dhe nuk ushqenin ndonjë iluzion ndaj saj. Por në këto çaste ata iu drejtuan Serbisë për dy arsye, së pari, meqenëse kryengritja do të zhvillohej kundër një armiku të armatosur mirë, ndihëj shumë nevoja për armë e municion. Së dyti, me kërkesën për ndihmë, ata synonin të tatonin pulsën e Serbisë, të zbulonin qëndrimin që ajo do të mbante ndaj kryengritjes shqiptare, të zbulonin nëse do t'i kishin ose jo krahët e qetë nga ana e saj². Një siguri të tillë, Isa Boletini e kërkonte sepse ai si shumë udhëheqës të tjerë popullorë e kishin kuptuar prej kohësh rrezikun që u kanosej trojeve shqiptare nga monarkitë ballkanike, të cilat prisnin rastin për të vënë në jetë planet e tyre ekspansioniste.

Duke shfrytëzuar rivalitetin që Serbia kishte me Austro-Hungarinë për trojet shqiptare, Isa Boletini në mënyrë të tërthortë bëri dhe një farë presioni ndaj qeverisë serbe. Ai i bëri të njohur asaj se shqiptarëve u ishte ofruar ndihmë edhe nga Austro-Hungaria, por ata nuk e kishin pranuar ngaqë e quanin të udhës, t'i drejtoheshin së pari Serbisë duke menduar se ajo do të ishte e gatshme³. Por qeveria serbe, meqenëse për shkak të interesave ekonomike, politike e ushtarake, zhvillonte marrëdhënie mjaft të mira me Turqinë, jo vetëm që nuk iu përgjigj pozitivisht kërkesës së shqiptarëve, por siç do ta shohim më poshtë, ajo nëpërmjet agjentëve të saj, ndihmoi në shtypjen e kryengritjes.

Ndërkaq qeveria turke, që nuk përfilli asnjë nga kërkesat e drejta të deputetëve shqiptarë në parlamentin turk, për t'i dhënë fund arbitraritetit të autoriteteve lokale në Shqipërinë Veriore, po mernte masa ener-

1) Z. Cana, *vep. për m.*, f. 134.

2) *Po aty*, f. 133.

3) *Po aty*.

gjike për shtypjen e kryengritjes me forcën e armëve. Ajo nisi në drejtim të Shqipërisë 18 batalione të korparmatës së kartërt të Selanikut, 18 batalione të korparmatës së parë të Stambollit, një numër të madh baterish artilerie dhe disa reparte kalorësish. Të gjitha këto forca do të grumbulloheshin në Shkup, nga ku do të fillonin sulmin kundër kryengritësve. Në krye të forcave osmane u vu Shefqet Turgut pasha¹.

Synimi i forcave osmane ishte që t'i kapnin në be-fasi kryengritësit dhe t'i shkëpusnin ata nga masat popullore. Këtij qëllimi i shërbente edhe deklarata demagogjike e Shefqet Turgut Pashës se forcat osmane kishin ardhur gjoja për të ndihmuar popullsinë e për të përmirësuar administratën e se populli duhej ta ndihmonte për të vendosur rregullin duke kallëzuar frymëzuesit dhe udhëheqësit e kryengritjes e duke ia dorëzuar ata autoriteteve².

Por masat popullore shqiptare, që tashmë i njihnin mirë turqit e rinj dhe synimet e tyre, jo vetëm që nuk u gënjen nga këto deklarata, jo vetëm nuk i kallëzuan e dorëzuan te xhonturqit prijësit, por i mbrojtën, i strehuan, i mbështetën dhe u bashkuan më fort rreth tyre, në luftë kundër sunduesit të huaj.

Në dhjetëditorin e tretë të prillit, forcat osmane, të komanduara nga Shefqet Turgut pasha, përbëheshin nga 40 batalione këmbësorie e ndjekësish, një regjiment kalorësie, 15 bateri dhe disa reparte mitralierësh. Nga këto forca, 8 batalione ishin vendosur në Shkup, 12 në territoret e Prishtinës, Pejës, Gjakovës, e Gjilanit. Si pikë përqendrimi të forcave ushtarake osmane Shefqet Turgut pasha zgjodhi Ferizajn, i cili që një gabim sepse u la kohë dhe rrugë kryengritësve për të zënë grykat e Cerralevës dhe Kaçanikut, pozicione mjaft të favorshme për qëndresë, që u thellua më vonë me zhve-

1) ACSR. Relacion i konsullit Galanti në Shkup «Mbi gjendjen në Shqipëri në vitet 1908-1910», MPJ të Italisë (AIH, dosja, nr. L-511)

2) *Po aty*.

ndosjen e kësaj pike në Lipjan. Synimi i Shefqet Turgut pashës ishte që t'i copëtonte forcat kryengritëse dhe t'i asgjësonte ato pjesë-pjesë.

Duke vlerësuar drejt lëvizjen e forcave osmane, Isa Boletini arriti të zbulonte planin e tyre dhe për t'iu kundërvënë atij, ai dhe krerët e tjerë kryengritës, i përqendruan forcat kryesore në dy drejtime.

Për të zënë Grykën e Cerralevës Isai në krye të 100 luftëtarëve u nis nga Isniqi i Pejës, kaloi në Podgor, Drenicë, Vuçitern dhe arriti më 19 prill në Sedllar, 4-5 orë larg në veriperëndim të destinacionit. Numri i kryengritësve arriti në 5000 veta. Më 20 prill grupi i kryengritësve të kryesuar nga Isa Boletini zuri Grykën. Grupi i dytë i kryengritësve të Gjilanit e Preshevës, i komanduar nga Idriz Seferi u nis në drejtim të Grykës së Kaçanikut.

Që të nesërmen më 21 prill grupi i Isa Boletinit u ndesh me një kolonë ushtarësh që vinte nga Shtimja në drejtim të Prizrenit. Në Grykë u zhvilluan luftime të ashpra. Forcat osmane pësuan humbje serioze dhe vetëm kur u erdhën në ndihmë forca të freskëta, kolona ushtarake osmane mundi të tërhiqej në Shtimje¹, duke lënë në 40 të vrarë dhe 50 të plagosur².

Pak ditë më vonë në Carralevë mbërriti dhe një grup tjetër kryengritësish, i kryesuar nga Hasan Hysen Budakova. Për të përcaktuar sa më drejt detyrat luftarake të forcave kryengritëse Isa Boletini, në bashkëpunim me krerët e tjerë si Musa Rahoveci, Azem Ostrozubski etj., organizuan një kuvend te sheshi i Xhamisë së Carralevës³. Aty u vendos që Isa Boletini në krye të 3000 luftëtarëve nga Podgori, Drenica, Llapit e Shala të mbron-

1) AK. Rap. nr. 544, konsullit serb në Shkup, MPJ të Serbisë, 29 prill 1910.

2) ACSR. Relacion i konsullit Galanti në Shkup «Mbi gjendjen në Shqipëri...», drejtuar MPJ të Italisë. (AIH, dosja nr: L-511)

3) AQSH. Fondi nr. 74, dosja nr. 4. Shih: Cana, vep, përm. f. 107.

te me çdo kusht Grykën në të dy anët e saj, për të penguar depërtimin e forcave osmane në drejtimin Ferizaj — Shtimje — Prizren. Ndërsa 5000 luftëtarë u shpërndanë në fshatrat Ribarë, Bllac, Godancë, Shtimje etj.¹. Këto forca kishin për detyrë të mbronin pjesën veriore të Grykës, krahun e djathtë të kryengritësve, ndërsa Hasan Hysen Budakova do të komandonte kryengritësit të përqendruar në Grykë të Jezercës në Topillë (Budakovë) për të mbrojtur pjesën jugore të Grykës së Carralevës².

Për numrin e kryengritësve në grykën e Carralevës, madje dhe për atë të të gjithë kryengritësve nuk kemi të dhëna të sakta, pasi ato shtoheshin çdo ditë, prandaj numri i tyre, siç theksonte konsulli italian në Shkup — nuk mund të njihet qoftë edhe me përafërsi³. Nga ana e saj qeveria osmane vendosi censurë të fortë për të mos lejuar të njihet gjendja e vërtetë në Kosovë. Asnjë korrespondent gazete nuk u lejua të ndiqte trupat as përpara dhe as gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake. Në këto kushte burim lajmesh mbetej vetëm qeveria osmane⁴.

Duke zënë dy pikat kyçe me rëndësi strategjike siç janë Grykat e Carravelës dhe ajo e Kaçanikut, kryengritësit kishin mundësi të zotëronin e shfrytëzonin me mjeshtëri terrenin dhe të zbatonin taktikën tradicionale të luftës popullore. Në të njëjtën kohë ato krijuan një sërë vështirësish për forcat ushtarake osmane si duke penguar lidhjen midis grupforcave ushtarake, ashtu edhe duke mos lejuar lëvizjen e trenave për furnizimin e tyre me ushqime, veshmbathje e mjete të tjera. Këto si dhe lajmet për rritjen e numrit të kryengritësve sollën shqetësime serioze në komandën osmane, sa që Shefqet Turgut pasha u detyrua të vinte në dijeni Portën e Lartë për gjendjen e vështirë dhe t'i kërkonte asaj përforcime

1) AK. Rap. i konsullit serb në Shkup, MPJ të Serbisë, 29 prill 1910.

2) AQS. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

3) ACSR. Relac. i konsullit Galanti në Shkup «Mbi gjendjen në Shqipëri...», MPJ të Italisë. (AIH, dosja nr. L-511)

4) *Po aty*.

të tjera që ta çonte aksionin në fitore¹. Mbasi e zhvendosi shtabin e përgjithshëm ushtarak nga Lipjani në afërsi të Ferizajt, Shefqet Turgut pasha u përgatit për të sulmuar kryengritësit në Grykën e Kaçanikut. Kështu më 28 prill ai dha urdhër për mësymje kundër mbrojtësve të Kaçanikut². Për dy ditë me radhë u zhvilluan luftime të përgjakshme. Qëndresa e shqiptarëve të udhëhequr nga Idriz Seferi, Adem e Mustafa Kabashi ishte heroike dhe i shkaktoi humbje të mëdha forcave osmane duke i zbrapsur ato disa herë.

Por përballë forcave të panumërta armike që e sulmonin grykën nga të katër anët dhe për shkak të municionit tepër të kufizuar, kryengritësit u detyruan të linin grykën e Kaçanikut e të tërniqeshin duke luftuar në drejtim të krahinës së Gjilanit.

Mbasi shtiu në dorë Grykën e Kaçanikut, Shefqet Turgut pasha i përqendroi batalionet dhe redifët në Ferizaj për të përforcuar sulmin kundër Grykës së Carralevës. Ministri i Luftës Mahmut Shefqet pasha, duke parë se operacionet luftarake kundër kryengritësve shqiptarë po ecnin shumë ngadalë, e mori vetë komandën e forcave operative. Për marrjen e grykës së Carralevës, ku komandonte Isa Boletini ai hartoi një plan të posaçëm veprimesh luftarake. Sipas këtij plani, forcat osmane të përqëndruara në Ferizaj, të përbëra nga 16 batalione këmbësorie, dy bateri topash dhe një korpus mitralierësh, u ndanë në tri kolona dhe filluan lëvizjen në Grykën e Carralevës në këto drejtime: Shtimje — Carralevë — Qafë, Narodimje — Duhlë — Qafë dhe Narodimje — Zaskok — Jezercë — Budakovë. Një kolonë tjetër për në Grykën e Carralevës do të nisej nga Lipjani dhe do të afrohej krahas tre kolonave të para për të marrë anën e saj të majtë³. Gjithashtu për të mbyllur rrethimin e

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) *AMAE*: Letër nr. 24, konsulli i Francës në Shkup, ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, 13 maj 1910; *ACSR*. Relacion i konsullit Galanti në Shkup «Mbi gjendjen në Shqipëri...», MPJ të Italisë (AIH, dosja nr. L-511).

forcave kryengritëse, Mahmut Shefqet pasha urdhëroi të nisej nga Prizreni një kolonë e përbërë nga 3 batalione për t'i goditur forcat kryengritëse në shpinë. Operacioni i forcave osmane në drejtim të Grykës së Carralevës filloi më 6 maj 1910. Në mëngjesin e asaj dite artileria turke bombardoi me zjarr të fuqishëm pozicionet e krengritësve. Pas përpunimit me artileri filloi sulmi i batalioneve të këmbësoresë.

Në betejën për mbrojtjen e Grykës së Carralevës, dolën në pah aftësitë e Isa Boletinit si një komandant i talentuar ushtarak popullor. Për zhvillimin e veprimeve luftarake ai hartoi dhe zbatoi një taktikë të zhdërvjellët dhe vepruese, manovroi me shpejtësi zgjuars i në rrethanat e krijuara. Nën udhëheqjen e tij kryengritësit e filluan mbrojtjen duke sulmuar kolonat armike nga pozicionet më të favorshme. Isa Boletini që ndiqte me kujdes zhvillimin e luftimeve dhe lëvizjen e forcave osmane, jepte në kohën e duhur udhëzimet e nevojshme, ngrinte lart moralin e luftëtarëve duke kërkuar prej tyre që të mos e pushonin këngën për asnjë çast¹. Isai kushtoi kujdes shfrytëzimit të municionit që ishte i pakët, prandaj i porosiste luftëtarët që ta kursenin atë sa më shumë duke qëlluar vetëm kur armiku të ishte sa më afër². Sulmin mbi Grykën e Carralevës forcat osmane e filluan në mënyrë ballore dhe në të dy krahët, por nuk mundën ta thyenin rezistencën e kryengritësve. Krahas sulmeve të këmbësoresë, Mahmut Shefqet pasha i dendësoi edhe bombardimet me artileri, jo vetëm në Grykën e Carralevës, por edhe në fshatrat përreth duke i shkatërruar ato. Këtë ai e bënte për të ngjallur panik në radhët e popullit dhe për të ndikuar për keq në moralin e kryengritësve. Por terrori, shkatërrimet dhe masakrat e tyre, nuk bënë gjë tjetër veçse e shtonin edhe më shumë urrejtjen popullore kundër pushtuesit osman. Në situatat që krijoheshin e ndryshonin me shpejtësi, Isai i

1) AQSh. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

2) *Po aty*.

drejtonte me zgjuarsi forcat e tij për t'iu përgjigjur në kohën dhe vendin e duhur manovrave të armikut që po sulmonte. Kështu, kur turqit thyen krahun e mbrojtësve nga ana e Zborcit, Isai menjëherë dërgoi përforcime, të cilat i thyen forcat osmane që kishin mundur të përparonin në pozicionet e kryengritësve.

Rëndësi të veçantë Isai i kushtoi shfrytëzimit të terrenit dhe sidomos ruajtjes e mbrojtjes me çdo kusht të lartësive më të mëdha. Në pamundësi për të depërtuar në vijën ku mbroheshin kryengritësit, komandantët e reparteteve osmane duke manovruar forcat e mjetet, ndërronin shpesh drejtimin e goditjes kryesore. Kështu, forcat e komanduara nga Xhaferr Tajari kaluan në Topillë me pikësynim të kapnin majën e Carralevës, çka do t'u siguronte atyre pozita sunduese mbi Grykën e Carravelës. Por Isa Boletini që i ndiqte me shumë kujdes lëvizjet e kundërshtarit menjëherë mori masa për sigurimin e majës. Nisi një grup kryengritësish të kryesuar nga Halil Ahmeti e Lam Halili¹. Në këto çaste kritike për kryengritësit, erdhën në ndihmë çetat e Gjakovës, të udhëhequra nga Bajram Deklani e Selim Xhula. Këto forca Isai i dërgoi në ndihmë të Hasan Hysen Budakovës për të penguar përparimin e forcave osmane drejt majës. Mbas luftimesh të përgjakshme, depërtuan nga ana jugore e Grykës 4 taborë të cilët po lëviznin me shpejtësi drejt majës së Carralevës. Sipas kujtimeve të Tafil Boletinit të parët në majë u ngjitën nipi i Isait, Jonuzi me një grup kryengritësish nga Isniqi e pas tij arriti grupi i Halil Ahmetit. Përpjekjet e kryengritësve për të mbrojtur majën me çdo kusht ishin të mëdha, por municioni i tyre i paktë dhe numri i madh i forcave armike po bënë që maja të rrezikohej. Në këto momente, ndoshta vendimtare, Isa Boletini mbasi organizoi mirë mbrojtjen e pozicioneve të zëna në afërsi të Grykës, me një grup kryengritësish me shpejtësinë e një luftëtari të ri u nis drejt majës së Carralevës. Atje rreziku ishte shumë i madh. Për ta mbrojt-

1) *Po aty.*

tur prijësin e tyre kryengritësit iu lutën Isait që të mos i ngjitej majës. «Më mirë të vritemi ne të gjithë se sa ti» — i tha atij njeri nga luftëtarët¹.

Megjithëse artileria e dendësoi zjarrin mbi ta, Isa Boletini nuk e ndali vrullin, por duke thirrur «Përpara djema!» u gjend në majë. Luftimet u zhvilluan trup me trup e të ashpra. Sulmet e befasishme, të shpejta e të fuqishme që drejtonte e organizonte Isa Boletini i detyruan forcat armike të tërhiqeshin dhe të ndërprisnin dy ditë veprimet luftarake.

Kryegritësit të komanduar nga Isa Boletini, megjithëse pësuan humbje të ndjeshme (mbi 46 të vrarë e shumë të plagosur)², i mbrojtën me vendosmëri pozicionet. Trimëria, guximi dhe heroizmi i shqiptarëve ngadhñjeu edhe një herë mbi ushtrinë osmane. Kjo ua shtoi atyre edhe më tepër besimin në forcat e veta.

Për luftën e Carrallevës, një oficer turk në shënimet e tij, midis të tjerash, shkruante: «Ne luftojmë kundër një armiku të padukshëm që shfaqet në një pikë, sulmon, pastaj zhduket dhe shfaqet në një tjetër»³. Drejtimi me zgjuarsi nga Isa Boletini i forcave kryengritëse në sulmet e kundërsulmet, shkalla e lartë e organizimit dhe drejtimit të tyre, i shtyu oficerët turq të mendonin se ato drejtoheshin nga njerëz të shkolluar e specialistë, të cilët, sipas tyre, nuk mund të ishin shqiptarë⁴. Për zhvillimin e luftimeve në Grykën e Carrallevës, konsulli francez në Shkup, në një raport të tij, midis të tjerave vërente se kryengritësit luftonin sipas

1) *Po aty*.

2) *AMAE*. Nxjerrë nga gaz. «Istanbul», nr. 1159, 20 maj 1910.

3) *Po aty*. Letër nr. 24 e zëvendës konsullit të Francës në Shkup Kalvini. MPJ të Francës, 13 maj 1910.

4) *AMAE*. Nxjerrë nga gaz. «Le progrès de Salonique», maj 1910.

një plani të caktuar e të parapërgatitur, sipas një taktike mjaft të përpunuar¹.

Ndërkaq në faqet e shtypit të kohës Isa Boletini cilësohej si gjenerali i ushtrisë shqiptare². E vërteta është se Isa Boletini nuk kishte studiuar e as kishte mbaruar ndonjë shkollë ushtarake. Aftësitë ushtarake, ai dhe krerët e tjerë të kryengritjes i kishin fituar në përvojën e gjatë të luftërave popullore kundër armiqve të vendit.

Pushimi dyditor u shfrytëzua nga komanda osmane për t'u riorganizuar dhe për të përgatitur një ofensivë më të gjerë. Më 10 maj filloi sulmi në të gjitha drejtimet Mësymja u shoqërua me bombardimet masive të artillerisë për të shkatërruar çdo gjë. Forcave osmane u erdhën ndihma të tjera nga Shkupi dhe numri i tyre u rrit shumë. Komanda osmane, 4 batalione i vendosi përballë Budakovës e Suharekës, një pjesë tjetër kaloi nga Shtimja në drejtim të Jezercës³. Operacionet luftarake kundër Isa Boletinit dhe kryengritësve shqiptarë vijonte t'i drejtonte vetë ministri i luftës Mahmut Shefqet pasha. Në Jezercë forcat osmane hasën në qëndresën e fortë të kryengritësve. Vetëm pas luftimesh të ashpra ata mundën t'i detyronin kryengritësit të tërhiqeshin në drejtim të Carralevës.

Një ndihmë të madhe u dhanë forcave osmane mësuesit e priftërinjtë serbë të këtyre zonave. Kështu p.sh., kur luftohej në Kaçanik e Carralevë, konsulli serb i Prishtinës mori udhëzime nga qeveria e tij që t'i jepte ekspeditës turke çdo përkrahje. Në zbatim të këtyre udhëzimeve, ai i porositi agjentët serbë të Ferizajt që të viheshin në shërbim të Shefqet Turgut pashës⁴.

Mbasi thyen kryengritësit edhe në Budakovë forcat

1) AMAE. Letër nr. 24 e zëvendës konsullit francez në Shkup, MPJ të Francës, 13 maj 1910

2) Gaz. «Shqypja e Shqypenis», viti II, nr. 1, 14 qershor 1910.

3) AK Rap. nr 944 i konsullit serb së Shkup. MPJ të Serbisë. 29 prill — 9 maj 1910.

4) Z. Cana. *vep. për m.* f. 142.

osmane që luftonin në atë drejtim u bashkuan me kolonën ushtarake që vinte nga Prizreni në Qafë të Duhlës¹.

Me përforcimet që i vinin vazhdimisht dhe pa marrë parasysh humbjet e mëdha që pësonte nga zjarri i mbrojtjes së Grykës së Carralevës, Mahmut Shefqet pasha e ngushtoi edhe më tepër rrethimin.

Në këto çaste tepër kritike forcat kryengritëse kishin nevojë të domosdoshme për ndihma e përforcime të reja. Kjo ishte parashikuar edhe në planin e zhvillimit të kryengritjes që u hartua para fillimit të saj.

Isa Boletini u dërgoi Sulejman Batushës dhe Shaban Binakut lajmëtarë që, sipas besës së dhënë në Verrat e Llukës, të futnin në luftim forcat kryengritëse që ata udhëhiqnin². Por ata nuk erdhën në ndihmë të të rrethuarve.

Luftimet e pandërprera prej më se tre ditësh i lodhën kryengritësit. Numri i tyre në fushën e betejës zvogëlohej gjithmonë e më shumë, ndërsa municioni, megjithëse përdorej me shumë kursim, po mbarohej. Kështu, që raporti i forcave ndryshonte gjithnjë e më shumë në dobi të armikut. Gjendja e të rrethuarve në Grykën e Carralevës bëhej gjithnjë e më e vështirë, megjithatë Isai dhe luftëtarët e tij vazhduan të qëndronin heroikisht. Duke folur për qëndresën e kryengritësve shqiptarë për mbrojtjen e Grykës së Carralevës konsulli italian në Shkup shkruante: «Kryegritësit të shpërndarë në një front shumë të gjerë bënë një qëndresë pothuajse të çmendur. Në Budakovë u luftua me një guxim të mbinjerëzishëm»³.

Rrethimi po bëhej gjithnjë e më i ngushtë. Në këto kushte vazhdimi i mëtejshëm i betejës rrezikonte asgjësimin e plotë të forcave kryengritëse, prandaj Isa Boletini dhe krerët e tjerë të kryengritjes vendosën të çanin rrethimin e të tërhiqeshin. Isai, megjithëse i pla-

1) AQSË. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

2) *Po aty*:

3) ACSR. Relacion i konsullit, Galanti në Shkup, «Mbi gjendjen në Shqipëri në...». MPJ të Italisë. (AIH, dosja, L-511).-

gosur, e drejtoi vetë operacionin për çarjen e rrethimit¹. Ai ishte mjeshër i shfrytëzimit të terrenit, dinte të ruante gjakftohtësinë e të mbante lart moralin e luftëtarëve edhe në çastet më të vështira. Në sajë të këtyre aftësive ai i drejtoi forcat kryengritëse në atë mënyrë që të gjitha veprimet u kryen me sukses dhe pa humbje. Kryengritësit të organizuar e të ndarë në dy grupe dhe me sulme të përqendruara e të fuqishme dolën prej rrethimit. Njëri grup kaloi në Moravë nëpërmjet Slivovës, Kosinës, Gadimbjes dhe u përqëndrua midis Tërpezës dhe Zhitinit², ndërsa grupi tjetër, me Isa Boletinin kaluan në Drenicë³. Gjatë tërheqjes nën zjarrin e artilerisë, — theksonte një nga komandantët turq — shqiptarët shfaqën një gjakftohtësi të veçantë dhe dije taktike⁴.

Megjithëse beteja e Carralevës mbaroi me tërheqjen e kryengritësve shqiptarë, Isa Boletini dhe luftëtarët e tij treguan shembuj të lartë heroizmi e trimërie. Me luftën e tyre ata i dhanë një shtytisë tjetër shpirtit luftarak e lirishtesë të popullit tonë, i cili i përjetësoi ata në këngët e tij. Në njërën nga këto këngë thuhet:

«Ç'ka kanë retë që po vetojnë
dy dragonj po luftojnë
në Kaçanik e Carralevë
Isa beg e Idriz Seferi
Turgut pasha me njëqind mij
Isa begu me Shqiptari»⁵.

Nga Drenica Isa Boletini, në krye të 150 luftëtarëve u largua në luginën e Drinit, në Podgor të Pejës, prej ku

1) AQS^h. Fondi nr 74, dosja nr 4.

2) AK. Rap. nr. 944, konsullata serbe në Shkup, MPJ të Serbisë, 29 prill (9 maj) 1910.

3) AMAE. Nxjerrë nga gaz. «Istanbul» (AIH, dosja L-507); AQS^h Fondi nr. 74, dosja nr 4.

4) AK. Raport i konsullit serb në Selanik. MPJ të Serbisë. 28 prill — 8 maj 1910.

5) AQS^h. Fondi nr. 74 dosja nr. 4.

kaloi në drejtim të Deçanit¹. Në ndjekje të tyre, komanda turke dërgoi forca të shumta ushtarake. Për t'i lënë kryengritësit pa ushqim e për t'i detyruar të dorëzoheheshin, autoritetet osmane urdhëruan të mbylleshin të gjitha stanet e stanarët me gjithë bagëti të zbrisnin në fshatrat e tyre. Gjithashtu, Mahmut Shefqet pasha mori masa për bllokimin e kufirit dhe i dërgoi klubit xhonturk në Shkodër 100 lira turke që do të viheshin në dispozicion të atij që me dredhi e pabesi do të vriste Isa Boletinin².

Nga Deçani Isai kaloi në bjeshkët e Hasan Ferrit në rajonin e Plavës³. Këtu ai u përpoq të hynte në marrëveshje me qeverinë malazeze për t'u strehuar në Malin e Zi.

Kështu edhe kryengritja e vitit 1910 u shtyp. Megjithëse nuk ia arriti qëllimit, Isa Boletini nuk e humbi besimin në fitoren e çështjes së drejtë për të cilën ai dhe populli shqiptar kishin luftuar dhe vijonin të luftonin. Dobësitë që u vunë re gjatë organizimit të kryengritjes, si lidhjet e dobëta midis grupeve kryengritëse, mungesa e një udhëheqjeje të vetme dhe e një programi të qartë politik, mangësitë që u vunë re gjatë zhvillimit të luftimeve si moskoordinimet e veprimeve luftarake midis grupeve kryengritëse, ruajtja nga disa udhëheqës kryesorë të kryengritjes e mëvetësisë, ngurrimit të ndonjerit për të dalë e për të kryer veprime luftarake jashtë zonës së tij, u bënë mësimet për Isa Boletinin që do t'i shërbenin atij për organizimin dhe udhëheqjen e kryengritjeve të vitit 1911 e të asaj të vitit 1912.

Shkaqet e shtypjes së kryengritjes së vitit 1910 dhe mësimet që dilnin prej saj e që përbënin edhe kyçin e fitores, Isa Boletini i ka përmbledhur me këto fjalë:

1) AMAE, nxjerrë nga gaz «Istanbul» maj 1910. HHSStA,PA. Tel. nr. 16, konsullit Prohaska në Prizren, Vjenës, 17 qershor 1910.

2) HHSStA,PA. Tel. i konsullit Zambaur në Shkodër, Stambollit 7.6.1910; AQSh. Fondi nr 74, dosja nr 4.

3) AQSh Fondi nr. 74, dosja nr 4.

«Kur të bashkohena të gjithë shqiptarët ku jena e të lidhim ndër vedi një besë shqiptare, do të jena të zotë ta përzemë urdinë e turkut jo ma me armë, por edhe me hunjt e gardhit»¹.

2. NË KRYENGRITJEN E VITIT 1911

Mbasi qëndroi afro një muaj në bjeshkë i bllokuar nga forcat osmane në afërsi të kufirit me Malin e Zi, Isa Boletini më në fund mundi të hvnte në lidhie me qeverinë malazeze. së cilës i kërkoi strehim në emër të të gjithë krerëve të kryengritjes².

Qeveria malazeze e pranoi kërkesën e Isa Boletinit dhe të krerëve të tierë kryengritës.

Në fillim të qershorit 1910³ Isai kaloi në Velikë (në Malin e Zi) së bashku me djemtë e tij dhe 13 shokë, e prej andei autoritetet kufitare malazeze e cuan në Andrijevicë ku qëndroi 10 ditë⁴. Për mbërritien e Isait me nierzit e tij u nioftua Ministria e Punëve të Jashtme dhe ajo e Punëve të Brendshme të Malit të Zi. Meqenëse Andrejevica ishte në afërsi të kufirit me Shqipërinë, ministri i Brendshëm malazez, urdhëroi që Isa Boletini të dërgohej në brendësi të vendit, në Nikshiq. Këtu ai arriti në fund të muajit qershor⁵. Prej këtej Isai shkoi në Podgoricë ku ndejti afro 3 muaj⁶.

Autoritetet malazeze fillimisht e trajtuan mirë Isa Boletinin dhe emigrantët e tjerë shqiptarë, në veçanti

1) R. Ll. Siliqi, *vep. për.*, f . 24.

2) AOSH. Fondi nr 74, dosja nr 4.

3) HHStA. PA. Tel. nr. 76. Konsulli Von Heimorth në Shkup. Vienës. 23 qershor 1910; AK. Tel. nr. 1294. kosullata principale e Malit të Zi në Shkodër, kryeministrit në Cetinë, dr. Ll. Tomashjeviç, 6/19.6 1910.

4) AK. Tel. nr. 471. komisari Protic nga Andrejevica, MPI të Malit të Zi Cetinë. 1 qershor 1910.

5) AK. Tel. nr. 1277 prefekti i Nikshiqit Zh. Nikoçeviq. MBP të Malit të Zi Cetinë. qershor. 1910

6) AIH. Dokumente ruse, dosja R-3.

krerët. Madje për ta interesoheshin drejtpërsëdrejti Ministria e Punëve të Jashtme dhe ajo e Punëve të Brendshme të Malit të Zi. Ato u dërguan prefekturave të Podgoricës, Nikshiqit dhe Andrijeviçës telegrame ku i porositin që të tregonin kujdes për Isa Boletinin dhe emigrantët e tjerë dhe të siguronin jetën e tyre¹. Në të njëjtën kohë, Isa Boletinit dhe disa krerëve të tjerë me influencë të emigrantëve shqiptarë si Hasan Ferrit, Zeqir Binakut, Brah Alisë, Mëxhun Nimani, Myrteza agës nga Kosova, dhe Zenel Shabanit, Dedë Gio Lulit, Prend Marashit, Dedë Nikës nga Malësia e Mbishkodrës, qeveria malazeze u caktoi edhe një pagë ditore që ishte më e lartë se e pjesës tjetër të emigrantëve². Në fund të shtatorit 1910 ajo e tërhoqi Isa Boletinin në Cetinë³.

Strëhimi politik dhe përkujdesia e madhe e qeverisë malazeze për Isa Boletinin dhe emigrantët e tjerë shqiptarë, nuk kishin aspak karakter njerëzor, bujar e dashamirës ndaj shqiptarëve, sikurse e propagandoi në atë kohë krahil Nikolla. E vërteta është krejt ndryshe. Prapa kësaj përkujdesjeje fshiheshin synimet e tii antishqiptarë. Qeveria e krahil Nikollës i strëhoi Isa Boletinin dhe emigrantët e tjerë shqiptarë për t'i përdorur si mish për top në luftën që po përgatitej kundër Turqisë dhe si mbështetje për përmbushjen e synimeve të saj shoviniste ndaj tokave shqiptare.

Ndryshe nga autoritetet dhe qeveria malazeze, masat nopullore i pritën emigrantët shqiptarë me shumë bujari. «Malazertë — i theksoi Isai në gazetari në korrik të 1911-tës më pritën mua dhe bashkatdhetarët e mi si vëllezër dhe bënë çmos për të na i lehtësuar vuajtjet

1) AK: Tel. i ministrit të Punëve të Jashtme Pllamenac, prefekturës së Nikshiqit, qershor 1910: tel. nr. 2297 i ministrit të Punëve të Jashtme të Malit të Zi, prefekturës së Podgoricës, qershor 1910: tel. nr. 2297 i ministrit të Punëve të Jashtme të Malit të Zi, prefekturës së Podgoricës, qershor 1910.

2) AK. Tel. i konsullit serb në Prishtinë, MPJ të Serbisë, 19/22.III:1911:

3) AK. Tel. nr. 3149, MPJ e Malit të Zi, prefekturës së Nikshiqit, 30/8 -13.9.1910.

tona. Ata nuk kursyen asgjë dhe bëjnë për ne gjithçka që kishin në dorë»¹.

Ndërkohë, mbas shtypjes së kryengritjes së vitit 1910, gjendja në Kosovë po bëhej përherë më e keqe, përherë e më e padurueshme. Terrori i egër i ushtruar nga Shefqet Turgut pasha mbi popullsinë shqiptare, vënia në zbatim e ligjit mbi shënbimin ushtarak dhe rritja e taksave, nuk i nënshtroan masat popullore në Shqipëri, përkundrazi, ato i ashpërsuan edhe më shumë kontradiktat dhe e thelluan më tej urrejtjen e tyre ndaj sunduesit osman, ndaj shtypjes dhe shfrytëzimit. Pikërisht, gjendjen e vështirë të masave popullore dhe gatishmërinë e tyre për të luftuar, Isa Boletini dhe atdhetarët e tjerë, të cilët për asnjë çast nuk kishin hequr dorë nga lufta për liri, menduan ta shfrytëzonin për organizimin e një kryengritjeje të re kundër sunduesit osman².

Në disa krahina të vendit si në Lumë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Shkup e Shkodër³ si dhe në qytetet e ndryshme të Italisë, Greqisë e Malit të Zi⁴, u krijuan komitetet e fshehta, të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në organizimin e kryengritjes së vitit 1911. Një komitet i tillë u krijua edhe në Podgoricë, në të cilin mori pjesë aktive edhe Isa Boletini. Vëmendje të veçantë Isai i kushtoi punës me emigrantët shqiptarë në Malin e Zi, të cilët do të përbënin një forcë të madhe në kryengritje. Ai bënte propagandë të vazhdueshme në mjedisin e tyre për luftë kundër xhonturqve⁵.

Në 4 shkurt 1911 në Podgoricë u organizua një mbledhje e gjerë ku morën pjesë shumë emigrantë shqiptarë. Aty u diskutua për situatën e krijuar në Shqipëri dhe u vendos që në pranverë të po atij viti ata të ktheheshin në Shqipëri dhe të fillonin përsëri luftën kundër sundi-

1) AIH. Dokumente ruse, dosja R-3.

2) AQSh. Fondi, nr 74, dosja nr 4.

3) *Historia e Shqipërisë*. Vëll, II. Tiranë, 1984, f. 447.

4) *Po aty*, f. 448.

5) *AMAE*. nxjerrë nga gaz. «Vessische Zeitung» 4. 4. 1911.

mit osman¹. Në mbledhjen e Podgoricës u formulua edhe një thirrje drejtuar gjithë shqiptarëve për t'u ngritur në mbrojtje të lirisë dhe të të drejtave të tyre. Për pjesëmarrjen e Isa Boletinit në këtë mbledhje nuk ka ndonjë dokument të mirëfilltë, por meqenëse ai në këtë kohë ndodhej në Podgoricë², duhet të ketë qenë një ndër organizatorët e mbledhjes.

Isa Boletini, gjatë kohës së qëndrimit në Mal të Zi, krahas punës që bënte me emigrantët shqiptarë, ndiqte me vëmendje edhe përgatitjet për kryengritje, që bëheshin brenda vendit. Ai mbante lidhje të vazhdueshme me krerët shqiptarë që vepronin në Kosovë, me të cilët këshillohej për zgjerimin e propagandës kundër regjimit të xhonturqve dhe për organizimin e masave popullore në luftën kundër tyre³. Kjo flet për vlerësimin e drejtë që i bënte Isa Boletini faktorit të brendshëm dhe në mënyrë të veçantë rolit të masave popullore në shpërthimin e kryengritjes dhe aq më tepër për fitoren e saj. Në mjaft krahina si në Pejë, Gjakovë etj., ishin krijuar çeta të reja të armatosura, që shpesh hynin në përpjekje me forcat osmane dhe mbanin lidhje të vazhdueshme me emigrantët e Malit të Zi⁴.

Analiza e shkaqeve të dështimit të kryengritjes së vitit 1910, siç u tha edhe më lart, e kishte shpënë Isa Boletinin në përfundimin se kyçi për fitoren kundër sundimit osman ishte bashkimi i të gjithë popullit shqiptar në një kryengritje të vetme. Këtë gjë ai e pati parasysh në veprimtarinë e tij për organizimin e kryengritjes së vitit 1911 dhe bëri përpjekje që t'i jepte asaj karakter mbarëshqiptar. Kjo del edhe në letrën që Isa Bo-

1) AK. Tel. nr. 367 i konsullit serb në Prishtinë, MPJ të Serbisë, 10/23 shkurt 1911.

2) AK. Tel. nr. 204, ministri i Punëve të Brendshme të Malit të Zi M. Gjukanoviç, Prefekturës së qarkut të Podgoricës 26/2 /19.3.1911.

3) ACSR. Letër nr. 30/11 konsullit italian Galanti së Shkup, MPJ të Italisë, 24 janar 1911.

4) Po aty.

5) HHStA. PA, Letër nr. 37 e konsullit Zilkovski në Ma-

letini i dërgonte Komitetit të Manastirit, i cili kryente funksionet e qendrës organizuese të kryengritjes.

Në këtë letër del qartë në pah shqetësimi që Isai kishte për përgatitjen e kryengritjes në viset jugore të Shqipërisë. Ndërsa në veri, dhe sidomos emigrantët shqiptarë në Malin e Zi po përgatiteshin mirë dhe ishin të vendosur për të luftuar, — siç shprehej Isa Boletini, — edhe sikur qeveria (turke-F.M.) të hidhte mbi ta gjithë ushtrinë¹, në viset jugore një gjë e tillë nuk po ndodhte. Prandaj ai i kërkonte Komitetit të Manastirit të vepronte më energjikisht, të merrte masa dhe të dërgonte njerëz të përgatisnin popullin për kryengritje në Shqipërinë e Jugut². Në letër vërehen edhe përpjekjet e Isait për të vendosur bashkëpunimin me Komitetin e Manastirit. Duke e parë gjendjen e krijuar në Kosovë dhe në viset e tjera veriore, pas shtypjes së kryengritjes së vitit 1910, të volitshme për shpërthimin e një kryengritjeje të re, ai kërkonte që edhe komitetet e jugut të mos humbisnin rastin, por të përgatisnin popullin³. Nëpërmjet kësaj letre ai njoftonte edhe vendimin e marrë nga Komiteti i Podgoricës për ta shtyrë kryengritjen, prandaj dhe kërkonte që kjo kohë të shfrytëzohej për propagandimin dhe përgatitjen sa më të mirë të kryengritjes. Aty ai vinte në dukje edhe punën e madhe organizuese dhe propaganduese që po zhvillonte Komiteti i Podgoricës⁴, i cili, siç dihet, luajti rolin kryesor në kryengritjen e vitit 1911.

Në letër Isai prekte edhe problemin e përkrahësve të mundshëm të jashtëm të kryengritjes. Të tillë — shprehej ai — mund të ishin Mali i Zi ose Italia⁵.

nastrir, Vjenës, 25 prill 1911. Letra nuk është e datuar, por nga përmbatja e saj duket se Isa Boletini t'ia këtë dërguar atë Komitetit të Manastirit aty nga fillimi i marsit 1911.

- 1) *Po aty.*
- 2) *Po aty.*
- 3) *Po aty:*
- 4) *Po aty.*
- 5) *Po aty.*

Ç'eshtë e vërteta në këtë kohë qëndrimi i Malit të Zi ndaj kryengritjes shqiptare ishte ende i papërcaktuar. Në muajin mars Isa Boletini dhe krerë të tjerë shqiptarë ishin orvatur të bindnin Nikollën e Malit të Zi për të marrë një aksion të përbashkët shqiptaro-malazez kundër forcave osmane. Krajl Nikolla nuk e kundërshtoi këtë propozim, por me qëllim që t'i shmangej konfliktit të hapur me Turqinë, u kërkoi atyre që kryengritja të mos fillonte si një aksion i përbashkët, por si aksion thjesht shqiptar¹, të cilit më vonë do t'i vinin në ndihmë forcat malazeze. Siç duket, udhëheqësit shqiptarë, duke parë këtë qëndrim të papërcaktuar të qeverisë malazeze, i vijuan përpjekjet për ta tërhequr Malin e Zi në një aksion të përbashkët kundër Turqisë, por një bashkëpunim i tillë nuk u arrit, mbasi krajl Nikolla, siç dihet doli hapur me pretendimet e tij territoriale ndaj vendit tonë.

Isai shpresonte gjithashtu në ndihmën e Italisë, e cila po përgatitej në këtë kohë të pushtonte Tripolin dhe i interesonin trazirat në Perandorinë Osmane. Isai mendonte se qeveria italiane do të lejonte që demokratët italianë, të bashkuar në organizatën «Pro Albania» dhe arbëreshët e Italisë, të bashkuar rreth «Komitetit italo-shqiptar» ta ndihmonin materialisht kryengritjen shqiptare, duke dërguar edhe një ekspeditë vullnetarësh². Por as ndihma materiale, as ekspeditat e vullnetarëve nuk mbërritën në Shqipëri, sepse ato u penguan e u ndalën nga qeveria italiane.

Qeveria turke kishte rënë në gjurmë të veprimtarisë së komiteteve të fshehta brenda e jashtë vendit dhe e shqetësuar filloi të merrte masa për të zbutur gjendjen, me qëllim që të pengonte përgatitjen dhe shpërthimin e kryengritjes. Kështu, Porta e Lartë shpalli amnistinë dhe njoftoi qeverinë e Malit të Zi se të gjithë shqiptarët që

1) *Po aty*, Rap. nr. 1465 i drejtorit të policisë në Trieste Vjenës, 20.2.1911.

2) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 448:

ishin të arratisur atje mund të ktheheshin lirisht në vendin e tyre, mbasi ishin falur nga sulltani, ndërsa krerët si Isa Boletini, Sulejman Batusha, Bajram Daklani etj., të dënuar me vdekje po të dorëzoheshin do t'u falej jeta, veçse do të internoheshin në Azinë e Vogël¹.

Isa Boletini dhe krerët e tjerë nuk e pranuan amnistinë e ofruar nga qeveria turke dhe nuk lejuan kthimin e malësorëve në Shqipëri. Pranimin e «faljes» nga ana e sulltanit dhe shkëputjen e cilitdo nga malësorët shqiptarë në ato caste, me të drejtë ai e cilësoi sabotim të kryengritjes dhe tradhti. Të tillë e quajti Boletini largimin e Hasan Ferrit nga Mali i Zi.²

Veprimtarinë e Isa Boletinit dhe të Komitetit të Podgoricës për organizimin e kryengritjes, qeveria malazeze e ndiqte hap pas hapi dhe me interesim të madh.

Qëndrimi i qeverisë së mbret Nikollës ndaj Isa Boletinit dhe kryengritjes në përgjithësi, siç kemi vënë re edhe më parë, përcaktohej nga synimi i saj për të shtënë në dorë tokat shqiptare dhe konkretisht Pejën, Shkodrën dhe Lezhën³. Malit të Zi nuk i interesonte që shqiptarët të ngriheshin në kryengritje e të luftonin për vetëqeverisjen e Shqipërisë, siç qenë shprehur Isa Boletini dhe krerët e tjerë shqiptarë kur u lidh besa⁴ midis tyre në Mal të Zi.

1) CDIA. Informacion i konsullatës bullgare në Cetinë, MPJ të Bullgarisë, 10.2.1911.

(Pas shtypjes së kryengritjes së vitit 1910 Porta e Lartë, krahas masave të egra që ndërmori, dënoi me vdekje organizatorët e saj. Por në dokumentet e vitit 1910 nuk kemi hasur ndonjë të dhënë që bën fjalë për dënimin e dhënë veçse në muajt shkurt-mars 1911 njihemi nga dokumente të ndryshme për dënimin me vdekje dhënë nga Porta e Lartë Isa Boletinit e krerëve të tjerë).

2) Sh: Rahimi. *art. përm.*, f. 58.

3) *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë, 1984, f. 449.

4) Gaz. «Dielli»: Boston Mass. nr. 109, 3.6.1911. Data për lidhjen e kësaj bese për kryengritje midis shqiptarëve nuk dokumentohet, por duket se ajo të jetë bërë në mbledhjen e 4 shkurtit 1911 në Podgoricë.

Qeveria malazeze donte ta përdorte kryengritjen si vegël të politikës së saj të shtrirjes territoriale¹.

Pikërisht, për këtë qëllim, Cetina u tregua e gatshme të «ndihmonte» kryengritësit shqiptarë. Nga njëra anë, Nikolla shprehej për bashkëpunim me shqiptarët në luftë kundër Turqisë, ndërsa nga ana tjetër, vepronte që kryengritja të mos merrte karakter kombëtar, por të mbetej e përçarë, lokale, kryesisht në ato krahina ku ai kishte pretendimet e veta. Për t'ia arritur këtij qëllimi, ai u përpoq të bënte për vete disa nga krerët e Malësisë së Mbishkrodrës e të Kosovës e në radhë të parë Isa Boletinin, ndikimi i të cilit në radhët e emigrantëve, — siç shprehej dhe konsulli serb në Prishtinë, — ishte shumë i madh aq sa ata dëgjonin çdo këshillë të tij².

Qeveria e Cetinës për ta komprometuar Isanë gjatë kohës që ai qëndroi në Mal të Zi, mundohej t'i plotësonte atij çdo nevojë. Megjithëse u përpoq të fshihte qëllimet shoviniste nën maskën e tij prej «miku», mbret Nikollës nuk i ndriti para Isait dhe emigrantëve të tjerë malësorë. Qëndrimi i vendosur i Isait për të ruajtur pavarësinë e kryengritjes nga Mali i Zi dhe qëllimin e saj të vetëm për të çliruar vendin nga sunduesit osmanë del mjaft mirë në pah në takimin që ai pati me mbret Nikollën. Ky takim u bë në Pallatin Mbretëror në Cetinë, aty nga fillimi i marsit, ku Isa Boletini ishte thirrur për bisedime nga vetë mbreti i Malit të Zi. Në bisedën që mbret Nikolla bëri me Isa Boletinin dolën qartë dhe synimet e tij lidhur me kryengritjen shqiptare për përgatitjen e së cilës Isai po përpiqej me ngulm.

Që në fillim, mbreti malazez e «informoi» Isa Boletinin që në pranverën e ardhshme malësorët do të ngriheshin në kryengritje për t'u çliruar nga Turqia dhe, në mënyrë provokuese i propozoi Isait që një gjë të tillë mund ta bënte edhe ai me emigrantët kosovarë në Plavë, Guci e Gash, mbasi, sipas mbret Nikollës, në këto

1) A. Puto, *vep. për m.*, f. 89.

2) AK. Tel. i konsullit serb në Prishtinë. MPJ të Beogradit. 19...3. 1.4.1911.

qytete, ushtritë osmane ishin të pakta dhe mund t'i merrnin lehtë¹.

Isa Boletini, i matur si në pushkë dhe në fjalë e ho dhi poshtë provokimin e mbretit për të veçuar kryengritësit e Kosovës nga ata të Malësisë së Mbishkodrës dhe për t'i kufizuar ata vetëm në Plavë e Guçi. Sipas kujtimeve të Tafilit, përgjigjja që Isai i dha krajlit, që e tillë sa ky i fundit, në vazhdimin e bisedës e zbuloi veten. «Me këto forca, — iu përgjigj Isai, — edhe pse do t'i çlirojmë këto dy qytete, nuk mund t'i mbajmë, pasi Kosova është e lodhur dhe e çarmatosur nga kryengritja e vjetme»². Mbreti dinak malazez mendoi se kishte ardhur çasti për t'iu ofruar kryengritësve shqiptarë «gatishmërinë» e tij për ndihmë. «S'ka nevojë për shumë fuqi, — deklaroi më tej krajl Nikolla në bisedë, — të gjithëve sa jeni këtu do t'ju jap unë armë e në këto qytete do t'ju vijë ushtria ime mbrapa që t'i mbanin ata. Unë, — shpejtoi mbreti i Malit të Zi të shprehte «dashurinë e madhe» që ai kishte për shqiptarët, — ju shqiptarëve ju dua, ju kam miq, prandaj me mua do të jeni më rehat»³. Nuk ishte vështirë të kuptohej ç'fshihet në diplomacinë e krajl Nikollës. I zemëruar thellë nga çka po i kërkohej, Isa Boletini u ngrit menjëherë në këmbë dhe i dha atij përgjigje të prerë. «Unë nuk po luftoj të ndjek njërin (mbret — F.M.) e të sjell tjetrin, nuk erdha këtu me kondita, erdha vetëm si mik»⁴.

Pikërisht kur përpjekjet e Nikollës për ta vënë Isa Boletinin në shërbim të tij dështuan, mbaroi dhe dashamirësia, përkujdesja që me aq bujë ishte trumbetuar nga mbret Nikolla. Tashmë tek Isa Boletini ai shihte një kundërshtar të vendosur për planet e tij shoviniste. Për këtë arsye, si dhe për të veçuar emigrantët shqiptarë të Kosovës nga malësorët e Mbishkodrës, qeveria mala-

1) AQS: Fosdi nr. 74, dosja nr 4.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) *Po aty.*

zeze urdhëroi që Isa Boletini dhe emigrantët kosovarë të largoheshin nga territori i Malit të Zi. «Kthimi i tyre në Malë dhe, — shkruan konsulli austro-hungarez në Cetinë u bë nga qëllimi që këta elementë të mos kishin asnjë kontakt të mundshëm me malësorët kryengritës e emigrantët e tjerë».¹ Për t'i kaluar sa më parë në Shqipëri, mbret Nikolla ndërhyri pranë konsullit turk në Cetinë për riatdhesimin e Isa Boletinit e emigrantëve kosovarë². Në të njëjtën kohë, për t'i detyruar malësorët e Malësisë së Madhe të fillonin kryengritjen para kohe e të papërgatitur mirë, aty nga mesi i marsit qeveria malazeze u preu atyre ndihmat.

Në kundërshtim me planet e qeverisë malazeze, Isa Boletini, në bashkëpunim me krerët e tjerë u munduan t'i jepnin kryengritjes karakter të përgjithshëm. Për këtë qëllim Isa Boletini, Mehmet Shpendi etj., i drejtuan popullit shqiptar një thirrje për t'u bashkuar me kryengritien që do të fillonte së shpejti e për të mos iu nënshtruar urdhërave të qeverisë, për të kundërshtuar shërbimin ushtarak, pra, për t'u ngritur i tëri për të ndihmuar çlirimin e vendit³. Por qeveria e Malit të Zi nuk u la kohë krerëve kryengritës ta realizonin këtë qëllim.

Malësorët, meqenëse ndihma e Malit të Zi u ndërpre dhe Komiteti i Podgoricës nuk ishte në gjendje t'i mbante me mietet e veta, më 24 mars 1911 sulmuan fortifikatën kufitare në Rrapsh. Kjo shënoi fillimin e kryengritjes. Qeveria malazeze dërgoi repartet e saj ushtarake në zonën e veprimeve luftarake⁴ për ta pushtuar atë.

Përpjekjet e qeverisë së Malit të Zi për të ndërhyrë

1) *HHStA. PA. Rap nr: 21/A-B. Konsulli austro-hungarez në Cetinë Vjenës. 2 prill 1911.*

2) *Pa aty.*

3) *AMAE. Letër nr 22 e konsullit francez në Shkodër, MPJ të Francës. 24 mars 1911.*

4) *Historia e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë, 1984, f. 456.*

në punët e kryengritjes, ndikimi i saj te disa krerë, presioni për fillimin e parakohshëm të kryengritjes, si dhe shoqërimi i forcave kryengritëse të Malësisë së Mbishkodrës nga forcat ushtarake malazeze, Isa Boletini nuk i pëlqyen. Këtë ai e shprehu hapur edhe kur arriti në Guci, ku midis të tjerash tha: «I kam parë me sytë e mi ushtarët dhe oficerët malazez me kryengritësit». Për ndikimin e Malit të Zi (ndaj kryengritësve — F. M.) ai theksoi se, do të bënte ende zbulime të reja»¹. Kjo duhet të jetë edhe arsyeja e përgjigjes negative që Isa Boletini i dha kërkesës së krerëve të malësorëve të Mbishkodrës për të marrë pjesë në kryengritje edhe emigrantët kosovarë². Sipas tij malësorët qenë ngutur që filluan kryengritjen pa u gatuar kjo ende në Kosovë³. Nga të dhënat e mësipërme Isa Boletini, dhe krerët e tjerë kosovarë duket se e mbivlerësuan rrezikun malazez, u trembën nga ndërhyrjet e agjenturës malazeze në punët e kryengritjes, e nuk vlerësuan forcat e shëndosha atdhetare si Dedë Gjo Luli, Risto Siliqi etj., që qëndruan në krye të forcave malësore. Ndonëse kryengritja u zhvillua në një territor të kufizuar, ata, në bashkëpunim me ideologët e Lëvizjes Kombëtare si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi etj., arritën t'i jepnin kryengritjes programin autonomist kombëtar. Pjesëmarrja e Isait e emigrantëve kosovarë në kryengritje, do të ndikonte pozitivisht jo vetëm në shtimin e radhëve të kryengritësve, por edhe në shtrirjen e saj territoriale.

Presionet e Malit të Zi në krerët kryengritës u bënë shkak që këtej e tutje Isa Boletini do të presë çdo lidhje me qeverinë malazeze. Këtë të vërtetë historike të pamohueshme, historianët e sotëm jugosllavë përpiqen

1) PAAA. Informacion i konsullit gjerman në Selanik, von. Bajthmen Holming, 7.4:1911; *HHStA,PA.* rap. nr. 21/A-B konsulli a-h Gisel në Cetinë, Vjenës, 3 prill 1911.

2) *HHStA,PA.* Rap: nr.21/A-B. Konsulli Gisel në Cinë, Vjenës, 3 prill 1911:

3) G: Shpuza. *Kryengritja shqiptare vitit 1911*, në: «Buletini shkencor», nr. 4, Shkodër, 1966, f. 87.

ta mohojnë. Kështu p.sh., autori jugosllav Bogumil Hrabaku, për qëllime të caktuara, si shkak të vërtetë, si faktor i prishjes së marrëdhënieve të Isa Boletinit me Malin e Zi, paraqet shqiptarët, Isa Boletinin, i cili sipas tij nuk kishte besim në ndihmën e Malit të Zi, mbasi e konsideronte atë si një vend tepër të varfër për të qenë një aleat serioz¹. Këtë pikëpamje të Bogumil Hrabakut, siç e pamë e hedhin poshtë vetë dokumentet e kohës, të përmendura më sipër.

Nga ana e saj Porta e Lartë, nëpërmjet përfaqësisë së saj në Cetinë, ndiqte me kujdes ashpërsimin e marrëdhënieve të Isait e të emigrantëve kosovarë me qeverinë malazeze dhe shqetësohej, për përgatitjen e kryengritjes. Duke mos qenë në gjendje të ndalonte shpërthimin e saj, ajo u përhoq të pengonte të paktën bashkimin e emigrantëve kosovarë me kryengritjen e malësorëve. Për këtë qëllim ajo shpalli një amnisti të dytë, sipas së cilës faleshin në radhë të parë ata shqiptarë me fe myslimane që nuk ndiqeshin nga organet gjyqësore ndërsa të tjerët, do të faleshin me rastin e ardhjes së sulltanit në Kosovë². Përjashtoheshin nga amnistia Isa Boletini dhe krerët e tjerë të dënuar me vdekje.

Në këto kushte, nisur edhe nga mendimi se Porta e Lartë nuk e dëshironte acarimin e mëtejshëm me shqiptarët, Isa Boletini i kërkoi falje qeverisë turke, por pa asnjë kusht³. Porta e Lartë, me qëllimin që ta shkëpuste e ta largonte Isa Boletinin nga masat popullore, i premtoi atij falje, por me kusht që ta dërgonte në Anadoll ku do t'i krijonte kushte mjaft të mira e do t'i paquante rrogë⁴. Këto kushte Isa Boletini nuk i pranoi.

1) B. Hrabak: *Arbansko Prvak Isa Boletini i Cerno Gora 1910-1911*. Titograd, 1977. (Në: AH faqe përkthimi nr. 4).

2) *HHStA, PA*. Rap. nr. 119. Ambasadori austriak në Stamboll, Vjenës, 12 prill 1911:

3) *Po aty*. Rap. nr. 25/13, i konsullit, Gisel në Cetinë, Vjenës, 18 prill 1911.

4) *Gaz. »Dielli e Flamuri«*, Boston Mass, 5 maj 1911, f. 4.

Në përgjigjen që Isai i dha përfaqësuesit turk në Cetinë, Sadedin beut, i la të kuptonte se nuk mund të jetonte larg popullit të tij. Ai vërtet i kërkoi falje Portës së Lartë, por që «të jetonte në Shqipëri dhe që popullsia shqiptare të mos i jepte as ushtarë, as vergji e as kurrëgjja mbretërisë turke, ndryshe, — i tha Isai përfaqësuesit turk, — lamtumirë, dhe urdhëro të vijë ushtria në Shqipëri e të provojë burrërinë e Shqipërisë»¹.

Në këtë mënyrë, i urdhëruar nga qeveria malazeze që të largohej menjëherë nga Mali i Zi edhe pa ju dhënë amnistia, Isa Boletini vendosi të kalonte në Kosovë. Aty nga fundi i marsit ai në krye të 1000 emigrantëve kosovarë, të grumbulluar në Podgoricë, kaluan në Krahinën e Gucisë².

Isa Boletini, Sulejman Batusha, Zeqir Halili, etj., i dërguan një letër nënprefekturës së Gucisë, ku e vënin në dijeni për mbërritjen e tyre dhe njëkohësisht e njoftonin se nuk kishin ndonjë qëllim (për kryengritje — F.M.), por, po të sulmoheshin nga ushtria, do të luftonin deri në njeriun e fundit³.

Siç shihet, Isa Boletini nuk u largua nga Mali i Zi për në Kosovë i shtyrë nga mbret Nikolla për të filluar kryengritjen në Pejë e Gjakovë⁴, sikurse shprehej konsulli austriak në Cetinë, (sepse në këtë kohë kryengritja aty ende nuk ishte përgatitur, por u dëbua nga qeveria malazeze, mbasi nuk iu nënshtua synimeve të saj). Është pikërisht koha kur në Malësinë e Madhe, kishte shpërthyer para kohe kryengritja. Autoritetet turke ishin tërë frikë e shqetësim se mos flakët e saj përhapeshin edhe në Kosovë e në të gjithë vendin, duke kërcënuar në këtë mënyrë pushtetin osman në Shqipëri. Ky rrezik u bë më i madh pas kthimit të Isa Bole-

1) Gaz: «Dielli e Flamuri» Boston Mass, 5 maj 1911, f. 4.

2) HHStA, PA: Rap: nr: 21/A-B kons a-h në Cetinë-Vjenës, 3 prill 1911.

3) Po aty. AQSh: Fondi nr 74, dosja nr. 4.

4) HHStA, PA. Rap. nr. 25/13 i konsullit Gisel në Cetinë, Vjenës, 18 prill 1911.

tinit në Guci. Në këto kushte, Porta e Lartë e gjeti më të udhës të hiqte dorë nga kushtet e faljes që i kish-te caktuar Isa Boletini e bashkëluftëtarëve të tij. Në përgjigjen që autoritetet osmane i kthyen Isait dhe kre-rëve të tjerë Kosovarë, u bënin të ditur se qeveria nuk ushqente asnjë mendim të keq për ta dhe ngado që të kalonin, e kishin rrugën e lirë¹. Kështu Isa Boletini, pa asnjë incident, kaloi në Kosovë dhe u vendos në fsha-tin Bellajë të Pejës².

Ndërkohë, kryegritja në Malësinë e Mbishkodrës ki-shte arritur një sërë suksesesh kundër forcave osmane në kufirin shqiptaro-malazet. Kryengritësit shtinë në do-rë Tuzin dhe më 6 prill 1911 ngritën flamurin shqiptar në majën e Bratilës së Hotit³. Ata arritën t'u bënin ba-llë me sukses divizioneve të Turgut pashës që sulmuan në vijën Tuz-Deçiç-Kastrat. Komiteti i Podgoricës, mbë-shtetur në këto fitore të kryengritësve, mbledhi në Plla-shëm të Greçës më 23 qershor 1911 «Kuvendin e Përgjith-shëm të krerëve shqiptarë». Kuvendi miratoi 12 pika të hartuara nga Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, etj., të cilat iu paraqitën qeverisë turke në trajtën e një memoran-dumi ose, siç u quajt «Libri i kuq»⁴. Memorandumi i Greçës ishte me rëndësi të madhe për lëvizjen shqipta-re. Nga njëra anë ai i jepte kryengritjes karakter mba-rëshqiptar dhe, nga ana tjetër, ishte një goditje e drejt-përdrejtë për planet shoviniste të mbretit Nikollë të Ma-lit të Zi.

Isa Boletini megjithëse nuk mori pjesë në kryengri-tje, e ndiqte atë me vëmendje. Fitoret e arritura nga kryengritësit dhe sidomos kërkesat e Memorandumit të Greçës, i zhdukën atij dyshimin e krijuar në fillim se mos kryengritja drejtohej nga Mali i Zi. Ai u bind plo-

1) A.Q.Sh. Fondi nr. 74, dosja nr 4.

2) *Po aty*.

3) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II, Tiranë, 1984, f. 451.

4) *Po aty*, f. 452.

tësisht se malësorët luftonin jo vetëm për Malësinë e Madhe, por për të gjithë Shqipërinë dhe se ndërhyrjes së Malit të Zi në punët e shqiptarëve po u vihej kufi. Prandaj ai e përkrahu Memorandumin e Greçës dhe i frymëzuar prej tij, u bë më i vendosur për luftën kundër Turqisë. «Çështja shqiptare, — theksonte Isa Boletini në këtë kohë, — duhet të fitojë, shqiptarët do të fitojnë lirinë dhe armët do t'i mbajnë lëruar (në brez — F.M.)»¹.

Prania e Isa Boletinit në Kosovë i shqetësonte shumë autoritetet osmane. Ato ndiqnin nga afër çdo lëvizje të tij dhe nuk i rreshtën përpjekjet për ta larguar atë nga masat popullore dhe nga Lëvizja Kombëtare. Shqiptare. Disa herë kryetari i bashkisë së Pejës, Xhafferr Tajari e ftoi Isa Boletinin për t'u takuar, ndërsa mytesarifi i Pejës, i ofroi shuma të mëdha parash vetëm që ai t'i nënshtrohej qeverisë osmane².

Por kërkesat e tyre ai i hodhi poshtë. Megjithatë qeveria osmane nuk ndërmori ndonjë veprim kundër Isa Boletinit. Një qëndrim të tillë ndaj Isa Boletinit ia diktonte asaj gjendja e rëndë e krijuar për të në Kosovë dhe në të gjithë Shqipërinë. Nga njëra anë, malësorët e Malësisë së Mbishkodrës i kishin hapur mjaft telashe Portës së Lartë, nga ana tjetër, dhuna e terrori i ushtruar nga qeveria turke gjatë e pas kryengritjes së vitit 1910, i kishte revoltuar masat popullore në Kosovë. Në këto kushte, një hap i pamatur ndaj Isa Boletinit e udhëheqësve të tjerë popullorë do të shërbente si një shkëndijë që zjarri i kryengritjes të përhapej edhe në Kosovë. Situata në Kosovë ishte aq shumë e mbarsur për kryengritje, sa që shpërthimi i saj, sikurse vërente edhe konsulli italian në Shkup, varej shumë nga qëndrimi i

1) Gaz. «Koha». Korçë, vëll. I, 18 korrik 1911, f. 2.
2) AQS^h, Fondi nr 74, dosja nr 4.

krerëve, e në radhë të parë nga Isa Boletini i Mitrovicës¹.

Në Pejë, Isa Boletini u takua me shumë krerë të kësaj krahine të cilët shprehën gatishmërinë dhe besnikërinë e tyre të bashkëpunonin me të. Ai kaloi edhe në krahinën e Gjakovës ku gjeti përkrahje të plotë nga populli i saj për luftë kundër pushtuesit osman².

Por me gjithë gatishmërinë e masave popullore, Isa Boletini dhe krerët e tjerë popullorë, nuk i ngritën ato në kryengritje. Përgatitja për organizimin e kryengritjes në Kosovë ishte e pamjaftueshme dhe mund të sillte pasoja të rënda për popullsinë e sapo dalë nga kryengritja e vitit 1910. Prandaj Isa Boletini, Bajram Daklani, Sulejman Batusha u mjaftuan vetëm me rritjen e numrit të çetave të armatosura, si parapërgatitje për kryengritjen e ardhshme. Veprimtaria e këtyre çetave nuk ishte e parëndësishme. Ato lëviznin në të gjithë krahinën dhe goditnin trupat, karvanët e armikut që qarkullonin në rrugët e Gjakovë-Pejë, Pejë-Prishtinë, duke u shkaktuar atyre dëme të ndjeshme në forca e materiale. Kundër tyre qeveria osmane dërgoi nga Ferizaj forca të shumta të armatosura³.

Për ta ulur disi tensionin dhe për ta veçuar Kosovën nga kryengritja, në 15 qershor erdhi për vizitë në Kosovë vetë sulltan Mehmet Reshiti V i shoqëruar nga një suitë e madhe zyrtarësh të lartë⁴.

Autoritetet lokale osmane morën masa që sulltanit t'i bëhej një pritje madhështore, ku të merrnin pjesë masat popullore dhe sidomos udhëheqësit e tyre. Ata i dërguan Isa Boletinit ftesë të posaçme për të marrë pjesë në

1) ACSR. Let. 131/46 e konsullit Galanti në Shkup. MPJ të Italisë, 5.4.1911.

2) CDIA. Tel nr: 980 i legatës bullgare në Romë, 16 prill 1911.

3) AK. Rap. nr. 487. Konsulli serb në Prishtinë, MPJ të Serbisë, 5 korrik 1911.

4) *Historia e Shqipërisë*. Vëll: II, Tiranë, 1984, f: 457.

këtë pritje (që do t'i bëhej sulltanit), por ai nuk e pranoi ftesën. Isai e kishte të qartë se ardhja e sulltanit nuk ishte gjë tjetër veçse një manovër politike për të mashtruar popullin. Gjithashtu ai nuk u zuri besë autoriteteve osmane dhe dyshoi për ndonjë kurth që ato mund t'u kishin ngritur krerëve kosovarë për t'i asgjësuar. «Turqit, — shprehej Isai, — të presin me muzikë dhe të vrasin pas shpine»¹.

Mungesa e Isa Boletinit në pritje, ra në sy të zyrtarëve të lartë osmanë. Vetë ministri i Luftës, Mahmud Shefqet pasha u interesua dhe pyeti Hasan Prishtinën përse nuk kishte ardhur Isai. «Isa Boletini, — iu pergjigj Hasan Prishtina, — nuk është nga ata që harron. Ai s'ka me fal kurrë, si çdo shqiptar fyerjen e dinjitetit kombëtar që ju bë prej qeverisë»².

Vizita e sulltanit në Kosovë u propagandua si përkujdesje që tregonte Porta e Lartë, madje vetë sulltani, për shqiptarët. Me këtë rast, sulltani shpalli edhe faljen e të gjithë atyre që kishin marrë pjesë në kryengritjen e vitit 1910 dhe dha një fond prej 30 000 li-rash për shtëpitë e shkatërruara gjatë kryengritjes. Si shpërblim për të gjitha këto «ndere», xhonturqit kërkuan prej shqiptarëve të Kosovës që të dëronin programin autonomist të Greçës. Por një gjë të tillë autoritetet xhonturke nuk mundën ta arrinin. Ideja e autonomisë së Shqipërisë, siç shkruante vetë konsulli serb në Prishtinë, kishte shumë përkrahës e për këtë flitej në mënyrë të hapur»³.

Isa Boletini jo vetëm nuk u gënjye nga këto përpjekje të qeverisë turke, por përkundrazi i dënoi ato. Në një shkrim të botuar në revistën «La nazione Albanese» të datës 31 korrik 1911, thuhet se Isa Boletini, tërhiqte vëmendjen se qeveria turke nuk po plotësonte

1) AQSht, Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

2) HHStA, PA. Rap. i konsullit austro-hungarez në Shkup, Vjenës, 16 qershor 1911; AQSht. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

3) AK Rap. i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit 2/15.7. 1911.

asnjë nga kërkesat e shqiptarëve që luftonin në kufirin shqiptaro-malazez¹. Pra, është fjala për kërkesat autonome të shprehura në Greçë, me të cilat Isa Boletini u pajtua plotësisht dhe deklaroi se shqiptarët ishin betuar se do të vazhdonin të luftonin deri sa t'u plotësohejshin kërkesat e tyre, madje, vetë ai, nuk do të ndahej asnjëherë nga pushka e tij².

1) «La nazione albanese», nr. 4, 31 korrik 1911.

2) *Po aty*:

KREU IV

NJË NDËR UDHËHEQËSIT E KRYENGRITJES SË PËRGJITHSHME TË VITIT 1912

1. NË PRAG TË KRYENGRITJES

Në gjysmën e dytë të vitit 1911 administrata xhonturke duke e ndier veten të pasigurt, sa kohë që shqiptarët kishin në dorë armët, filloi të marrë masa për t'i çarmatosur krerët shqiptarë që u falën nga amnistia dhe ia arriti qëllimit në shumë prej tyre¹. Këtë masë ajo u orvat ta zbatonte edhe ndaj Isa Boletinit. Isai jo vetëm që nuk pranoi, por si përgjigje ai bashkë me 30 luftëtarë doli në mal². Kjo shënoi një ashpërsim të ri në marrëdhëniet midis Isa Boletinit dhe pushtetit të xhonturqve.

Duke nuhatur rrezikun e një kryengritjeje të re, autoritetet osmane u shqetësuan dhe shpejtuan të «korrigjounin» gabimin, i propozuan Isait të hynte në bisedime. Isai nuk pranoi të takohej me ta, por u kërkoi që ai dhe

1) AK. Raport nr: 487, konsulli serb në Prishtinë, Beogradit 5/18. 7.1911.

2) *Po aty.*

njerëzit e tij të lejoheshin t'i mbanin armët lirisht dhe t'i kthehej pasuria e konfiskuar gjatë viteve 1909-1910.¹ Autoritetet shtetërore u detyruan t'i pranonin këto kushte. «Kjo, — theksonte konsulli serb në Prishtinë, — shënon kapitullimin e autoriteteve shtetërore para Isa Boletinit si dhe ngritjen në mënyrë të jashtëzakonshme të prestigjit dhe të fuqisë së tij.»²

Në kohën kur Isai kaloi në Kosovë, në rrethet atdhetare kishte lindur ideja për organizimin e një kryengritjeje të re. Në Kosovë organizimin e saj e kishte marrë në dorë Komiteti i Shkupit dhe ai i Prishtinës, ku bënin pjesë prijës të njohur, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Ali Danish Prishtina etj. Për ta Isa Boletini ishte tashmë një udhëheqës me përvojë të pasur në organizimin e luftës së armatosur. Ai gëzonte respekt e autoritet të madh në masat popullore. Me fjalën e tij mund të ngriheshin në kryengritje mijëra shqiptarë. Qenia e Isait në udhëheqje të kryengritjes do të luante një rol të madh në suksesin e saj. Për këtë arsye Hasan Prishtina, Bajram Curri, etj., menduan të hynin në bisedime me Isanë e të bashkëpunonin për organizimin e kryengritjes. Hasan Prishtina i ngarkuar me këtë detyrë u lidh me të dhe e njohu me mendimin për organizimin e një kryengritjeje të re. «Hasani, — vërente konsulli serb në Prishtinë, — takimet me Isanë i shfrytëzon në dobi të çështjes kombëtare shqiptare, për organizimin e kryengritjes së ardhshme antiosmane»³. Nëpërmjet Hasan Prishtinës, Isa Boletini u lidh nga afër me Komitetin e Prishtinës. Kjo ia përforcoi edhe më tepër atij bindjen për seriozitetin, rëndësinë dhe përmasat që do të kishte kryengritja e përgjithshme që do të përgatitej, e cila do të siguronte fitoren e autonomisë së Shqipërisë.

Po në këtë kohë (në verën e vitit 1911) në qarqet

1) *Po aty*. Gaz. «Drita», Manastir, 25 gusht 1913, nr: 25, f. 1.

2) AK: Rap. nr. 487, i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit 5/18.7.1911.

3) AK: Raport nr. 531 i konsullit serb në Prishtinë. MPJ të Serbisë. 15/28.7.1911.

shoviniste serbe, fillon të rritej interesimi për qëndrimin e Isa Boletinit ndaj sunduesve osmanë. Konsulli serb në Prishtinë, nëpërmjet agjentëve të tij, mbledhte të dhëna për Isa Boletinin dhe informonte Beogradin për çdo gjë. Në këto raporte jepen të dhëna të hollësishme për veprimtarinë e Isait në këtë kohë. Nga këto dokumente del se Isa Boletini tashmë kishte arritur në përfundimin se shqiptarët dhe xhonturqit nuk mund të pajtoheshin më, sepse midis tyre kishte shumë urrejtje e mosbesim. Për më tepër ata tashmë i ndanin midis tyre lumenj gjaku. Përfundimi i Isait, sipas këtyre raporteve, ishte se shqiptarët duhej të shkëputeshin nga Turqia dhe se kjo do të arrihej vetëm nëpërmjet kryengritjes së armatosur. Po sipas konsullit serb, Isai kishte deklaruar se, kryengritja do të shpërthente në pranverën e vitit 1912 dhe se vetë ai do të ngrinte në kryengritje gjithë krahinën e Mitrovicës, të Vuçiternit dhe deri në Ferizaj, të Drenicës dhe një pjesë të krahinës së Pejës.¹ Njohja me mendimin e atdhetarëve për organizimin e kryengritjes së ardhshme dhe plotësimi nga autoritetet osmane i kërkesave të Isait (për mbajtjen e armës dhe kthimin e pasurisë së konfiskuar),² e bindën Isanë të kthehej në Boletin. Këtë gjë, Hasan Prishtina e vlerësoi si diçka pozitive, sepse sipas tij, kjo do t'i jepte më shumë mundësi Isait të lidhej lehtë e më fort me masat popullore, të punonte më intensivisht me to dhe t'i përgatiste ato për luftë kundër xhonturqve. Kështu, nga fundi i korrikut Isa Boletini u kthye në Vuçitern. Lidhja dhe bashkëpunimi i Isa Boletinit, Hasan Prishtinës dhe krerëve të tjerë shqiptarë u bë më i ngushtë. Përpjekjet për organizimin e kryengritjes së armatosur u shtuan. Në këtë veprimtari po kristalizohej dhe udhëheqja e kryengritjes së ardhshme. Gjatë rrugës për në Boletin, Isai mori pjesë në mbledhjen e organizuar në shtëpinë e Hasan Prishtinës, ku ndodhe-

1) *Po aty.*

2) A.K. Tel. i konsullit serb në Prishtinë, drejtuar Beogradit 22.7.(4.8.). 1911.

shin shqiptarët më me autoritet nga Vuçiterni dhe nga krahinat e tjera.¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth përgatitjes së kryengritjes. Aty Isa Boletini deklaroi se do të punonte me të gjitha forcat kundër sunduesve osmanë.² Edhe krerët e tjerë u porositën të përgatiteshin që të ishin të gatshëm për luftë me sa më shumë njerëz të tyre.³ Në këtë mbledhje Isa Boletini, Hasan Prishtina dhe krerë të tjerë, theksuan që periudha deri në fillimin e kryengritjes të mos shihej si periudhë qetësie. Përkundrazi duhej të luftohej me forma nga më të ndryshmet. Kështu p.sh. u vendos që menjëherë shqiptarët të hoj-kotonin pushtetin e turqve, si të valiut në Shkup, të mytesarifëve e të kajmekamëve etj. Asnjë shqiptar nuk duhej t'i drejtohej pushtetit shtetëror për ndonjë problem, por ta zgjidhnin atë me njëri-tjetrin dhe të krijonin organe gjyqësore shqiptare.⁴

Mbas përfundimit të mbledhjes Isai u kthye në Boletin, ndërsa Hasan Prishtina shkoi në Stamboll. Detyra e këtij të fundit ishte që në bashkëpunim me deputetët e tjerë shqiptarë, ta detyronin qeverinë turke të njihte kombësinë shqiptare dhe të drejtat e saj për një jetë autonome⁵.

Veprimtaria e Isa Boletinit nga shtatori 1911 deri në fundin e janarit 1912 ende nuk ndriçohet nga dokumentacioni që kemi në dorë. Madje kjo periudhë edhe në kujtimet e Tafil Boletinit kalohet në heshtje. Duket se Isa Boletini dhe atdhetarët e tjerë kosovarë prisnin përfundimet e bisedimeve në parlament, i cili u hap në dhjetor 1911. Në parlament deputetët shqiptarë i paraqitën qeverisë kërkesën për reforma politike, ekonomi-

1) AK. Raport i konsullit serb në Prishtinë, drejtuar Beogradit 26.7.(8.8.) 1911.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) *Po aty.*

5) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II, Tiranë, 1984, f. 465.

ke e kulturore në Shqipëri. Hasan Prishtina më 11 janar 1912 e kërcënoi qeverinë turke me një kryengritje të re në Shqipëri, në rast se nuk plotësoheshin kërkesat shqiptare.¹

Të ndodhur përballë një opozite të fortë, xhonturqit më 18 janar 1912 e shpërndanë parlamentin dhe shpallën zgjedhjet e reja me qëllim që në parlamentin e ri të siguronin shumicën absolute. Manovrat e xhonturqve treguan qartë se ata as që kishin ndërmend t'i përfillnin kërkesat e deputetëve shqiptarë. Prandaj një grup shqiptarësh nën kryesinë e Ismail Qemalit, zhvilloi një mbledhje të fshehtë në Stamboll. Duke parë gjendjen e nderë që ishte krijuar në Shqipëri dhe sidomos në Kosovë (ku përpjekjet me armë midis shqiptarëve e garnizoneve turke ishin bërë më të shpeshta, duke i detyruar këta të fundit të mbylleshin në qytete, në disa kra-hina nëpunësit turq u detyruan të largoheshin nga detyra etj.),² si edhe gjendjen e favorshme ndërkombëtare që u krijua në fillimin e luftës italo-turke ku u angazhua një pjesë e konsiderueshme forcash osmane, vendosën për të organizuar një kryengritje të përgjithshme, e cila do të fillonte në Kosovë e më vonë do të përhapej në pjesën tjetër të Shqipërisë.³ Për zbatimin e këtij vendimi, Hasan Prishtina u nis për në Kosovë, ndërsa Ismail Qemali shkoi në shtetet evropiane për të siguruar armë dhe të holla.⁴

Me të mbërritur në Kosovë, Hasan Prishtina u mor konkretisht me organizimin e kryengritjes. Ai hyri menjëherë në lidhje me Isa Boletinin, Zejnullah Begun nga Vuçiterni, Xhemal beg Prishtinën, Halim beg Derrallën, Ahmet beg Gjakovën, me krerët e Llapit, Dre-

1) *Po aty*, f. 466.

2) AK. Raport nr. 724 i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit 8/21.9.1911.

3) H. Prishtina. *Një shkurtim kujtimesh për kryengritjen e vitit 1912*. Shkodër, 1921, f. 8-9.

4) *Po aty*.

nicës. Të gjithë lidhën besën se do ta çonin deri në fund punën për organizimin e kryengritjes.¹ Vëmendje organizatorët e kryengritjes qysh në fillim i kushtuan sigurimit të aleatëve të jashtëm. Duke e vlerësuar këtë anë të veprimtarisë së rilindasve, shoku Enver shkruan: «Një orientim me rëndësi të madhe i njerëzve të Rilindjes që vërteton madhësinë, diapazonin e gjerë dhe përmbajtjen e thellë revolucionare të lëvizjes sonë kombëtare ishte synimi për ta lidhur luftën e popullit tonë me luftën çlirimtare të popujve fqinjë kundër armikut të përbashkët...»².

Në fillim Hasan Prishtina u propozoi përfaqësuesve të lëvizjes bullgare — maqedone të bashkëpunonin me shqiptarët kundër Turqisë.³ Kërkesa e Hasanit për marrëveshje me bullgarët nuk ishte e rastit. Sigurimin e ndihmës nga ana e Bullgarisë duket se ai e mbështeste në interesat e kësaj të fundit në Maqedoni. Ai mendonte se bullgarët do të përkrahnin krijimin e një Shqipërie autonome si kundërpeshë ndaj interesave serbe në Shqipërinë Veriore për të dalë në Durrës. Por kërkesa e tij nuk u pranua nga qarqet shoviniste të Sofjes (mbasi ata kishin hyrë në marrëveshje me qeverinë serbe e të Malit të Zi në aleancën ballkanike për copëtimin e Shqipërisë). Po kështu, përgjigje negative kërkesave të shqiptarëve u dhanë edhe konsulli anglez në Shkup⁴ dhe përfaqësuesi i Vjenës.⁵ Vetëm Italia, meqenëse ishte në luftë me Turqinë dhe i interesonin turbullirat në Shqipëri, nuk i pengoi rrethet e interesuara italiane që nëpërmjet komiteteve «Pro Albania» të vepronin në favor të kryengritjes duke dërguar armë në Shqipëri.⁶

Ndërsa Bullgaria e Mali i Zi iu përgjigjën negati-

1) *Po aty*, f. 15.

2) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 24, f. 12.

3) H. Prishtina, *Vep. e përm.*, f. 14.

4) *Po aty*, f. 14-15.

5) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 468.

6) *Po aty*.

visht kërkesës së udhëheqësve shqiptarë për të bashkëpunuar në luftë kundër Turqisë, Serbia këtë radhë ndryshoi taktikë. Ajo nuk doli hapur kundër shqiptarëve, siç kishte bërë në kryengritjen e mëparshme, përkundrazi qarqet ushtarake dhe politike serbe filluan të afroheshin me krerët kryesorë të kryengritjes dhe u treguan të gatshëm për ta përkrahur atë.

Ky qëndrim «dashamirës» i qarqeve serbe ndaj kryengritjes që po përgatitej dhe krerëve të saj, mbartte në vetvete prapaskena. Kësaj here atyre u interesonte përleshja me armë e shqiptarëve me xhonturqit, sepse kështu do të dobësoheshin të dyja palët e Serbia do ta kishte më të lehtë për të depërtuar ushtarakisht në Kosovë dhe në krahinat e tjera shqiptare. Është e kuptueshme që gjithnjë duke u përpjekur për përmbushjen e synimeve të saj, qeveria serbe kurrsesi nuk dëshironte zgjerimin e kryengritjes në shkallë kombëtare dhe daljen e saj jashtë kërkesave ekonomike. Këto interesa të qarqeve politiko-ushtarake serbe i shpreh qartë në raportin e tij drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë konsulli serb në Prishtinë ku, midis të tjerash, thekson: «Pikëpamja jonë e përgjithshme është që zgjerimi i lëvizjes shqiptare të përkrahet sa të sigurohen kushtet që Serbia të mund të ndërhyjë me sukses nga ana diplomatike dhe në mënyrë të armatosur. Por derisa të sigurohen këto, lëvizja shqiptare të mbetet brenda kufijve që nuk do të lejojnë që rëndësia e saj të rritet dhe të kalojë në një revolucion të përgjithshëm shqiptar».¹

Në të njëjtën kohë, duke u ofruar ndihma në armë e municion krerëve kryengritës, për të cilat ata kishin shumë nevojë, Serbia mendonte t'i fuste ata në prehrin e saj dhe të merrte në dorë frenat e kryengritjes.

Kështu, qysh në gjysmën e dytë të vitit 1911, qarqet qeveritare serbe i shtuan përpjekjet për të hyrë në

1) AK. Rap. i konsullit serb në Prishtinë, MPJ të Serbisë, 30. 4. 13.5.1912.

lidhje me ta dhe sidomos me Isa Boletinin, Sulejman Batushën, Bajram Currin, Sadik Ram Gjurgjevikun etj. Në këtë kuadër vëmendje të veçantë Serbia i kushtoi Isa Boletinit duke e vlerësuar atë si ndër më të rëndësishmit prijës dhe me ndikim të madh edhe ndaj krerëve të tjerë. Gjithashtu, duke parë autoritetin që gëzonte Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, Serbia mendonte të depërtonte dhe ta kanalizonte atë në rrjedhën e synimeve të saj, të paktën në Kosovë. Për këtë qëllim në fund të korrikut 1911, qeveria serbe dërgoi tek Isa Boletini përfaqësuesit e saj për t'i propozuar të kalonte në Serbi, ku nuk e kërcënonte asnjë rrezik¹. Në të njëjtën kohë ajo caktoi një shumë të madhe për tërheqjen e tij². Sot për sot, ende nuk kemi ndonjë dokument që të bëjë fjalë për përgjigjen që u dha Isai të dërguarve të qeverisë serbe. Sidoqoftë faktet flasin vetë. Isa Boletini nuk u largua për asnjë çast nga Kosova, pra përgjigjja mbetet e kuptueshme, ka qenë negative.

Mbështetjen ose aleancën e popullit tonë me shtetet fqinjë Isai e vlerësonte si një faktor ndihmës e të rëndësishëm në luftë kundër sunduesit osman. Por, në pamundësi për të realizuar atë, Isai kërkonte arritjen e bashkëpunimit me pakicat serbe e bullgare që banonin në viset shqiptare (çka do të siguronte tërthorazi përkrahjen e shteteve fqinje), do të mënjanonte përçarjen midis tyre e cila, siç theksonte Isai, u leverdiste vetëm xhundurqve dhe, në të njëjtën kohë, do të pengonte zbritjen e Austro-Hungarisë drejt Jugut.³ Prandaj, ndryshe nga Hasan Prishtina që përjashtonte çdo lidhje me Serbinë, Isai dhe një pjesë e krerëve kosovarë si Baj-

1) AK. Tel. i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit, 15/28.7. 1911.

2) AK. Rap. i konsullit serb në Prishtinë. Beogradit, 2/15.7. 1911.

3) AIH. Dosja A-IV — 31, f. 114-116. Dokumente ruse, dosja nr-2):

ram Curri, Nexhip Draga, Sadik Gjurgjeviku, etj. ndoqën ndaj Serbisë një politikë afrimi.

Qëndrimin «pozitiv» që po mbante Serbia, Isa Boletini dhe krerë të tjerë të kryengritjes menduan ta shfrytëzonin për nevojat e tyre. Prandaj ata pranuan të hynin në marrëdhënie me qeverinë serbe. Por kjo nuk do të thotë se Isa Boletini dhe krerët e tjerë nuk i njihnin synimet armiqësore të Serbisë. Për ta ishte më se i qartë rreziku që mund t'u kërcënohej nga Serbia. Për të vënë në jetë planet e saj aneksioniste, ajo mund të ndërhynte ushtarakish në trojet shqiptare. Megjithatë marrëveshja me Serbinë në këtë kohë ishte një qëndrim që përcaktohej nga çasti dhe lejohej nga rrethanat e krijuara. Së pari, nevojat për armatim, mundicion e të holla dhe për një mbështetje të jashtme politike, në kushtet kur gjithkush ua mohoi, e përligjin afrimin e Isa Boletinit e krerëve të tjerë me Serbinë. Së dyti, me gjithë dëshirat e synimet e saj Serbia në këtë kohë nuk mund të ndërmerre veprime ushtrike ndaj shqiptarëve. Këtë gjë Isa Boletini e krerët e tjerë të kryengritjes e mbështetnin në kontradiktat që ekzistonin midis Serbisë e Austro-Hungarisë. Mbretëria dualiste që kishte pretendimet e saj në Ballkan dhe që përpiqej të ruante statusquo-në e të pengonte krijimin e aleancës ballkanike nuk do të lejonte kurrsesi veprimet e armatosura të Serbisë për të dalë në Adriatik.

Kontaktet e Isa Boletinit me Serbinë mbas korrikut të vitit 1911 filluan të bëheshin më të shpeshta. Kështu, në fund të vitit 1911 dhe fillim të vitit 1912, pranë Isa Boletinit, që në qarqet politike diplomatike serbe konsiderohej si «më i forti ndër udhëheqësit e kryengritjes shqiptare»¹ erdhi i dërguari i organizatës së fshehtë «Dora e zezë»,² majori Tankosiç. Që në për-

1) J. Swire. *Albania. The rise of a Kingdom*. London, 1929 (sipas përkthimit në AIH, f. 2).

2) A. Puto. *Vep. e për.*, f. 83, «Dora e zezë» — organizatë e fshehtë e krijuar në Beograd më 1911 nga oficerët e ushtrisë «Bashkim ose vdekje». Organizata kishte si qëllim realizimin e «idealit kombëtar». që ishte bashkimi i të gjithë serbëve. të ci-

pjesët e para Tankosiçi e pa se do ta kishte tepër të vështirë ta përmbushte misionin e tij ndaj Isa Boletinit. Vetë ai shprehej se Isai ishte një shqiptar që ruhej e dyshonte në çdo gjë.¹

Me sa duket Tankosiçi nuk mundi t'ia arrinte qëllimit, prandaj «Dorës së zezë» iu desh të dërgonte pranë Isait njerëzit e saj më të besuar Dragutin Dmitrieviç — Apis, Bogdon Radenkoviç dhe Milan Zavajdil, të cilët i shprehën atij dëshirën e Serbisë për të çliruar kombet e robëruara të Turqisë evropiane. Serbët e shqiptarët, duhej të luftonin së bashku e të çlironin vendin nga Turqia.² (këtu është fjala për pakicat serbe që jetonin në tokat shqiptare dhe të viseve ku banonin popullsi serbe të përfshira brenda kufirit të Perandorisë Osmane).

Për qëndrimin konkret që mbajti Isai në këto takime nuk kemi të dhëna dokumentare, por, me sa duket, emisarët serbë e patën të vështirë të kapërcenin mosbesimin e Isait kundrejt qëllimeve të vërteta që fshiheshin prapa këtyre nismave të qeverisë serbe.³

Misionin e të dërguarve të «Dorës së zezë» e vijoi i dërguari i qeverisë serbe Bozhin Simiç, i cili mbërriti në Boletin më 20 prill 1912. Kapiten Simiçi kërkoi nga Isa Boletini dhe krerët e tjerë kryengritës pengjigje pozitive për të bashkëpunuar në luftë kundër xhonturqve. Ashtu si në takimet e mëparshme me emisarët serbë, edhe me B. Simiçin, Isa Boletinit nuk iu davarit dyshimi e mosbesimi ndaj Serbisë. Ajo që bie në sy dhe është karakteristika në marrëdhëniet e Isait me serbët, është se ai asnjëherë nuk u bashkua me ta në pikëpamje poli-

lin përpiquej ta arrinte me veprimtari komplotuese. Kjo veprimtari ishte e drejtuar jo vetëm kundër Austro-Hungarisë që përfshinte brenda kufijve të saj një popullsi sllave të konsiderueshme. Në kohën e luftërave ballkanike organizata zhvilloi një veprimtari të dendur shoviniste për krijimin e Serbisë së Madhe në dëm të popullit shqiptar e popujve të tjerë fqinjë.

1) J. Swire. *Vep. e përm.*, (Sipas përkthimit në AIH, f. 3).

2) *Po aty*, f. 4.

3) A. Puto: *Vep. e përm.*, f. 83.

tike dhe nuk u dha asnjë koncesion në dëm të tërësisë territoriale të vendit.

Që në fillim të bisedimeve Isa Boletini ia bëri të qartë kapitenit Simiç karakterin antiosman të kryengritjes. «Shqiptarët, — theksonte ai, — dëshirojnë të jenë vetë zot në krahinat e tyre»;¹ Si kusht për bashkëpunim Isa Boletini paraštroi kërkesa që kishin të bënin kryesisht me ndihmën materiale e morale dhe konkretisht: 1 — Me rastin e kryengritjes së përgjithshme Serbia duhet të vinte në dispozicion sasinë e nevojshme të armëve, municionin dhe nevoja të tjera. 2 — Në rast nevoje Serbia duhej t'u hapte derën kryengritësve dhe t'i pranonte në territorin e vet. 3 — Duke nxjerrë një pjesë të ushtrisë në kufi dhe duke ndërhyrë në Evropë t'i ndihmonte moralisht kryengritësit².

Isa Boletini, ndryshe nga Mahmut Zajmi etj. miratoi përqëndrimin e ushtarëve serbë në kufi vetëm si presion ndaj forcave osmane në fillim të kryengritjes dhe nuk pranoi aspak që ata të kalonin kufirin. Këtë qëndrim të prerë e tepër syçelët të Isa Boletinit ndaj propozimeve serbe e shpreh qartë konsulli serb në Prishtinë kur shkruan: «Njerëzit e Zajmit do të pranojshin ndihmën e ushtarëve tanë, kjo nuk mund të thuhet për Isanë se është fanatik i madh».²

Me sa duket Serbia donte të dinte ç'lidhje mund të kishte Isa Boletini me Austro-Hungarinë e Malin e Zi, sepse interesat e tyre në Shqipëri kryqëzoheshin me ato të Serbisë. Prandaj Isai e siguroi kapitenin Simiç se me Vjenën nuk kishte asnjë lidhje dhe i kërkoi atij përgjigjen e qeverisë serbe për kërkesat që bëri, mbasi kryengritja mund të fillonte në javën e parë të muajit.

Kështu B. Simiçi nuk mundi të arrinte gjë për misionin e tij, sepse, siç shprehet vetë ai në raportin dërguar Beogradit, te Isai gjeti një njeri të zgjuar, trim dhe të

1) *Dokumenti o spolnoj politici kraljevine Srbije 1903-1914*. dok. 281. Knjiga V. Sveska 1. Beograd, 1984, f. 514-516:

2) *Po aty*:

3) *Po aty*, dok: 356, f. 610:

fjalës,¹ i cili si kompensim për ato shërbime të mëdha që kërkoi prej tyre, nuk dha asnjë premtim konkret.²

Isa Boletini dhe krerët e tjerë kryengritës, u përpoqën që ta realizonin bashkëpunimin në veprimtarinë konkrete. Kështu, në kohën e zgjedhjeve, Isai u bëri thirrje pakicave serbe që të votonin për deputetët shqiptarë. Në periudhën e organizimit të kryengritjes Isai e ftoi përsëri popullsinë serbe të Kolashinit e të viseve të tjera që të bashkëpunonte me popullsinë shqiptare.³ Një gjë të tillë ai e bëri dhe gjatë zhvillimit të kryengritjes. Siç thekson konsulli serb në Prishtinë, në raportin drejtuar MPJ, shpesh Isai i thërriste serbët që të hynin nën flamurin e kryengritjes.⁴

Por këtyre përpjekjeve konkrete të Isa Boletinit për të bashkëpunuar, Serbia nuk iu përgjigj aspak. Ajo mbajti ndaj këtij problemi një qëndrim me dy faqe. Nga njëra anë, qeveria serbe shprehej e gatshme për të bashkëpunuar me kryengritësit, për t'i ndihmuar ato me armë e materiale të tjera, ndërsa nga ana tjetër, në mënyrë të fshehtë e të pabesë ajo punonte për ta penguar atë. Kjo politikë mishërohet fare qartë në udhëzimet e konsullit serb në Prishtinë në kohën e zgjedhjeve. Ai udhëzonte pakicat serbe: «Në çështjen e zgjedhjeve të ndihmojmë xhonturqit, por njëkohësisht nga ana tjetër të forcojmë besimin te krerët shqiptarë se jemi me ata dhe se do t'i ndihmojmë e do t'i përkrahim në luftë kundër xhonturqve. Në këtë mënyrë, — shprehej ai, — do të arrihet që lufta të bëhet midis shqiptarëve dhe pushtetit, qëndrimi i popullsisë tonë (serbe — F.M.) duhet të jetë i atillë që të nxjerrë leverdi nga të dy palët».⁵

1) *Po aty*.

2) *Po aty*, dok. 277, f. 510.

3) *Ak. Rap.* nr. 576 i konsullit serb së Prishtinë, MPJ të Serbisë, 7/20.5.1912.

4) *AK. Rap.* nr. 780 i konsullit serb në Prishtinë, MPJ të Serbisë, 7/20.6.1912.

5) *AK. Rap* i konsullit serb në Prishtinë, MPJ të Serbisë 9/22. 4.1912.

Të njëjtën politikë të dyfishtë ndoqi konsulli serb edhe gjatë zhvillimit të kryengritjes. Në një nga raportet e tij drejtuar Beogradit pohohet se kur kryengritësit i kërkonin vazhdimisht popullsisë serbe të hynte në radhët e tyre, ai këshillonte në fshehtësi që të kishin lidhje (pakicat serbe) shumë të mirë me kryengritësit, por të mos bashkoheshin me ta.¹

2. NË ORGANIZIMIN E MASAVE POPULLORE DHE UDHËHEQJEN E VEPRIMEVE LUFTARAKE

Periodha organizuese e kryengritjes së vitit 1912 përkoi me fushatën e zgjedhjeve parlamentare. Duke e vlerëuar siç duhet rëndësinë e kësaj ngjarjeje Isa Boletini, Hasan Prishtina, Nexhip Draga, etj. propagandonin në masat popullore që të votohej për deputetët shqiptarë. Në këtë kuadër në dhjetëditëshin e dytë të shkurtit ata organizuan në Boletin një mbledhje, ku u diskutua qëndrimi që duhej të mbahej në zgjedhje dhe u theksua se shqiptarët duhet të votonin për opozitën.² Nga ana e vet qeveria xhonturke mori masa për të fituar në zgjedhje. Në prag të zhvillimit të zgjedhjeve Komiteti Qendror xhonturk dërgoi në Kosovë një komision të kryesuar nga ministri i brendshëm Haxhi Adil beu, i ngarkuar me detyrë të shqyrtonte gjendjen në Shqipëri dhe të propozonte zbatimin e reformave të nevojshme. Qëllimi i komisionit ishte të mashtronte shqiptarët, duke u premtuar atyre se do t'u plotësoheshin kërkesat ekonomike, politike e kulturore dhe t'i shkëpuste ata nga udhëheqësit e tyre.³ Në të njëjtën kohë komisioni kishte në dispozicion një shumë të madhe të hollash për komprometimin e krerëve. Ministri turk u përpoq së pari, ta afronte Isa

1) AK. Rap. nr. 576 i konsullit serb në Prishtinë, MPJ të Serbisë, 7/20.6.1912.

2) AMAE. Letër e konsullit francez në Shkup Karlie. ministrit të Punëve të Jashtme të Francës Puankare, 21 shkurt 1912.

3) Z. Cana. *Vep. e përm.*, f. 465.

Boletin, prandaj ditën e tubimit të madh në Gazimestan ftoi, në emër të sulltanit, Isa Boletini e Idriz Seferin që të merrnin pjesë në ditën e Mevludit.¹ Por, si Isa Boletini ashtu dhe Idriz Seferi e hodhën poshtë ftesën e ministrit turk. Gjithashtu qeveria turke përdori edhe forcën e armatosura për t'u diktuar zgjedhësve vullnetin e vet. Të gjitha këto bënë që në parlament të mos zgjidhej asnjë nga ish-deputetët shqiptarë.

Lufta e ashpër politike që u zhvillua midis forcave atdhetare dhe xhonturqve gjatë fushatës së zgjedhjeve si dhe rritja e pakënaqësisë në gjirin e masave popullore për shkak të metodave që përdori komisioni qeveritar ndaj shqiptarëve, e forcuan më tej situatën revolucionare në vend. H. Prishtina, I. Boletini e shfrytëzuan atë për të shpejtuar përgatitjet e kryengritjes.

Krahas veprimtarisë agjitative për zgjedhjet që zhvilloi kryesisht në Mitrovicë², Isa Boletini nuk la pas dorë dhe punën për përgatitjen e kryengritjes. Ai kalonte nga një krahinë në tjetrën, takonte krerët e tyre dhe lidhte me ta besën për luftë kundër sundimit osman. Në mars 1912 Isai shkoi në Shalë të Dukagjinit ku u takua me Mehmet Shpendin dhe krerë të tjerë të asaj krahine. Në kuvendin që organizoi bashkë me ta, u lidh besa për kryengritje në Shqipërinë e Sipërme, e cila do të pasohej dhe nga Shqipëria e Jugut.³ Në këtë kohë dhe komitetet e Manastirit, Dibres, Korçës, Elbasanit e Vlorës kishin vendosur lidhje të rregullta dhe po merreshin me formimin e çetave të armatosura.⁴

Në prill 1912 Hasan Prishtina, Isa Boletini, Zejnullah Vuçiterni e atdhetarë të tjerë u mbledhën në fshatin Gojëbulë ku diskutuan rreth gjendjes së krijuar dhe

1) HHSIA, P.A.A Tel. i konsullit austro-hungarez në Shkup Heimroth, kontit Bertold, Vjenë, mars 1912.

2) AK. Tel. Nr. 427 i konsullit serb në Prishtinë, ministrit të Punëve të Jashtme, Millovanović, 19.4/ 2.5.1912.

3) «La Nazione Albania», Vëll. XVI, nr. 5, 15.3.1912, f. 5.

4) Historia e Shqipërisë. Vëll. II, Tiranë, 1984, f. 468.

vendosën që kryengritja të fillonte aty nga mesi i majit.¹

Përgatitiet për krvengritje po eonin mirë. Kulla e Boletinit që disa herë ishte diegur e shkatërruar priti edhe këtë radhë miaft bashkëlufëtare të Isait nga Shala (e Mitrovicës), Llapi, Mitrovica, si dhe nga viset e Gjilanit, të cilët hynin e dilnin vazhdimisht aty,² takoheshin me Isa Boletinin, shkëmbenin mendime dhe merrnin detyra për punët e krvengrities. Përkushtimi i plotë i Isa Boletinit ndaj saj kishte rënë në sy të opinionit diplomatik. «Energjia dhe vendosmëria e tij (I. Boletini — F.M.) që i kishte shkaktuar sundesve osmanë aq shumë telashe — shprehej konsulli austro-hungarez në Mitrovicë — nxjerr në plan të parë shpërthimin e një krvengritieje të re në Shqipëri».³ Kuptohet që kjo veprimtari do të diktohej edhe nga autoritetet osmane. Për t'i bërë ballë çdo të papriture I. Boletini mori një sërë masash sigurimi, criti numrin e rojeve me luftëtarë trima nga Shala⁴ të gatshëm për t'i bërë ballë çdo sulmi të mundshëm të forcave osmane të përqëndruara përreth Boletinit e në fushën e Kosovës,⁵ familjen e tij e dërgoi në krahinën e Pejë, në depot e kullës grumbulloi sasira të konsiderueshme drithi. Të gjitha këto trejtinë se Isa Boletini po përgatitej me plot seriozitet për luftë.⁶

Në saje të veprimtarisë së Isa Boletinit dhe të krerëve të tierë krvengritës në mjaft zona si në Malësinë e Gjakovës, në rrethet e Pejës, në krahinën e Lumës etj.

1) AQSH. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

2) HHSStA. PA A Rap. i konsullit a-h në Mitrovicë Vjenës. 18 qershor 1912. AQSH Fondi, nr. 143, dosia nr. 36, qershor 1912.

3) Z. Prela. *Problemi shqiptar e politika austro-hungareze 1897-1912* në: «Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare». Tiranë. 1962. f. 175.

4) HHSStA. PA.A. Informacion nga zëvendës konsulli a-h në Mitrovicë. Vjenës, 30 janar 1912.

5) *Po aty*.

6) *Po aty*. Rap. i konsullit a-h në Mitrovicë, Vjenës 18 qershor 1912.

ishin ngritur grupe kryengritësish. Përpyjekjet me armë midis tyre dhe forcave osmane po bëheshin çdo ditë e më të shpeshta. Përmasa më të mëdha morën veprimet e kryengritësve në Gjakovë. Në rrethet e saj ishin përqëndruar rreth 6-7 mijë shqiptarë të armatosur.¹ Në ditët e para të majit këto forca me sulme të pjesshme u përpoqën të hynin në qytet. Më 10 maj, ata ndërморën një sulm të përgjithshëm. Luftimet u zhvilluan të ashpra e të përgjakshme. Forcat osmane duke e ndier veten të pasigurt për t'u bërë ballë kryengritësve u propozuan atyre një armëpushim dhjetëditor. Meqenëse municioni për të vijuar luftimet ishte i pamjaftueshëm forcat shqiptare e pranuan propozimin për armëpushim. Sulmi i kryengritësve për të marrë Gjakovën nuk përfundoi me sukses, por megjithatë ai pati rëndësi të madhe, sepse jehona e tij u përhap në të gjithë Kosovën dhe i dha një shtytje të fuqishme kryengritjes. Kështu në ditët që pasuan vala e kryengritjes përfshiu edhe Pejën. Isa Bole-tini në krye të 800 kryengritësve² së bashku me luftëtarë të tjerë pejanë, sulmuan për t'u futur në Pejë. Ndërkohë rugovasiit prenë rrugën Beranë-Guci; në Guci dhe rrethet e saj po ndodhnin shumë trazira, në krahinën e Llapit ishte rritur lëvizja antiosmane, në Gjilan mbaheshin mbledhje të fshehta për t'u organizuar në kryengritje. Në Dibër u lidh besa për luftë midis krahinave të Mirditës, Malësisë së Lezhës, bregut të Matit.³

Gjendja në Shqipëri po bëhej çdo ditë e më kanosëse për pushtetin osman. «Në të gjitha anët e Shqipërisë, — shkruante konsulli serb në Prishtinë, — po përgatitet një lëvizje më serioze. Në malësi krerët përgatiten të paraqesin për zgjidhje projektin e tyre të njohur prej 12 pi-

1) *Dokumenti o Spolnoj politici...* dok. 366, f. 385, Z, Cana; *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në Kosovë në vitet 1908-1912*. Prishtinë, 1979, f. 222.

2) *Dokumenti o Spolnoj-politici...*, dok. 366, f. 585.

3) *Po aty*.

kave që ka si qëllim të hapur krijimin e një Shqipërie autonome». ¹

Zhvillimi i ngjarjeve me shpejtësi dhe zgjerimi i veprimtarisë së kryengritësve e detyruan qeverinë serbe të kthente përgjigje pozitive për kërkesat që i kishte shtruar Isa Boletini kapitenit Simiç. Por, për të bashkëpunuar me kryengritësit e për t'i ndihmuar ata, Beogradi vuri kushte në interes të politikës së tij. «Qeveria serbe, — theksonte Millovanoviçi në udhëzimet drejtuar konsullatës në Prishtinë, — është e detyruar të kërkojë, t'i lënë të vendosë vetë kur aksioni mundet dhe duhet të fillojë, sepse vetëm ajo është në gjendje të emojë drejt a janë përkushtet evropiane për një lëvizje të tillë kundër osmanëve. Përdorimi i qeveria serbe nuk do të vendosë për fillimin e aksionit miqtë tanë shqiptarë që janë në marrëveshje me ne, duhet të mënjanojnë të gjitha ato që mund të ndezi një kryengritje e përgjithshme». ²

Më 15 maj shkuan në Boletin prifti Angjelko Neshiq dhe Ognjen Radenkoviç. Ata i njoftuan Isa Boletinit përgjigjen pozitive të qeverisë serbe dhe në të njëjtën kohë kërkuan prej Isait që të shtyhej kryengritja për në një kohë më të përshtatshme kur ta shihte të arsyeshme qeveria serbe. ³

Ç'fshihej pas kësaj e çfarë parakuptonte me kushte më të përshtatshme qeveria serbe? Qëllimi i vërtetë i Serbisë prapa së cilës qëndronte Rusia, ishte të fitonte kohë derisa të kalonte nëpër Selanik në drejtim të Serbisë, treni i fundit i armëve të rënda artilerike, të kryhej armatimi i elementëve serbë që jetonin brenda kufijve të Perandorisë Osmane në mënyrë që të ishin të

1) *Po aty*.

2) *Po aty*, dok. 281, f. 314-516

3) *Po aty*, dok. 344, f. 595. Angjelko Nishiq ishte prift serb në Mitrovicë. Miqësinë e tij me Isa Boletinin qeveria serbe u mundua ta përdorte për të korruptuar Isanë.

përgatitur për çdo ngjarje të papritur dhe më në fund të përfundonin negociatat bullgaro-serbe.¹

Pranimi i një kushti të tillë që vinte Serbia do të ishte gabim i rëndë ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe do t'i vinte minat kryengritjes së armatosur, e cila sapo kishte filluar në Gjakovë e Pejë, që ishin edhe vatrë e saj të para. Prandaj qysh në fillim Isa Boletini e kundërshtoi në mënyrë të prerë propozimin e Serbisë. «Kryengritja, — u tha ai të dërguarve serbë, — nuk do të shtyhet. Kemi lidhur besën të gjithë vilajetet shqiptare e kemi vendosur të dalim me faqe të bardhë të gjithë së bashku, dhe i pari do të fillojë luftën vilajeti i Kosovës.² Meqenëse Isa Boletini mbajti qëndrim të prerë ndaj propozimit të tyre Neshiqi e Radenkoviçi u munduan ta përligjinin kërkesën për shtytjen e kryengritjes me rrezikun që gjoja i kanosej Kosovës dhe gjithë Shqipërisë nga Austro-Hungaria.³ Por zhvillimin e kryengritjes Isa Boletini si dhe krerët e masat e kryengritësve nuk e kushtëzonin nga faktorë të jashtëm. Ai nuk tregoi asnjë lëkundje dhe nga rreziku i sulmit austro-hungarez. «Ne, — u përgjigj Isai, — kemi vendosur të luftojmë edhe sikur të vritemi të gjithë shqiptarët dhe sikur të na sulmojë kushdo qoftë. Nëse do të na sulmojë Austro-Hungaria gjysma e kryengritësve do të kthehet kundër saj».⁴ Në vijim të bisedës Isa Boletini pasi u foli emisarëve serbë për përgatitjet, u kujtoi atyre premtimin e Serbisë për armë dhe u kërkoi një mijë copë. Por në të njëjtën kohë ai u la atyre të kuptonin se ndihma nga ana e qeverisë serbe nuk do të ishte faktor përcaktues për fillimin e kryengritjes. «Ne, — i theksoi Isai

1) Z. Cana. *Vep. e përm.*, f. 212.

2) AK. Rap. i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit 2/15.5. 1912.

3) *Po aty.*

4) *Po aty.*

palës serbe, — do të luftojmë edhe me sëpata kush nuk ka armë... do të luftojmë edhe pa pushkët tuaja».¹

Ajo që spikat në bisedimet me të dërguarit e Serbisë është kjo: Isa Boletini nuk u bëri atyre asnjë lëshim, në të gjitha rastet ai diti të ruante shumë mirë pavarësinë e kryengritjes dhe nuk pranoi asnjë klauzolë, qoftë edhe të dyshimtë, që qarqet politike e ushtarake serbe të ndërhyjnë në punët e saj. «Sado miqësi që tregojnë karshi nesh (I. Boletini, S. Ram Gjurgjeviku etj.) — theksonte konsulli serb në Prishtinë, unë nuk arrij në përfundimin se ata janë lidhur me ne».²

Qëndrimi i Isa Boletinit ndaj propozimeve serbe ishte i palëkundshëm, megjithatë diplomacia serbe nuk hoqi dorë prej tij, ajo synonte që me çdo kusht Isa Boletinin ta bënte për vete. Në telegramin dërguar Beogradit konsulli serb në Prishtinë theksonte: «Mbasi nuk e ndryshojmë dot rrjedhën e ngjarjeve, duhet t'i plotësojmë Isait kërkesën (për armë — F. M), sepse është më mirë ta kemi atë me ne se sa kundër nesh».³

Po në këtë kohë Isa Boletini u bë objekt edhe i presioneve të autoriteteve lokale osmane. Ato e ndiqnin me shqetësim veprimtarinë e Isait për përgatitjen e kryengritjes, prandaj shpejtuan të hynin në bisedime me të, për ta nënshtruar ose të paktën ta mënjanonin nga kryengritja.

Për këtë qëllim në fillim të qershorit 1912 vajti në Boletin vetë valiu i Kosovës Manxhar beu bashkë me my-

1) Dokumenti o spolnoj..., dok. 345, f. 597.

2) AK. Rap. nr 660 i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit, 20.5. 3.6. 1912. Për dështimin e përpjekjeve serbe në këtë drejtim, bëhet fjalë edhe në një dokument të mëvonshëm ku midis të tjerave theksohet: Përvoja e ndjekur nga Millovanoviçi me Isa Boletinin (është fjala për ndihmat që iu dhanë Isait për kryengritjen e 1912-ës nga Beogradi) duhet t'i ketë neveritur serbët që ta vazhdojnë këtë me krerë të tjerë në Shqipëri. (AMAE. Letër nr. 227. I ngarkuari me punë i Francës në Beograd, Kryetarit të Këshillit të Ministrave të Francës. Beograd, 28 dhjetor 1913.)

3) Po aty, dok. 345, f. 597.

tesarifin e Mitrovicës, me Nexhip pashën nga Peja.¹ Manxhar beu shpresonte se me premtimet që do t'i bënte Isait do ta shmangte atë nga kryengritja. Meqenëse Isa Boletini nuk ndodhej në Boletin, valiu i Kosovës ngarkoi Nexhip pashën për t'i bërë atij propozimin e qeverisë osmane, që të mos përzihej me lëvizjen dhe për këtë Isa Boletini do t'i jepeshin shuma të mëdha. Por Isa Boletini, ashtu si dhjetëra herë të tjera më parë, nuk e pranoi ofertën dhe me bindje të plotë e në mënyrë të hapur i deklaroi Nexhip pashës se do ta vazhdonte luftën kundër sundesve osmanë deri në fund.² Jo vetëm kaq, por Isa Boletini arriti të bindë Nexhip pashën se edhe ai si shqiptar duhej të ishte me popullin e jo me qeverinë. Kështu mytesarifi i Mitrovicës u largua nga Boletini duke i dhënë Isait besën e tij³ për kryengritje. Edhe pas këtij dështimi të ri autoritetet xhonturke nuk hoqën dorë nga Isa Boletini. Ata i dërguan atij dhe 850 lira turke të shoqëruar me kërkesën e tyre të zakonshme, por Isai në vend që të pajtohej me regjimin, — shkruante konsulli serb në Prishtinë, — i vuri ato në shërbim të kryengritjes.⁴ Edhe kërkesës së valiut të Kosovës për të shkuar në Pejë e Gjakovë, në ndihmë të autoriteteve osmane, Isai iu përgjigj negativisht.⁵ Pa asnjë premtim u kthye edhe oficeri i xhandarmërisë që vajti në Boletin dhe bisedoi me Isanë në fund të majit 1912.⁶

Mbas gjithë këtyre përpjekjeve të pasuksesshme, autoritetet osmane iu kthyen një rruge tjetër. Për të larguar masat popullore nga Isai ato shpërthyen një fushatë shpifjesh kundër tij. «Organet e pushtetit, — shkruante konsulli serb në Prishtinë, — po zhvillojnë një agji-

1) AQSH, Fondi nr. 143, dosja nr. 121, f. 114, Fondi nr. 74, dosja nr. 4, AIH. Dokumente ruse, dosja r-2.

2) HHStA, PA.A. Rap. i konsullit a-h në Mitrovicë, Vjenës. 18 qershor 1912:

3) AQSH, Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

4) *Dokumenti o spolnoj politici...*, dok. 334. f. 582.

5) *Po aty.* dok. 356, f. 610:

6) *Po aty.*

facion të gjerë kundër Isa Boletinit duke e quajtur atë si të paguar nga të huajt etj.¹

Si përpjekjet e qeverisë serbe për të ndërhyrë në punët e brendshme të kryengritjes dhe për ta futur atë në hullinë e saj, ashtu edhe ndërhyrjet e pareshtura të qeverisë osmane për ta shkëputur Isa Boletinin nga kryengritja nuk mundën t'i pengonin përgatitjet për kryengritjen dhe aq më pak veprimtarinë energjike të Isa Boletinit në interes të saj.

Në mënyrë të veçantë roli i Isa Boletinit ndihej në përpjekjet për zgjerimin dhe masivizimin e saj. Aty nga mesi i majit 1912 në shtëpinë e tij u mbajt mbledhja e Shalës së Bajgorës ku u vendos që shqiptarët e kësaj ane të hidhen në luftë.² Po në këtë kohë H. Prishtina e N. Draga lanë Shkupin dhe dolën në Drenicë për t'u bashkuar me Isa Boletinin³. Dhjetëditëshi i armëpushimit që u vendos në Pejë, u shfrytëzua nga Isai dhe krerët e tjerë kryengritës për të mbajtur gjallë frymën e kryengritjes në ato zona ku kishte filluar e për ta përhapur atë dhe në krahinat e tjera. Në mëngjesin e 16 majit (ditën që po martohej vajza e tij) Isai shkoi në fshatin Çabër. Aty, përveç popullsisë shqiptare ai i bëri thirrje edhe popullsisë serbe për t'u ngritur në kryengritje, «duhet të ngrihem i të luftojmë së bashku e të fitojmë së bashku — i tha Isai kreut të tyre».⁴ Nga Çabri ai shkoi të bisedonte me Ahmet Delinë nga Prekazi i Drenicës e N. Dragën.⁵ Përshekoi fshatrat Zhabar e Koshutovë dhe doli në Rugovë për të përcaktuar një plan pune me kryengritësit e atjeshëm.⁶ Të nesërmen, më 17 maj, me porosi të tij, në Boletin u organizua një takim me krerët e Shalës (së Mitrovicës), të cilët deklaruan se ishin të gatshëm për kryengritje.⁷ Prej Rugove Isai kaloi në Gjur-

1) Po aty, dok. 538, f. 845.

2) Z. Cana: *vep. e përm.*, f. 233.

3) Po aty. Shih edhe *Dokumenti o spolnoj...*, dok. 375, f. 632.

4) *Dokumenti e spolnoj politici...*, dok 375 f. 632.

5) Po aty.

6) Po aty.

7) Po aty.

gjevik ku më 18 maj do të mbahej mbledhja e krerëve kryengritës. Në atë mbledhje morën pjesë H. Prishtina, Zejnullah Vuçiterni dhe Ahmet Delia nga Prekazi,¹ e krerë të tjerë nga Mitrovica, Drenica, Vuçiterni. Të gjithë pjesëmarrësit u shprehën për domosdoshmërinë e zgjerimit të kryengritjes në të gjithë Shqipërinë. Aty u diskutua edhe çështja e ndihmës nga jashtë, sepse ndihej nevoja për armë e municione.

Mbledhja e Gjurgjevikut u pasua nga takime të tjera me krerë e luftëtarë të krahinave të ndryshme ku Isai merrte pjesë vetë ose dërgonte njerëzit e tij, siç qe rasti në Lumë.²

Vëmendje të veçantë Isa Boletini i kushtoi bashkëpunimit midis krahinave të ndryshme dhe arriti të krijonte lidhje të qëndrueshme midis krahinave të Rugovës, Gjilanit, Mitrovicës, Llapit etj.³

Më se 40 krerë nga Drenica dhe krahinat e përmeandura më lart, qëndronin në Boletin dhe prisnin sinjalin për t'u hedhur në kryengritje.⁴ Gjithashtu, Isa Boletini u bëri thirrje krerëve të Pazarit të Ri që të ngriheshin në kryengritje;⁵ dërgoi në krahinën e Shalës (së Dukagjinit) djalin dhe nipin e tij të cilët u takuan me krerët e saj, përforcuan besën e dhënë për luftë kundër sundimit osman,⁶ dhe njëkohësisht vendosën lidhje të vazhdueshme me të; ndërpreu punimet që bëheshin në rrugën Rozhajë-Mitrovicë-Pazari i Ri,⁷ meqenëse ajo do t'u shërbente xhonturqve për qëllime ushtarake etj. Siç shihet, Isa Boletini zotëronte mirë gjendjen në këto krahina të Kosovës. Të nisura, nga roli që luante dhe nga veprimtaria e dendur e Isa Boletinit në përgatitjen e

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) AK. Rap. nr. 576 i konsullit serb në Prishtinë, Millovanoviçit, 7/20.V.1912.

4) AK. Rap. i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit, 2/15.5.1912.

5) *Po aty.*

6) AQSH. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

7) AK. Rap. i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit. 5/18.5.1912.

kryengritjes, qarqet konsullore në Prishtinë e quanin atë agjitorin kryesor të kryengritjes.¹

Meritë e Isa Boletinit dhe e krerëve të tjerë është gjithashtu që ditën të hynin në xhandarmërinë e ushtrisë osmane e të shfrytëzonin pakënaqësinë që kishte filluar në radhët e tyre. Ata mundën të hynin në lidhje me elementë shqiptarë me të cilët lidhën besën për të luftuar kundër sunduesve osmanë. Këtë gjë e shpreh vetë Isai në bisedën që bëri me kapiten Simiçin ku, midis të tjerash, thotë: «Kemi lidhur besën me kordonin kufitar ndaj Serbisë që të aktivizohet menjëherë me xhandarmërinë, policinë e ushtrinë dhe nuk kemi frikë, sepse kemi oficerët që do të kalojnë në anën tonë.»²

Falë punës së madhe që kryen. H. Prishtina, Isa Boletini dhe atdhetarë të terë, në dhjetëditëshin e dytë të muajit maj, kryengritja u përhap në shumë krahina të vendit. Urrejtja e thellë që masat popullore kishin për sunduesit osmanë, i ndihmoi krerët kryengritës që brenda një kohe të shkurtër, siç shprehet Hasan Prishtina në kujtimet e veta, të ishin të zotët të ngrinin në këmbë një ushtri të madhe e të fortë kryengritësisë.³

Stadi i zhvillimit të kryengritjes shtronte përpara Hasan Prishtinës, Isa Boletinit dhe krerëve të tjerë kryengritës detyrë të menjëhershme krijimin e një qendre të vetme udhëheqëse dhe një program në shkallë kombëtare. Për këtë qëllim u thirr në Junik kuvendi i përgjithshëm, i cili u mbajt nga 21 deri më 25 maj 1912. Në këtë kuvend mori pjesë Isa Boletini bashkë me 12 krerë të tjerë nga krahina e Mitrovicës,⁴ përfaqësues nga të gjitha krahinat e Kosovës, nga Dibra, nga Shkodra, nga disa krahina të Jugut si dhe sekretari personal i Ismail Qemalit, Sali Hidri.⁵ Gjatë zhvillimit të kuvendit Isa Bo-

1) *Dokumenti o spolnoj politici...*, dok. 537, f. 844.

2) *Po aty*. AK. Konsulli serb në Prishtinë, Beogradit, 2/15.5.1912.

3) H. Prishtina *Vep. e për.*, f. 17.

4) AK. Tel.nr. 2709 konsullata serbe në Prishtinë, Beogradit, 15/28.5.1912.

5) Z. Cana. *Vep. e për.*, f. 231.

letini veproi energjikisht dhe i palëkundur. Ai, në bashkëpunim me Hasan Prishtinën dhe krerë të tjerë që përbënin grupin autonomist, mposhtën përpjekjet e parisë turkomane e të agjentëve të xhonturqve për të përçarë kuvendin dhe vijuan punën për të përpunuar planin e kryengritjes së armatosur. Në të njëjtën kohë bënë të njohur programin politik të kryengritjes që përmbli dhej në gjashtë pika kryesore: caktimi i kufijve të Shqipërisë, krijimi i një administrate shqiptare, ngritja e flamurit kombëtar, njohja e shqipes si gjuhë zyrtare, caktimi i një guvernatori të përgjithshëm që do të zgjidhej nga një familje e njohur e vendit dhe sigurimi i plotësisimit të këtyre kërkesave nga ana e Fuqive të Mëdha.¹

Programi politik i kryengritjes që kishte karakter mbarëshqiptar iu dorëzua qeverisë së Stambollit dhe u botua në shtypin shqiptar dhe të huaj.²

Mbas kuvendit të Junikut Isa Boletini në bashkëpunim me krerë e tjerë kryengritës, vendosën të sulmonin Pejën dhe Gjakovën.³ Kryengritja mori pëspjesëtime më të gjera. Sulmi mbi Pejë filloi më 31 maj. Kryengritësit rrethuan qytetin. Numri i përgjithshëm i tyre ishte 3500-4000 veta. Sulmet qenë të fuqishme dhe u shoqëruan me luftime të ashpra. Megjithatë kryengritësit nuk mundën ta merrnin Pejën që mbrohej nga forca të shumta osmane. Ndërkohë, të rrethuarve u erdhën në ndihmë edhe forca të freskëta nga Gjakova e Mitrovica, të cilët i vunë forcat kryengritëse midis dy zjarresh. Luftime të ashpra u zhvilluan në afërsi të Strellcës ku kryengritësit, të udhëhequr nga Isa Boletini e Bajram Curri, bënë qëndresë heroike ndaj sulmit të befasishëm të forcave osmane. Humbjet në radhët e armiqve ishin të mëdha, por dhe kryengritësit pësuan humbje të ndjeshme.⁴

Për mungesë armësh e municioni kryengritësit nuk

1) *Po aty*, f. 231-232.

2) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 470.

3) AK. Rap. nr. 2709 i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit, 15/28.5.1912.

4) *Dokumenti o spolnoj politici...*, dok. 490, f. 783.

mundën t'i vazhdonin më tej luftimet në Pejë dhe u detyruan të tërhiqeshin. Por kjo nuk ndryshoi gjë në objektivat e kryengritjes, e cila mbeti në rend të ditës. Tërheqjen krerët kryengritës e shfrytëzuan për t'u armatosur dhe për t'u organizuar më mirë për sulmet e mëvonshme kundër forcave osmane. Isa Boletini u tërhoq në Bellajë, në afërsi të krahinës së Deçanit,¹ e prej këtu shkoi në Boletin.

Një grup kryengritësish prej 2 000 luftëtarësh kaluan në Guci dhe më 9-10 qershor sulmuan gazermat ushtarake dhe futën në dorë një sasi të konsiderueshme armësh e municioni,² ndërsa grupi tjetër prej 2300 luftëtarësh u tërhoq në grykën e Rugovës.³

Në këtë kohë Isai në krye të forcave kryengritëse të Vuçiternës, Shalës, Llapit dhe Mitrovicës, organizoi bllokimin e rrugës Mitrovicë — Pazari i Ri⁴. Tashmë nën udhëheqjen e Isa Boletinit ishin vënë një numër i madh kryengritësish jo vetëm nga Mitrovica, por edhe nga krahina të tjera. Autoriteti dhe popullariteti i tij ishte i madh në djalërinë shqiptare. Në të gjitha krahinat ku shkelte Isa Boletini, organizoheshin kuvende të burrave dhe bëhej betimi besa-besë, të gjithë kemi me vdekë me Isa Boletinin.⁵

Krahas shtimit të radhëve kryengritëse Isa Boletini tregoi kujdes edhe për ruajtjen e forcimin e unitetit ndërmjet kryengritësve, në mënyrë që armiku të mos kishite mundësi t'i përçante. Ai mbante qëndrim të rreptë e të prerë ndaj atyre që sabotonin çështjen e kryengritjes. Kështu Isai dënoi Haxhi Hysniun në fshatin Banjskë pranë Vuçiternit, i cili ishte vënë në shërbim të xhonturqve.⁶

1) AK. Tel. nr. 707 i konsullit serb në Prishtinë, ministrit të Punëve të jashtme të Serbisë M. Gj. Millovanoviç, 28.5/10.6.1912.

2) AK, Rap. nr. 750 i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit, 7/20.6.1912.

3) Z. Cana. *Vep: e për.*, f. 233.

4) *Po aty.*

5) AQSh Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

6) AK. Rap. nr. 780 i konsullit Serb në Prishtinë, Beogradit, 7/20.6.1912.

Meqenëse Isa Boletini po bëhej një ndër protagonistët kryesorë të kryengritjes dhe përpjekjet për ta larguar atë nga rruga e kryengritjes kishin dështuar, autoritetet osmane u orvatën edhe një herë (pas provave të pasuksesshme) ta asgjësonin fizikisht. Por Isa Boletini nuk e mbrohin vetëm disa njerëz, por masat popullore të cilave u kishte prirë në sa e sa beteja prandaj atentati i organizuar dështoi dhe atentatori u kap.¹

Isa Boletini e ndihmoi kryengritjen edhe në një aspekt tjetër. Ai u përpoq ta financonte atë mbasi vuri në dispozicion të lëvizjes gjithë dëmshpërblimin që i dha qeveria turke² në gusht të vitit 1911, Isai kërkoi ta bënin këtë gjë edhe të tjerët. Në bisedat me pasanikët e Mitrovicës, Vuçiternit e Prishtinës, ai e vlerësoi çështjen e ndihmës materiale si kontribut për çështjen kombëtare.³

Shembullin e tij e ndoqën edhe disa të tjerë, si Sadik Rama, i cili shiti gjithë grurin që kishte, për nevojat e kryengritjes.⁴

Aty nga mesi i qershorit 1912, kur Isa Boletini vazhonte mobilizimin e forcave kryengritëse në lindje të hekurudhës Shkup-Pazari i Ri, Bajam Curri me një pjesë të forcave kryengritëse të krahinës së Gjakovës, sulmoi batalionin osman të përqendruar në Qafën e Prushit. Në sajë të befasisë dhe shpejtësisë me të cilën vepruan, forcat kryengritëse arritën fitore të shkëlqyera mbi trupat osmane duke i shpartalluar ato plotësisht.⁵

Kryengritja tashmë ishte përhapur edhe në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, ku rol të rëndësishëm luante «Shoqëria e zezë për shpëtim».⁶

1) AQSH, Fondi nr. 143 dosja nr. 136, 26 maj — qershor 1912; AIH. Dokumente ruse, dosja nr r-2.

2) AK. Raport i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit, 7/20 qershor 1912:

3) *Dokumenti i spolnoj politici...*, dok. 526. f. 830.

4) AK. Rap. i konsullit serb në Prishtinë. Beogradit, 7/20 qershor 1912.

5) *Historia e Shqipërisë*. Vël. II. Tiranë, 1984, f. 471.

6) *Po aty*.

Ndihmat e Isa Boletinit, Sadik Gjurgjevikut e ndonjë tjetri në dobi të kryengritjes, armët që i rrëmbeheshin armikut si dhe ato pak ndihma që vinin nga Serbia, nuk mund të përballonin numrin e madh të luftëtarëve që çdo ditë e më shumë shtonin radhët e kryengritjes. Në këto kushte Hasan Prishtina, Isa Boletini dhe krerë të tjerë të kryengritjes, menduan të afroheshin me opozitën ushtarake që ishte krijuar e po rritej në ushtri, si pjesë e lëvizjes së pëngjithshme opozitare e kryesuar nga itilafistët. Itilafistët (anëtarë të partisë «Liri dhe marrëveshje») kundërshtarë politikë të xhonturqve, me gjithë karakterin reaksionar të disa kërkesave të programit të partisë së tyre parashikonin edhe decentralizimin administrativ të krahinave kombëtare të Perandorisë.

Në bisedimet që u zhvilluan me opozitën ushtarake, komitetet shqiptare kërkuan që në programin e përbashkët të vihej edhe kërkesa për autonominë e Shqipërisë. Por qysh në fillim dolën në pah divergjencat parimore që ekzistonin midis programeve të tyre. Opozita ushtarake hodhi poshtë kërkesën e shqiptarëve për autonomi, sepse ashtu si gjithë lëvizja itilafiste, ajo ishte kundër autonomisë së Shqipërisë.¹

Por të ndodhur në kushte të vështira për mungesë armësh e municionesh dhe para një armiku të madh në numër që arrinte në 60 000 ushtarë si dhe rrethanave të vështira ndërkombëtare qëndrimin negativ të Fuqive të Mëdha të Austro-Hungarisë dhe të Italisë ndaj lëvizjes shqiptare, udhëheqësit e kryengritjes, duke mos gjetur rrugëdalje tjetër, bënë një kompromis të përkohshëm, ngushtuan në disa pika platformën e Junikut, u bashkuan me programin e opozitës ushtarake për të siguruar bashkëpunimin e saj në luftë kundër xhonturqve.² Isa Boletini e mbështeti këtë qëndrim dhe së bashku me Hasan Prishtinën, Bajram Currin etj., në fund të qershorit bënë një deklaratë ku theksonin se shqiptarët ishin ngritur në kry-

1) *Po aty.*

2) *Po aty*, f. 472:

engritje jo vetëm për të mbrojtur Shqipërinë, por edhe për interesat e gjithë Turqisë, kundër xhonturqve që kishin shkelur kushtetutën dhe po e çonin Turqinë drejt shkatërrimit.¹ Deklarata e bëri shpejt efektin e vet pozitiv. Me qëllim që të përdorte kryengritjen shqiptare për të realizuar programin e saj, opozita ushtrake vendosi t'i përkrahte kryengritësit. Shumë ushtarë shqiptarë, pas shpalljes së deklaratës, filluan të dezertinin nga repartet e ushtrisë osmane e u bashkuan me kryengritësit.² Kështu që në fund të qershorit luftimet morën përsëri hov. Në këtë kohë Isa Boletini, Ahmet Prekazi, Zejnullah Vuçiterni, Xhemal Prishtina etj., udhëhiqnin veprimet luftarake në rrugën Mitrovicë-Pejë dhe Podujevë-Prishtinë, duke çliruar disa qytete të Kosovës. Kryengritësit e Gollakut, Shalës e Llapit, të grumbulluar në fshatin Veskofcë në afërsi të Vuçiternit, u besatuan rreth Isa Boletinit se do të luftonin deri në fund.³ Duke marrë me vete një pjesë të kryengritësve, Isai u nis për në Boletin për t'u bashkuar me kryengritësit e atjeshëm, ndërsa pjesa tjetër, sulmoi më 28-29 qershor forcat osmane të ura e Sitnicës, pranë Mitrovicës.⁴ Mbas luftimesh të ashpra ata shkatërruan rreth dy batalione osmane. Për të penguar bashkimin ose dhe bashkëveprimin me grupin tjetër të kryengritësve të Isait në Boletin, komandanti i garnizonit ushtarak të Mitrovicës, Fadil pasha, organizoi operacionin luftarak kundër Boletinit.⁵ Në fillim të korrikut, forcat osmane (rreth 4 000 veta) drejtimin e të cilave e kishte marrë në dorë vetë vali i Kosovës po e ngushtonin rrethimin në përqëndrimin kryesor të kryengritësve në Sokolicë. Veprimet luftarake të të rrethuarve i organizonte e i drejtonte vetë Isa Boletini.

Në ndihmë të tyre u nisën disa forca kryengritëse të

1) AMAE. Aneks i letrës nr. 72, konsulli francez në Shkup. MPJ së Francës, 29.6.1912.

2) «La Nazione Albanese» vëll. XVI. 30 qershor 1912.

3) AQS: Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

4) Z. Cana Vep. e përm., f. 240.

5) Dokumenti o spolnoj politici..., dok. 575, f. 896.

komanduara nga Zejnullah Vuçiterni. Ato u diktuan dhe u sulmuan nga trupat osmane, dhe vetëm mbas luftimesh të ashpra, mundën të bashkoheshin me Isa Boletinin. Duke u mbështetur dhe në ndihmat që i erdhën, Isa Boletini i theu disa herë sulmet e osmanëve dhe bëri që operacioni i tyre të dështonte.

Më 2 korrik, mbas dy ditë luftimesh të ashpra, ku forcat osmane lanë rreth 100 të vrarë e shumë të plagosur, Isa Boletini, në krye të kryengritësve çau rrethimin dhe me rregull të plotë u tërhoq në luginën e Llapit.¹ Në mëbrëmjen e datës 2 korrik, forcat osmane hynë në Boletin dhe u hakmorrën ndaj grave, fëmijëve, pleqve etj. Dogjën e shkatërruan plotësisht kullën e Isa Boletinit dhe shumicën e shtëpive në fshatrat Boletin, Lipa, etj. Terror të egër ushtruan sidomos kundër familjeve të krejve të cilat vendosën t'i internonin.²

Sapo mbërriti në luginën e Llapit, Isa Boletini u bëri thirrje burrave të kësaj krahine të ngriheshin në luftë kundër sundimit osman. Thirrjes së tij iu përgjigj gjithë krahina, e cila u bashkua me kryengritësit. Isa Boletini, në bashkëpunim me disa kontigjente të Hasan Prishtinës e të Riza Gjakovës, sulmoi forcat osmane në grykën e Kulinës dhe i veçoi nga forcat e tjera trupat që ndodheshin në Bodivë dhe në afërsi të saj.³ Vetëm pas shumë përpjekjesh, siç shprehet një vëzhgues i huaj, forcat osmane mundën të vendosnin komunikimin me Bodivën e me Shalën.⁴

Në kohën kur Isai luftonte në Sokolicë e Kulinë, sulmet e kryengritësve kundër forcave osmane u bënë më të shpeshta dhe në krahina të tjera. Forca kryengritësishe, të udhëhequra nga Zejnullah Vuçiterni zhvilluan luftime

1) *Po aty*, dok. 576, f. 896.

2) *Po aty*. AK. Informacion nr. 870 i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit, 21.6-4.7.1912.

3) *AMAE*. Letër nr. 464 e atasheut ushtarak i Francës në Turqi. Moker, MPJ së Francës, më 22.7.1912.

4) *Po aty*.

të ashpra me trupat osmane në Drenicë në afërsi të fshatit Zhabar.¹ Më 12 korrik kryengritësit e tjerë të kryesuar nga Bajram Curri ranë në përpjekje me forcat osmane në Zogaj të Gjakovës. Në këtë betejë turqit patën shumë humbje në njerëz, armatime e municione, të cilat ranë në dorë të kryengritësve. U zhvilluan përlëshje të ashpra në fshatin Rudnik e Braboniq në rrethinat e Vuçiternit. Edhe në Pejë pati trazira të mëdha, që u shkaktuan pasiguri forcave e autoriteteve lokale osmane.² Gjendje e nderë u krijua edhe në Prishtinë.

Popullsia e qytetit u ngrit dhe i dërgoi sulltanit kërkesa për të ndërruar ministrat, për të shpërndarë parlamentin dhe për shpalljen e zgjedhjeve të reja. Prijësit u shprehën njëzëri se do të sulmonin Prishtinën në qoftë se nuk do të merrnin përgjigje në një afat sa më të shkurtër prej Stambollit.³ Këto kërkesa u përkrahën edhe nga oficerët e shtabit të Divizionit të Gjakovës dhe më vonë edhe nga oficerët e Mitrovicës, Selanikut e Manastirit⁴. Me sukses u zhvilluan sulmet e kryengritësve edhe në zonën e Gjilanit, Prizrenit, Lumës, Tetovës etj. Gjatë kohës së qëndrimit në krahinën e Llapit Isai mori pjesë në luftimet e forcave kryengritëse kundër forcave osmane në Podujevë e Prishtinë.⁵ Mbas sulmeve të herëpashershme kundër osmanëve në Podujevë dhe në rrethet e Prishtinës, Isa Boletini, Zenel Vuçiterni, Xhemal Vuçiterni etj., i përqëndruan forcat e tyre në fshatin Rep. Iljaz Vuçiterni me kryengritësit e tij do të vendosej në fshatin Mramor, së bashku me forcat e Idriz Seferit etj. Në radhët e ushtrisë osmane filluan dezertime në masë, reparte e nënreparte kundërshtonin urdhrin

1) *Po aty*. AK. Letër 870 e konsullit serb në Prishtinë, Beogradit, 21.6./4.7.1912, HHSStA, PA.A. Rap. nr. 41, konsulli a-h në Mitrovicë, Vjenës, 24.7.1912.

2) *Po aty*: AMAE. Letër 666 e konsullit francez në Shkup Karlie, MPJ së Francës, 8.7.1912.

3) Z. Cana, *Vep. e përm.*, f. 246.

4) *Po aty*: dok, 614, f. 936.

5) *Dokumenti o spolnoj politici*, dok 595, f. 919.

për të luftuar me kryengritësit. Batalioni i Ferizajt nuk u bind të nisej në Boletin kundër Isait.¹

Mbështetur në sukseset e arritura ndaj forcave osmane dhe në gjendjen e ushtrisë së tyre, Isa Boletini dhe krerët e tjerë kryengritës menduan se kishte ardhur çasti për t'u hedhur në sulm të përgjithshëm për çlirimin e qyteteve. Bajram Curri në krye të luftëtarëve të Gjakovës, sulmoi forcat osmane në zonën e Hasit dhe më 17 korrik çliroi Gjakovën.² Forcat kryengritëse me 19 korrik iu drejtuan Prishtinës dhe hynë në qytet pa luftë. Mbas luftimeve në Boletin, Podujevë e Prishtinë Isai u përgatit për të sulmuar Mitrovicën, por shpejt ndërroi mendje dhe u tërhoq përkohësisht nga sulmi mbi të. Ka shumë mundësi që Isai t'i ketë gjykuar të papërshtatshme kushtet e krijuara. Në Mitrovicë ishin përqendruar forca të shumta ushtrake dhe ishin marrë masa të mira mbrojtëse për të përballuar sulmet e mundshme të kryengritësve. Në këto kushte, sulmi mbi Mitrovicën nuk do ta kishte befasinë e nevojshme të kryengritësve, të cilët ishin të pakët në numër dhe të varfër në armatime e municione dhe do t'u kushtonte shtrenjtë edhe sikur të përfundonte me fitore. Madje, edhe për popullsinë e qytetit do të kishte pasojat e rënda se do t'i nënshtrohej terrorit e vrasjeve nga ana e turqve. Prandaj Isai mendoi se më i përshtatshëm do të ishte sulmi ndaj Pazarit të Ri. Kështu, Isa Boletini me 500 veta rrethoi Pazarin e Ri dhe natën e 22 korrikut u fut në qytet.³ Ndërkohë Isai u bëri thirrje fshatarëve të Senicës, Prepoljes, Plevljes, Tërgovishtës, Beranës, për t'u ngritur në kryengritje⁴ dhe komandës së garnizonit të lëshonte qytetin pa luftë.⁵ Masat popullo-

1) AK. Tel. 879 i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit, 23.6./6.7.1912.

2) Z. Cana. Vep., e përm., f. 249

3) Po aty.

4) HHSIA, P.A.A. Rap. nr. 36 Tahy në Stamboll, von Goluhovskit, Vjenë, 22 korrik 1912.

5) Po aty.

re të rrethinave dhe qytetit iu përgjigjën thirrjes së Isa Boletinit. Përfaqësues nga fshatrat dhe qyteti u takuan me Isanë dhe u shprehën për besnikëri ndaj kryengritësve. Nën presionin e forcave shqiptare, kajmekami i qytetit dhe oficerët turq, pranuan pa kundërshtim kërkesat e Isa Boletinit.¹

Sukseset e njëpasnjëshme të kryengritësve tronditën thellë pushtetin osman. Lëkundjet u ndien jo vetë në organet lokale, por edhe në ato qendrore. Ministri i Luftës Mahmud Shefqet pasha dha dorëheqjen. Më 17 korrik dha dorëheqjen dhe gjithë qeveria e Said Pashës.

Kriza në qeverinë osmane i nxiti kryengritësit për të vepruar më energjikisht. Sulmet e tyre kundër garnizoneve osmane u bënë më të shpeshta. Brenda pak ditësh u çliruan Prishtina, Peja, Ferizaj, Gryka e Kaçanikut kontrollohej nga kryengritësit.

Më 22 korrik erdhi në fuqi qeveria e re kundërshtarë e xhonturqve e kryesuar nga Ahmet Myftar pasha. Isa Boletini dhe udhëheqës të tjerë të kryengritjes përshëndetën qeverinë e re dhe i kërkuan asaj që të shpërndante parlamentin e të shpallte zgjedhjet e reja.²

Duke parë se kryengritja kishte marrë përpjesëtime të gjera dhe nuk mund të përballohej aktualisht, qeveria e re urdhëroi që forcat ushtarake osmane të ndërprisnin luftimet dhe deklaroi se do të hynte në bisedime me shqiptarët.³

Në këto rrethana Hasan Prishtina, Isa Boletini dhe udhëheqës të tjerë të kryengritjes organizuan një mbledhje në Prishtinë,⁴ me sa duket, për t'u këshilluar lidhur me qëndrimin që duhej të mbanin ndaj propozimit të kabinetit të ri osman për të hyrë në bisedime.

Sipas disa burimeve del se Isa Boletini dhe një pjesë e krerëve u shprehën për vazhdimin e kryengritjes de-

1) *Po aty*.

2) Z. Cana. Vep. e përm., f. 249.

3) AK. Tel. i konsullit serb në Selanik, Beogradit, 14/27.7.1912.

4) *Po aty*. Tel 1028 i konsullit serb, në Prishtinë, Beogradit, 12/25.7. 1912:

ri në fund.¹ Me sa duket në mbledhje mund të jetë shfaqur edhe mendimi për të ndërprerë veprimet luftarake, në pritje të bisedimeve me qeverinë osmane. Zhvillimi i mëvonshëm i ngjarjeve na shtyn të mendojmë që krerët e mbledhur në Prishtinë të kenë pranuar të hyjnë në bisedime me qeverinë osmane, por njëkohësisht kanë rënë dakord midis tyre që të vazhdonin edhe veprimet luftarake në mënyrë që t'i vinin turqit në negociatat e marrëveshjes në pozitat e të mundurit.²

Nga Prishtina Isa Boletini shkoi përsëri në Pazar të Ri për të organizuar sulmin drejt Mitrovicës. Radhët e kryengritësve të udhëhequr nga Isa Boletini tashmë ishin shtuar. Numri i tyre kishte arritur në rreth 6 000 veta.³

Pasi mori masa për pajisjen më të mirë të luftëtarëve me armë e municion, si dhe furnizimin me ushqime të zëna forcave osmane në Pazar të Ri, më 26 korrik 1912 Isa Boletini iu drejtua Mitrovicës.⁴ Qyteti mbrohej mirë. Forcat e shumta osmane, ishin vendosur në fortifikime në kodrat përreth tij. Por situata nuk ishte e favorshme për mbrojtësit. Në radhët e reparteve ushtarake gjendja morale ishte mjaft e ulët. Gatishmëria e masës së thjeshtë të ushtarëve (shqiptarë që kryenin shërbimin ushtarak) për të luftuar kundër kryengritësve ishte e dobët, kishte dezertime dhe mosbindje ndaj oficerëve. Duke e njohur këtë gjëndje si dhe duke u nisur nga fakti që vetë qeveria e re osmane kishte dhënë urdhër të ndërpriteshin luftimet, Isa Boletini mendoi se mund të hynte në Mitrovicë pa gjakderdhje. Prandaj, i dha ultimatum komandantit të qytetit që brenda 2 orëve ai të lëshonte pozicionet e fortifikuara dhe ta kthente ushtrinë

1) *Po aty*.

2) Z. Cana. Vep. e përm., f. 250.

3) AMAE. Informacion i konsullit francez në Shkup, MPJ së Francës, 31.7.1912.

4) HHSIA P.A.A. Rap. nr. 36 Tahy në Stamboll, Vjenës, 28.7. 1912.

në kazerma, në të kundërt luftëtarët shqiptarë do të sulmonin.¹

Komandanti turk, duke parë numrin e madh të kryengritësve dhe vendosmërinë e tyre për të shtënë në dorë qytetin, e pranoi kërkesën e Isa Boletinit. Kështu, më 26 korrik 1912 Isa Boletini në krye të forcave kryengritëse, hyri triumfalisht në Mitrovicë². Populli i qytetit e priti me entuziazëm hyrjen e luftëtarëve shqiptarë dhe i bëri të njohur telegrafisht sulltanit se Mitrovica ishte me kryengritësit.³

Në Mitrovicë u hapën burgjet, u liruan të burgosurit politikë, dhe u shkatërruan trekëmbëshat që kishin ngritur turqit për të ekzekutuar kundërshtarët e politikës së tyre etj. Por masat që filloi të merrte Isa Boletini nuk i çoi deri në fund. Fitoret e arritura në fushën ushtarake nuk u shoqëruan edhe në atë politike. Kryengritësit u orvatën të bënin ndryshime në administratën civile osmane, por jo të plota. Ata nuk arritën ta zëvendësonin atë me administratën shqiptare. Ky qëndrim u përcaktua nga dy faktorë: nga presioni i krerëve itilafistë brenda lëvizjes dhe nga politika armiqësore e shteteve fqinje, synimet e të cilave për copëtimin e Shqipërisë ishin bërë tanimë krejtësisht të qarta.⁴ Pra kjo që një dobësi jo vetëm e Isa Boletinit, por dhe e të gjithë udhëheqësve të tjerë kryesorë, gjë që mendojmë se përbënte dobësinë themelore të kryengritjes.

Pas Mitrovicës Isa Boletini iu drejtua Vuçiternës. Ashtu si në Pazar të Ri e Mitrovicë edhe në Vuçiternë, Isa Boletini mundi t'u imponohej forcave ushtarake osmane dhe të hynte në qytet pa gjakderdhje. Ajo që binte në sy, ishte aftësia që Isa Boletini kishte për t'i drejtuar forcat kryengritëse në mënyrë shumë të organizuar dhe me disiplinë. Kur hynin në qytet (kryengritësit — F.M.) —

1) *Po aty.*

2) *Po aty*

3) *Po aty.*

4) *Historia e Shqipërisë*, Vëll. II, Tiranë, 1984, f. 485.

shkruan konsulli serb në Prishtinë, — linin mbresa shumë të mira sa që dukeshin sikur ishin ushtri të rregullta.¹

Kështu, nga fundi i korrikut në pjesën më të madhe të qyteteve të Kosovës kryengritësit u bënë zotër të situatës. Kryengritja ishte zgjeruar e fuqizuar. Numri i kryengritësve sipas një të dhëne, arrinte në mbi 60000 veta, dhe më shumë se gjysma e tyre ishin të armatosur mirë.²

Përballë një force kaq të madhe kryengritësishe, e trembur nga fitoret e njëpasnjëshme që po arrinin luftëtarët shqiptarë, qeveria e Ahmet Myftar pashës u detyrua të dërgonte komisionin për të hyrë në bisedime. Krerët kryengritës pranuan të shtroheshin në bisedime, por nuk hoqën dorë nga lufta e armatosur. Forcat kryengritëse, filluan të zbrisnin në fushën e Kosovës.

Isa Boletini, i lajmëruar nga Hasan Prishtina për arrijtjen e komisionit turk, u nis nga Vuçiterni dhe më 29 korrik³ arriti në Prishtinë për të marrë pjesë në këto bisedime.

Përpara krerëve kryengritës dilte detyrë e rëndësishme që në bisedimet me palën turke të dilnin me një platformë të përbashkët për autonominë e Shqipërisë. Kjo do të thoshte që ata të shkëputeshin nga programi itilafist.

3. NË KUVENDIN E FERIZAJT

Bisedimet midis palës shqiptare dhe asaj turke filluan më 2 gusht 1912. Komisioni turk përbëhej prej 3 vetash, i kryesuar nga Ibrahim pasha, ndërsa nga pala shqiptare merrnin pjesë Hasan Prishtina, Isa Boletini, Idriz Seferi, Bajram Curri, Mehmet pashë Derralla, si dhe

1) AK. Rap. nr. 1059 i konsullit serb në Prishtinë, MPJ të serbisë Beograd, 16/29.7.1912.

2) AMAE. Rap: i konsullit francez në Shkup, MPJ së Francëz. 31.7.1912.

3) AK; Rap. nr. 1059 i konsullit serb në Prishtinë, Beogradit 16/29.7.1912.

përfaqësues nga paria e Prizrenit, Lumës e Malësisë së Gjakovës¹ si dhe përfaqësues të parisë turkomane të Prishtinës, Tetovës dhe Shkupit, i ftatë të itilafistëve. Këta të fundit të përkrahur nga popozita ushtarake, kishin fituar pozita të rëndësishme në udhëheqjen e lëvizjes në saje të ndihmave finaciare që i kishte dhënë asaj. Përfaqësuesit e vilajetit të Shkodrës e të Shqipërisë së Mesme ende nuk kishin arritur, njëkohësisht edhe Hasan Prishtinës nuk i kishte ardhur mandati si përfaqësues i Shqipërisë Jugore.²

Për kërkesat që do t'i parashtroheshin komisionit turk, në krerët e kryengritjes u shfaqën dy rryma politike: rryma e autonomistëve që këmbëngulnin për formulimin e kërkesave nën frymën e Memorandumit të Greçës dhe rryma reformiste. Megjithëse reformistët përbënin një grup shumë të fortë,³ Hasan Prishtina dhe grupi autonomist u shkëputën nga programi itilafist dhe i paraqitën komisionit turk kërkesat themelore të programit autonomist. Këto kërkesa komisioni turk nuk i pranoi, madje Ibrahim pasha refuzoi edhe kërkesën e vetme që paraqiti mbledhja nën presionin e delegatëve turkomanë, për shpërndarjen e parlamentit. Kështu që bisedimet u ndërprejnë.⁴

Meqenëse përgjigja që pritej nga qeveria turke nuk erdhi dhe me që qëndrimi i mëtejshëm në Prishtinë u bë i pamundshëm për shkak të vështirësive të furnizimit me ushqim, Isa Boletini, Hasan Prishtina dhe krerë të tjerë kryengritës, më 5 gusht u nisën në drejtim të Ferizajt.⁵ Lajmi për marshimin e forcave kryengritëse në Ferizaj u prit në Stamboll me shqetësim të madh. Në kabinetin turk Hilmi pasha, ministër i Drejtësisë kër-

1) AMAE: Letër. Nr. 500. Atasheu ushtarak i Francës në Stamboll Mokbor, Ministrisë së Luftës së Francës. 20.8.1912.

2) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 478.

3) Z. Çana. Vep. e përm. f. 258.

4) *Po aty*.

5) AK. Tel. i konsullit serb në Prishtinë. MPJ të Serbisë, 22. 7./4.8.1912.

konte me ngulm shpërndarjen e parlamentit. Nëse shqiptarët marrin Shkupin, — deklaronte ai, — na iku nga dora Rumelia.¹ Më 5 gusht qeveria mori vendim për të shpërndarë parlamentin dhe u shpallën zgjedhjet e reja. Kjo bëri që itilafistët turq dhe përkrahësit e tyre shqiptarë të largoheshin nga kryengritësit.

Të ndodhur larg presionit të itilafistëve, dhe me qëndërkaq Hasan Prishtinës i erdhi mandati i përfaqësimit për Shqipërinë e Jugut² u krijua mundësia që prijësit shqiptarë t'i paraqitnin komisionit turk një memorandum në emër të të gjithë shqiptarëve. Për këtë në Ferizaj u organizua një mbledhje. Hasan Prishtina paraqiti programin autonomist, i cili u kundërshtua nga disa krerë, midis të cilëve, siç shkruante Hasan Prishtina në kujtimet e veta, ishte edhe Isa Boletini.³ Një fakt tjetër që mbështet mendimin e Hasan Prishtinës, është pohimi i konsullit gjerman në Selanik, ku, midis të tjerash, theksonte se Isa Boletini, B. Curri, Jahja Prizreni etj., në mbledhjen e Ferizajt ishin për kërkesa të moderuara.⁴

Për qëndrimin e Isa Boletinit në këtë kohë ndaj problemit të autonomisë, jemi mbështetur në bisedën që vetë ky ka zhvilluar në fund të gushtit me Aubrey Herbertin (kryetar i Komitetit Proshqiptar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Anglisë). Pyetjes së Herbertit nëse shqiptarët e duan apo jo autonominë e Shqipërisë Isa Boletini i qe përgjigjur «Jo, ajo që duan ata (shqiptarët) është që të mos trazohen nga të tjerët».⁵

1) Z. Cana. *Vep. e për.*, f. 264.

2) *HHStA, PA, A.* Informacion i konsullit gjerman në Selanik 10.8.1912.

3) H. Prishtina. *Vep. e për.*, f. 30-31.

4) *PAAA.* Informacion i konsullit gjerman në Selanik, 20 gusht 1912.

5) A. Herbert. *Ben Këndim, a record of esatern travel.* London 1924, (AIH. faqe përkth: 31-52).

Nga kjo përgjigje mund të gjykojmë se tërheqja e Isait nga programi autonomist u kushtëzua kryesisht nga faktorët politikë, ekonomikë, e shoqërorë që u krijuan në Shqipëri dhe për Shqipërinë gjatë kryengritjes së vitit 1912.

Shtetet fqinje të lidhura me Aleancën Ballkanike e të mbështetura nga Rusia Cariste, Franca etj., i shtuan përpjekjet e tyre jo vetëm brenda vendit, por edhe në arenën ndërkombëtare për të minuar kërkesat e kryengritësve për një shtet autonom shqiptar. Duke bërë presion diplomatik te qeveria e Stambollit Fuqitë e Mëdha i bënë asaj të ditur se me rastin e caktimit zyrtar të koncesioneve që do t'u jepnin shqiptarëve, nuk do të kishin punë vetëm me ata, por edhe me vendet ballkanike që ishin të gatshme për aksionin e armatosur dhe pritnin çastin e përshtatshëm që të fillonin luftën kundër Turqisë.¹

Konfliktet e armatosura në kufirin shqiptaro-malazez po bëheshin gjithnjë e më të shpeshta.

Këto ishin arsyet që krijuan tek Isai dhe një pjesë e krerëve kryengritës, bindjen se lufta e shteteve fqinjë kundër Turqisë nuk do të ishte e largët dhe se nuk duhej të prekej status qu-oja e Perandorisë Osmane, qoftë edhe me kërkesën për autonominë.

Duke analizuar veprimtarinë atdhetare të Isait, deri në prag të bisedimeve shqiptaro-turke, vëmë re këtë karakteristikë kryesore: Përkrahja, propagandimi i programit autonomist, në gjirin e masave popullore dhe lufta për të vënë atë në jetë, e përshton si një fill i kuq gjithë veprimtarinë e tij organizative e luftarake. Për më tepër vetëm 3 muaj pas bisedimeve ndeshemi me përkrahjen pa rezerva nga ana e tij të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë e pjesëmarrjen në luftë për forcimin e shtetit të pavarur shqiptar. Të gjitha këto na çojnë në, përfundimin se tërheqja e Isait nga programi

1) Z. Cana. *Vep. e për.*, f. 277.

autonomist që e përkohshme dhe u kushtëzua nga faktorët e përmendur më lart.

Dalja në dritë e dokumenteve të reja do të ndihmojë në një arsyetim të mëtejshëm mbi qëndrimin e Isait në bisedimet e Prishtinës e të Ferizajt për problemin në fjalë.

Në mbledhjen e Ferizajt u diskutuan edhe probleme të tjera të rëndësishme si i shpërndarjes së armëve të grumbulluara nga Stambolli gjatë kryengritjeve të viteve, 1910, 1911, çështja e alfabetit, mbi të drejtat e serbëve,¹ etj. Lidhur me çështjen e shpërndarjes së armëve, Hasan Prishtina doli me propozimin që armët, të cilat do t'u ktheheshin shqiptarëve (nga turqit) të grumbulloheshin në depo dhe mbas 2-3 muajsh t'u shpërndaheshin atyre në mënyrë të fshehtë.²

Ky propozim mbartte rrezikun që, duke u lënë këto armë në dorë të administratës osmane, e cila mbahej ende në këmbë në Shqipëri e që vazhdimisht kishte kërkuar çarmatimin e shqiptarëve, të mos ua shpërndante armët atyre.

Ndryshe nga Hasan Prishtina, Isai u shpreh për shpërndarjen e menjëhershme të armëve shqiptarëve. Rreziku i luftës ballkanike, e bënte të domosdoshme armatosjen e shqiptarëve. Me propozimin e Isait u bashkuan Bajram Curri dhe disa krerë të tjerë.

Isa Boletini propozoi që disa të drejta t'i jepeshin edhe popullsisë serbe³ ashtu sikurse kërkuan përfaqësuesit e kësaj popullsie që morën pjesë në këto mbledhje. Duke u dhënë të drejtë pakicave serbe si dhe shqiptarëve s'ka dyshim se Isai shpresonte t'i tërhiqte edhe këto pakica në luftën kundër sundimit osman.

Udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe në

1) AK. Rap. i konsullit serb. në Prishtinë, MPJ së Beogradit, 2/15.6.1912.

2) *Po aty*; AMAE. Letër 512. Atasheu ushtarak i Francës në Stamboll, 21.8.1912.

3) *Po aty*.

mënyrë të veçantë Isa Boletini, të zhveshur nga çdo ndjenjë nacionalizmi të ngushtë edhe në këtë rast mbajtën një qëndrim të drejtë ndaj elementit serb në Kosovë. Për këtë flet qartë edhe fakti që qysh në fillimin e kryengritjes, siç është theksuar më lart, Isai i bënte thirrje popullsisë serbe për të marrë pjesë së toku në luftë kundër të njëjtit sundues. Po kështu edhe në bisedimet me komisionin turk, Isai i ftoi përfaqësuesit e popullsisë serbe që të shprehnin edhe ata kërkesat e tyre.¹ Edhe autorja angleze E. Durham, që i ka ndjekur nga afër ngjarjet e vitit 1912, në shkrimet e saj, vë në dukje qëndrimin dashamirës dhe trajtimin pa dallim të pakicave serbe nga Isa Boletini. Isai, theksonte ajo, e mbrojti pakicën sllave që banonte në Kosovë, kundër sundimit osman.² Ndërsa për respektin që Isai gëzonte në popullsinë serbe ajo shkruante se për udhëheqësin shqiptar Isa Boletinin kryengritësit serbë kishin respekt të madh. Kudo që ai drejtoi, asnjë nga serbët nuk qe shqetësuar, përkundrazi qe trajtuar me drejtësinë më të madhe, bile ai kishte ndihmuar edhe me armë kryengritësit serbë.³

Ndërsa historiani jugosllav Bogumil Hrabak, i nxitur nga ndjenjat shoviniste, mundohet të hedhë baltë e t'i injorojë përpjekjet e Isa Boletinit dhe krerëve të tjerë kryengritës, për t'u lidhur e bashkuar me popullsinë serbe.⁴

Në çështjen e alfabetit Isa Boletini u bashkua me Hasan Prishtinën që për gjuhën shqipe të përdorej alfabeti latin. Kundër këtij mendimi u ngritën hoxhallarët si dhe disa qytetarë.⁵

1) AK. Tel. 4778 i MPJ së Serbisë. Beogradit (degës konsullore), 3./16.8.1912.

2) A. Puto. *Vep: e për.*, f. 85.

3) E. Durham. *The Struggle for Scutari*. London, 1914, f. 170.

4) B. Hrabak. *Arbanashki ustanci 1912, godine Vranjë*, 1975 (sipas përkth. në AIH)

5) AK. Rap. 1180 i konsullit serb, në Prishtinë, MPJ Beogradit, 30. 7./ 12.8.1912.

Mbas shumë debatesh midis krerëve kryengritës u arrit të hartohej një memorandum me 14 pika, i cili u paraqit nga H. Prishtina. Midis të tjerave, çështja e caktimit të kufijve të Shqipërisë që do të shpinte vetvetiu në njohjen e kombësisë shqiptare dhe ishte një nga kërkesat themelore të lëvizjes, aty u shpreh në kërkesën për të vënë në zbatim organizimin e nahijeve (komuneve). Më 8 gusht ky memorandum iu dërgua Komisionit qeveritar në Prishtinë. Për t'u përgjigjur atij Stambollit iu dha afat prej 48 orësh, pas këtij afati kryengritësit do të marshonin drejt Shkupit.¹

Meqenëse përgjigja nuk erdhi në afatin e caktuar, kryengritësit vendosën të marshonin në drejtim të Shkupit. Grupi i parë i kryengritësve prej 100 vetash u nis nga Ferizaj e hyri në Shkup më 5 gusht. Grupi i dytë, ai i Gjakovës i përbërë prej 200 luftëtarësh hyri në qytet më 11 gusht,² ndërsa grupi i tretë mbërriti të nesërmen para dite. Pjesa kryesore e forcave kryengritëse u nis drejt Shkupit në drejtime të ndryshme, — rrugës së shkurtër. Forcat shqiptare të grumbulluar në Ferizaj u ndanë në dy kolona të mëdha dhe filluan lëvizjen. Kolona e parë, e udhëhequr nga Bajram Curri e Riza Kryeziu, mori drejtimin e Komogllavës, kurse kolona e dytë, e udhëhequr nga Isa Boletini e Ramadan Zaskoci, u nis në drejtim të Sllatinës. Po këtë ditë u nisën edhe kryengritësit e Prizrenit që do të marshonin në bregun e djathtë të Lepencit e do të bashkoheshin me tetovarët në malet e Kaçanikut.³ Forca të tjera nga Pre-sheva e Gjilani hynë në Shkup më 13-14 gusht. Në mesditën e 14 gushtit, Isa Boletini dha urdhër për hapjen e burgjeve dhe çliroi në këtë mënyrë një numër të madh të burgosurish.⁴ Me hyrjen e kryengritësve në

1) AK. Rap. 4778 i konsullit serb në Prishtinë — MPJ të Serbisë 3/16.8.1912.

2) Z. Cana. Vep. e përm. f. 269.

3) Po aty. AK. Tel. nr. 1179 i konsullit serb në Prishtinë 13.8.1912.

4) AK. Aneks III i letrës nr. 103 i konsullit francez në Shkup, 17.8.1912.

Shkup, administrata osmane u bë krejesisht e pafuqishme.

Në literaturën dhe dokumentacionin e hulumtuar del se pasi u mor Shkupi ndër krerët kryengritës u shfaq mendimi për të marshuar drejt Selanikut që të çlirohej sulltan Abdyl Hamidi. Për qëndrimin e Isa Boletinit në këtë pikë janë dhënë mendime të ndryshme. E. Durhami në ditarin e saj mbajtur në atë kohë, shkruante se grupi i Isa Boletinit ishte për autonomi dhe nuk dëshironte kthimin e Abdyl Hamidit.¹ Ndryshe nga pohimi i mësipërm H. Prishtina në kujtimet e tij thotë se Riza Begut dhe Isa Boletinit nuk mund t'u përmendje gjë për autonomi, ata mendonin për të marshue drejtim Selanikut për të shpëtue Abdyl Hamidin.²

Kjo çështje gjen pasqyrim edhe në dokumentet e kohës, serbe austro-hungareze,³ franceze etj. Në këto dokumente nismëtar i kësaj ideje paraqitet Riza Kryeziu. Por, sipas të dhënave të konsullit austro-hungarez në Shkup, ideja e Riza Kryeziut u përkrah në Shkup edhe nga Isa Boletini. Bajram Curri, Idriz Seferi etj.⁴ Kjo shkaktoi shqetësim të madh te Hasan Prishtina dhe krerët e tjerë kryengritës. Në kushtet kur fqinjët ballkanikë prisnin nga çasti në çast të sulmonin Perandorinë Osmane, lëvizja e forcave kryengritëse në drejtim të Jugut, përbënte një rrezik të madh për trojet shqiptare, sepse do t'u linte rrugën të lirë ushtrive serbo-malazeze për të marshuar drejt këtyre trojeve e për t'i pushtuar ato. Për këtë arsye Hasan Prishtina e krerët e tjerë organizuan më 18-19 gusht një mbledhje ku u kritikua si e dëmshme për lëvizjen nisma e Riza

1) AIH, A-IV-256. (Nga ditari i E. Durhamit).

2) H. Prishtina. *Vep. e përm.*, f. 30.

3) AK. Tel. i konsullit serb në Prishtinë, ministrit të Punëve të Jashtme në Beograd, 19.7./1.8.1912, AMAE. Letër nr. 512, Atasheu ushtarak i Francës në Turqi, ministrit të Luftës së Francës. 21.8.1912

4) HHStA, P.A.A. Rap. nr. 60, konsulli a-h Heimroth në Shkup, Vjenës, 21 gusht 1912.

Kryeziut. Kështu, Isa Boletini, B. Curri dhe I. Seferi vendosën menjëherë të ktheheshin në krahinat e tyre duke e lënë vetëm Riza Beun në mendimin e tij.¹ Më 19 gusht Isai me njerëzit e tij ishin gati për t'u kthyer në Mitrovicë² e për të organizuar mbrojtjen në krahinat e tyre. Duket qartë se bashkimi i I. Boletinit, B. Currit e I. Seferit me mendimin e Riza Kryeziut për të marshuar drejt Selanikut që i çastit.

Përpara kthimit Isa Boletini, Sali Aga, Bajram Curri, Islam Spahiu i bënë një letër Valiut, ku i kërkonin plotësimin e 14 pikave të memorandumit, në të kundërt do të fillonin përsëri luftën e do të ndaheshin nga sundimi osman.³

Përmasat dhe forca e kryengritjes shqiptare e trembën mjaft qeverinë turke, prandaj më 18 gusht, njoftoi se i pranonte kërkesat e kryengritësve shqiptarë. Mirëpo, më pas nën presionin e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve ballkanike, qeveria turke jo vetëm që nuk pranoi kërkesën për autonomi, por hodhi poshtë edhe kërkesat e tjera të memorandumit të Ferizajt. Ajo i botoi ato më 23 gusht në mënyrë tepër të thjeshtëzuar, duke u dhënë një karakter gjysmak e të pasigurt.⁴ Ajo i kishte bërë ato të padëmshme si për interesat e saj, ashtu dhe për ato të Fuqive të Mëdha imperialiste dhe të monarkive fqinje ballkanike, të cilat nuk donin kurrësesi ngritjen e një shteti autonom shqiptar.

Në këtë kohë rreziku nga shtetet shoviniste fqinje po rritej. Ato filluan të lëviznin për të realizuar planet e tyre aneksioniste ndaj tokave shqiptare. Kështu, Mali i Zi që kishte filluar provokacionet në kufirin me Shqipërinë qysh në korrik, u fut në brendësi të tokave

1) *Po aty*

2) *Po aty*.

3) ACSR. Letër nr. 2135/302 ministri i Italisë në Sofje, Bordaci, 28 gusht 1912; Gaz. «Liri e Shqipërisë», vëll. 2, nr. 53, Sofie 16 gusht 1912, f. 2.

4) St. Pollo. *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë* në: «Lëvizja Kombëtare Shqiptare», Tiranë, 1962, f. 66.

shqiptare duke pushtuar disa fshatra në drejtim të Shkodrës dhe të Pejës.¹

Përpara atdhetarëve gjendja e krijuar shtroi detyrën e menjëhershme: marrjen e masave për të mbrojtur tokat shqiptare. Kështu Hasan Prishtina e miratoi marrëveshjen dhe lajmëroi menjëherë telegrafisht qytetet e tjera shqiptare që t'u jepnin fund veprimeve luftarake kundër Turqisë.²

Me shpërndarjen e kryengritësve në krahinat e tyre, mori fund kryengritja e vitit 1912, një nga lëvizjet e fuqishme të masave popullore kundër sundimit osman. Ajo që shprehje e ngritjes në një shkallë më të lartë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në këtë kryengritje, ndër udhëheqësit e saj si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Sadik Rama, Nexhip Draga etj. u shqua edhe Isa Boletini. Ai mori pjesë aktive në organizimin e kryengritjes, organizim i cili nuk që akt i menjëhershëm, por një proces i gjatë që vazhdoi edhe mbas fillimit të kryengritjes, krahas veprimeve luftarake.

Në saje të propagandës së madhe bindëse, që Isa Boletini zhvilloi me masat e gjera fshatare si dhe me njerëz të veçantë në disa krahina të ndryshme si në Mitrovicë, Vuçitern, Pejë, Gjakovë, Rugovë, Shalë, Prishtinë, Pazar i Ri etj. u bë e mundur të sigurohej pjesëmarrje e gjerë e forcave kryengritëse dhe të vendoseshin lidhje të mira bashkëpunimi midis tyre. Isai u dallua gjithashtu dhe në organizimin dhe drejtimin e veprimeve luftarake. Forcat kryengritëse që udhëhiqeshin prej tij karakterizoheshin nga rregulli e disiplina e fortë. Duke shfrytëzuar shpejtësinë si dhe befasinë e veprimeve, dy tipare të rëndësishme të taktikës luftarake të Isa Boletinit forcat kryengritëse arritën fitore të njëpasnjëshme.

Për veprimtarinë e tij të gjerë luftarake, organizu-

1) *Po aty*

2) *Historia e Shqipërisë*, Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 482.

ese e udhëheqëse në kryengritjet e mëdha antiosmane, Isa Boletini, krahas udhëheqësve të tjerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, shoku Enver Hoxha e ka quajtur si «shpirti i kryengritjeve çlirimtare që shpërthyen në vitet 1910-1912, i mbledhjeve luftarake të shqiptarëve për liri e pavarësi që zienin kudo në Jug e Veri të Shqipërisë».¹

Kryengritja i kishte dhënë një goditje të fortë pushtetit osman në Shqipëri. Forca e tij qeverisëse ishte dobësuar mjaft. Në shumë qytete atdhetarët filluan të merrnin një varg masash, kështu ata dëbuan nëpunësit turq dhe kërkonin zbatimin e menjëhershëm të premtimeve të bëra nga qeveria.² Edhe Isa Boletini, i mbështetur nga masat popullore, krijoi në Mitrovicë një komision prej 6 anëtarësh për administrimin e vendit.³ Krijimi i komisionit dhe administrimi i krahinës prej tij, tregonte konkretisht mënyrën se si mund të vepronin edhe krahinat e tjera në të mirë të vendit.

Komisioni i drejtuar nga Isa Boletini shprehte vullnetin e popullsisë vendase. Këtë gjë Isai ia bëri të qartë dhe valiut të Shkupit. «Tash e tutje, — i telegrafonte Isai atij, — për çdo gjë populli do të vetëvendosë në mënyrë të pavarur nga pushteti osman»⁴. Në kushtet kur në vend ishin të pranishme edhe mjaft forca kundërshtarë etj., komisionit, këtij organi administrativ, i duhej edhe një mjet dhune për të bërë të detyrueshme vendimet që ai mund të merrte. Prandaj Isa Boletini me njerëzit e vet krijoi forca vullnetare të armatosura.⁵

Isa Boletini në krye të komisionit vepronte në mënyrë të pavarur jo vetëm nga administrata lokale osmane, por edhe nga vali i Kosovës. Në Mitrovicë, shpre-

1) E. Hoxha. *Raporte e fjalime 1972-1973*. Tiranë, 1974, f. 195-196.

2) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 482.

3) *Mitrovica...* f. 97.

4) *HHStA, PA, A*. Tel. nr. 267. Ambasadori gjerman Vangelbier në Therapia, 3 shtator 1912, MPJ në Berlin; «La Nazione albanese», vëll. XVI, nr. 17. 15. 9. 1912,

5) *Po aty*:

hej ambasadori austro-hungarez në Stamboll — Isa Boletini mban plotësisht pushtetin në duart e veta.¹ Në këto kushte, prania e autoriteteve osmane në qytet ishte e tepërt, prandaj me të drejtë Isa Boletini kërkonte që ato të zboheshin nga qyteti dhe pushteti të merrrej në dorë plotësisht nga shqiptarët. «Në Mitrovicë dhe rrethin e saj, — shprehej Isa Boletini, — dy zotër (dy pushtete — F.M.) nuk shkojnë, janë shumë».²

Puna e filluar nga Isa Boletini në Mitrovicë dhe nga atdhetarë të tjerë në disa qytete të Shqipërisë për të mënjeluar e zhdukur administratën turke, nuk u çua deri në fund. Për ndërprerjen e saj ndikoi negativisht faktori i jashtëm. Stuhia e luftës ballkanike po afrohej.

4. QËNDRESA KUNDËR INVAZIONIT SERBO—MALAZEZ

Fitoret e njëpasnjëshme të kryengritësve shqiptarë, lufta italo-turke e dobësuan shumë Perandorinë Osmane, si dhe kërkesa për autonominë e Shqipërisë që u shtrua në bisedimet me palën turke bënë që aty nga gjysma e dytë e vitit 1912, me gjithë kontradiktat që kishin midis tyre, shtetet ballkanike të krijonin aleancën politike e ushtarake kundër Turqisë. Bisedimet e zhvilluara nga kryeministri bullgar Geshov dhe ai serb Millovanoviç, qysh në tetor të vitit 1911 përfunduan me marrëveshjen e 13 marsit 1912 midis Sofjes dhe Beogradit. Nga ana e saj qeveria malazeze kishte përfunduar me Bullgarinë një marrëveshje verbale në bazë të së cilës Sofja do t'i njihte Cetinës tokat që ajo do të pushtonte në rast lufte kundër Turqisë. Përgatitjet e këtyre shteteve për luftë kundër Turqisë çdo ditë e më shumë bëheshin më të dukshme.

Lufta Ballkanike, përderisa drejtohej kundër Peran-

1) HHStA, P.A.A. Tel. i ambasadës a-h në Stamboll, Vjenës, 5 shtator 1912.

2) AK. Rap. i konsullit serb në Prishtinë, MPJ të Beogradit, 3. 11. 1912.

dorisë mesjetare në Ballkan, objektivisht kishte një rol përparimtar. Por, meqenëse në krye të saj ishin qarqet monarkike të këtyre vendeve, ajo u zhvillua nën flamurin e nacionalizmit borgjez dhe u kthye në një luftë grabitqare kundër Shqipërisë e Maqedonisë.¹

Në gjendjen e ndërlikuar dhe kontradiktore që u krijua nga Lufta Ballkanike, para popullit shqiptar, si detyrë themelore shtrohej lufta kundër ushtrive të Aleancës Ballkanike që ishin të gatshme për t'u hedhur në sulm. Atdhetarëve shqiptarë u kërkohesh të shpëtonin nga rreziku i copëtimit që do të sillte me vete likuidimin e Shqipërisë nga harta politike e Ballkanit.²

Iniciativën në këtë drejtim e morën përfaqësues të «Shoqërisë së zezë për shpëtim» dhe komiteti «Shpëtimi» që ishte krijuar në Shkup.³

Mbasi diskutuan të gjitha rrugët dhe mundësitë për të shpëtuar atdheun nga rreziku që po i kanosej, atdhetarët arritën në përfundimin se përkrahja pa kushte që shqiptarët do t'i jepnin Turqisë në luftën kundër Aleancës Ballkanike, do t'u jepte një argument qeverive të asaj aleance për të mbrojtur para opinionit ndërkombëtar planin e copëtimit të Shqipërisë si provincë e thjeshtë e Perandorisë Osmane.⁴ Nga ana tjetër, pjesëmarrja e shqiptarëve në Aleancën Ballkanike pa u njohur zyrtarisht të drejtat e tyre, ishte një vetëvrasje.⁵ Prandaj shqiptarët zgjodhën rrugën më të drejtë, atë të luftës së armatosur për të mbrojtur atdheun nga të huajt, cilëtdo të ishin ata. Kështu në mbledhjen që organizuan në Shkup më 14 tetor 1912,⁶ atdhetarët Sali Gjuka, Nexhip Draga, Bedri Pejani etj., mbasi kishin

1) *Historia e Shqipërisë*, Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 491.

2) *St. Pollo. Art. i përm.*, f. 78.

3) *Historia e Shqipërisë*, Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 491.

4) *Po aty*.

5) *Po aty*, f. 490.

6) *Po aty*.

marrë më parë miratimin e Hasan Prishtinës, Bajram Currit dhe Isa Boletinit, që kishin shkuar në front për organizimin e mbrojtjes së trojeve shqiptare, vendosën që t'u njoftohej Fuqive të Mëdha, se populli shqiptar po i kapte armët, jo për të forcuar pushtetin e Turqisë në Ballkan, por për t'i dalë zot tërësisë tokësore e lirisë së Shqipërisë dhe se shqiptarët nuk do të praninin për katër vilajetet veçse një formë të vetme qeverisjeje.¹

Në ato çaste merrte rëndësi organizimi për luftë në shkallë sa më të gjerë i masave popullore dhe në veçanti i luftëtarëve që ishin kthyer nga kryengritja. Përballë një armiku aq të fuqishëm, kërkohet më tepër se kurrë jo vetëm mobilizimi mbarëshqiptar, por edhe sigurimi i një udhëheqjeje të vetme. Për këtë qëllim Isa Boletini në bashkëpunim me Hasan Prishtinën, Bajram Currin etj. organizuan disa mbledhje të rëndësishme politike në krahina të ndryshme si në Gjakovë, Pejë, Shkup etj. Në njërin prej këtyre mbledhjeve ata hodhën mendimin për organizimin e një kuvendi të përgjithshëm mbarëshqiptar ku të merrte pjesë gjithë paria e vendit. Por në ato kushte kur ngjarjet po rrokulliseshin me shpejtësi të madhe, një mbledhje e tillë nuk u bë.

Në mbledhjet e organizuara u diskutua përveç të tjerave edhe problemi i pajisjes me armë e municion i popullit shqiptar,² për të përballuar sulmet e ushtrive aleate të pajisura me armët më moderne të kohës. Nga mbledhjet që u zhvilluan në fund të gushtit e në fillim të shtatorit doli vendimi i përbashkët që shqiptarët të luftonin kundër ushtrive të shteteve fqinje, qoftë në radhët e ushtrisë osmane, qoftë jashtë saj si vullnetarë për të mos lejuar pushtimin e Shqipërisë nga armiqet që tashmë dihej mirë që synonin copëtimin e saj.³

Isa Boletini, ashtu si shumë atdhetarë të tjerë të

1) *Po aty*

2) AQSH, Fondi «Elmaz Plava», D. nr. 2, f. 164.

3) St. Pollo, *art. i përmb.*, f. 79.

shquar, i përveshën punës për organizimin e qëndresës kundër ushtrive të Aleancës Ballkanike. Masat popullore në Mitrovicë ashtu si në krejt Shqipërinë ishin të gatshme për të kundërshtuar me çdo kusht copëtimin e vendit. Në qytete të ndryshme u organizuan mitingje si shprehje të kundërshtimit ndaj planeve grabitqare të aleatëve ballkanikë.¹ I. Boletini në bashkëpunim me Hasan Prishtinën, N. Dragën, Idriz Seferin, filluan të mobilizonin masat popullore për luftë. «Janë marrë masat, — shkruante në letrën e tij konsulli austro-hungarez në Shkup, — që të vihen nën armë malësorët e krahinave të ndryshme.² Për të rinjtë rruga e vetme e pajisjes me armë ishte pjesëmarrja në shërbim ushtarak. Si asnjëherë tjetër, të rinjtë shqiptarë shkuan pa asnjë ngurrim në shërbimin aktiv. «Në tërësinë e tyre, — theksonte ato ditë Hasan Prishtina, — shqiptarët do të kthehen kundër armikut sllav, në rast nevojë me po ato armë të marra nga Beogradi gjatë kryengritjes së vitit 1912, do të luftojmë serbët».³

Por me gjithë përpjekjet e shumta të Isa Boletinit, Hasan Prishtinës, B. Currit, I. Seferit në Veri si dhe të atdhetarëve të tjerë në Jug nuk u arrit që në ato çaste aq kritike për fatet e atdheut, të krijohej në shkallë kombëtare një qendër e vetme udhëheqëse, një tërësi e organizuar.⁴

Për këtë ndikuan negativisht disa faktorë: pjesëmarrja në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare e forcave shoqërore me tendenca të ndryshme politike, ekzistenca e mbeturinave të marrëdhënieve feudale, ndarja politikoadministrative e Shqipërisë, dobësia e borgjezisë sonë kombëtare që nuk kishte arritur të krijonte as parti politike të veta.

Shtetet ballkanike dhe në veçanti shovinistët serbë u munduan të siguronin mbështetjen e shqiptarëve në

1) *HHStA, PA: A.* Letër nr. 67 e konsullit austro-hungarez në Shkup, Vjenës, 8 tetor 1912.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll 23. f. 131.

luftën kundër Turqisë, ose të paktën qëndrimin e tyre prej sehirxhiu. Një qëndrim i tillë do t'u siguronte ushtrive serbe marshim të lirë drejt Jugut. Drejtuesit e organizatës ultrashoviniste serbe «Dora e zezë», e përqendruan përsëri vëmendjen tek Isa Boletini. Ata shpresonin se ai do të merrte anën e tyre si shpërblim ndaj «ndihmës» me armë e municion që qeveria e Beogradit i kishte dhënë atij në pranverën e vitit 1912. Sipas tyre, kjo ndihmë kishte kontribuar shumë në suksesin e kryengritjes shqiptare.

Që në takimin e parë me Isa Boletinin, të dërguarit e Serbisë u munduan të mësonin se ç'qëndrim do të mbante Isai (dhe mbas tij shqiptarët) në konfliktin e ardhshëm. Këtë konflikt ata e paraqitnin si luftë midis tyre dhe Turqisë, prandaj shqiptarët duhej, sipas tyre, të luftonin bashkë me ta kundër ushtrive osmane duke e vijuar më tej bashkëpunimin e vendosur midis tyre gjatë kryengritjes së vitit 1912. Pasi i përmendën «ndihmat» që ai kishte pasur nga Serbia, ata i kërkuan Isait që së paku të qëndronte asnjans po qe se nuk do të bashkëpunonte me trupat serbe.¹

Por rrethanat historike në të cilat i propozohej Isa Boletinit të bashkëpunonte me Serbinë, tashmë kishin ndryshuar. Në qoftë se gjatë kryengritjes së vitit 1912 kontradikta kryesore për shqiptarët ishte ajo me sunduesin osman dhe ndihma që kërkerët shqiptarë pranuan nga Serbia ishte me vend, në situatën e re që u krijua kur kontradikta themelore ishte ajo midis shqiptarëve dhe Serbisë e shteteve të tjera të Aleancës Ballkanike, bashkëpunimi me të mbartte rrezik për trojet shqiptare. Bisedimet jozyrtare dhe të veçuara që qeveria serbe bënte me Isa Boletinin, tregonin se ajo nuk dëshironte kurrsesi që shqiptarët të trajtoheshin me të drejta të barabarta në aleancat e tyre, por synonin t'i përdornin ato si mish për top në luftë kundër Turqisë.² Me sa duket Isa Boletini e kuptoi thelbin e

1) A. Puto. *Vep. e për.*, Tiranë, 1978, f. 84.

2) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. II. Tiranë, 1984, f. 490.

politikës serbe ndaj shqiptarëve prandaj në përgjigjen që u dha të dërguarve të Serbisë kuptohej qartë se shqiptarët nuk do të bashkëpunonin në asnjë agresion, por ata ishin të vendosur të luftonin kundër cilitdo që do të rrezikonte atdheun e tyre. «Në rast se Serbia, — u tha Isai, — do të sulmohet nga Turqia, atëherë as unë e as shqiptarët e mi nuk do të jemi me turqit, por nëse do të jemi me ju, këtë nuk jam në gjendje ta them, kurse po të sulmonin trupat serbe (Shqipërinë — F. M.) shqiptarët do të kundërveprojnë, sepse në këtë rast synoheshin tokat shqiptare».¹

Situata çdo ditë e më shumë bëhej më e acaruar. Dobësimi i gjithanshëm i Perandorisë Osmane po e afronte më tepër ditën e luftës midis saj dhe shteteve ballkanike. Këto prisnin vetëm rastin e përshtatshëm për të grabitur zotërimet osmane, të cilat Porta nuk ishte në gjendje t'i mbronte më. Gjendja e vetë shqiptarëve ishte mjaft e vështirë. Ekspeditat ndëshkimore xhonturke që në katër vjetët e fundit ishin përsëritur disa herë, kishin rrënuar ekonomikisht dhe kishin çarmatosur popullsinë e Kosovës. Por, edhe në këtë gjendje të vështirë, Isa Boletini ashtu si dhe udhëheqësit e tjerë, nuk e humbi optimizmin e besimin e tij te luftëtarët shqiptarë. Këmbëngulës në qëllimin e tij të lartë ai veptoi energjikisht për të sqaruar masat e gjera popullore, për t'i organizuar e për t'i ngritur ato në luftë për mbrojtjen e atdheut. Kështu, brenda një kohe të shkurtër, sipas të dhënave të konsullit francez në Shkup, Isa Boletini mundi të grumbullonte 1000 forca të armatosura.²

Vetë veprimtaria e Isa Boletinit për mobilizimin e popullit dhe organizimin e luftëtarëve shqiptarë për qëndresë të armatosur hodhi poshtë mendimin e gabuar që ishte krijuar në disa rrethe konsullore në Kosovë, se

1) Milan Zh. Zhivanoviç. Pukovnik Apis. Beograd, 1955.s. 649-651, cituar sipas A. Putos, *vep. e për m.*, f. 84.

2) AMAE. Letër nr. 124 e konsullit francez në Shkup, Karlie, ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Puankare, 16 tetor 1912.

Isa Boletini punonte për Serbinë dhe se ai do ta ndihmonte atë në luftën ballkanike.

Të kundërtën e këtij mendimi e pohon konsulli francez kur thotë se Isa Boletini, bën një propagandë të zjarrtë kundër këtij vendi (Serbisë — F.M.)¹. Po kështu, bie poshtë edhe pohimi i dhënë nga ish-oficeri i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë serbe Milan Zavajdil se Isa Boletini dhe krerët shqiptarë të këtyre anëve e mbajtën besën deri në fund, pjesa më e madhe e tyre vetëm një muaj më vonë kundërshtoi me vendosmëri dhe luftoi kundër ushtrisë serbe.²

Fillimi i Luftës Ballkanike në tetor 1912 dhe sulmi i ushtrive serbe e malazeze nuk ishte i papritur për Isa Boletinin dhe atdhetarët e tjerë shqiptarë. Ata nuk u gjendën të papërgatitur. Me forcat që kishin mbledhur, morën masa për të mbrojtur kufirin nga forcat serbe të nisura në disa drejtime. Brigada e dytë, e komanduar nga gjenerali Zhivkoviç, vinte në drejtim të Pazarit të Ri,³ armata e 3-të e komanduar nga Gjeneral Jankoviç marshonte për në Podujevë.⁴ Në Prizren u përqendrua tërë divizioni i Shumadisë.⁵

Për të përballuar sulmin e forcave serbe I. Boletini organizoi qëndresë të fortë në hapësirën midis Ibrit e Llapit, dërgoi në Veri të Mitrovicës 500 vullnetarë për të zënë rrugën Pazar-Mitrovicë.⁶, ndërsa 800 vullnetarë të tjerë ai i dërgoi në Soçanicë.⁷ Vetë Isai me 90 luftëtarë u nis në drejtim të Podujevës për të përba-

1) *Po aty*.

2) Milan Zh. Zhivanoviç. Pukovnik Apis, s. 649-651, cituar sipas A. Putos, *vep. e përm.*, f. 84.

3) F. Çakmak. *Kujtime nga Lufta Ballkanike* (përkth. nga libri: «Si u humb Rumelia Perëndimore» në AIH, f. 32 ose 38).

4) *Po aty*.

5) Z. Cana. *Kosta Novakoviç për Shqipërinë dhe invadimi nga Serbia*, në «Përparimi», nr. 1. Prishtinë, janar-shkurt 1977, f. 84.

6) F. Çakmak. *Vep. e përm.*, f. 42; S. Luarasi, *vep. e përm.*, f. 189:

7) AMAE. Letër nr. 124 e konsullit francez në Shkup, Karlie, ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, Puankare, 16 tetor 1912.

lluar përkrah forcave vullnetare të Llapit, sulmet e forcave serbe që kishin filluar para se Serbia t'i shpallte luftë Turqisë, më 15 tetor.

Sulmet e ushtrive serbe u dëndësuan mbas 17 tetorit kur Serbia i shpalli luftë Turqisë dhe i dha urdhër armatës së tretë që duke kaluar përmes Prepalcit dhe Medvegjes të pushtonte Prishtinën. Vullnetarët shqiptarë si dhe batalioni i rregullt me ushtarë shqiptarë, luftuan me heroizëm në Merdar dhe në Podujevë. Duke folur për luftimet në Podujevë, Fevzi Çakmak në kujtimet e tij shkruan se sikur të kishim edhe 9 batalione të tjera si ky batalioni i shqiptarëve, fuqia e armikut qind për qind do të thyhej e do të shkatërrohej.¹ Pasi e thyen qëndresën në Merdar, Podujevë, ushtritë serbe iu drejtuan Prishtinës. Në mbrojtje të saj Isa Boletini me luftëtarë të ardhur edhe nga krahina të tjera përreth, zhvilluan luftime të ashpra në Llapashticë e Kulinë, por nuk mundën t'i rezistonin atyre gjatë. Mbas thyerjes së qëndresës shqiptare në malësinë e Llapit, numuri i madh i ushtrisë serbe si dhe terreni fushor i Kosovës i ndihmoi forcat serbe të pushtonin për një kohë të shkurtër disa qytete të saj. Prishtina u pushtua më 22 tetor² dhe pas saj, serbët po rrezikonin Ferizajn. Isai u tërhoq në Mitrovicë për të riorganizuar forcat për mbrojtjen e Ferizajt.³ Por autoritetet osmane në Mitrovicë, nënprefekti Nexhip pasha dhe komandanti i divizionit turk Baftjar pasha, u munduan që të shfrytëzonin luftën e masave popullore si pararojë për të siguruar tërheqjen e tyre pa hyrë në luftë me forcat serbe.⁴ Për këtë qëllim, ata hapën lajmin e rremë se në ndihmë të Ferizajt ishin nisur nga Kumanova forca të shumta osmane, prandaj Isait me luftëtarët e tij i mbetej të qëndronte në Mitrovicë.⁵ Isai nuk e besoi këtë lajm, prandaj pasi la aty Tafil

1) F. Çakmak. *Vep. e përm.*, f. 40.

2) AQSH. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

3) F. Çakmak. *Vep. e përm.*, f. 42:

4) AQSH. Fondi nr. 74, dosja nr.4.

5) AQSH. Fondi nr. 74, nr. 4.

Boletinin për të ndjekur çka do të ndodhte, u nis me disa vullnetarë shqiptarë në drejtim të Shalës, ku në bashkëpunim me vullnetarët e kësaj ane zhvilloi luftime të ashpra kundër forcave serbe që vinin drejt Mitrovicës. Por lajmi se serbët po pushtonin Vuçiternën e detyroi të kthehej pa humbur kohë në Mitrovicë, e cila po rrethohej. Ndërkohë, Baftjar pasha po tërhiqej përmes Drenicës për në Gostivar,¹ duke i lënë vullnetarët shqiptarë të vetëm përballë forcave serbe. Me gjithë qëndresën këmbëngulëse të luftëtarëve shqiptarë të udhëhequr nga Isa Boletini e atdhetarët e tjerë si Hasan Prishtina, Idriz Seferi, Bajram Curri, forcat serbe arritën që në 1 nëntor 1912 ta pushtojnë Mitrovicën. Ndërkohë dy armata serbe vërshuan në drejtim të Kumanovës, të Shkupit, të Kërçovës, të Manastirit e të tërë Shqipërisë Lindore.²

Forcat serbe pasi pushtuan qytetet kryesore të Kosovës u përqendruan në Prizren me objektiv daljen në Adriatik. Me dhimbjen e fortë në zemër Isa Boletini me bashkëluftëtarët e tij, kaloi në Prizren dhe prej andej mundi të tërhiqej në krahinat ende të papushtuara për të vijuar më tej luftën për mbrojtjen e vendit.

Në fund të dhjetëditëshit të parë të nëntorit Isai mbërriti në krahinën e Lumës.³ Aty ai gjeti forca të organizuara nga disa krahina në brigjet e Drinit të Bardhë, të Zi e të Bashkuar, të udhëhequra nga Ramadan Zaskoku, Islam Spahia, sheh Hasan Prizreni etj. Shumë luftëtarë të Isa Boletinit Bajram Currit, Idriz Seferit zunë pozicione në krahinat strategjike të Opojës, Lumës, Hasit e Malësisë së Gjakovës. Në ndihmë të tyre erdhën luftëtarë nga Dibra të udhëhequr nga Elez Isufi etj. Si udhëheqës me përvojë Isait i kërkoheshin nga paria e vendit mendime për organizimin e qëndresës kundërserbe.

1) F. Çakmak. *Vep. e për.*, f. 38.

2) Sh. Braha. *Idriz Seferi*. Tiranë, 1981, f.192.

3) *HHS*A. P.A. A. Tel. nr. 104, konsulli Maryan von Heimroth në Shkup, Vjenës, 26 nëntor 1912.

Forcat ushtarake të armatës së tretë serbe të nisura nga Prizreni më 15 nëntor hasën në qëndresën e fortë të vullnetarëve shqiptarë në krahinën e Lumës. Luftime të përgjakshme u zhvilluan në vijën Qafa e Zhurit-Lumë dhe në betejën e Kullës së Lumës në luftimet e së cilës sipas njoftimit të konsullit a-h në Shkup, mori pjesë edhe Isa Boletini.¹

Mbas luftimeve të ashpra që u shkaktuan forcave serbe humbje të mëdha në njerëz dhe municione Isa Boletini me 1000 luftëtarë kosovarë së bashku me Elez Isufin u larguan nga Luma në drejtim të Dibrës dhe qëndruan në fshatin Sllovë në shtëpinë e Elez Isufit.²

Në Sllovë Isa Boletini mori vesh për aktin e madh politik kombëtar që po përgatitej në Vlorë. Vetëm aty ai pa shpëtimin e Kosovës e viseve të tjera shqiptare të pushtuara nga ushtritë e Aleancës Ballkanike. Caktimi i tij si delegat në kuvendin kombëtar e gëzoi atë pa masë. Në dhjetëditëshin e dytë të nëntorit kaloi nga Sllova në qytetin e Dibrës ku u bashkua me delegatët e tjerë kosovarë Mehmet pashë Derallën dhe Ajdin Dragën,³ në pritje për të nisur udhëtimin e shumëpritur prej tyre për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

1) *Po aty*; Tel. nr. 107, Konsulli Maryan von Heimroth në Shkup, Vjenës, 27 nëntor 1912.

2) AQSH, Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

3) AQSH, Fondi 245, dosja 2, f. 6, viti 1912.

KREU V

PËRPPJEKJET E ISA BOLETINIT PËR KONSOLIDIMIN E SHTETIT TË RI SHQIPTAR DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE KOMBËTARE

1. NË VLORË E NË LONDËR PËRKRAH ISMAIL QEMALIT

Ushtritë ballkanike i shpartalluan forcat osmane brenda një kohe të shkurtër dhe u futën në tokat shqiptare nga drejtime të ndryshme. Pasi pushtuan Kosovën, armatat serbe kaluan luginën e Drinit dhe pushtuan Lumën, Mirditën, Matin dhe dolën në Lezhë. Një pjesë e tyre iu drejtua Durrësit, ndërsa pjesa tjetër u nis drejt veriut dhe së bashku me forcat malazeze, kryen rrethimin e Shkodrës. Ndërkaq malazezët kishin pushtuar edhe Pejën.

Ushtria greke, pas fitores në Thesali, çliroi Selanikun, rrethoi Janinën, pushtoi Sazanin dhe zbarkoi në Himarë, të cilën e pushtoi bashkë me fshatrat përreth¹.

1) *Historia e Shqipërisë Vëll, II, Tiranë, 1984, f. 493.*

Në këto kushte tepër të vështira kur fatet e kombit ishin vënë në pikëpyetje, atdhetarët shqiptarë, brenda dhe jashtë vendit, u vunë në lëvizje për të mbrojtur e shpëtuar atdheun.

Rrethet atdhetare të «Shoqërisë së zezë për shpëtim» brenda vendit si dhe ato jashtë, të udhëhequra nga Ismail Qemali, arritën në përfundimin se e vetmja rrugë për shpëtimin e Shqipërisë ishte Shpallja e Pavarësisë.

Për të plotësuar këtë detyrë të vështirë por të lavdishme, më 21 nëntor, një grup atdhetarësh me Ismail Qemalin në krye, arriti në Durrës dhe prej andej u nis drejt Vlorës. Drejt saj u nisën delegatë nga të gjithë krahinat e Shqipërisë.

Po këtë ditë Isa Boletini, Ajdin Draga, Mehmet pashë Deralla dhe delegatët e Dibrës, u nisën nga Dibra për në Elbasan¹, ku i prisnin delegatët e asaj treve për të shkuar së bashku drejt Vlorës². I shoqëruar nga delegatët e Durrësit, Shijakut, Tiranës e Krujës Ismail Qemali arriti në Vlorë më 25 nëntor. Rrethet atdhetare brenda vendit, në bashkëpunim me komisionin e Vlorës, kishin bërë të gjitha përpjekjet për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar.

Ndërkohë, ushtritë serbe po përparonin me shpejtësi në drejtim të Shqipërisë së Mesme. Në këto rrethana kritike nuk mund të pritej më tej. Prandaj Ismail Qemali dhe atdhetarët e tjerë të mbledhur në Vlorë, hapën më 28 nëntor në orën 14⁰⁰ Kuvendin Kombëtar dhe e shpallën Shqipërinë shtet të pavarur, pa pritur të vinin delegatët e të gjithë krahinave.

Isa Boletini dhe delegatët e tjerë të Kosovës, në këtë kohë ndodheshin në rrethin e Fierit³ duke udhëtuar për në Vlorë. Kështu ata nuk mundën të merrnin pjesë në kuvend. Megjithatë delegatëve që priteshin të vinin Ku-

1) AQSH, Fondi nr. 245, dosja nr. 2, f. 6, viti 1912.

2) AQSH, Fondi nr. 32, dosja 26, f. 133.

3) HHS^tA, PA, A. Tel. nr. 64. Konsulli a-h Lejhanec në Vlorë, Pallaviçinit në Stamboll, 29.11.1912; Tel nr. 35 i konsullit a-h Lejhanec në Vlorë, Vjenës, 30 nëntor 1912.

vendi iu njohu të drejtën për të miratuar e nënshkruar vendimin sapo të mbërrinin.

Mbas shumë përpjekjesh, duke përshtuar në një mot të vështirë rrugë të gjata e plot rreziqe, Isa Boletini së bashku me delegatët e tjerë të Kosovës e 100 luftëtarë të armatosur, në mbasditen e 29 Nëntorit¹ arriti në Vlorë. Populli i Vlorës i bëri një pritje të ngrohtë e vëllazërore, duke shprehur në këtë mënyrë respektin dhe dashurinë e tij për Isa Boletinin, emri i të cilit ishte i njohur tashmë jo vetëm në Kosovë, por në të gjitha viset e Shqipërisë.

I shoqëruar nga populli që kishte dalë ta priste në hyrje të qytetit, Isa Boletini përshkon rrugën deri te Sheshi i Flamurit, Aty ai u prit nga Ismail Qemali dhe pjesëmarrës të tjerë në Kuvend. Me një ndjenjë të thellë kënaqësie, Isa Boletini përgëzoi Ismail Qemalin dhe atdhetarët e tjerë për aktin e madh politik që kishin bërë. Isa Boletini shprehu entuziazmin, dëshirën e vullnetin e tij dhe të të gjithë popullit të Kosovës për veprën historike që kishte bërë Kuvendi duke miratuar në këtë mënyrë plotësisht vendimin për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, kjo ngjarje me rëndësi historike për fatet e popullit shqiptar, ishte rrjedhojë e luftës së gjatë e heroike të masave popullore dhe atdhetarëve rilindës. Ndërmjet tyre Isa Boletini zinte një vend të rëndësishëm.

Duke e vlerësuar Isa Boletinin si një luftëtar trim e udhëheqës të shquar popullor, Ismail Qemali i tha: «Luftrat tuaja ishin baza e përpjekjeve të mija, ju me dyfek e unë me pendë».²

Përpjekjet e lufta e përbashkët, qëllimi dhe ideali i tyre i lartë për t'i shërbyer popullit dhe atdheut i lidhi ngushtë këta dy atdhetarë. Isa Boletini qëndroi për një kohë të gjatë pranë Ismail Qemalit dhe, kurdoherë bes-

1) *Po aty*. Rap. nr. 64, Lejhance në Vlorë, Pallavicinit në Stamboll 29. 11. 1912.

2) AQSH. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

nik i Shqipërisë së Pavarur, përkrahu të gjitha përpjekjet e plakut të Vlorës për konsolidimin e shtetit të ri shqiptar, si brenda vendit ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Përpara Kuvendit Kombëtar të Vlorës që u zhvillua nga 30 nëntori deri më 7 dhjetor u shtruan disa detyra kryesore e të ngutshme, si zgjedhja e qeverisë dhe e pleqësisë, caktimi i një komisioni që do të dërgohej pranë Fuqive të Mëdha për të mbrojtur çështjen shqiptare etj. Isa Boletini mori pjesë në disa nga mbledhjet e këtij Kuvendi.

Përveç kësaj, Isa Boletini, përkrah Ismail Qemalit, Luigj Gurakuqit etj., punoi që pushteti i Qeverisë së Vlorës të njihej edhe në qytetet e tjera shqiptare që ende nuk ishin pushtuar nga ushtritë ballkanike. Qysh në ditët e para të dhjetorit Qeveria e Vlorës e shtriu pushtetin e saj në Fier, Lushnjë, Berat dhe Gjirokastrë, Duke vlerësuar të rëndësishme për Qeverinë e Vlorës dhe interesat e vendit, ata i kushtuan vëmendje të veçantë dhe u përpoqën që mbrojtja në Janinën e rrethuar nga ushtritë greke si dhe mbrojtja e Shkodrës së rrethuar nga ushtritë serbo-malazeze, të bëhej nën flamurin shqiptar. Për këtë qëllim, Isa Boletini në bashkëpunim me Ismail Qemalin i kërkuan Esad Toptanit që në Shkodër të luftohej nën flamurin shqiptar, sepse kështu, — theksonin ata, — luftohej sipas nevojave të vendit dhe nderit kombëtar¹. Por Esad pashë Toptani e hodhi poshtë kërkesën e Isa Boletinit e të Ismail Qemalit. Ai nuk e njohu Qeverinë e Vlorës dhe vijoi rrugën e tradhtisë, kundërshtoi përpjekjet e Ismail Qemalit dhe të Isa Boletinit për forcimin e unitetit kombëtar dhe të shtetit të pavarur shqiptar.

Meritë të veçantë Isa Boletini ka në mbrojtjen e Qeverisë së Vlorës. Dihet se Qeveria e Përkohshme e Vlorës e filloi veprimtarinë e vet në kushte shumë të vështira ekonomike e politike, të brendshme e të jashtme.

1) AQSH. Fondi nr. 245, dosja nr. 50, f. 1.

Ajo kishte mjaft kundërshtarë, që ishin shumë më të fuqishëm se ajo. Ushtritë ballkanike që kishin pushtuar toka deri në kufi me Vlorën, forcat turke si dhe çifligarët e mëdhenj ishin armiqtë e saj të betuar. Në këto çaste, forca ushtarake e Qeverisë së Vlorës mbështetej vetëm në disa formacione që përbëheshin nga vullnetarë. Me to u bashkuan edhe njëqind luftëtarët kosovarë që erdhën në Vlorë me Isa Boletinin. Isa Boletini së bashku me to, u preu rrugën forcave osmane të komanduara nga Xhavit pasha në brigjet e Vjosës¹. Po kështu, Isa Boletini mbante forcat e veta në gatishmëri për të luftuar kundër ushtrive greke që ishin ndalur në vijën Llogora-Tepelenë si dhe anijeve greke që gjendeshin në Gjirin e Vlorës².

Vëmendjen e Isa Boletinit dhe të gjithë elementëve atdhetarë shqiptarë, më tepër se gjithçka e tërhiqte zgjidhja e çështjes së kufijve të shtetit shqiptar, Shqetësimi i Isait për këtë problem ishte i dyfishtë, sepse vendlindja e tij, Mitrovica, dhe tërë Kosova, ndodhej nën pushtimin e ushtrisë serbo-malazeze. Prandaj, ai i ndiqte me interes punimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, që kishin filluar në dhjetor 1912.

Trajtimi i çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve sipas interesave të fuqive imperialiste dhe të monarkive ballkanike shtroi me forcë përpara Qeverisë së Përkohshme nevojën që të ndërmerreshin në kryeqytetet e mëdha dhe në Konferencë hapa të rinj për mbrojtjen e interesave themelore të vendit³. Për këtë qëllim Qeveria e Përkohshme nisi një delegacion nëpër Evropë të kryesuar nga Ismail Qemali.

Në këtë delegacion si përfaqësues të Shqipërisë Veriore, Ismail Qemali, zgjodhi Isa Boletinin. Kjo nuk u bë rastësisht. Megjithëse de jure nuk bënte pjesë në Qeverinë e Përkohshme, pjesëmarrja e tij në delegacion

1) A. Haxhiu, *Hasan Prishtina*, Tiranë 1964, f. 101.

2) S. Luarasi, *Vep. e perm.* f. 116.

3) A. Puto, *Vep. e perm.* f. 351.

ishte shumë domethënëse. Ai ishte tani një figurë e njohur e luftës së popullit shqiptar për liri e pavarësi. Si atdhetar i ndershëm e i pakomprometueshëm siç ishte Isai, do të dinte të mbante qëndrim të prerë e të drejtë në takimet me diplomatët evropianë. Gjithashtu Isa Boletini ishte përfaqësues i asaj popullsie shqiptare, trojet e së cilës po bëheshin plaçkë tregu nga Fuqitë e Mëdha dhe fqinjët shovinistë.

Më 30 mars 1913 delegacioni u nis nga Vlora dhe po atë ditë arriti në Brindisi¹. Prej tyre, Ismail Qemali shkoi në Romë, ndërsa Isa Boletini dhe Luigj Gurakuqi vajtën në Bari, ku qëndruan deri në 1 prill². Në Bari ata bënë përpjekje për të mbledhur ndihma nga atdhetarët që banonin në ato qytete.

Përpara se të nisej për në Vjenë delegacioni qëndroi një ditë në Milano³. Aty u prit mirë nga shqiptarët që banonin në Itali me të cilët Ismail Qemali pati biseda të ngrohta, u dha atyre mbresat e tij gjatë qëndrimit në Romë në takimet e bisedat me politikanët e atjeshëm.

Në Milano, Boletini pati një takim krejt të pazakontë me një emisar të qeverisë së Beogradit me Zhivojin Ballugxhiqin. Zh. Ballugxhiqi një diplomat serb i karrrierës kishte qenë dërguar nga Beogradi në Shqipëri së bashku me ushtrinë serbe me një mision të veçantë ekspansioniste serbe. Përpjekjet e pasuksesshme të tij dhe të bashkëpunëtorëve të tjerë për përmbushjen e misionit diplomatik në Durrës e Vlorë për t'u lidhur me krerë shqiptarë si I. Qemalin e I. Boletinin, Ballugxhiqi i vijoi edhe në Milano. Në dy takimet që pati në fillim me I. Qemalin e pastaj me I. Boletinin, ai kërkoi që si përfaqësues të Qeverisë së Përkohshme ata të pra-

1) J.S.Swire. *Vep. e perm.* f. 28; P. Tako. *Luigj Gurakuqi*, f. 199.

2) *HHSStA, PA, A*, Rap. i konsullit, a-h në Vlorë, Pallaviçinit në Stamboll, 31.3.1913.

3) *Po aty*. Tel. 201, Von Merey në Romë, Vjenës, 9 prill 1913.

nonin vijën kufitare që caktonte Serbia dhe ta njoftonin atë botërisht. Veç kësaj, pala shqiptare duhej të pranonte kërkesën që Durrësi të bëhej skelë tregtare e Serbisë, pastaj të deklarohet pozitivisht për bashkimin e Shqipërisë me këtë shtet fqinjë.

Por Ballugxhiqi hasi në kundërshtimin e rreptë të Ismail Qemalit lidhur me çështjen e kufijve. Si kusht për vendosjen e lidhjeve ekonomike e politike me Serbinë, I. Qemali, i kërkoi emisarit serb lëshimin e viseve shqiptare të pushtuara nga Serbia. Ndryshe do të vinte koha, — theksoi ai, — që Serbia do të pendohej për qëndrimin kundrejt Shqipërisë, sepse në brendinë e territorit do të ndeshesh në luftë me elementin trim dhe të vendosur¹.

Mendimin e Ismail Qemalit e mbështeti tërësisht Isa Boletini në takimin që pati të nesërmen me Ballugxhiqin. Që në fillim të bisedës i dërguari i Nikolla Pashiqit, i kujtoi Isa Boletinit ndihmën prej 20 dinarësh në ditë që i jepte qeveria serbe familjes së tij. Isai, duke kuptuar mirë domethënien e këtyre fjalëve, dhe nga ana tjetër, duke njohur qëllimin e «kujdesit» të qeverisë serbe ndaj familjes së tij, me indiferentizëm, ç'ka e habit mjaft diplomatit serb pohoi se nuk e dinte këtë gjë, por edhe tani që e merrte vesh i dukej, — i shkruante Ballugxhiqi qëndrës së tij, — që kjo ndihmë është diçka që ia kemi borxh, sepse me asnji fjalë (Isa Boletini) nuk shprehu mirënjohje për këtë kujdes ndaj familjes së tij»².

Në bisedën me Ballugxhiqin, Isa Boletini e vuri theksin në padrejtësitë e mëdha që Serbia po bënte ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve, dhe i deklaroi emisarit serb se ata nuk do të pajtoheshin kurrsesi me atë gjendje. «Serbia, — theksoi Isa Boletini, — rrëmbeu viset tona, duke robëruar gjysmë milionë shqiptarë. Shqiptarët nuk do të rrinë duarkryq, ata, — shprehte bindjen ai, — do

1) Z.Cana. *Misioni politik i Ballugxhiqit në Shqipëri, më 1913*, në: «Përparimi», nr. 1, Prishtinë, 1979, f. 116.

2) *Po aty*.

të çojnë krye, do t'i tregojnë Evropës se nuk duan të jetojnë nën zgjedhën serbe», dhe kjo ishte e drejta e tyre, sepse «shqiptarë, — thoshte Isai, — ka më shumë se serbë, kështu që të gjithë do të ngrihen në këmbë për ta mbrojtur atë që është e tyre»¹.

Pasi dështoi në përpjekjet e tij, për t'i diktuar Ismail Qemalit e Isa Boletinit vullnetin e qeverisë serbe, Ballugxhiqi, në raportin e tij dërguar Nikolla Pashiqit, i paraqiste ata si «agjentë» të Austro-Hungarisë dhe misionin e tyre të lartë në shërbim të atdheut, si shërbim që ata i bënin asaj².

Ndërkohë propaganda serbe kishte përhapur lajme të rreme sikur Isa Boletini gjatë Luftës Ballkanike, pati bashkëpunuar me ushtritë serbe³, ose sikur Isa Boletini ishte vrarë nga një gjeneral serb⁴. Lidhur me këto lajme, disa gazetarë e morën në intervistë Isa Boletinin. Mendimi i Isait, dhënë gazetarëve, ishte se «lajmet ishin përhapur me një qëllim të caktuar nga shtypi serb»⁵, kuptohet që serbët e bënin këtë me qëllim që të çorientonin masat popullore dhe të ulnin sado pak qëndresën e tyre ndaj sundimit serb. Duke përgënjeshtruar lajmet që përhapte Serbia rreth tij, Isa Boletini po me këtë rast deklaroi botërisht atë që për vite me radhë kishte shprehur me fjalë në kuvende dhe me pushkë në luftëra, se kishte dëshirë t'i shkrinte të gjitha forcat e tij dhe të jepte prova për ruajtjen e Pavarësisë së Shqipërisë e për Unitetin e kombit shqiptar⁶.

Nga Milanoja delegacioni u nis për në Vjenë ku arriti më 10 prill 1913⁷. Sipas gazetës «Dielli» në Vjenë Isa Boletini pati takime me ministrin e Punëve të Jashtme,

1) *Po aty*, f. 117.

2) *Po aty*, f. 117, 118.

3) «La Nazione Albanese», 15 prill 1913, nr. 8.

4) *Po aty*.

5) *Po aty*.

6) *Po aty*.

7) A. Puto.. *Vep. për.*, f. 360.

ministrin e Luftës dhe disa gjeneralë¹. Në këto takime, krahas Isa Boletinit, merrte pjesë edhe Luigj Gurakuqi. Rreth bisedimeve që Isai zhvilloi me zyrtarët e lartë të Vjenës, dokumentacioni që kemi në dorë nuk na jep asnjë të dhënë, por është e natyrshme që ai të ketë trajtuar aty problemin e kufijve të shtetit shqiptar.

Aty nga fillimi i majit, delegacioni shqiptar mbërriti në Londër, ku zhvillohej Konferenca e Ambasadorëve. Në Londër Isa Boletini la mbresa të veçanta në rrethet diplomatike. «Figura më piktoreske e këtij deputacioni, — shkruan Aubrey Herbert, — është Isa Boletini, Robin Hud i Shqipërisë. Ai ishte një njeri me reputacion të madh e të drejtë për kurajo dhe fuqi burrënese»². Qëndrimi pranë Ismail Qemalit dhe Luigj Gurakuqit si dhe takimet me rrethet e huaja diplomatike, ndikuan që Isa Boletini të kuptonte më mirë gjendjen e kohës e të njihej më nga afër me trajtimin e çështjes shqiptare në qarqet e huaja diplomatike.

Ndërkaq delegacioni u prit ftohtë e me mospërfillje nga qarqet zyrtare të Londrës dhe nga ato të Konferencës së Ambasadorëve³. Megjithatë, kjo nuk i trembi atdhetarët e nuk i sprapsi në qëllimin e tyre për të ngritur fuqishëm zërin në mbrojtje të të drejtave të kombit.

Për krah I. Qemalit e L. Gurakuqit edhe Isa Boletini dha ndihmesën e tij që delegacioni të kryente këtë mision, qëllimi kryesor i të cilit ishte siç do të shkruajë I. Qemali lufta për integritetin e tokave shqiptare⁴.

Gjatë qëndrimit në Londër, Isa Boletini, si anëtar i delegacionit, por edhe individualisht, zhvilloi një sërë takimesh me zyrtarë të lartë anglezë dhe deputetë të parlamentit. Në të gjitha rastet, ai shprehu me forcë protestën kundër kujtdo që shprehej për copëtimin e Shqipërisë, duke lënë jashtë kufijve Kosovën e duke

1) Gaz. «Dielli». Boston Mass. vëll. V, nr. 208, f. 2, 6 maj 1913.

2) A. Herbert *Vep. e përm.*, (sipas përkthimit në AIH., f. 34).

3) A. Puto, *Vep. e përm.*, f. 363.

4) *Po aty*, f. 356.

mohuar në këtë mënyrë sakrificat e panumërta të saj në luftë kundër sundimit osman.

Për këto padrejtësi që po bëheshin në kurriz të popullit shqiptar, Isa Boletini ishte thellësisht i indignuar, prandaj me të drejtë shtronte pyetjen: «Si mund të rri duarkryq kur shof vllaznit e mij, që dalin nga një zgjedhë dhe hyjnë në një tjetër edhe më të randë»¹.

Në kohën kur Isa Boletini ndodhej në Londër, për të shkruan disa gazeta dhe e intervistuan disa gazetarë, midis të cilëve dhe korrespondenti i gazetës amerikane «Christian Monitor» që botohej në Boston. «Gazetat e mëdha — do të shkruante Kristo Dako — lavdëronin me fjalë të zgjedhura karakterin fisnik e kalorës dhe atdhetarizmin e nxehtë të luftëtarit me famë (Isa Boletinit)»². Po kështu gazeta «Dielli» aso kohe, si dhe 17 vjet më vonë «Ora», do ta njihte opinionin shqiptar me vlerësimin dhe vëmendjen që i kushtohej Isa Boletinit nga shtypi i atyre ditëve në Londër, Vjenë etj. Në faqet e tyre është ribotuar një intervistë e Isa Boletinit, botuar së pari në fletoren «Neunes Viener Tageblatt», më 24 maj 1913. Është me interes të ndalemi në këtë bisedë që ka si bosht kryesor shqetësimin e Isa Boletinit për të ardhmen e Shqipërisë. Në këtë intervistë Isai ka shprehur mendime për një sërë problemesh të mprehta për Shqipërinë, të cilat edhe në ato rrethana të brendshme dhe të jashtme aq të ndërlikuara u përpoq që t'ia bënte të njohur edhe opinionit evropian.

Lidhur me vendimet që po merrte Konferenca e Ambasadorëve për Shqipërinë, Isa Boletini mbajti qëndrim të prerë duke u shprehur edhe botërisht kundër tyre. «Vendimet e Konferencës së Londrës për kufijtë e Shqipërisë, — iu përgjigj Isai korrespondentit, — janë krejt të padrejta meqenëse gjysma e tokës shqiptare dhe gjysma e kombit iu dha armiqve»³. Në asnjë argu-

1) S. Luarasi, *vep. për m.*, f. 197.

2) K.A. Daki, *Isa Boletini*, në «Ylli i mëngjezit», vëll. I, nr. 9, viti 1917, f. 266.

3) *Po aty*.

ment nuk mund të mbështetej vendimi i futjes së Kosovës në kufijtë e shtetit serb, përkundrazi Isa Boletini sillte fakte të pakundërshtueshme për të kritikuar padrejtësitë e vendimeve të Konferencës së Londrës, dhe për të hedhur poshtë pretendimet pa baza të Serbisë ndaj trojeve shqiptare të Kosovës. «Në këtë vilajet (Kosovë — F.M.), — deklaronte Isai, — shqiptarët përbëjnë shumicën, dhe pjesa më e madhe bujqësore është shqiptare, prandaj me çfar të drejte, — shtronte pyetjen ai, — e kërkojnë armiqtë tanë këtë vend?»¹.

Isai, Ismail Qemali e të tjerë shpresonin se do të ndikinin me argumentet e tyre në politikën e Fuqive të Mëdha evropiane për të zgjidhur drejt çështjen e kufijve të Shqipërisë. Për këtë qëllim ata edhe ndërморën udhëtimin nëpër kryeqytetet e tyre. Por ashtu si dhe më parë, Fuqitë e Mëdha evropiane bënë tregti me fatet e shqiptarëve, duke vepruar në kundërshtim edhe me rregullat më elementare të të drejtës së kombeve. Prandaj Isai me keqardhje shprehte zemërimin e tij ndaj Evropës. «Unë, — theksonte Isai, — nuk do të besojsha që Evropa me një kulturë të naltë do të na bënte një padrejtësi kaq të madhe. Do të ishte një vepër tepër antinjerëzore, — shtonte ai, — nëse Evropa e civilizuar do t'i lerë vëllezërit në duart e armikut, i cili është sjellë tepër barbar karshi nesh»².

Për Isanë ishte më se e qartë se zgjidhja që i dha Evropa kufijve të Shqipërisë, nuk do të ishte pa pasoja, se shqiptarët nuk do t'i ulnin armët, si në fushën politike, ashtu edhe në të luftës për të mbrojtur të drejtat e tyre. Në këto çaste Isa Boletini shprehte mendimin se askush nuk do të besonte që shqiptarët e Kosovës që kishin vuajtur aq shumë mizorina e barbarizma nga Turqia, të duronin të ishin skllavë të përhershëm³. Prandaj, me bindje të plotë te populli që ai përfaqësonte dhe i vendosur për drejtësinë e luftës së tij, Isa Boletini de-

1) Gaz. «Ora», Tiranë, 1930, viti I, nr. 90, f. 4.

2) *Po aty*.

3) *Po aty*.

klaronte: «Unë ju them sot, që nuk do të mbesim skllavë, por do të luftojmë deri sa të mos mbesi asndonjë»¹. Duke u njohur më nga afër me padrejtësinë e diplomacive evropiane, Isai arriti në përfundimin se lirinë shqiptarët nuk do ta prisnin nga të tjerët, por do ta fitonin vetë me luftë dhe këtë ai ia bëri të qartë opinionit evropian duke deklaruar «ne do të luftojmë deri në vdekje për t'u çliruar prej duarve të huaja». Për sa i përket vetë Isait, asnjëherë nuk do të pajtohej me pushtimin serb të tokave shqiptare, prandaj hapur be-tohej «Për besa — besën e shqiptarit, u thoni se unë kurrë nuk do të rri në prehje, sa vëllazërit e mij do të jenë nën zgjedhën e armiqve»².

Është i rëndësishëm fakti se Isa Boletini e quante zgjidhjen e drejtë të çështjes nacionale si faktorin vendimtar për paqen në Ballkan. Mbi këtë bazë Isai me largpamësi paralajmëroi «N'është se Evropa nuk do ta zgjidhte drejtë çështjen e kufijve të Shqipërisë, Ballkani nuk do të ketë kurrë qetësi»³, dhe për këtë përgjegjësia binte mbi të tjerët dhe aspak mbi shqiptarët. «Ne shqiptarët, — theksonte ai, — nuk marrim asnjë barrë përsipër për luftat që do të shkaktohen në të ardhmen, në sajë të zgjidhjes jo të drejtë të kësaj çështjeje»⁴. Por Isai nuk arrinte të kuptonte se zgjidhje të tilla nga pozitat e shovinizmit borgjez, ishin të natyrshme në kuadrin e politikës imperialiste të Fuqive të Mëdha evropiane, të cilat ishin e janë vazhdimisht të interesuara për ta pasur Ballkanin një fuçi baruti.

Një problem po aq i rëndësishëm sa i kufijve veriorë dhe verilindorë të Shqipërisë ishte për Isa Boletinin edhe çështja e kufijve jugorë. Rreziku për tokat në Jug të Shqipërisë, vinte nga qarqet shoviniste greke, të cilat, ashtu si dhe ato serbe e malazeze në Veri, kishin preten-

1) *Po aty*

2) *Po aty*.

3) *Po aty*.

4) «Përlindja e Shqipërisë», Vlorë, vëll. I, nr. 7, 21 vjeshtë, I, 1913, f. 3.

dimet e tyre absurde për Shqipërinë e Jugut. Propaganda shoviniste greke kishte filluar një fushatë të tërbuar antishqiptare¹. Në këto kushte Isa Boletini vinte në dukje se duhej parë zgjidhja e kufijve të Shqipërisë së Jugut, sepse grekët po përdorin çdo mënyrë për të rrëmbyer si serbët në veri².

Është e rëndësishme të përmendim se në këto intervista të Isait shprehet koncepti i drejtë që kishte ai për zgjidhjen e çështjes nacionale. Isa Boletini deklaronte se «nuk duam asnjë katund më të vogël sllav, por ç'ka është shqiptare, të mbetet e jona e të mos mbetet nën sundimin e huaj»³. Me një pohim të tillë, Isa Boletini në mënyrë kuptimplote i kundërvihet tendencave shoviniste të shteteve fqinje, me një koncept të qartë e të drejtë për çështjen e kufijve midis shteteve fqinje, që gjithsecili të shtrihej në kufijtë e vet dhe jo të lakmonte trojet e të tjerëve.

Në pamundësi për të siguruar ndonjë mbështetje të Fuqitë e Mëdha për rishikimin e çështjes së kufijve, delegacioni vendosi të kthehej në atdhe. Isa Boletini u kthye me bindjen se ishte e domosdoshme të mbaheshin armët ngjeshur e të vazhdohej më tej lufta. «Populli ynë ka vuajtur shumë sa mos me harrue. — thoshte ai, — prandaj do të luftojmë deri në fund kundër ushtrive push-tuese»⁴.

Në fillim të qershorit delegacioni u kthye në Vlorë. Megjithëse nuk u arrit ndonjë përfitim konkret a ndonjë ndryshim në qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj problemit shqiptar, vajtja e delegacionit në kryeqytetet e Fuqive të Mëdha pati rëndësinë e vet. Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Isa Boletini dhe pjesëtarët e tjerë të delegacionit, nëpërmjet gazetave të ndryshme që shkruanin për ta si dhe nëpërmjet intervistave që dhanë, i bënë të njohur Evropës, se shqiptarët nuk do të pajtoheshin

1) Po aty; K.A.Dako *vep. për.*, f. 266.

2) Gaz. «Dielli». Boston Mass, 18 prill 1913.

3) Po aty.

4) A.Herbert. *Vep. për.*, (sipas përkthimit në AIH), f. 52.

kurrë me vendimet e padrejta të Konferencës së Londrës dhe se do të luftonin për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

2. KRYENGRITJA E SHTATORIT TË 1913-ës DHE ISA BOLETINI

Isai dhe anëtarët e tjerë të delegacionit, e gjetën atdheun në një gjendje tepër të vështirë. Pjesa më e madhe e tij vazhdonte të qëndronte e pushtuar nga ushtritë serbe dhe greke, që ushtronin terror e masakra çnjerëzore ndaj popullsisë vendase. Reaksioni po përpiqej me të gjitha mënyrat të mënjanonte Qeverinë e Vlorës dhe t'i hapte rrugë vetes për të shtënë në dorë drejtimin e shtetit¹. Duke e parë realisht rrezikun, populli shqiptar, në forma të ndryshme, shprehu pakënaqësinë dhe zemërimin e tij. Ai i kundërshtoi me forcë vendimet e Konferencës së Londrës për aneksimin e tokave shqiptare (nga monarkitë fqinje ballkanike)².

Isa Boletini edhe mbasi u kthye në atdhe nuk hoqi dorë nga përpjekjet pranë Fuqive të Mëdha. Ai së bashku me delegatët e tjerë të Kosovës, Ajdin Dragën e Mehmet Derallën u dërguan një telegram proteste qeverive të 6 Fuqive të Mëdha evropiane, në të cilin kërkonin rishikimin e kufijve shqiptarë³.

Edhe më e rëndë ishte gjendja në zonat që Konferenca e Londrës u kishte aneksuar Malit të Zi e Serbisë. Autoritetet serbe ndiqnin, arrestonin e vrisnin në masë popullsinë shqiptare, me qëllim që të shuanin në të çdo lëvizje çlirimtare e të forconin sundimin e tyre në këto krahina. Madje, qeveria e Beogradit në kundërshtim edhe me vendimet e Konferencës së Londrës, kishte vendosur në mënyrë arbitrare një kufi strategjik që

1) *Historia e Shqipërisë*, Vëll. III, Tiranë, 1984, f. 110.

2) *HHStA.PA.A*, Rap. nr. 54 i konsullit Lejhanec në Vlorë, Vjenës, 7.6.1913.

3) *Po aty*.

kalonte gjatë luginës së Drinit duke përfshirë pjesërisht edhe Matin, gjoja për të siguruar mbrojtjen nga sulmet e shqiptarëve¹ dhe po përpiquej me të gjitha mënyrat ta detyronte popullsinë e zonës strategjike «të kërkonte bashkim me Serbinë»². Për këtë qëllim, ajo i kërcënoi malësorët me vdekjen nga uria duke u mbyllur atyre rrugët e tregjeve me qytetet. «...Ajo (qeveria serbe — F.M.), — shkruante Dmitrije Tucoviq, — e ndau bujkun prej arës, bagëtinë prej kullotës..., katundin prej mullirit, blerësin dhe shitësin nga tregu, rrethin prej qytetit dhe tërë viset malore prej qendrës së tyre ekonomike dhe hambarët e ushqimit. Shqiptari i andejshëm (i zonës së pushtuar — F.M.) nuk mund të kalonte në tokën që kishte ngelur në këtë anë. Të gjitha burimet e jetës u prenë. Populli i lodhur dhe i uritur, së pari, u lut që ta linin të vinte lirisht në treg, por kur iu pre kjo, atij nuk i mbeti gjë tjetër veç vdekjes prej urisë ose plumbit dhe ai zgjodhi këtë të dytën»³.

Si rezultat i gjithë kësaj shtypjeje sistematike viset e zonës strategjike si dhe tokat që ishin lënë nga Fuqitë e Mëdha jashtë kufijve të Shqipërisë, u përfshinë nga një lëvizje antiserbe.

Duke analizuar gjendjen e brendshme e të jashtme, Isa Boletini, Hasan Prishtina, Bajram Curri e atdhetarë të tjerë kosovarë që ndodheshin në Vlorë, arritën në përfundimin se duheshin shfrytëzuar kushtet e krijuara për të organizuar një kryengritje të armatosur në tokat që kishin kaluar në zgjedhën e huaj. Qysh më parë Isa Boletini kishte deklaruar se «ne shqiptarët duam paqe, por duhet të mbrojmë veten në qoftë se popullin tonë e çoptojnë, e vdesin unit dhe e vrasin»⁴. Një përpjekje e tillë nga prijësit kosovarë ishte plotësisht e drejtë, sepse më tepër se askujt tjetër atyre u takonte të mendonin për fatin e popullit të zonave të push-

1) *Historia e Shqipërisë*. Vëll. III. Tiranë, 1984, f. 112.

2) *Po aty*.

3) D. Tucoviq. *Serbija e Shqypnija*. Prishtinë, 1968, f. 82-83.

4) «*Perlindja e Shqipërisë*», v. I, nr. 7. Vlorë, 21. 8. 1913. f. 3.

tuara. Qeveria e Beogradit e nisur nga qëllime të caktuara politike, e paraqiste këtë si një sulm të nxitur nga qeveria e Ismail Qemalit¹. Solidariteti i Qeverisë së Vlorës me lëvizjen çlirimtare të vëllezërve të një gjaku ishte i padiskutueshëm. Por a shkoi më tutje se kaq Qeveria e Vlorës? A e mbështeti kryengritjen e shtatorit të 1913-ës në mënyrë vepruese? Këtë le t'ia lemë rrjedhës së ngjarjeve.

Krërët kosovarë bënë përpjekje për të siguruar edhe ndonjë aleat të jashtëm. Kështu, mbështetje për kryengritjen iu kërkua Austro-Hungarisë por ajo nuk e pranoi kërkesën, madje, u shpreh kundër organizimit të kryengritjes. Konsulli austro-hungarez Majer-hauser e këshilloi të dërguarin e Bajram Currit të hiqej dorë nga një plan që nuk i përshtatej aspak situatës së përgjithshme dhe që mund të kishte si përfundim të vetëm shfarosjen në masë të popullsisë dhe një përparim të ri të serbëve dhe malazezëve në territorin shqiptar².

Me Bullgarinë çështja qëndronte ndryshe. Pas disfatës në Luftën e Dytë Ballkanike, bullgarët i shtuan përpjekjet për të arritur një bashkëpunim bullgaro-shqiptar drejtuar kundër Serbisë. Për këtë qëllim, më 28 gusht 1913 Isa Boletini mori pjesë në takimin që u organizua në Vlorë me përfaqësuesin bullgar Sandanskin për t'u marrë vesh për një aksion të përbashkët kundër Serbisë³. Materialet e deritanishme nuk japin asgjë mbi realizimin e një bashkëpunimi të tillë.

Qëndrim armiqësor ndaj organizimit të kryengritjes antiserbe, mbajti Esad pashë Toptani. Ky mendohej të siguronte mbështetje në qarqet qeveritare serbe, që në një të ardhme të ndihmohej prej tyre për të marrë në dorë drejtimin e shtetit shqiptar. Prandaj, Esad pasha u premtonte atyre se emigrantët dhe veçanërisht Isa Boletinin e Bajram Currin, të cilët sipas tij keqpërdoronin

1) *Dokumenti o spolnoj politici kraljevine Srbije 1903-1914*, dok. 406, knjiga VI, Sveska 3, Beograd, 1983, f. 432-433.

2) A. Puto. *Vep. për.*, f. 441.

3) *Dokumenti o spolnoj...*, dok. 337, f. 377-379.

mikpritjen, së shpejti do t'i përzinte nga Shqipëria dhe do t'ia dorëzonte Serbisë, madje ai u premtonte atyre se në bashkëpunim me njerëzit e tij do të arrinte ta asgjësonte deri në fund kryengritjen¹.

Megjithëse nuk arritën të siguronin mbështetjen për ndihma konkrete, Isa Boletini, Bajram Curri dhe Elez Isufi u nisën në zonat përkatëse për të organizuar kryengritjen. Nga Vlora, Isa Boletini e Bajram Curri shkuan në Lezhë dhe pastaj në Shkodër, ku qëndruan disa ditë. Duket që në Lezhë e Shkodër, Isai në bashkëpunim me Bajram Currin, të kenë marrë ndonjë masë përgatitore për kryengritjen. Në fillim të gushtit 1913 Isa Boletini, Bajram Curri e luftëtarë të tjerë Kosovarë u nisën për në Malësinë e Gjakovës. Në telegramin drejtuar Ismail Qemalit që mban datën 5 gusht — Luigj Gurakuqi njoftonte — Isa Boletini u nis për në Malësinë e Gjakovës². Po në këtë kohë një njoftim të tillë e jepte edhe gazeta «Liri e Shqipërisë», e cila në numrin e saj të datës 5 gusht shkruante: «Isa Boletini bashkë me shumë shokë të armatosur, shkoi për në Shqipërinë e Veriut, që të luftojnë kundër tiranisë serbe»³. Me sa dihet, Isa Boletini nuk mori me vete luftëtarë nga Lezha a Shkodra, prandaj shokët e tij të armatosur për të cilët njoftonte gazeta «Liria e Shqipërisë» kanë qenë luftëtarë nga Kosova, të cilët i qëndronin Isa Boletinit gjithmonë pranë dhe që ishin me të edhe në Vlorë.

Me të mbërritur në Gjakovë, Isa Boletini u orvat të vendoste lidhjet me Qeverinë e Vlorës. Dëshmi për këtë është letra që Isai i ka drejtuar nga Gjakova Ismail Qemalit.

Në Malësinë e Gjakovës, ai i gjeti shqiptarët në një gjendje tepër të vështirë, Forcat pushtuese serbe u kishin shkaktuar vuajtje dhe mjerim të pashembullt masave popullore.

1) *Po aty*, dok. 266, f. 316.

2) AQSH. Fondi nr. 145, dosja nr. 6, f. 7.

3) «Liri e Shqipërisë», vëll. 3, nr. 81, Sofie, 5 gusht 1913, f. 1

Pikërisht me përshkrimin e kësaj gjendjeje e fillonte Isa Boletini letrën drejtuar Ismail Qemalit. «Ne, — shkruante Isai, — tash jemi në Malësinë e Gjakovës. Çdo skutë e Malësisë, gurë e shkëmb, gjithçka është përplotë mbushë me emigrantë të mjerë»¹. Serbët i kishin dëbuar shqiptarët me dhunë nga vatrat e tyre duke djegur e shkatërruar çdo gjë e duke i lënë ata pa strehë, pa bukë dhe pa mjete të tjera jetese. Para një tabloje të tillë mjerimi e shkatërrimi Isa Boletini u ligështua dhe, siç shkruante vetë, zemra nuk po i duronte përpara vajtimit të atyre bijve të atdheut².

Për t'u ardhur atyre sado pak në ndihmë, Isa Boletini mendoi t'i drejtohej Qeverisë së Vlorës. «Sot, — i shkruante Isai, Ismail Qemalit, — është koha më e nevojshme më u ardhë në ndihmë këtyre bijve. Me qindra e mijëra vetë presin këtë ndihmë sublime tuajën»³.

Gjendja e vështirë e malësorëve e pengoi organizimin e një kryengritjeje të mirëfilltë në Malësinë e Gjakovës, por nuk e bëri të pamundur organizimin e qëndresës në atë zonë. Isa Boletini, Bajram Curri në Kosovës, krijuan çeta të armatosura në Gjakovë, Prizren, dhe në afërsitë e Prishtinës. Lufta e këtyre çetave gëzonte përkrahjen e popullit shqiptar. Shtypi i kohës i bënte jehonë vendosmërisë së luftëtarëve të atyre anëve për të fituar të drejtat e tyre. «Luanët e Malësisë së Kosovës dhe të Malësisë së Shkodrës, — shkruante gazeta «Perlindja e Shqipërisë», — mundohen të ngrihen e të luftojnë bashkërisht kundër pushtuesit të huaj, për t'u bashkuar me vëllezërit e tyre të Shqipërisë së lirë. Le ta dijë fort mirë Evropa, theksonte Isai, që gjersa pa mbushur qëllimet dhe dëshirat e tyre, shqiptarët e Kosovës, Hotit e Grudës kurrë nuk do të

1) I. Qemali, *vep. për m.*, dok. 292, f. 311.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

qetësohen, por do të luftojnë gjer në fund sa të mos mbetet këmbë burri»¹.

Por përmasa të mëdha lëvizja antiserbe mori aty nga mesi i shtatorit, kur plasi kryengritja në Dibër. Më 20 shtator 1913 malësorët dibranë dëbuan ushtarët serbë nga fshatrat e tyre dhe në bashkëpunim me popullsinë e qytetit hynë në Dibër². Mbas luftimesh të ashpra, qyteti i Dibrës u çlirua. Trupat serbe u detyruan të tërhiqeshin edhe nga Ohri, Struga dhe Gostivari. Kryengritësit, numri i të cilëve kishte arritur në disa mijëra, marshuan në drejtim të Kërçovës³.

Në dokumentet serbe e austro-hungareze të kohës, thuhet se në sulmin për çlirimin e Dibrës kishte marrë pjesë edhe Isa Boletini⁴ në krye të një kolone shqiptarësh. Një pohim i tillë nuk është i përpiktë, sepse në këtë kohë Isa Boletini sipas disa të dhënave ndodhej në Malësinë e Gjakovës.

Fitorja e kryengritjes në Dibër, i dha nxitje të re lëvizjes antiserbe dhe në disa krahina të Kosovës si në Drenicë, Prizren, Gjakovë etj. Megjithatë në këto krahina ajo nuk mundi të marrë atë shtrirje dhe forcë si në Dibër. Çetat e krahinave të ndryshme nuk mundën të bashkëpunonin në aksionet e tyre kundër pushtuesve serbo-malazez, sepse forcat pushtuese kishin vendosur aty një regjim të egër, të cilin e përforcuan në prag të fillimit të kryengritjes.

Isa Boletini, e zhvilloi veprimtarinë e tij kundër pushtuesve serbë në muajt shtator — tetor 1913, në Malësinë e Gjakovës dhe në afërsi të Prizrenit. Nga korrespondenca diplomatike a-h, del se nën udhëheqjen e Isa Boletinit dhe Bajram Currit ishin më se 2 000 veta të armatosur⁵. Kjo e dhënë ka mundësi të mos jetë

1) Gaz. «Përlindja e Shqipërisë», vëll. I, nr. 7. Vlorë, 21. 8. 1913.

2) *Dokumenti o spolnoj.*, vep. për. dok. 337, f. 377-379.

3) *Historia e Shqipërisë*, Vëll. III. Tiranë, 1984, f. 114.

4) *Dokumenti o spolnoj.*, vep. për. dok. nr. 337, f. 377-379.

5) *HHStA, PA, A*, Tel. 16 i konsullit a-h Bilinski në Manastir, Vjenës, 25 shtator 1913.

shumë e përpiktë, sepse mundësitë ekonomike të popullsisë së atyre krahinave, që i kishte pllakosur mjehurimi e shkatërrimi, e bënë tepër të vështirë organizimin e një numri të madh kryengritësish. Pavarësisht nga saktësia e kësaj shifre e vërtetë është që çetat e udhëhequra nga Isa Boletini e Bajram Curri, zhvillonin veprime luftarake dhe arritën disa suksese. Këto të dhëna na i jep vetë Isa Boletini në letrën që i drejton Ismail Qemalit në fund të shtatorit. «Çetat e këtushme, — shkruante Isai, — po tregojnë mjaft aktivitet. Përveç aksioneve të vogla, ato kanë sulmuar kodrat e Morinës, dhe i kanë ripushtuar ato. Trupat serbe u detyruan të linin vendin e të tërhiqeshin në Gjakovë»¹.

Lufta që zhvillohej nën udhëheqjen e Isa Boletinit, Bajram Currit dhe atdhetarëve të tjerë kosovarë gjeti përkrahjen morale në shtypin përparimtar të kohës, brenda dhe jashtë vendit. «Çetat shqiptare, — shkruante gazeta «Përlindja e Shqipërisë», — nën udhëheqjen e Isa Boletinit dhe Bajram Currit, u përpoqën dhe e shtynë ushtrinë serbe në afërsi të Prizrenit»². Po në ato ditë gazeta «Dielli» shkruante: «Lufta po vazhdon e rreptë në Shqipërinë e Veriut. Isa Boletini duke përveshur llërët e duke zhveshur pallën si një skënderbeg i dytë, dita-ditës po korr dafina lufte»³.

Për vazhdimin e mëtejshëm të qëndresës së armatosur, ishte i domosdoshëm furnizimi i luftëtarëve me armë, municione dhe ushqime. Prandaj, Isa Boletini iu drejtua Ismail Qemalit me një letër të dytë ku i shtronte përsëri kërkesën për drithë e të holla⁴. Por përsëri Qeveria e Vlorës nuk mundi të plotësonte kërkesat e Isa Boletinit. Si nga letra e parë, ashtu dhe nga e dyta mund të arrihet në përfundimin se Qeveria

1) I. Qemali, *Vep. për.*, f. 348.

2) Gaz. «Përlindja e Shqipërisë», Vlorë, nr. 16, 21. vjesht e parë, 1913, f. 5,

3) Gaz. «Dielli» Boston Mass, vëll. V, nr. 249, 31 shtator 1913, f. 2.

4) I. Qemali, *Vep. për.*, dok. 328, f. 347.

e Vlorës përveç përkrahjes dhe solidarizimit moral nuk ndërmori asnjë veprim konkret në ndihmë të tyre. Qeveria e Vlorës nuk e bëri një hap të tillë për disa arsye. Në radhë të parë, ajo nuk duhej të komprometonte politikën e saj, e cila në bazë të vendimeve të Londrës duhej t'i përmbahej asnjësisë¹ dhe së dyti, dhe më kryesorja Qeveria e Vlorës i kishte mundësitë ekonomike e financiare shumë të kufizuara për të ndihmuar kryengritjen materialisht².

Faktet e mësipërme e hedhin poshtë tezën serbe që ia ngarkonte Qeverisë së Vlorës rolin aktiv të dorës së parë në përgatitjen dhe zhvillimin e kryengritjes së shtatorit³. Qeveria e Beogradit e propagandonte këtë tezë me qëllime të caktuara politike, për të paraqitur lëvizjen antiserbe të atyre zonave si fryt i një aksioni sistematik që ndërmerrej prej Shqipërisë autonome⁴ dhe më pak si shprehje të kundërshtimit që i bëhej nga vetë populli i atyre zonave pushtimit serb. Duke e ngarkuar Qeverinë e Vlorës me «fajësinë» e nxitjes së kryengritjes së shtatorit Qeveria e Beogradit e përdorte këtë si argument për të përligjur raprezaljet që ushtria serbe kryente në shkallë masive⁵ dhe për të ngarkuar atë me përgjegjësi në sytë e opinionit diplomatik evropian.

Përveç kërkesës për ndihmë që Isa Boletini i drejtonte Ismail Qemalit, nga letra del se ai dhe Bajram Curri e propagandonin Qeverinë e Vlorës dhe sqaronin masat popullore të krahinave ku ata vepronin, Krasniqe, Gash, Bytyç, Has etj., se «rruga e vërtetë dhe e nevojshme është me iu shtruar urdhërit të Ismail Qemalit, atij patrioti të madh që ka si qëllim rregullimin e

1) A. Puto. *Vep. e përm.*, f. 433.

2) *Historia e Shqipërisë*, Vëll. III, Tiranë, 1984, f. 114.

3) A. Puto *Vep. e përm.*, f. 420, Gaz; «Përlindja e Shqipërisë», 25, vjesht e parë, 1913, f. 1.

4) A. Puto, *Vep. e përm.*, f. 430: *Dokumenti o spolnoj...* dok. 406, f. 432-433.

5) A. Puto. *Po aty*.

qeverisë së re të Shqipërisë»¹. Qëllimi i tyre ishte që duke siguruar përkrahjen e masave popullore për Qeverinë e Vlorës, të zgjeronin sa më shumë bazën e saj shoqërore dhe në të njëjtën kohë të forconin idenë në masat popullore se e vetmja rrugë shpëtimi për to dhe trojet e tyre, për të ruajtur unitetin e kombit shqiptar dhe të Shqipërisë ishte bashkimi me Qeverinë shqiptare të Vlorës. Duke e parë Qeverinë e Vlorës, si qeveri të të gjithë Shqipërisë, malësorët e Gjakovës u shprehën se «...deri te kalamajtë në djep ishin gjithsi të lidhur me të [Ismail Qemalin] dhe fjalët e thëna njëzëri, — shkruante Isa Boletini, — i mbërthyen në besën e dhënë»².

Luftën që po bënin për çlirimin e tyre shqiptarët e zonave të pushtuara nga ushtria serbe Isa Boletini e trajtonte si çështje të të gjithë Shqipërisë duke pohuar kështu unitetin e popullit shqiptar dhe të trojeve të banuara prej tij, si një të tërë dhe të pandashme. «Siç e dini shkëlqesia juaj, — shkruante ai po në këtë letër — edhe na jena përpjekur e po përpjekna për ta qit në breg këtë atdhe, këtë Shqipëri»³. Dhe për të kryer detyrën ndaj atdheut deri në fund Isa Boletini dhe luftëtarët që ai udhëhiqte, ishin betuar dhe kishin lidhur besën se do të flijonin edhe jetën⁴.

Veprimet luftarake të çetave të krahinave të Kosovës, të udhëhequra nga Isa Boletini dhe Bajram Curri, si dhe sukseset e kryengritësve në Dibër, e detyruan qeverinë serbe të merrte masa më serioze. Ajo mobilizoi afro 3 divizione dhe i përqëndroi ato në viset shqiptare të aneksuara. Aty nga fillimi i tetorit, forcat ushtarake serbe, filluan operacionet luftarake kundër luftëtarëve shqiptarë dhe ushtruan një terror të paparë ndaj popullsisë shqiptare. Me gjithë qëndresën që bënë si çetat e Isa Boletinit ashtu dhe krye-

1) I. Qemali, *Vep. e përm.*, dok. 328, f. 347.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) *Po aty.*

ngritësit e Dibrës, serbët mundën të shtypnin krye-ngritjen.

Por shtypja e kryengritjes së shtatorit 1913 nuk do të thoshte se shqiptarët e humbën shpresën dhe e pushuan luftën kundër pushtuesve serbo-malazezë. Në ato çaste të vështira Ismail Qemali deklaronte para popullit të Vlorës: «Ne shpresat nuk duhet t'i humbasim gjithmonë duhet të kemi parasysh që Kosova ka qenë dhe do të jetë shqiptare»¹.

Me ndjenjën e rëndë të hidhërimit në zemër, Isa Boletini, Bajram Curri dhe shumë familje kosovare u detyruan të largohen nga Malësia e Gjakovës dhe zbritën në Shkodër. Aty, me vështirësi të madhe Isa Boletini mundi të sistemonte disa familje kosovare dhe nëpërmjet të njohurve të vet, u siguroi atyre mjetet minimale për jetesë.

Sipas të dhënave Isai qëndroi në Shkodër deri në mesin e nëntorit 1913. Aty është takuar me mjaft atdhetarë, luftëtarë të lirisë si M. Grameno, Ç. Topulli, H. Mosi e N. Ivanaj. Ajo që spikat në bisedat e tyre, është optimizmi që karakterizonte Isa Boletinin për të ardhmen. Këtë optimizëm ai e mbështeste në përvojën e madhe që kishte fituar populli shqiptar në përballimin e vendosur të armiqve, të cilët i përdorën të gjitha mënyrat e mjetet për ta nënshtruar e gjunjësuar atë. Që në takimin e parë, kur M. Grameno e Ç. Topulli etj., shkuan në shtëpinë ku ishte strehuar Isai për t'i shprehur atij keqardhjen për kobin e mjerimin që u kishte rënë mbi kokë malësorëve të Shqipërisë së Veriut, Isa Boletini u shprehu atyre besimin se, pavarësisht nga dhuna dhe mënyrat më barbare që përdornin shovinistët serbë, ai ishte i bindur se ata nuk ia kishin arritur dhe nuk do t'ia arrinin kurrë qëllimit të tyre për të dëbuar shqiptarët nga Kosova. «Neve, — tha ai (Isai), — nuk na shuajti dot as Turguti, as Xhavit Pasha, as gjithë turqit për 500 vjet e jo të na shuajnë

1) Gaz., «Përlindja e Shqipënisë», 21.8.1913, f. 2; Shih: A. Puto, *Vep. e për.*, f. 431.

këlyshët e Nikollës e të Pjetrit¹». Isa Boletini mendonte me të drejtë se pikërisht kur reaksioni i brendshëm dhe ai i jashtëm synonin përçarjen e shqiptarëve, duhej më tepër se kurrë bashkimi midis tyre. Në mënyrë shumë kuptimplote, Isai nderi dorën dhe me të u lidhën edhe duart e B. Currit e të atdhetarëve të tjerë. «Po të jemi të lidhur të gjithë — tha Isa Boletini — s'kanë ç'na bëjnë ushtarët e Nikollës e të Pjetrit»². Kryesisht mbi bazën e bashkimit të shqiptarëve, Isai mendonte se do të arrihej çlirimi i Kosovës nga ushtritë pushtuese³.

Krahas dhunës së egër, masakrave e terrorit që ushtruan ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës e të viseve të tjera, qarqet shoviniste të Beogradit, ashtu si në periudhat e mëparshme edhe në këtë kohë, u orvatën të tërheqin në Kosovë udhëheqësit e qëndresës popullore. Në mënyrë të veçantë, qeveria serbe u mundua ta bënte këtë edhe me Isanë si edhe krerë të tjerë kosovarë, t'i bindte ata të ktheheshin në Kosovë e t'i zhdukte më lehtë duke dobësuar kështu grupin e kosovarëve që vepronte e punonte për bashkimin e Kosovës e trojeve të tjera me Shqipërinë. Ndaj Isa Boletinit qeveria serbe përdori përsëri mjete dhe rrugë të ndryshme. Fillimisht Beogradi u premtoi Isa Boletinit dhe Bajram Currit poste të larta dhe se do t'u siguronte jetën atyre⁴. Por si Isai ashtu edhe Bajram Curri, nuk mund t'i jepnin përgjigje tjetër veçse refuzimit kategorik. Ata jo vetëm që nuk pranuan postet e larta⁵ të afuara nga Beogradi, por e vijuan më tej luftën kundër pushtuesve serbë .

Përprjekje të tjera bënë shovinistët serbë për ta tërhequr Isa Boletinin në Mitrovicë nëpërmjet familjes së tij.

1) Gaz. «Koha». Art. i M. Gramenos *Luanët e vdekjes*, 16.12.1915.

2) *Po aty*.

3) *Po aty*.

4) *HHStA,PA,A*, Relacioni Imre Balint në Budapest. Vjenës, 14.11.1913.

5) *Po aty*.

Jo pa qëllim ata e mbajtën familjen e Isait në Mitrovicë e nuk e dëbuan ashtu siç bënë me qindra familje kosovare. Nga ai qëndrim «dashmirës» dhe i «kujdesshëm» që u mbajt ndaj familjes Boletini në fund të vitit 1912 kur Isai u largua për në Vlorë, mbas shtypjes së kryengritjes së shtatorit 1913, u kalua në presion të hapur dhe nënës së Isait iu kërkua që ta tërhiqte atë në Mitrovicë, madje, serbët edhe e kërcënuan se do ta largonin me gjithë të afërmit nga Kosova¹. Por, edhe këto përpjekje të serbëve përfunduan pa sukses. Ata nuk mundën t'i diktonin vullnetin e tyre Aishe Boletinit. Sipas konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, nëna e Isait i dha këtë përgjigje nëpunësit të Serbisë: «Nuk e di ku ndodhet djali im, prandaj s'kam për të bërë asgjë për ta bindur që të kthehet. Dijeni se unë jam nëna e Isa Boletinit e ju deklaroj se askush nuk mund të na detyrojë të lemë shtëpinë tonë, jeni të lirë të na vrisni, ose t'i vini zjarrin shtëpisë mbi kokat tona, por të gjallë ju nuk mund të na nxirrni nga shtëpia»². Meqenëse qeveria serbe nuk arriti ta shtinte në dorë edhe me këto presione Isa Boletinin, ajo urdhëroi komandën supreme që të kapej Isa Boletini, Bajram Curri e atdhetarë të tjerë e të vriteshin³, gjë që komanda e lartë ushtarake serbe nuk mundi ta arrinte.

Interes për Isa Boletinin tregoi në këtë kohë edhe Esad pashë Toptani. Ai, mbasi formoi në tetor 1913 «Pleqësinë e Shqipërisë së Mesme», preu çdo marrëdhënie me Qeverinë e Vlorës. Për të siguruar sa më shumë përkrahës, Esad pashë Toptani i propozoi Isa Boletinit, që ta braktiste Qeverinë e Vlorës e të bashkohej me «qeverinë» e tij në Durrës. Por Isa Boletini nuk i pranoi propozimet e Esad pashë Toptanit⁴, përkundrazi ai e dënoi politikën përçarëse e antikombëtare të tij.

1) HHStA, PA, A, Rap. i konsullit a-h në Mitrovicë, — Vjenës, 24 tetor 1913.

2) *Po aty*.

3) *Mitrovica, Vep. e për. m.*, f. 101.

4) *AQSH. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.*

Pasi qëndroi disa ditë në Shkodër, Isa Boletini u nis për në Vlorë. Dokumentet nuk na japin datë të përpiktë, por sipas kujtimeve të Tafil Boletinit, ai mund të ketë mbërritur në Vlorë në 15 ditëshin e dytë të nëntorit 1913. Me sa duket, Isa Boletini në Vlorë shkoi të takohej me Ismail Qemalin për të trajtuar problemin e organizimit të mëtejshëm të qëndresës antiserbe. Gjatë qëndrimit në Vlorë, Isai pa më nga afër vështirësitë dhe ndërlikimet që iu krijuan Qeverisë së Përkohshme, mbas mbërritjes në tetor 1913 të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit që nuk ishte gjë tjetër veçse zbatues i politikës së Fuqive të Mëdha në Shqipëri.

Ndërhyrja e vijueshme në punët e brendshme të shtetit shqiptar si dhe presioni gjithnjë e më i madh që bënte mbi të, KNK e paralizoi krejtësisht veprimtarinë e Qeverisë së Përkohshme¹. Nga njëra anë KNK, dhe nga ana tjetër veprimtaria minuese, intrigat, ambiciet dhe interesat vetjake të elementëve reaksionarë si Esad pashë Toptani, ia bënë të pamundur veprimtarinë Qeverisë së Vlorës. Prandaj më 22 janar 1914, ajo dha dorëheqjen.

Kështu, administrata shqiptare u përqendrua në dorë të KNK. Në këto kushte, qëndrimi i mëtejshëm i Isa Boletinit në Vlorë, ishte pa interes, prandaj aty nga fundi i janarit ai kaloi përsëri në Shkodër, sepse këtu ai ishte më afër vendlindjes së tij, më afër malësorëve kosovarë, që ishin larguar nga trojet e tyre për t'i shpëtuar terrorit dhe masakrave të shovinistëve serbo-malazez, e që u vlonte dëshira për të luftuar për të drejtat e tyre.

3. QËNDRIMI NDAJ PRINC VIDIT

Fuqitë e Mëdha vendosën më në fund të sillnin në fronin e Shqipërisë princin gjerman Vilhelm Vidin.

Princ Vidi erdhi në Shqipëri më 7 mars 1914. Ashtu

1) *Historia e Shqipërisë*, Vëll. III, Tiranë, 1984, f. 127.

si shumë atdhetarë të tjerë dhe Isa Boletini e priti mirë ardhjen e tij. Që kur ishte në Londër, ai u pajtua me idenë e Ismail Qemalit që në Shqipëri të vinte një princ i huaj, i cili të mos ishte as i fesë myslimane, as katolike e as i asaj ortodokse¹. Kështu mbetej që princi i ardhshëm të ishte protestan. Duket se Isai dhe udhëheqës të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare kishin shpresë se ardhja e një princi në një fe që nuk kishte besimtarë në Shqipëri, do të ndikonte pozitivisht në bashkimin e shqiptarëve pa dallime fetare dhe do të mënjanonte përpjekjet përçarëse të shovinistëve fqinjë dhe të reaksionit të brendshëm. Në kuadrin e gjithë Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Isa Boletini kishte gjithashtu mendimin se princi do të ishte në gjendje t'i jepte fund anarkisë brenda vendit, të zgjidhte çështjet politike të mbetura pezull, siç ishin sigurimi i tërësisë tokësore të shtetit shqiptar sipas kufijve të caktuar nga Konferenca e Ambasadorëve². Pra, Isai e shihte princin gjerman si simbolin e Shqipërisë së pavarur dhe të bashkuar. Për këtë arsye Isa Boletini bashkë me Bajram Currin dhe kosovarë të tjerë, shkuan në Durrës në pallatin mbretëror të Vidit dhe në takimin që patën me të, i premtuan atij se ata do të përpiqeshin për të mirën e të gjithë kombit dhe të fronit të Shqipërisë³. Isa Boletini dhe mjaft elementë të tjerë përparimtarë, nuk arritën të shihnin se çfarë fshihej pas personit të Vidit dhe nuk mundën të kuptonin se ardhja e tij në Shqipëri «ishte, — siç ka thënë shoku Enver Hoxha, — një koniunkturë e shteteve të fuqishme të Antantës dhe të shteteve të Evropës Qëndrore për përgatitjen e Luftës së madhe Botërore»⁴.

Me ardhjen në fron, princ Vidi u orvat të zgjidhte problemin e largimit të trupave greke nga Shqipëria

1) Gaz. «Dielli», Boston Mass. vëll. I, 18 prill 1913.

2) G. Shpuza. *Kryengritja fshatare e Shqipërisë së Mesme*, vitet 1914-1915, Tiranë, 1986, f. 83.

3) Gaz. «Kushtrimi i lirisë». Durrës, nr. 11, 14 mars 1914.

4) Enver Hoxha, *Vepra*. vëll. 23, f. 160.

e Jugut dhe të vendosjes së administratës shqiptare në këto vise. Por, megjithëse ishte përcues i politikës së fuqive evropiane, ai nuk u ndihmua prej tyre për të forcuar pozitat e fronit shqiptar. Në këtë drejtim, Vidi u pengua edhe nga Esad pashë Toptani.

Në fund të marsit, me kërkesën e konsullit bullgar në Vlorë, Isa Boletini u nis nga Durrësi, për në Vlorë. Për atë që u bisedua midis tyre dhe për faktin se cili nga shqiptarët mori pjesë në takimin me konsullin bullgar përveç Isait, nuk kemi të dhëna dokumentare, por takimi midis tyre duhet të ishte vijim i përpjekjeve bullgare për të arritur një bashkëpunim shqiptaro-maqedonas për luftë kundër Serbisë. Ndërkohë, qeveria e princ Vidit i drejtoi Isa Boletinit kërkesën për të shkuar në Veri e për të grumbulluar vullnetarë për në Shqipërinë e Jugut për të luftuar kundër forcave greke që fshiheshin prapa atyre «vorioepirote»¹. Kështu, Isa Boletini u nis nga Vlora për në Shkodër². Ai e konsideroi të domosdoshme luftën për çlirimin e tokave të zëna nga forcat greke, prandaj, bashkë me B. Currin dhe nipin e tij Tafil Boletinin, dërgoi letra në malësi, në të cilat u bënte thirrje malësorëve për t'u grumbulluar në Shkodër³.

Në kohën kur Isa Boletini po përgatitej për në Jug, në Shqipërinë e Mesme plasi Kryengritja Fshatare. Shkëndija e parë ishte prita e organizuar nga fshatarët e revoltuar kundër batalionit të vullnetarëve tiranas të Ura e Limuthit më 17 maj 1914*. Kryengritja e gjeti trullin të përgatitur, pakënaqësia kishte përfshirë masa të gjera fshatarësh. Më 18 maj 1914 kryengritësit iu afruan Durrësit⁴. Qeveria e Durrësit e shihte këtë si një krye-

1) AQSH. Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

*) Rritja e pakënaqësisë ndaj çifligarëve të grumbulluar në Durrës bëri që batalionin e vullnetarëve tiranas, Esad pasha ta niste në drejtim të Durrësit, në vend që të shkonte në jug për të luftuar kundër grekëve.

4) Historia e Shqipërisë. Vëll. III, Tiranë, 1984, f. 139.

ngritje të nxitur e të përkrahur nga Esad Pasha që synonte të krijonte qeverinë e vet. Grupi proaustriak në oborrin e princit dhe në radhët e qeverisë gjeti rastin e përshtatshëm për të mënjanuar Esad Pashën, agjentin kryesor të Italisë, ndërsa atdhetarët demokratë menduan të përfitonin për të hequr qafe kreun e reaksionit feudal¹. Më 19 maj forcat e xhandarmërisë e rrethuan pashanë toptanas në shtëpinë e tij dhe e detyruan të dorëzohej. Mbas ndërhyrjes energjike të ministrit italian në Durrës, Vidi ia dorëzoi Esad Toptanin Italisë². Në këto kushte Isa Boletinit iu njoftua nga Qeveria e Durrësit, se Esadi u largua për në Itali, ndërsa rebelët e tij po mësynin Durrësin, prandaj me fuqitë që kini nisuni për në Durrës nga Shëngjini me det³.

Për të vlerësuar qëndrimin e Isa Boletinit në këtë kohë si ndaj lëvizjes fshatare të Shqipërisë së Mesme, ashtu dhe ndaj Vidit, është e nevojshme të shohim në mënyrë të përgjithshme gjendjen brenda vendit. Periudha e viteve 1914-1915 është mjaft e ngjeshur me ngjarje politike e shoqërore që pasojnë njëra-tjetrën me shpejtësi. Forca me tendencë të ndryshme e të kundërta vepronin në Shqipëri, ku kryqëzoheshin edhe interesat e fuqive evropiane e të shteteve ballkanike, të cilat nuk mund të mos ndikonin në zhvillimin e ngjarjeve të brendshme. Këtë periudhë shoku Enver Hoxha e ka përcaktuar si një «Periudhë mjaft të ndërlikuar nga pikëpamja e forcave lëvizëse e drejtimet e tyre, si dhe orientimet politike të këtyre forcave nga shtetet e mëdha»⁴. Më dukshëm në atë kohë vepronte Vidi nga njëra anë, si përfaqësues i Fuqive të Mëdha dhe Esad pashë Toptani nga ana tjetër si agjent i italianëve dhe i serbëve, ndërsa kryengritja e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme, që s'ishte gjë tjetër veçse rrjedhim i pakënaqësisë ndaj çifligarëve dhe kreut të tyre Esad pashë Top-

1) *Po aty.*

2) *Po aty.*

3) S. Luarasi. *Vep. e përsm.*, f. 208.

4) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 23, f. 100.

tanit, u quajt dhe u propagandua nga Qeveria e Durrësit si «rebelizëm» me tendenca politike, e nxitur dhe nga intrigat e pashait toptanas. Në këto kushte midis princ Vidit, si njeriu i Vjenës, dhe Esad pashë Toptanit si njeriu i Romës¹, Isa Boletini dhe atdhetarë të tjerë morën nën mbrojtje Princ Vidin me shpresë gjithmonë se do të mbronin më mirë shtetin shqiptar, do të forconin pavarësinë e Shqipërisë si dhe do të zgjidhnin çështjen e kufijve.

Këto duhet të kenë qenë arsyet që e kanë shtyrë Isa Boletinin t'i kundërvihet kryengritësve të Shqipërisë së Mesme, dhe bashkë me Bajram Currin dhe malësorë të tjerë kosovarë në fillim të qershorit të grumbullohen në Durrës në mbrojtje të Princit. Për këtë angazhim të Isa Boletinit ndaj Princ Vidit, konsulli francez shkruantë në raportin drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme se: «Isa Boletini ka pranuar të mbrojë Vidin me të vetmen shpresë se në këtë mënyrë i shërben çështjes shqiptare»². Ndërkaq me Esad pashë Toptanin, Isa Boletini nuk u pajtua asnjëherë, pasi atë e konsideronte «trédhtar të popullit shqiptar që me italianët, grekët, serbët e malazetë punonte për të shkatërruar Shqipërinë»³. Marrjen e tij në mbrojtje nga pala italiane Isai e shihte me dyshim, si mbështetje të saj për të lehtësuar ndërhyrjen në Shqipëri. Prandaj Isai paralajmëronte atdhetarët se «Ata (italianët-F.M.) që e shpëtuan (Esad Toptanin) do ta përkrahnin, prandaj këtu e mbrapa është gjithë puna»⁴.

Kryengritësit brenda një kohe të shkurtër shtinë në dorë Krujën, Kavajën e Peqinin dhe po i afroreshin Durrësit. Në luftimet që u bënë kundër tyre më 16

1) M. Çami, *Mbi aleancat politike e klasore në shoqërinë shqiptare në vitet 1912-1920*, në: «Studime historike», nr. 1, Tiranë, 1985.

2) AMAE, Letër nr. 118. Ministri francez në Durrës, MPJ Francës, 10.8.1914,

3) AQSH, Fondi nr. 74, dosja nr. 4.

4) *Po aty*.

qershor në kodrat e Rashbullit dhe te Ura e Shijakut, për mbrojtjen e Durrësit, veproi dhe Isa Boletini në krye të 700 malësorëve shqiptarë¹. Mbas luftimesh të ashpra ku Isa Boletini la disa të vrarë e të plagosur, ai u tërhoq në Durrës. I indinjuar për atë që ndodhi, Isai shfaqti pakënaqësinë ndaj qeverisë, e cila me mëndjelehtësi, siç u shpreh ai, i nisi drejt masakrimit². Luftën midis kryengritësve dhe malësorëve Isa Boletini dhe njerëzit e tij e konsideruan si të padrejtë, si luftë vëllavrasëse, prandaj mbasi u tërhoqën në qytet, ata deklaruan se detyra e tyre ishte mbrojtja e mbretit dhe jo dalja në luftë të hapur kundër vëllezërve shqiptarë³.

4. NË FILLIM TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Krahas problemit të forcimit të shtetit të pavarur shqiptar, që ishte detyra kryesore mbas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, atdhetarët shqiptarë nuk harruan për asnjë çast, që në rrethanat e favorshme kombëtare dhe ndërkombëtare që krijoheshin, të realizonin tërësinë territoriale të Shqipërisë, si një nga detyrat kryesore të programit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Përgatitjet e dy blloqeve imperialiste për Luftën e Parë Botërore, i shtynë I. Boletin, H. Prishtinën, B. Currin e të tjerë atdhetarë shqiptarë, që në lëmshin e kontradiktave midis shteteve ndërimperialiste, të kapnin e të shfrytëzonin ato midis Austro-Hungarisë e Serbisë në Shqipëri, për çlirimin e Kosovës e viseve të tjera shqiptare e bashkimin e tyre me Shqipërinë. Megjithëse Austro-Hungaria ishte fuqi imperialiste e lufta që ndërmori kundër Serbisë në korrik 1914, ishte luftë imperialiste, atdhetarët shqiptarë u munduan të sigu-

1) *HHStA, P.A.A.* Rap. nr. 13. Përfaqësuesi a-h në Durrës, Vjenës, 17 qershor 1914; S. Italo, «In Albania sei mesi di Regno», Milano, 1914, (e përkthyer në AIH, f. 67-70).

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

ronin tek ajo një mbështetje në qoftë se do të hynin në luftë kundër Serbisë, për dy arsye: së pari, se Austro-Hungaria ishte armikja kryesore e Serbisë nën pushimin e së cilës kishin mbetur Kosova e vise të tjera shqiptare, dhe së dyti, se ajo në ato çaste nuk paraqiste synime të afërta grabitqare në Shqipëri.

Austro-Hungaria, nga ana e saj, duke shfrytëzuar kontradiktat nacionale midis Shqipërisë dhe dy fqinjëve të saj, Serbisë dhe Malit të Zi, u orvat të përdorte popullin shqiptar në interes të luftës së saj imperialiste grabitqare¹. Për këtë arsye ajo u tregua e gatshme të përkrahte Isa Boletinin dhe krerët e tjerë kosovarë në idenë e organizimit të kryengritjes antiserbe. Për këtë qëllim u zhvilluan edhe bisedime midis Isa Boletinit, Hasan Prishtinës dhe përfaqësuesve të qeverisë austro-hungareze, në Kastelnuovo në mesin e korrikut 1914². Por, përveç datës së vajtjes dhe të kthimit, burimet dokumentare nuk hedhin dritë rreth bisedimeve. Duket se aty do të jetë diskutuar problemi i organizimit të shqiptarëve kundër Serbisë. Krerët kosovarë shpresonin se, në rast se do të fitonte kundër Serbisë, Austro-Hungaria do t'i mbështeste ata për çlirimin e Kosovës, e të viseve të tjera shqiptare nga Serbia. Këtë kërkesë ata ia parashtruan qeverisë austro-hungareze. Në telegramin që i dërgonte Vjenës përfaqësuesi i saj në KNK, midis të tjerave theksonte se. Isa Boletini dhe krerët e tjerë kosovarë kërkonin siguri, se mbas mundjes së Serbisë, të mbështeteshin (nga Austro-Hungaria) për çlirimin me të vërtetë dhe përgjithmonë nga sundimi serb³. Në dokumentacionin e shfrytëzuar del se përveçse furnizimit me disa armë, municion dhe të holla që iu

1) M. Çami, *Shqipëria në planet e fuqive imperialiste të Antantës në fillim të Luftës së Parë Botërore*, në: «Buletini i Shkencave Shoqërore të UT». Tiranë, 1961, nr. 3, f. 33.

2) *HHStA, PA, A*, Tel. nr. 77/422 i konsullit a-h në Kastelnuovo, Vjenës, 20 korrik 1914; Tel. nr. 225 i konsullit a-h në Durrës Krali, Vjenës, 31.7.1914.

3) *HHStA, PA, A*, Tel. nr. 61 i Kralit në Vlorë, Vjenës, 11.8.1914.

dha krerëve kosovarë qeveria austro-hungareze nuk u bëri atyre asnjë premtim.

Si atdhetar demokrat, i lidhur ngushtë me luftën e popullit, Isa Boletini nuk mund të mos i tërhiqte vëmendjen lëvizja e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme. Duke ndjekur zhvillimin e kryengritjes, ecurinë e saj, Isa Boletini dhe një pjesë e patriotëve në Durrës arritën të kuptonin atë që kishte ndier Isa Boletini që kur ishte tërhequr nga beteja e 16 qershorit, se ajo nuk ishte siç propagandohej nga Qeveria e Durrësit, lëvizje «rrebele», «esadiste», por ishte një lëvizje me tendenca antiçifligare dhe antiimperialiste, Prandaj, ai, në bashkëpunim dhe me Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Dervish Himën, Jashar Erebarën, menduan të lidheshin me kryengritësit për t'u hedhur në luftë kundër Serbisë. Për këtë qëllim, ata u takuan disa herë në Durrës, te myftiu i Durrësit dhe vendosën të dërgonin njerëz për të biseduar me kryengritësit¹. Sipas raportit të ministrit serb në Durrës, del se kryengritësit nuk e pranuan propozimin e Isa Boletinit e të atdhetarëve të tjerë², sepse, sipas tyre, fronti më i rëndësishëm i luftës së popullit shqiptar ishte ai antivindist kundër Qeverisë së Durrësit. Realizimi i një bashkëpunimi të tillë u pengua nga Turhan Pasha (kryeministër në Qeverinë e Durrësit) për të ruajtur pozitën e asnjësisë së shtetit shqiptar³.

Afrimin e krerëve kosovarë, udhëheqësit e kryengritjes shfrytëzuan dhe bënë përpjekje për t'i tërhequr ata në luftë kundër Vedit⁴. Prandaj ata iu drejtuan disa herë krerëve kosovarë në Durrës me shpresë se do të mund të arrinin bashkëpunimin me ta. Por takimi midis tyre nuk u arrit. Negativisht këtu ndikuan ndërhyrjet e Austro-Hungarisë së cilës nuk i interesonte bashkëpu-

1) *HHStA, P.A.A.* Rap. i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë, në Nish, Legatës mbretërore serbe në Romë, 12 gusht 1914.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.*

4) G. Shpuza. *Vep. për.*, f. 165.

nimi i krerëve kosovarë me kryengritësit kundër Vidit, por një Shqipëri e bashkuar rreth tij për ta hedhur në luftë kundër Serbisë. Me anë të njerëzve të saj Austro-Hungaria hapi fjalë se gjoja kryengritësit ishin të lidhur me serbët dhe u kishin ngritur kurthe krerëve kosovarë¹. Mundet që Isa Boletini e Bajram Curri t'u kenë zënë besë njoftimeve të rreme të Austro-Hungarisë dhe iu shmangën takimit të drejtpërdrejtë me kryengritësit. Ata dërguan atje Mehmet pashë Derrallën dhe dr. I. Temon e dy durrsakë të tjerë me të cilët kryengritësit nuk pranuan të hynin në bisedime². Isa Boletini nuk hyri në lidhje me kryengritësit ndoshta, sepse i kishte dhënë fjalën Vidit se do ta mbronte atë deri në fund. Një mendim të tillë e mbështet edhe fakti që Isa Boletini qëndroi në Durrës derisa Vidi u largua nga Shqipëria.

Mungesa e bashkërendimit dhe e bashkëveprimit midis forcave atdhetare duhet kërkuar së pari në mungesën e një qendre të vetme udhëheqëse të organizuar që, aq më shumë në ato rrethana aq të ndërlikuara, të jashtme e të brendshme, ishte e domosdoshme. Prandaj ato u gjetën të përçara, pa unitet mendimi dhe veprimi.

Mbas përpjekjesh të pasuksesshme për t'u lidhur me kryengritësit, krerët kosovarë vendosën të ndërmerrnin vetë një aksion të tillë. Në fund të korrikut një pjesë e malësorëve kosovarë, midis tyre edhe Hasan Prishtina, u nisën nga Durrësi në drejtim të Shkodrës prej ku do të niseshin për në Kosovë³. Në këtë grup ndodhej edhe Tafil Boletini, nipi i Isait⁴.

Politika shkombëtarizuese që ndiqej nga qeveria e Beogradit, terrori dhe masakrat që ushtronte ajo në Kosovë e krahina të tjera, e kishin detyruar popullsinë

1) *HHStA, P.A.A.* Konsulli a-h në Shkodër, Vjenës, 6 gusht 1914.

2) *Po aty.*

3) *Po aty.* Rel. i MPJ-së së Serbisë në Nish, Ministrisë së Luftës, 28.7.1914.

4) *Dokumenti o spolnoj politici...*, dok. 221, knjiga VII, Sveska 2. Beograd, 1980, f. 354-355.

shqiptare të shpërngulej në masë në Turqi dhe në vende të tjera të Evropës. Shtimi i kolonëve serbë në krahinat shqiptare e shqetësonte, pa masë Isa Boletinin, prandaj, ai e porositi Tafilin t'u kundërviheshin kësaj politike shoviniste të Beogradit, të propagandonte në krahinën e tyre (Mitrovicën — F.M.) kundër shpërnguljes në Turqi e vende të tjera. Të përballojnë të gjitha vështirësitë qoftë edhe duke u varfëruar në truallin e tyre, — theksonte Isai, — duke i qëndruar kështu qytetarë të zgjuar dhe besnikë vendit të vet, pasi në Turqi, nuk do të gjejnë ujë, klimë dhe bukuri si në Mitrovicë¹.

Përpjekjet e Isa Boletinit dhe të krerëve të tjerë për kryengritje në Kosovë, e vunë në lëvizje konsullin serb në Durrës. Qarqet serbe ndiqnin me shqetësim lëvizjen e kosovarëve dhe sidomos takimet e tyre me konsullin e atjeshëm austro-hungarez. Duke pasur dhe përkrahjen e përfaqësuesit të Rusisë në KNK Petrajev, serbët ndërhyjnë pranë Qeverisë së Durrësit dhe i kërkuan Turhan pashës të ndalonte ekspeditën e «aventurierëve» të Kosovës, si dhe të sekuestronte gjithë armatimin dhe lëndët eksplozive që malësorët kishin marrë me vete nga Durrësi në Shkodër².

Ndërkohë, pozitat e Qeverisë së Durrësit u bënë edhe më të lëkundshme. Kryengritësit, pasi hynë në Vlorë, iu drejtuan Durrësit me forca të përqëndruara. Mbi Vidin po bënin presion gjithnjë më të madh dy fuqitë imperialiste të Adriatikut e në mënyrë të veçantë Austro-Hungaria, e cila, e bindur se Vidi qe gjithsesi i përshtatshëm për të hedhur shtetin shqiptar në luftë kundër Serbisë, e braktisi atë duke i hequr atij të vetmen mbështetje të jashtme³. Duke mos mundur t'u bënte ballë vështirësive që iu krijuan, princ Vidi u largua nga Shqipëria më 3 shtator 1914.

1) *Po aty*.

2) *HHStA, P.A.A.* Rap. i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë në Nish, Legatës serbe në Romë, 12 gusht 1914.

3) *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Tiranë, 1984, f. 144.

Mbas largimit të Vidit, Isa Boletini. Bajram Curri dhe ajo pjesë e kosovarëve që ishin në Durrës, u larguan për në Lezhë dhe mbas disa ditësh, u nisën për në krahinën e Hasit, ku mbërritën në javën e parë të shtatorit.¹ I detyruar nga sëmundja Isa Boletini qëndroi në Krumë deri në fund të muajit tetor, ndërsa Bajram Curri e Hasan Prishtina, vijuan përpjekjet për mobilizimin e forcave për kryengritje. Nga ana e vet, Vjena u bënte thirrje krerëve kosovarë për të hyrë sa më parë në luftë me Serbinë, pavarisisht se ata ishin të papërgatitur. Austro-Hungaria synonte kështu t'i hidhte sa më shpejt shqiptarët kundër Serbisë dhe të lehtësonin në këtë mënyrë luftën e saj.

Krerët shqiptarë e gjykuan si më të drejtë të fillonin kryengritjen kundër Serbisë në rast se arrihej fitorja e Austro-Hungarisë kundër saj. Në përgjigjen që Bajram Curri i dha konsullit a-h në Shkodër Halla i bënte të ditur se ata do të fillonin kryengritjen kur trupat austro-hungareze të kishin arritur në Mitrovicë². Me gjithë përpjekjet e tyre për të mobilizuar masat popullore në zonat kufitare, I. Boletini, H. Prishtina, B. Curri nuk mundën të organizonin një kryengritje anti-serbe në Kosovë. Masat e marra nga Serbia në kufirin me Shqipërinë ua bënë atyre të pamundur depërtimin në krahinat e saj.

Por disfatat që pësuan forcat austro-hungareze në frontin me Serbinë, larguan çdo perspektivë për një kryengritje shqiptare kundër Serbisë, e cila rriti përqëndri-

1) *HHStA, P.A.A.* Rap. nr. 102. Ministria e PJ të Serbisë në Nish. Ministrisë së Luftës të Serbisë, 5.9.1914; *AQSH*. Fondi nr. 74, dosja nr. 4, Isa Boletini u strehua në shtëpinë e Dervish Pekës, ndërsa B. Curri në familjen e Sadik Didës, Isai qëndroi aty 1 muaj i sëmurë rëndë. (Vuante shumë nga stomaku, si dhe pasojat që i kishte lënë sëmundja e malarjes).

2) *Po aty*. Tel. 4952 i konsullit Halla në Shkodër, Vjenës, 5 dhjetor 1914; Tel. 1004 i konsullit Halla në Shkup, Vjenës, 1 tetor 1914.

min e forcave në kufi me Shqipërinë. Në të njëjtën kohë, qeveria serbe u përpoq të hidhte kundër Isa Boletinit dhe krerëve të tjerë kosovarë forcat e reaksionit të brendshëm të kryesuara nga Esad pashë Toptani¹.

Megjithëse i bllokuar nga forcat kryengritëse të Shqipërisë së Mesme, Esadi nuk qëndroi pasiv ndaj kërkesës së qeverisë serbe. Ai aktivizoi kundër Isa Boletinit, Bajram Currit e Hasan Prishtinës një nga bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, Ceno bej Kryeziu. Në bashkëpunim me forcat malazeze Ceno bej Kryeziu në nëntor 1914, sulmoi Hasin për të asgjësuar Isa Boletinin dhe krerët e tjerë².

I ndjekur nga forcat e reaksionit, Isa Boletini së bashku me 150 veta kaloi nga fshati Gjinaj në Krumë³ dhe prej andej, në Kolmekaj të Krasniqes. Meqenëse sëmundja iu rëndua shumë ai qëndroi aty deri në maj 1915⁴. Në Krasniqe, Isa Boletini e demaskoi veprimtarinë antishqiptare të Esad pashë Toptanit, duke iu kundërvënë në këtë mënyrë propagandës esadiste të zhvilluar nga njerëzit e Esadit. Për këtë qëllim Isai mundi të organizonte rreth vetes edhe një parti (grup simpatizantësh të vet)⁵.

Në çdo vatër fshatare Isai u prit bujarisht. «Këtë nder e njerëzi burrërore e patriotike të malësisë së Gjakovës dhe të Hasit, — kujtonte Tafil Boletini, — ne kosovarët kurrë s'kemi me i harrue»⁶.

1) Në fillim të Luftës I Botërore, duke parashikuar fundin e sundimit të Vidit në Shqipëri, Esad pashë Toptani ishte nisur nga Italia dhe pas një qëndrimi të shkurtër në Athinë arriti në Nish ku ndodhej qeveria serbe. Me përkrahjen e serbëve dhe të Greqisë, si dhe me ndihmën e forcave reaksionare brenda vendit, u shpall kryetar i «Këshillit të Përgjithshëm» dhe komandant i ushtrisë.

2) AQSH. Fondi 74, dosja nr. 4.

3) *Po aty*.

4) *Po aty*.

5) HHStA, P.A.A. Rap. i konsullit a-h në Shkodër, ministrit të Punëve të Jashtme Bertold, Vjenë, 5 dhjetor 1914.

6) S. Luarasi. *Vep. e përm.*, f. 214.

Vazhdimi i mëtejshëm i Luftës I Botërore e keqësoi më tepër gjendjen e shtetit shqiptar. Pushtimi i Vlorës nga Italia në dhjetor 1914, nënshkrimi i Traktatit të fshehtë të Londrës në prill 1915 dhe hyrja e Italisë në luftë përkrah shteteve të Antantës, vunë në lëvizje qarqet shoviniste serbe për të dalë në detin Adriatik dhe ato malazeze për të pushtuar Shkodrën. Kështu, trupat serbe në fund të majit 1915 nga Prizreni, Ohri e Dibra hynë në Shqipërinë e Mesme dhe shtypën kryengritjen fshatare duke i ardhur në ndihmë agjentit të tyre Esad pashë Toptanit¹. Ndërsa trupat malazeze më 8 qershor kaluan kufirin dhe të ndarë në dy kolona, u nisën në drejtim të Gucisë dhe Gjakovës.

Në këto kushte Isa Boletini u detyrua të linte Krasniqen dhe të zbriste në Shkodër. Gjendja e tij ekonomike ishte tepër e vështirë. Gjithçka që kishte pasur ai e kishte vënë në shërbim të interesave të luftës për liri e pavarësi. Përveç disa të hollave, me të cilat nuk mund të përballonte as shpenzimet për nevojat e përditshme, atij nuk i kishte mbetur asgjë.

Në Shkodër Isa Boletini u vendos në hotel «Parruca». Gjendja e tij shëndetsore keqësohej nga dita në ditë². Edhe më të rëndë e bëri gjendjen e Isa Boletinit e të bashkëluftëtarëve që e shoqëronin, rrethimi i Shkodrës nga forcat malazeze.

Në ato rrethana të vështira duhej gjetur rrugëdalje për të mos rënë në dorë të malazezve. Siç kujton Tafil Boletini, Isai vendosi të hynte në lidhje me konsullatën angleze e të kërkonte atje strehim. Me sa duket atje nuk gjeti njeri dhe më 23 qershor 1915 iu drejtua nënkonsullit francez në Shkodër dhe i kërkoi që ta ndihmonte për t'u larguar në një vend asnjanes, ose të ndërhynte pranë Malit të Zi e Serbisë, për t'u kthyer pranë

1) *Historia e Shqipërisë*, Vëll. III, Tiranë, 1984, f. 165.

2) A. Mitroviç. *Srbija u prvom svetskom raty*. Beograd, 1984, f. 261.

familjes në Mitrovicë¹. Në rast se Isait nuk do t'i plotësoheshin këto kërkesa, ai kishte vendosur, — shkruante konsulli francez në Shkodër, — të largohej natën nga Shkodra dhe me çdo sakrificë të hapte shtigje midis forcave malazeze².

Pushtimi i Shkodrës më 27 qershor e gjeti Isa Boletinin në konsullatën franceze. Shovinizmi i tërbuar serbo-malazez u shoqërua me ndjekje, vrasje, internime të veprimtarëve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare si të Mustafa Qullit, Çerçiz Topullit, Mehmet Shpendit etj. Vëmendje të veçantë ata i kushtuan edhe Isa Boletinit. Gjeneral Veshoviçi, i njoftuar nga angjentët e tij në Shkodër për vendndodhjen e Isait, e vëzhgonte konsullatën franceze për të mos humbur gjurmët e tij. Kërkesa e Isait për ndihmë dhe strehim në konsullatën franceze ishte një besim i tepruar i Isait ndaj kësaj përfaqësie konsullore, qeveria e së cilës kishte qenë e ishte mbështetje e flaktë e politikës serbo-malazeze në Shqipëri. Nuk kaluan shumë ditë dhe nënkonsulli francez e tradhtoi Isa Boletinin, duke ia dorëzuar atë Malit të Zi. «Pabesia, — ka theksuar shoku Enver Hoxha, — u qëndronte kurdoherë e fshehur prapa krahëve luftëtarëve të mëdhenj shqiptarë»³. Këtë e vërtetoi edhe rrjedha e ngjarjeve të mëvonshme.

Përfaqësuesi i Francës në Shkodër i propozoi Isa Boletinit të kalonte në Cetinë nga ku konsulli i atjeshëm francez mund ta përcillte më me lehtësi atë dhe njerëzit e tij në një vend asnjanes⁴.

Isa Boletini, që tashmë e kuptoi pabesinë e nënkonsullit francez iu përgjigj: «rrugën për në Cetinjë e kam ditur qysh moti, kur më luteshin (malazetë — F.

1) AMAE, Tel. 198 i Ministrit të Francës në Cetinë, Cetinë, 30 qershor 1915.

